

Hernando de Soto është President i Institutit për Liri e Demokraci (ILD), me seli në Peru dhe i konsideruar nga *The Economist* si institucioni i dytë studimor më i rëndësishëm në botë. Kohët e fundit ai u rendit nga revista *Time* si një nga pesë novatorët më të mëdhenj Latino-Amerikanë të shekullit të njëzetë. Si Përfaqësuesi Personal dhe Këshilltari Kryesor i Presidentit të Perusë, ai inicioi reformat ekonomike dhe politike të vendit. Libri i tij i mëparshëm *Rruga Tjetër*, ishte libri numër një më i shitur në gjithë Amerikën Latine dhe në Washington D.C.

Më tepër informacion për Hernando de Soto dhe ILD mund të gjeni në www.ild.org.pe

MISTERI I KAPITALIT

Pse Kapitalizmi Triumfon Në Perëndim
Dhe Dështon Kudo Tjetër

HERNANDO DE SOTO

“Një libër tepër bindës dhe i rëndësishëm,
për më tepër për shkak të thjeshtësisë
së madhe të idesë së tij qëndrore.

Daily Telegraph

Titulli i originalit:
THE MYSTERY OF CAPITAL: Why Capitalism Triumphs in
the West and Fails Everywhere Else
Copyright © 2000, Hernando de Soto
All rights reserved

© Për përkthimin dhe botimin në gjuhën shqipe:
Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Përkthyes: Enian Çela
Redaktimi shkencor: Dritan Shutina, Indrit Faja
Redaktimi letrar: Olta Çakciri

Publikimi i këtij libri nuk bëhet për qëllime fitimi



Co-PLAN Instituti për Zhvillimin e Habitatit
Rruga Dervish Hima, Kulla ADA, Ap. 11
KP 2995, Tiranë
Tel: (04) 257809; 257808
Fax: (04) 257807
e-mail: co-plan@co-plan.org
www.co-plan.org

Grafika: CREOstd
Dizenjimi i kopertinës: Net Vizion Studio

printing  afërdita 2006

*Për Mariano Cornejo, i cili më tregoi
si të qëndroj fort me këmbë në tokë, dhe
për Dunkan Makdonald, i cili më mësoi
si të orientohem me anën e yjeve.*

PARATHËNIE

NJË KONTRIBUT PËR SHQIPËRINË

Besnik Aliaj

Kontakti im i parë me librin “Misteri i Kapitalit“ dhe teorinë e Hernando De Sotos, ka qenë në vitin 1995 teksa kryeja studimet pasuniversitare në Hollandë. Konkluzioni im atëhere ishte se librat e tij janë vepra me ide mjaft të fuqishme. Sidoqoftë, do të ishte kthimi im në Tiranë, ai që do t’i jepte kuptim në praktikë kësaj teorie të iniciuar në Amerikën Latine, por që kishte fituar respekt dhe nderim në nivel global.

Nga viti 1995-2005 së bashku me disa kolegë të mi krijuam dhe konsoliduam me mjaft sukses një përvojë të veçantë profesionale të njohur me emrin Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, gjetjet e së cilës në terren vërtetuan në mjaft aspekte dhe në mënyrë të pavarur, ato që dikur i kisha lexuar në librat e Hernando De Sotos.

Gjatë 10 viteve Co-PLAN guxoi të atakonte, ndër të tjera, edhe një nga çështjet më komplekse të tranzicionit post-komunist në Shqipëri – atë që Hernando De Soto e quan “ekstralegalitet“, një fenomen që gërryen gjithënjë e më shumë respektin për shtetin ligjor në Shqipëri dhe përjashton nga zgjidhjet e ligjshme njerëzit, sidomos ata pa përkrahje dhe ata në nevojë.

Shqipëria e sotme natyrisht ka progres në disa drejtime, por mbeten ende problematike çështjet e trashëguara të pronësisë, mungesa e sistemeve të qëndrueshme të informacionit, zhvillimi kaotik i territorit, metodat e vjetra të planifikimit dhe shkatërrimi i mjedisit, mungesa e zgjidhjeve të qëndrueshme dhe të përballeshme, etj.

Gjatë dekadës së fundit, të paktën një e treta e popullsisë së vendit, e cila ka jetuar në terrene të vështira malore, e ka braktisur mënyrën tradicionale të jetesës për t'u shpërngulur nga zonat e izoluara rurale drejt qendrave më të mëdha urbane dhe tregjeve të punës. Popullsia e Tiranës tashmë është 3-fishuar, Durrësi është 2-fishuar, Kamza dhe Fush-Kruja janë 10-fishuar, bregdeti shqiptar po përjeton sot një bum demografik, etj.

Statistikat zyrtare flasin për të paktën 270 mijë ndërtime pa leje të ndërtuara deri më sot, me një vlerë të paktën 6 miliardë US\$, ekuivalente me dyfishin e kursimeve të shqiptarëve të depozituara nëpër banka. Rreth 6-7 nga 10 objekte të ndërtuara pas vitit 1990 në Shqipëri janë ndërtuar në mënyrë ilegale/informale. Mbi 350 mijë familje shqiptare, ose më tepër se gjysma e popullsisë së vendit, zotërojnë në një mënyrë ose tjetrën, asete ekstraligjore. Tashmë është e qartë se sektori informal në vend përbën një faktor të painjorueshëm, përfshi sfera prodhuese si biznesi i vogël, transporti, tregëtia, shërbimet e ndryshme, etj.

Vetëm në një bashki në veri të Kryeqytetit, 95% e të cilës është ndërtuar në mënyrë informale pas vitit 1990, komunitetet lokale kanë investuar gjatë një dekade të paktën 100 milion US\$ për strehim, biznes dhe infrastrukturë, ndërkohë që investimet publike në mjaft raste kanë munguar dhe, në rastin më të mirë, nuk e kanë kaluar vlerën 100,000 US\$/vit.

Siç thotë Hernando De Soto, duket sikur vendi është përfshirë në një lloj 'revolucionit social-ekonomik'. Të ardhurit në periferitë e qyteteve janë aktorët më të rinj në skenën e ekonomisë së vendit. Edhe pse këta 'migrantë' të postkomunizmit jetojnë në kushte tepër të vështira dhe janë të varfër krahasuar me standartet perëndimore, ata në fakt nuk janë pa asete. Në të kundërt, mund të themi se ata përfaqësojnë sot një 'klasë të re sipërmarrësish' që (fatkeqësisht) është krijuar mbi bazën e një sistemi pronësie tërësisht informal.

Në vitin 2004-2005 personalisht vendosa të anagzhohesha në politikë dhe atë përvojë të grumbulluar në terren me Co-PLAN, t'a përdorja në mënyrë sa më efikase në politikë-bërjen dhe vendim-marrjen e vendit. Gjatë fushatës elektorale të vitit 2005 dhe më tej, jam përpjekur të spjegoj jo pa vështirësi gjetjet e Co-PLAN, të cilat mund të konsiderohen pa frikë si versioni shqiptar i mendimit të Hernando De Sotos. Ky i fundit nënvizon se këta 'sipërmarrës informalë të heshtur' sot zotërojnë 'asete ekstraligjore' të cilat përlllogariten me shifra tronditëse.

Edhe pse shumë vetë në Shqipëri i konsiderojnë këta "sipërmarrës informalë" thjesht si "hajdutë" dhe "dhunues të ligjit", për hir të vërtetës duhet nënvizuar se ata nuk dëshirojnë të jetojnë jashtë ligjit. Sepse për këta njerëz, siç thotë edhe De Soto, ekonomia e tregut dhe kapitali nuk janë 'llafe në erë' por qëllime dhe objektiva për të cilat ata sfiliten çdo ditë me ambicien për t'i realizuar. Por, ndërkaq, procedurat për të siguruar pronësinë zyrtare ligjore të një ndërtese apo të një biznesi shpesh janë mjaft të gjata, të kushtueshme, përjashtuese, burokratike, të korruptuara dhe tepër të komplikuar, duke kontribuar më shumë për zgjerimin e sektorit informal.

Në fakt, pikërisht këtu qëndron problemi edhe në Shqipëri. Ashtu siç kanë qenë deri tani ligjet, i kanë përjashtuar njerëzit! Është pikërisht ky kurth ligjor që prodhon ndjenjën e vetëpërjashtimit për mjaft njerëz të thjeshtë, të cilët çdo ditë përfundojnë në logjikën e informalitetit të një 'klase sociale të dorës së dytë'. Kjo ka ndodhur sepse deri më sot nuk është kuptuar që institucionet, sistemet dhe legjislacioni për evidentimin e bizneseve dhe të pasurive të paluajtëshme, janë thelbësore për zhvillimin dhe prosperitetin e Shqipërisë.

Nga viti 2005 kam punuar me Qeverinë Shqiptare për të sjellë në Shqipëri Hernando De Soton dhe stafin e tij të ILD-së (Instituti për Liri dhe Demokraci). Së bashku me ta dhe

me ndihmën e UNDP-së ja arritëm të ngremë një projekt të posaçëm dhe një departament “think-tank“ me synimin për të asistuar autoritetet shqiptare.

Thelbi i projektit në fjalë synon të ndërtojë një koncept për pasuritë e paluajtëshme, e cila nuk duhet të ketë të bëjë thjesht me pronësinë. Në fakt, prona është ‘arkitektura e fshehtë’ që përcakton fatin e ekonomisë së tregut edhe në Shqipëri. Pa konsoliduar këtë koncept në praktikë, përpjekjet e Shqipërisë për të krijuar një ekonomi të qëndrueshme të tregut do të jenë të destinuara të dështojnë.

Kjo bëhet edhe më thelbësore po të kuptojmë së përveç posedimit fizik të shtëpive dhe bizneseve, një pjesë e mirë e shqiptarëve sot nuk mund të gjenerojnë pasuri dhe mirëqënie, pasi asetet e tyre qëndrojnë tërësisht jashtë sistemeve ligjore, ose, në rastin më të mirë, janë regjistruar me shumë pasaktësi dhe deformime, duke krijuar probleme serioze për të ardhmen. Pronësia në Shqipëri nuk mund të jetë e pasigurtë si deri më sot! Kjo është arsyeja pse bëhet e domosdoshme një Reformë e thellë në këtë sektor.

Në të vërtetë, reforma e formalizimit të bizneseve dhe asetëve ekstraligjore, kthimi i pronave, verifikimi i identitetit të qytetarëve dhe ngritja e sistemeve të koordinuara të informacionit, janë disa nga sfidat kryesore për çdo qeveri në Shqipëri.

Vetëm në këtë mënyrë - siç nënvizon edhe Hernando De Soto - do të jemi në gjendje: (i) të verifikojmë sistematikisht adresat, që të mbledhim taksat dhe të organizojmë zgjedhje të lira; (ii) t’i përshkruajmë asetet sipas standarteve të biznesit; (iii) të detyrojmë njerëzit të paguajnë borxhet që kanë; (iv) të identifikojmë autorët e vjedhjeve dhe humbjeve financiare; (v) të përdorim ndërtesat dhe tokat për të garantuar kreditë dhe kontratat, etj.

Me pak fjalë, vetëm duke hartuar ligje realiste dhe duke themeluar institucione të qëndrueshme për pasuritë e paluajhtëshme, kapitali që kanë krijuar dhe po krijojnë shqiptarët ndër vite, mund të rikrijojë mirëqënie dhe pasuri.

Por, ndërsa përpjekjet e përbashkëta me De Soton për të dizenuar një reformë për të gjithë shqiptarët vazhdojnë sistematikisht, në shtypin shqiptar, nuk kanë munguar as disa shkrime kritike për të dhe thelbin e teorisë së tij, të rrëmuara nëpër arkivat e publikimeve të ndryshme të huaja.

Kjo dukuri është vetëm pjesë e taktikës politike të atyre që nuk dëshirojnë reformën dhe duan të ruajnë statuskuonë. Këta janë përpjekur në një mënyrë disi të sofistikuar të krijojnë një front pa asnjë bosht ideologjik ose politik, mjaft që të plotësojnë kushtin e vetëm për të penguar me çdo kusht iniciimin nga Qeveria të një prej reformave më të rëndësishme që do të ndodhë në këtë vend, që pas ndryshimeve të fillim-viteve 90-të.

Kjo hyrje nuk merr absolutisht përsipër të mbrojë as De Soton dhe as teorinë e tij, pasi kjo do të ishte mungesë e theksuar modestie. Aq më tepër, hyrja nuk merr përsipër të komentojë përpjekjet e atyre që duan të bëjnë “opozitë”, një gjë më se normale në demokraci. Sepse në të vërtetë, vepra e De Sotos tashmë flet vetë. Ajo është një nga përpjekjet më serioze që është bërë deri më sot për të ravijëzuar të ashtuquajturën “rrugë e tretë” në politikën e zhvillimit dhe progresit ekonomik, krahas teorisë së “ekonomisë së centralizuar” dhe “ekonomisë klasike të tregut”.

Është kjo një nga arsyet pse sot Hernando De Soto është konsideruar si një nga gjenitë e fundit midis klasikëve të ekonomisë që ende jeton. Dhe natyrisht, siç thotë një shprehje popullore “pema me kokrra qëllohet me gurë”. Jo rastësisht teoria e tij sot është nga më të debatuarat. Madje ekzistojnë edhe mjaft kritika të kësaj teorie, një pjesë e të cilave edhe mund

të kenë bazë. Por është me rëndësi të theksojmë se në të gjitha këto kritika askush nuk ka guxuar të hedhë poshtë thelbin e tij, se sa janë munduar t'a shikojnë atë me sy kritik në përpjekjet për t'i zhvilluar dhe përsosur më tej idetë e tij revolucionare.

Thelbi i ideve të De Sotos qëndron pikërisht tek krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të pronësisë, si një garanci për një kapitalizëm të qëndrueshëm dhe eficient, jo vetem nga pikepamja ekonomike, por edhe ajo sociale. Kritikën që i bëhen sot De Sotos pranojnë absolutisht rëndësinë e padiskutueshme të sistemit të qëndrueshëm të pronësisë, por theksojnë se qëndrueshmëria sociale dhe ekonomike shkon edhe më tej se sa garantimi i pronësisë, duke angazhuar instrumenta të tjerë social-ekonomikë.

Është kjo arsyeja që vetë De Soto ka evoluar në idetë e tij, krahasimisht me idetë e shfaqura fillisht tek veprat e tij “Rruga Tjetër” dhe “Misteri i Kapitalit”. Emancipimi i një gjeniu të tillë mund të konstatohet pikërisht tek aftësia për të parë më sy kritik veprën e tij dhe për të pranuar evoluimin. Kjo është reflektuar edhe gjatë vizitave të tij në Tiranë, ku në leksione dhe takime publike ai ka dëshmuar të jetë me tërë kuptimin e fjalës një “guru” i ekonomisë moderne të tregut të lirë.

Në të vërtetë, prezenca e De Soto-s në Shqipëri dëshmon më shumë se çdo gjë për faktin se tashmë Shqipëria ka hyrë në një fazë pjekurie zhvillimi. Përzgjedhja dhe mundësimi i asistencës së tij shënon një moment kthese jo vetëm për mentalitetin e qeverisjes, por edhe për vetë faktorin e huaj dhe asistencën teknike ndërkombëtare në Shqipëri. Pas 15 viteve tranzicion Shqipëria nuk ka më nevojë për pseudo-ekspertë që jemi mësuar t'i etiketojmë “se na mësojnë si bëhet rakia nga rrushi”, por për asistencë të mirëfilltë dhe cilësore, e cila natyrisht duhet parë gjithmonë me sy kritik, pasi edhe shqiptari më i rëndomtë e njeh më mirë situatën e vendit se sa çdo ekspert i huaj, sado i mirë që të jetë.



Vetë De Soto e ka pranuar këtë gjatë vizitës së tij të parë ku insistoi që të punojë së bashku me Qeverinë Shqiptare dhe ekspertet e saj, për të përfutur reciprokisht nga njëri tjetri. Ndaj në këtë pikë, askush nuk mund të errësojë përpjekjet e admirueshme të kësaj asistence VIP. Ndërkohë, janë të dështuara përpjekjet e mjera për t'a etiketuar De Soton, të majtë, teoricien që jeton në luks, të dështuar, jashtë realitetit, etj, edhe pse dikujt i intereson të godasë indirekt dhe politikisht reformat e formalizimit të ekonomisë. Por këtu duhet të jetë e qartë se puna që De Soto dhe ekspertët vendas po iniciojnë nuk i shërben thjesht politikës së djathtë, por çdo force politike moderne që punon për shqiptarët e thjeshtë, për interesin publik, për një Shqipëri normale.

Prandaj, nuk është cinike të rikujtojmë faktin se edhe në vendin e tij, De Soto dhe teoria e tij u kërcënuan madje deri edhe me një sërë atentatesh terroriste, vepër e grupeve ekstremiste "maoiste", ku pati edhe viktima të pafajshme. E megjithatë, idetë e Hernando De Sotos sot vazhdojnë të inspirojnë edhe përtej vendlindjes së tij, ndaj nuk ka përse ato të adoptuara në

kushtet tona të mos triumfojnë edhe përballë interesave okulte në Shqipëri. Jo më kot De Soto që në fillim ka treguar një interes specifik dhe të veçantë për nivelin e krimit të organizuar, gradën e kapjes së shtetit dhe monopolet sidomos në ndërtim, pasi këto janë armiqtë kryesorë të reformës që pritet të ndodhë, pavarësisht sulmeve dhe manipulimeve që kërkohet t'i bëhen opinionit publik.

Në përfundim, pas këtij përshkrimi më duhet të nënvizoj se askush në Shqipëri më mirë se sa Co-PLAN nuk mund të ishte entiteti më i përshtatshëm për të marrë përsipër botimin e një vepre si kjo e Hernando De Sotos, Misteri i Kapitalit. Tashmë, i shkëputur dhe në distancë nga punët e përditshme të kësaj organizate, mund të them pa modesti se historia dhe eksperiencia e Co-PLAN janë prova më e shkëlqyer se si një OJF mund të ngrejë çështjen e formalizimit të ekonomisë esktralgjore nga skutat e përbaltura të lagjeve informale të Tiranës, në nivelet më të larta të bërjes politike në Shqipëri, duke patur një impakt të madh politik dhe social.

Kjo përvojë ka shërbyer si një shtrat i shkëlqyer edhe për pasionin dhe kurajon e Enian Çela, një student i talentuar e ekonomist në Tiranë, i cili përktheu dhe shqipëroi këtë vepër të shkëlqyer nga anglishtja në shqip.

I uroj sinqerisht Hernando De Sotos, rrugëtim të mbarë në mendjet dhe zemrat e lexuesve shqiptarë, dhe një impakt sa më të madh në favor të reformave për të cilat Shqipëria ka nevojë dëshpërimisht.

PËRMBAJTJA

KREU 1

Pesë misteret e kapitalit 1

KREU 2

Misteri i humbjes së informacionit 15

KREU 3

Misteri i kapitalit 39

KREU 4

Misteri i ndërgjegjësimit politik 73

KREU 5

Mësimet e humbura të historisë së Shteteve të Bashkuara 111

KREU 6

Misteri i dështimit ligjor 163

KREU 7

Për ta përfunduar 225

Shtojca 249

Falënderime 255

Shënime 263

Indeksi 279

1

PESË MISTERET E KAPITALIT

Problemi kryesor është të zbulohet se përse ai sektor i shoqërisë së shkuar, të cilën nuk ngurroj ta quaj kapitaliste, ka ekzistuar si i mbyllur brenda në një kambanë qelqi, i ndarë nga pjesa tjetër; pse nuk qe i aftë të zgjerohet dhe të pushtojë pjesën tjetër të shoqërisë?... [Pse] pjesa më e madhe e procesit të formimit të kapitalit mund të ekzistonte vetëm në disa sektorë të caktuar dhe jo në të gjithë ekonominë e tregut të kohës? Pse kapitalizmi triumfon në perëndim dhe dështon kudo tjetër.

FERNAND BRAUDEL, “Rrotat e Tregtisë”

Çasti i triumfit të lartë të kapitalizmit është edhe çasti i krizës së tij. Rënia e Murit të Berlinit i dha fund një shekulli konkurrence politike mes kapitalizmit dhe komunizmit. Kapitalizmi qëndron i vetëm, si e vetmja mënyrë e arsyeshme për të organizuar një ekonomi moderne. Në këtë çast të historisë, asnjë komb i arsyeshëm nuk ka një mundësi zgjedhjeje. Si rezultat, vende të Botës së Tretë dhe vende ish-komuniste, në shkallë të ndryshme pëlqimi, kanë ekuilibruar buxhetet, kanë shkurtuar subvencionet, kanë mirëpritur investimet e huaja dhe kanë shkurtuar barrierat tarifore.

Përpjekjet e tyre janë shpërblyer me zhgënjim të athët. Nga Rusia në Venezuelë, gjysmëdekada e fundit ka qenë një periudhë vuajtjeje ekonomike, të ardhurash të paqëndrueshme, shqetësimi, pështjellimi; “urie, revoltash dhe grabitjesh”, sipas fjalëve thumbuese të kryeministrit malajzian, Mahathir Mohamad. Në një botim të fundit të “New York Times” thuhet: “Në pjesën më të madhe të botës, ekonomia e tregut e lavdëruar nga Perëndimi pas fitores së Luftës së Ftohtë është shoqëruar nga egërsia e tregjeve, dyshimi për sa i përket kapitalizmit dhe rreziqet e paqëndrueshmërisë”. Triumfi i kapitalizmit vetëm në Perëndim mund të jetë një recetë për katastrofa ekonomike dhe politike.

Për amerikanët që shijojnë paqen dhe përparimin, ka qenë e lehtë të shpërfillnin shqetësimet që ngjisin gjetkë. Si mund të ketë probleme kapitalizmi kur mesatarja industriale Dow Jones* po ngjitet më shpejt se Sir Edmund Hillari**? Amerikanët vështrojnë kombet e tjera dhe shohin përparim megjithëse është i ngadaltë dhe i pabarabartë. A nuk është e mundur të hahen hamburger “Big Mac” në Moskë, të merren video “Blockbuster” me qira në Shanghai dhe të përdoret interneti në Karakas?

Megjithatë, edhe në Shtetet e Bashkuara ndjenja e përgjithshme nuk mund të jetë tërësisht e ndrydhur. Amerikanët shohin Kolumbinë në gjendjen e luftës civile mes guerilasve trafikantë droge dhe milicive shtypëse, shohin një kryengritje kokëfortë në jug të Meksikës si dhe një pjesë të mirë të forcave aziatike që ushqejnë rritjen ekonomike të zhyten gjithnjë e më shumë në korrupsion dhe kaos. Në Amerikën Latine, simpatia për ekonominë e tregut po bie: mbështetja për privatizimin ka rënë nga 46 në 36 për qind të popullsisë pro që nga maji 2000.

* *Indeksi i Bursës së Nju Jorkut që përfshin çmimet e aksioneve të 35 shoqërive amerikane.*

** *Alpinist nga Uells i është ngjitur Everestit*

Për më tepër, në kombet kapitaliste ish-komuniste kanë qenë problem përmbyset prapësuese dhe shumë individë të lidhur me regjimet e vjetra aspirojnë të kthehen në pushtet. Disa amerikanë ndiejnë se një arsye për zhvillimin e madh të tyre gjatë dhjetëvjeçarit ka qenë fakti se, sa më e dobët është pjesa tjetër e botës, aq më tërheqëse bëhen aksionet dhe bonot amerikane, të cilat përbëjnë parajsën për kapitalin ndërkombëtar.

Në bashkësinë afariste të Perëndimit, ekziston shqetësimi i madh se dështimi i zbatimit të kapitalizmit në pjesën tjetër të botës do të çojë në rënie të ekonomive të tyre. Ashtu sikurse kanë zbuluar miliona investitorë nga përtharja e fondeve të tyre në tregjet në zhvillim, globalizimi është një thikë me dy presa: nëse Bota e Tretë dhe vendet ish-komuniste nuk mund t'i largohen ndikimit të Perëndimit, as Perëndimi nuk mund të shkëputet prej tyre. Reagimet negative ndaj kapitalizmit janë theksuar shumë edhe brenda vendeve të pasura. Protestat në Siatëll gjatë takimit të “Organizatës Botërore të Tregtisë” në dhjetor 1999 dhe, disa muaj më vonë, gjatë takimit të FMN/Banka Botërore në Uashington, pavarësisht nga format, kanë theksuar urrejtjen që nxit përhapja e kapitalizmit. Shumë kanë kujtuar paralajmërimet e historianit ekonomik Karl Polanyi, i cili thoshte se tregjet e lira mund të përplasen me shoqërinë dhe të çojnë në fashizëm. Japonia po përballet me krizën më të zgjatur ekonomike që nga Depresioni i Madh. Evropianët perëndimorë votojnë për ata politikanë që premtojnë një “rrugë të tretë”, e cila hedh poshtë atë që një autor francez e ka quajtur “L’Horreur économique”*.

Këto sirena alarmi, megjithëse janë shqetësuese, vetëm sa kanë bërë që udhëheqësit amerikanë dhe evropianë t’i përsërisin pjesës tjetër të botës të njëjtin moral të mërzitshëm: stabilizoni

* *Tmerri Ekonomik*

monedhën, mbahuni fort, shpërfillni protestat me domate dhe prisni me durim që të kthehen investitorët e huaj.

Sigurisht, investimi i huaj është një gjë shumë e mirë. Sa më shumë, aq më mirë. Edhe monedhat e qëndrueshme janë gjë e mirë, ashtu sikurse tregtia e lirë dhe praktikat transparente bankare, po ashtu edhe privatizimi i industrive të zotëruara nga shteti dhe çdo ilaç tjetër i farmaceutikës perëndimore. E megjithatë, vazhdojmë të harrojmë se kapitalizmi global është provuar edhe më parë. Për shembull, në Amerikën Latine reformat me qëllim krijimin e sistemeve kapitaliste janë zbatuar të paktën katër herë që nga sigurimi i pavarësisë nga zgjedha spanjolle në vitet 20 të shekullit të 19-të. Në çdo rast, pas euforisë fillestare, amerikano-latinët tërhiqeshin nga politikat e kapitalizmit dhe të ekonomisë së tregut. Këto ilaçe me sa duket nuk mjaftojnë. Me të vërtetë, ato janë kaq të pandjeshme saqë mund të quhen të papërfillshme.

Kur këto ilaçe nuk japin efekt, perëndimorët shpesh përgjigjen jo duke analizuar zbatueshmërinë e praktikave, por duke fajësuar popujt e Botës së Tretë për mungesë shpirti sipërmarrës apo orientimi ndaj tregut. Nëse ata nuk kanë arritur të përparojnë me gjithë këshillat e shkëlqyera, kjo ka ndodhur për probleme të tyre vetjake: ata nuk arritën dot Reformimin Protestant, janë gjymtuar nga shkërmoqja e trashëgimisë koloniale evropiane, ose niveli i inteligjencës së tyre është tepër i ulët. Por, supozimi se kultura është burimi i suksesit të vendeve të tilla si Japonia, Zvicra dhe Kalifornia, si dhe i varfërisë relative në vende të tilla si Kina, Estonia dhe Baja Kalifornia, është më tepër se çnjerëzor; është jo bindës. Pabarazia e pasurisë mes Perëndimit dhe pjesës tjetër të botës është tepër e madhe për t'u shpjeguar vetëm me anë të kulturës. Shumica e njerëzve dëshirojnë frytet e kapitalit – që nga djemtë e Sançezit deri te ata të Hrushovit të gjithë po dynden të shkojnë në kombet Perëndimore.

Qytetet e Botës së Tretë dhe vendet e tjera ish-komuniste janë të tejmbushura me sipërmarrës. Nuk mund të ecësh në tregjet e Lindjes së Mesme, nuk mund të ngjitesh në fshatrat e Amerikës Latine dhe nuk mund të hysh në një taksi në Moskë pa takuar dikë që të propozon një marrëveshje. Banorët e këtyre vendeve zotërojnë talent, entuziazëm dhe një aftësi marramendëse për të nxjerrë fitim nga asgjëja. Ata mund të sigurojnë dhe të përdorin teknologji moderne. Përndryshe, bizneset amerikane nuk do të luftonin për të kontrolluar përdorimin e paautorizuar të patentave të tyre jashtë vendit dhe qeveria amerikane nuk do të përpiquej aq fort për të mbajtur armët e teknologjisë së fundit larg nga duart e vendeve të Botës së Tretë. Tregjet janë një traditë e vjetër dhe e përgjithshme: Krishti largoi tregtarët nga tempulli 2000 vjet më parë dhe meksikanët dërgonin produktet e tyre nëpër tregje shumë kohë para se Kolombi të zbulonte Amerikën.

Por, nëse banorët e vendeve tranzitore të kapitalizmit nuk janë lypsarë, nuk janë të kapur fort pas metodave të vjetruara dhe nuk janë të burgosur jokritikë të kulturave jofunksionale, çfarë e ndalon kapitalizmin t'u japë atyre të njëjtën pasuri që i ka dhënë Perëndimit? Pse kapitalizmi triumfon vetëm në Perëndim dhe është i mbyllur si në një kambanë qelqi?

Në këtë libër kërkohet të paraqes se pengesa më madhe që e ndalon pjesën tjetër të botës që të përfitojë nga kapitalizmi është paaftësia për të prodhuar kapital. Kapitali është forca që rrit prodhueshmërinë e fuqisë punëtore dhe krijon mirëqenien e kombeve. Është gjaku jetësor i sistemit kapitalist, themeli i zhvillimit dhe një gjë të cilën vendet e varfra të botës duket se nuk janë në gjendje ta prodhojnë vetë, pavarësisht nga angazhimi i banorëve të tyre në aktivitete të tjera që karakterizojnë ekonominë kapitaliste.

Po ashtu, do të paraqes, me ndihmën e fakteve dhe ilustrimeve që grupi im kërkues dhe unë kemi mbledhur lagje më lagje e fermë më fermë në Azi, Afrikë, Lindjen e Mesme dhe Amerikën Latine, se shumica e të varfërve zotërojnë tashmë të gjitha asetet me vlerë që u nevojiten për të pasur sukses në kapitalizëm. Edhe në vendet më të varfra, të varfrit kursejnë. Vlera e kursimeve të të varfërve është shumë e madhe – 40 herë më e madhe se ndihma ekonomike e huaj që ka siguruar bota që prej 1945. Për shembull, në Egjipt pasuria e grumbulluar nga të varfrit është 45 herë më e lartë se investimet e huaja direkte të të gjitha kohërave të marra bashkë, duke përfshirë Kanalin e Suezit dhe Digën Asuan. Në Haiti, në kombin më të varfër të Amerikës Latine, asetet totale të të varfërve janë 150 herë më të larta se të gjitha investimet e huaja që Haiti ka marrë që nga sigurimi i pavarësisë nga Franca më 1804. Nëse Shtetet e Bashkuara do të rritnin buxhetin e ndihmës së huaj në nivelin e rekomanduar nga Kombet e Bashkuara – 0.7 % të të ardhurave kombëtare – vendit më të pasur në botë do t'i duheshin 150 vjet për t'u dhënë vendeve të varfra një transfertë të barabartë me kursimet që ata disponojnë tani.

Por, këto vende i ruajnë kursimet në forma deficitare: ndërtojnë shtëpi mbi toka, pronësia e të cilave nuk është përcaktuar qartë, krijojnë biznese jokorporative me përgjegjësi të papërcaktuar, vendosin industrinë në vende ku financierët dhe investorët nuk mund t'i shohin. Meqenëse të drejtat për këto pronësi nuk janë të regjistruara rregullisht, këto asete nuk mund të kthehen menjëherë në kapital, nuk mund të tregtohen jashtë qarqeve të ngushta vendore ku njerëzit njihen dhe i besojnë njëri-tjetrit, nuk mund të përdoren si peng për të marrë hua dhe nuk mund të përdoren për blerje aksionesh investuese.

Nga ana tjetër, në Perëndim, çdo parcelë toke, çdo ndërtesë, çdo pajisje, çdo stok inventari përfaqësohet me një dokument pronësie që është shenja e dallueshme e një procesi të gjerë të padukshëm që lidh të gjitha këto asete me pjesën tjetër të ekonomisë. Falë këtij procesi përfaqësimi, asetet mund të drejtojnë një jetë të padukshme paralele së bashku me ekzistencën materiale. Ato mund të përdoren si peng për të marrë hua. Burimi më i rëndësishëm i fondeve për bizneset e reja në Shtetet e Bashkuara është hipoteka mbi shtëpinë e sipërmarrësit. Këto asete mund të krijojnë edhe një lidhje me historinë kreditore të pronarit, një adresë të verifikueshme për grumbullimin e detyrimeve dhe tatimeve, themelin e krijimit të ndërmarrjeve të shërbimeve bazë publike të sigurta dhe universale dhe një gur themeli për krijimin e instrumenteve të garancisë financiare të investimeve (si për shembull, instrumentet e borxhit - obligacionet - me garanci hipotekare) që mund të riskontohen dhe të shiten në tregjet dytësore. Nëpërmjet këtij procesi, Perëndimi u jep jetë këtyre aseteve duke i bërë që të prodhojnë kapital.

Vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste nuk e zotërojnë këtë proces përfaqësimi. Si rezultat, shumë prej tyre janë me deficit kapitali, ashtu sikundër një firmë ka deficit kapitali kur lëshon më tepër pasive se sa mund ta lejojnë të ardhurat dhe asetet e saj. Sipërmarrjet e të varfërve janë shumë të ngjashme me korporatat që nuk mund të lëshojnë aksione ose bono për të siguruar investime dhe financa të reja. Pa përfaqësim, asetet e tyre janë kapital i vdekur.

Banorët e varfër të këtyre vendeve - që përbëjnë 5/6 e njerëzimit - zotërojnë sende, por u mungon procesi që mundëson përfaqësimin e pasurisë dhe krijimin e kapitalit. Ata zotërojnë shtëpi por jo tituj; zotërojnë të korra por jo certifikatë pronësie; biznese por jo statute korporative. Pamundësia për

të siguruar përfaqësim të qenësishëm është arsyeja pse këta njerëz, që kanë siguruar çdo gjë të prodhuar nga Perëndimi, prej kapëses së letrës e deri te reaktorët bërthamorë, nuk kanë qenë të aftë të prodhojnë kapital të mjaftueshëm për të vënë në punë kapitalizmin e tyre vendas.

Ky është misteri i kapitalit. Zgjidhja e tij përfshin kuptimin e arsyes se përse Perëndimorët, duke përfaqësuar asetet e tyre me tituj, janë të aftë të shohin dhe të nxjerrin kapital prej tyre. Një nga sfidat më të mëdha për mendjen njerëzore është të kuptohen dhe të sigurohen ato gjëra që e dimë që ekzistojnë, por nuk mund t'i shohim. Jo çdo gjë reale dhe e nevojshme është e prekshme dhe e dukshme. Për shembull, koha është reale, por mund të shprehet me sukses vetëm nëse disponohet ora apo kalendari. Përmes historisë, qeniet njerëzore kanë shpikur sisteme përfaqësimi – shkrim, nota muzikore, kontabilitet me regjistrim të dyfishtë – për të kapur me mendje atë që nuk mund të kapet nga duart. Në të njëjtën mënyrë, praktikuesit e mëdhenj të kapitalizmit, që nga krijuesit e sistemit të integruar të titujve e aksioneve korporative deri te Michael Milkin, kanë qenë të aftë të zbulojnë dhe të nxjerrin kapital në vende ku të tjerët panë vetëm hekurishte, duke vijëzuar mënyra të reja për të përfaqësuar potencialin e dukshëm që mbyllet në asetet që grumbullojmë.

Në këtë çast jeni të rrethuar nga valë të tëra televizive ukrainase, kineze dhe braziliane që nuk mund t'i shihni. Kështu, pra, jeni të rrethuar edhe nga asete që mbyllin në mënyrë të padukshme kapital. Ashtu sikurse valët televizive ukrainase janë tepër të dobëta për t'i ndier, por mund të drejtohen, të regjistrohen dhe të dëgjohen përmes zotërimit të një aparati televiziv, ashtu edhe kapitali mund të nxirret dhe të përpunohet nga asetet. Por, vetëm Perëndimi zotëron procesin e konvertimit që nevojitet për të shndërruar të padukshmen në të dukshme. Kjo pabarazi

shpjegon pse kombet perëndimore mund të krijojnë kapital dhe pse vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste nuk janë në gjendje ta bëjnë këtë.

Mungesa e këtij procesi në rajonet më të varfra të botës – ku banojnë 2/3 e njerëzimit – nuk është pasojë e ndonjë konspirimi monopolistik perëndimor. Por, perëndimorët e marrin kaq për të mirëqenë këtë mekanizëm, sa që e kanë humbur vetëdijen se ai ekziston. Megjithëse sistemi është i madh, askush nuk e sheh këtë, përfshirë këtu amerikanët, evropianët dhe japonezët, të cilët pasurinë që kanë e sigurojnë përmes aftësisë së tyre për të përdorur këtë sistem. Është një infrastrukturë ligjore e nënkuptuar, e zhytur thellë brenda sistemit të tyre pronësor – ku pronësia është veç maja e ajsbergut. Pjesa tjetër e ajsbergut është një proces i ndërlikuar artizanal që mund të shndërrojë asetet dhe fuqinë punëtore në kapital. Ky proces nuk ka lindur nga librat teorikë dhe nuk përshkruhet përmes një shpjguesi me lustër. Filledat e tij janë të fshehta dhe rëndësia e tij është varrosur në ndërjegjen ekonomike të kombeve kapitaliste perëndimore.

Si ka mundësi që një gjë kaq e rëndësishme t'i ketë shpëtuar mendjes sonë? Nuk është e pazakontë që ne të dimë të përdorim gjërat pa kuptuar se përse funksionojnë ato. Marinarët përdornin busulla magnetike shumë kohë para se të paraqitej një teori e kënaqshme për magnetizmin. Rritësit e kafshëve kishin njohuri praktike në lidhje me fushën gjenetike shumë kohë para se Gregor Mendel të shpjegonte parimet e gjenetikës. Edhe pse Perëndimi përparon në saje të bollëkut të kapitalit, a e njohin njerëzit realisht origjinën e kapitalit? Nëse jo, ekziston gjithnjë mundësia që Perëndimi të dëmtojë burimin e fuqisë së tij. Qartësimi i zanafillës së burimit të kapitalit do të përgatisë Perëndimin që të mbrojë veten dhe pjesën tjetër të botës në çastin kur përparimi t'i lërë vendin krizës, e cila është

e sigurt se do të vijë. Atëherë pyetja që lind gjithmonë gjatë krizave ndërkombëtare do të ngrihet përsëri: “Paratë e kujt do të përdoren për të zgjidhur problemin?”

Deri tani, vendet perëndimore e kanë pasur të lehtë ta marrin për të mirëqenë sistemin e prodhimit të kapitalit pa u merakosur për të dokumentuar historinë e tij. Kjo histori duhet të zbulohet. Ky libër është një qëllim për të rihapur zbulimet në lidhje me burimin e kapitalit dhe për të shpjeguar se si do të korrighohen problemet ekonomike të vendeve të varfra. Këto probleme nuk kanë lidhje me mangësitë në trashëgiminë kulturore dhe gjenetike. A do të konceptoheshin ndonjëherë ngjashmëri “kulturore” mes amerikano-latinëve dhe rusëve? Megjithatë, në dhjetëvjeçarin e fundit, kur dy rajonet u përpoqën të ndërtonin kapitalizmin pa kapital, ata kanë pasur të njëjtat probleme politike, shoqërore dhe ekonomike: pabarazi të flakta, ekonomi informale, organizata mafioze të fuqishme, paqëndrueshmëri politike, largim të kapitalit, shpërfillje flagrante të ligjit. Këto probleme nuk lindën në manastiret e Kishës Ortodokse ose përgjatë rrugëve të inkasve*.

Por, nuk kanë qenë vetëm vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste që kanë vuajtur nga të tilla probleme. Kjo gjë ka vlejtur për Shtetet e Bashkuara më 1783, kur presidenti George Washington u ankua në lidhje me “banditët... që përvetësonin dhe korruptonin ajkën e vendit në kurriz të shumicës”. Këta “banditë” ishin pushtues tokash dhe sipërmarrës të vegjël të paligjshëm që zinin toka që nuk ishin të tyre. Për njëqind vjetët që pasuan, këta zaptues luftuan për të drejtat ligjore të tokës ndërsa minatorët vërshuan me deklarata pronësie për minierat për faktin se ligjet e pronës ndryshonin nga një qytet në tjetrin dhe nga një kamp punëtor në tjetrin. Zbatimi i të drejtave të pronësisë krijoi një qorrsokak të tillë paqëndrueshmërie dhe

**Banorët vendas të Amerikës Qendrore dhe Jugore*

antagonizmi shoqëror përmes Shteteve të Bashkuara (komb i ri), saqë Kryetari i Gjykatës së Lartë, Joseph Story, pyeti veten më 1820 nëse avokatët do të mund ta zgjidhnin këtë çështje.

A ju tingëllojnë të njohur zaptuesit, banditët dhe shpërfillësit flagrantë të ligjit? Amerikanët dhe evropianët u kanë përmendur vendeve të tjera: “Ju duhet të na ngjani ne”. Në fakt, ata ngjajnë me Shtetet e Bashkuara të një shekulli më parë, kur ky komb ishte në zhvillim e sipër. Politikanët perëndimorë janë ballafaquar dikur me të njëjtat sfida dramatike me të cilat drejtuesit e vendeve ish-komuniste po ballafaqohen sot. Por, pasardhësit e tyre kanë humbur lidhjet me ditët kur pionierët që hapën Perëndimin Amerikan ishin të pakapitalizuar sepse nuk zotëronin tituj për tokat ku vendoseshin dhe mallrat që kishin, në kohën kur Adam Smithi blinte në tregjet e zeza e kur xhepistët e rrugëve angleze vidhnin nga xhepat e turistëve hokatarë që shëtitnin pranë brigjeve të Tamizit, kur teknokratët Jean Baptist Colbert ekzekutonin 16,000 sipërmarrës të vegjël, krimi i vetëm i të cilëve ishte prodhimi dhe importimi i veshjeve të pambukta në kundërshtim me kodin industrial të Francës.

Kjo e kaluar është e tashme për shumë kombe. Kombet perëndimore i kanë integruar aq mirë të varfrit në ekonomitë e tyre, saqë nuk mbajnë mend si bëhet kjo, si ka nisur krijimi i kapitalit në atë kohë kur, sikurse ka shkruar historiani amerikan Gordon Wood: “diçka monumentale po ndodhte në shoqëri dhe kulturë, një gjë e cila ka zgjidhur aspiratat dhe energjitë e njerëzve të zakonshëm si kurrë ndonjëherë në historinë amerikane”¹. “Gjëja monumentale” ishte fakti se amerikanët dhe evropianët ishin në prag të krijimit të një ligji të gjerë zyrtar të pronësisë dhe zbulimit të një procesi konvertimi në këtë ligj, i cili do t’i lejonte të krijonin kapital. Ky ishte çasti kur Perëndimi kaloi kufirin e moskthimit që çonte në kapitalizëm të suksesshëm – kur nuk

ishte më një klub privat por një kulturë e gjerë kombëtare, ku “banditët” e urryer të George Washington u shndërruan në pionierët e dashur që lartësohen sot nga kultura amerikane.

* * *

Paradoksi është po aq i qartë sa edhe i turbullt: kapitali, përbërësi më thelbësor i përparimit ekonomik të perëndimit, është edhe ai që ka tërhequr më pak vëmendjen. Lënia pas dore e ka zhytur në mister – në fakt në një seri prej 5 misteresh.

Misteri i humbjes së informacionit

Organizatat e bimirësisë e kanë theksuar aq shumë varfërinë dhe mungesën e shpresës së të varfërve të botës, sa që askush nuk e ka dokumentuar siç duhet aftësinë e tyre për të grumbulluar asete. Gjatë pesë viteve të shkuar, unë së bashku me 100 kolegë të tjerë nga 6 kombe të ndryshme, kemi mbyllur librat dhe kemi hapur sytë – dhe kemi shkuar në rrugët dhe fshatrat e katër kontinenteve për të vlerësuar se sa ka kursyer sektori më i varfër i shoqërisë. Sasia është e stërmadhe. Por pjesa më e madhe është kapital i vdekur.

Misteri i Kapitalit

Ky është misteri kyç dhe boshti qendror i librit. Kapitali është një subjekt që ka mahnitur mendimtarët për tre shekujt e kaluar. Marksi ka thënë se duhet të shkosh përtej fizikës për të prekur “pulën që nxjerr vezën e artë”; Adam Smith ndiente se duhej krijuar “një lloj shtegu ajror” për të arritur te ajo pulë. Por askush nuk na ka thënë ku fshihet pula. Çfarë është kapitali, si prodhohet dhe si lidhet me paranë?

Misteri i Ndërgjegjshmërisë Politike

Nëse ka qaq shumë kapital të vdekur në botë dhe në duart e kaq shumë njerëzve të varfër, pse qeveritë nuk janë përpjekur të tërheqin këtë pasuri potenciale? Thjesht sepse provat për të cilat kishin nevojë janë bërë të dukshme vetëm në 40 vitet e shkuara, teksa miliarda banorë të botës kaluan nga jeta e organizuar në shkallë të ngushtë, në një jetë të organizuar në shkallë të gjerë. Ky migrim në qytete e ka ndarë shpejt punën dhe ka përhapur në vendet e varfra një revolucion të gjerë industrial-tregtar – i cili, në mënyrë të habitshme, është shpërfillur.

Leksionet e Humbura të historisë amerikane

Çfarë po ndodh në vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste ka ndodhur edhe më parë, në Evropë dhe në Amerikën e Veriut. Për fat të keq, kemi qenë kaq të hipnotizuar nga dështimet në shumë vende gjatë kalimit në kapitalizëm, saqë kemi harruar se si kanë vepruar kombet e suksesshme kapitaliste. Për vite me radhë kam vizituar teknokratë dhe politikanë në kombet e përparuara, nga Alaska në Tokio, por ata nuk kishin përgjigje. Ishte një mister. Më në fund gjeta përgjigje në librat e tyre historikë, ku shembulli më i rëndësishëm ishte ai i historisë amerikane.

Misteri i Dështimit Ligjor: Pse ligji i tokës nuk funksionon jashtë Perëndimit

Që prej shekullit të 19-të, kombet kanë kopjuar ligjet e Perëndimit për t'u dhënë qytetarëve të tyre strukturën e nevojshme institucionale për të prodhuar pasuri. Ato vazhdojnë t'i kopjojnë këto ligje edhe sot dhe sigurisht që një gjë e tillë nuk funksionon. Shumë qytetarë edhe sot nuk mund të përdorin ligjin për të konvertuar kursimet e tyre në kapital. Pse ndodh

kështu dhe çfarë nevojitet për të vënë në punë ligjin mbetet mister.

Zgjidhja e secilit mister është subjekt i çdo kreu të librit.

* * *

Çështja themelore është të shpjegohet se përse kapitalizmi triumfon në Perëndim dhe ngec praktikisht gjetkë. Të gjitha alternativat e pranueshme të kapitalizmit janë avulluar dhe tashmë jemi në gjendje ta studiojmë kapitalizmin në mënyrë të paanshme dhe të kujdesshme.

2

MISTERI I HUMBJES SË INFORMACIONIT

Gjatë viteve, ekonomia është bërë gjithnjë e më abstrakte dhe e ndarë nga ngjarjet në botën reale. Në shkallë të gjerë, ekonomistët nuk studiojnë funksionet e sistemit aktual ekonomik. Ata japin teori në lidhje me të. Sikurse ka thënë ekonomisti anglez Eli Devons gjatë një takimi: “Nëse ekonomistët dëshirojnë të studiojnë kalin, ata nuk shkojnë të vëzhgojnë kalin. Ata ulen dhe pyesin veten, “Çfarë do të bëja nëse do të isha kalë?””

RONALD H. COASE, “Detyra e Shoqërisë”

Përfytyroni një vend ku askush nuk mund të identifikojë se çfarë zotëron, adresat nuk mund të verifikohen lehtësisht, njerëzit nuk detyrohen të paguajnë borxhet e tyre, burimet nuk mund të kthehen lehtësisht në para, pronësia nuk mund të ndahet në pjesë, përsëkrimet e aseteve nuk janë të standardizuara dhe nuk mund të krahasohen lehtësisht dhe rregullat që përcaktojnë pronësinë ndryshojnë nga një lagje në tjetrën ose edhe nga një rrugë në tjetrën. Ju gjendeni kështu në kushtet e jetesës së një vendi të pazhvilluar ose ish-komunist; më saktë, ju keni përfytyruar kushtet e jetesës të më tepër se 80 për qind të popullsisë, e cila është e ndarë me thikë nga elita

“perëndimore”, ashtu sikurse të zinjë dhe të bardhët e Afrikës së Jugut ishin të ndarë nga aparteidi.

Kjo 80 për qind e popullsisë nuk është e varfëruar në mënyrë të pashpresë, sikurse mund të mendojnë perëndimorët. Me gjithë varfërinë e dukshme, edhe ata që jetojnë nën regjimet më të pabarabarta zotërojnë më tepër nga ç’ mund të mendohet. Megjithatë, ajo që zotërojnë nuk përfaqësohet në mënyrë të tillë që të prodhojë vlerë të shtuar. Kur dilni nga dyert e “Nile Hilton”, ajo që lini prapa nuk është bota e teknologjisë së lartë me fakte dhe makina akulli, televizione dhe antibiotikë. Populli i Kajros është në gjendje t’i sigurojë këto mjete.

Ajo që lini prapa është bota e transaksioneve të imponueshme me ligj mbi të drejtat e pronësisë. Kreditë hipotekare dhe adresat e verifikueshme për të prodhuar pasuri shtesë nuk janë të disponueshme as për ata banorë të Kajros që mund t’ju duken relativisht të pasur. Jashtë Kajros, disa prej më të varfërve jetojnë në një lagje me varre të vjetër, të quajtur “qyteti i të vdekurve”. Por, gati e gjithë Kajroja është qytet i vdekur – kapitali të vdekur, asetesh që nuk mund të shfrytëzohen tërësisht. Institucionet që janë në gjendje t’i japin jetë kapitalit – që t’u sigurojnë interesa palëve të treta në saje të punës apo asetit – nuk ekzistojnë këtu.

Për të kuptuar arsyen e kësaj gjendjeje, duhet parë historia e shekullit XIX, kur Shtetet e Bashkuara po gdhendnin një shoqëri mbi jetën e egër. Shtetet e Bashkuara patën trashëguar nga Britania jo vetëm ligjin shumë të ndërlikuar të tokës, por edhe një sistem të gjerë bllokues të granteve për tokën. E njëjta sipërfaqe toke mund t’i përkiste një individi që e kishte siguruar atë si pjesë e një granti nga ana e Kurorës Britanike, një tjetri që e kishte blerë nga një fis indian dhe një të treti që e kishte pranuar në formën e një pagese nga ana e legjislaturës shtetërore – dhe kishte mundësi që asnjëri prej tyre të mos e kishte parë

ndonjëherë atë copë tokë. Ndërkohë, vendi po mbushej me emigrantë, të cilët vendosnin kufij, plugonin tokën, ndërtonin shtëpi, transferonin toka dhe hartonin tapi shumë kohë para se qeveria t'u jepte të drejtë të vepronin në forma të tilla. Këto ishin ditët e pionierëve dhe të “Perëndimit të Egër”. Një nga arsytet që e bënte kaq të egër ishte fakti se pionierët, që në shumicën e rasteve ishin thjesht zaptues, “këmbëngulnin se ishte puna e tyre dhe jo titujt formalë në letër apo vijat kufitare arbitrare, ato që i jepnin tokës vlerë dhe vendosnin të drejtën e pronësisë”¹. Ata besonin se, nëse zaptonin tokën dhe e përmirësonin atë me shtëpi dhe ferma, atëherë toka bëhej e tyre. Qeveritë e shteteve dhe ajo federative mendonin ndryshe. Zyrtarët dërgonin trupa për të djegur ferma e shkatërruar shtëpi. Banorët luftonin për t'u mbrojtur. Kur ushtarët largoheshin, banorët rindërtonin dhe rifillonin mbijetesën. E kaluara është e tashmja e Botës së Tretë.

Një revolucion i papritur

Para vitit 1950, pjesa më e madhe e vendeve të Botës së Tretë ishin shoqëri bujqësore të organizuara në mënyrë të tillë që do të ishin shumë familjare për evropianët e shekullit të 18-të. Shumë njerëz punonin tokat që zotëroheshin nga një numër i vogël pronarësh të mëdhenj, disa prej të cilëve ishin oligarkë vendas ndërsa të tjerë plantacionistë kolonialë. Qytetet ishin të vegjël dhe funksiononin si tregje dhe porte e jo si qendra industriale; ata mbizotëroheshin nga elita të vogla tregtare që mbronin interesat e tyre me vendosje rregullash dhe rregulloresh të ashpra.

Pas vitit 1950, në Botën e Tretë nisi një revolucion ekonomik i ngjashëm me shpërthimet kulturore dhe ekonomike që shpërthyen në Evropë në vitet 1800. Makineritë e reja po reduktonin kërkesën për fuqi punëtore rurale, ashtu sikurse

medikamentet dhe metodat e reja të shëndetit publik po pakësonin normat e vdekshmërisë foshnjore dhe po zgjerorin horizontin jetësor. Shumë shpejt qindra mijëra vetë kalonin në autostradat e reja, drejt qyteteve të përshkruara në mënyrë kaq joshëse në programet e reja radiofonike.

Popullsia e qyteteve nisi të rritet shpejt. Vetëm në Kinë, më tepër se 100 milionë banorë janë zhvendosur nga fshati në qytet që prej vitit 1979. Mes viteve 1950 dhe 1988, popullsia e qytetit Port-au-Prince (kryeqytet i Haitit) u rrit nga 140,000 në 1,550,000 frymë. Më 1998 po i afrohej shifrës 2 milionë. Rreth dy të tretat e kësaj popullsie jeton në qytetet-kasolle. Ekspertët ishin të shqetësuar për rritjen e numrit të banorëve qytetarë që në vitin 1973, shumë kohë para se të niste fluksi i gjerë i zhvendosjes. “Çdo gjë bën të mendosh se qyteti po shembet”, shkruante një urbanist. “Ndërtime të pakontrolluara, kudo dhe sido. Sistemi i kanalizimeve nuk është në gjendje të thithë ujin e shiut që vazhdon të grumbullohet. Popullsia përqendrohet në zona të përcaktuara ku nuk ekziston asnjë infrastrukturë higjienike... Trotuaret e Shëtitores “Desalin” janë zënë nga shitësit e vegjël... Ky qytet është bërë i pabanueshëm”².

Shumë pak vetë e kishin parashikuar këtë transformim të madh për sa i përket jetesës dhe punës së njerëzve. Teoritë e bukura të kohës në lidhje me “zhvillimin”, kishin për qëllim t’i sillnin modernizim fshatit. Nuk ishte parashikuar që fshatarët të vinin në qytet për të gjetur shekullin e 20. Por, dhjetëra milionë erdhën, me gjithë veprimet kërcënuese që u kanoseshin. Ata u ballafaquan me një mur të papërshekueshëm rregullash që i ndante nga aktivitetet shoqërore dhe ekonomike. Ishte tmerrësisht e vështirë për banorët e rinj të qyteteve të siguronin shtëpi të legalizuara, të krijonin biznese të ligjshme apo të gjenin ndonjë punë të ligjshme.

Pengesat drejt legalizimit

Për të pasur një pamje të përgjithshme në lidhje me vështirësinë e jetës së migrantëve, së bashku me skuadrën time kemi hapur një dyqan të vogël veshjesh në periferi të Limës, në Peru. Qëllimi ynë ishte krijimi i një biznesi të ri dhe tërësisht të ligjshëm. Më pas, skuadra nisi të plotësojë formularët; nisën të qëndronin në radhë dhe nisën të merrnin autobusin për të arritur në qendër të Limës për të siguruar gjithë certifikatat e nevojshme për të operuar sipas ligjit për biznesin e vogël në Peru. Ata kalonin 6 orë të ditës me këto punë dhe, më në fund, e regjistruan biznesin - pas 289 ditësh. Megjithëse dyqani i veshjeve ishte ingranuar për të punuar vetëm me një punëtor, kostoja totale e regjistrimit ishte 1231 dollarë - 31 herë më e lartë se paga mesatare mujore. Për të siguruar një autorizim të ligjshëm për të ndërtuar një shtëpi mbi një tokë të zotëruar nga shteti nevojiteshin 6 vjet e 11 muaj si dhe 207 hapa administrativë në 52 zyra qeveritare (shihni figurën 2.1). Për të siguruar një titull pronësie të ligjshëm për atë copë tokë duhej kaluar në 728 hapa. Po ashtu, zbuluam se një autobus privat, një autobus i lirë apo një shofer i një taksie që kërkonte të siguronte njohje zyrtare për itinerarin që duhej të ndiqte, duhet të kalonte 26 muaj burokraci.

Skuadra ime, me ndihmën e kolegëve vendorë, ka përsëritur eksperimente të ngjashme në vende të tjera. Pengesat nuk ishin më pak të habitshme krahasuar me Perunë; nganjëherë ishin edhe më të tmerrshme. Në Filipine, nëse një individ ndërtonte një banesë mbi një tokë urbane të zotëruar nga shteti ose një privat, për ta legalizuar duhet të nënshkruante një aleancë me fqinjën e tij për të qenë i kualifikuar për t'u përfshirë në programin shtetëror të financimit për strehimin. I tërë procesi mund të kishte nevojë për 168 hapa, duke përfshirë kalimin në

53 agjenci publike dhe private, gjë që kërkonte 13-25 vjet (shihni figurën 2.2). Dhe, një gjë e tillë supozon se programi shtetëror i financimit për strehim ka fonde të mjaftueshme. Nëse banesa gjendet në një zonë të konsideruar ende si “bujqësore”, banorit i duhet të kalojë pengesa të tjera për ta shndërruar tokën për përdorim urban - 45 procedura burokratike shtesë para 13 enteve, duke i shtuar përpjekjes edhe 2 vjet të tjerë.


Në Egjipt, individi që kërkon të sigurojë dhe të regjistrojë në mënyrë të ligjshme një ngastër mbi një tokë shkretinore të zotëruar nga shteti duhet të kalojë të paktën 77 procedura burokratike në 31 agjenci publike dhe private (figura 2.3). Kjo mund të kërkojë 5-14 vjet. Për të ndërtuar një banesë të ligjshme mbi një tokë ish-bujqësore nevojiten 6-11 vjet zvarritje burokratike, në disa raste edhe më shumë. Kjo shpjegon pse 4.7 milionë egjiptianë kanë vendosur të ndërtojnë banesat e tyre në mënyrë jolegale. Nëse, pasi ndërton shtëpinë, banori vendos të bëhet një qytetar që respekton ligjin dhe të blejë të drejtat për banesën e tij, rrezikon t’i prishet banesa, të paguajë një gjobë dhe të kryejë deri në 10 vjet burg.

Në Haiti, një mënyrë në dispozicion të qytetarit për t’u vendosur ligjërisht mbi tokë shtetërore është që fillimisht ta marrë me qira nga qeveria për 5 vjet dhe më pas ta blejë atë. Gjatë punës me kolegë në Haiti, kërkimet tona kanë zbuluar se, për të siguruar një qira të tillë, duhet kaluar në 65 hapa burokratike - kjo kërkon mesatarisht dy vjet - të gjitha këto për një qira 5-vjeçare. Për të blerë tokën në fjalë kërkohen edhe 111 hapa të tjerë burokratike - dhe 12 vjet të tjerë (figura 2.4). Periudha totale për të siguruar tokë në Haiti: 19 vjet. E përsëri, gjithë kjo orvatje nuk siguron që prona të mbetet e ligjshme.

Në fakt, në çdo vend ku bëjmë kërkime, kemi zbuluar se është po aq vështirë të mbetesh legjitim sa edhe të bëhesh legjitim.

FIGURA 2.1


Procedurat për legalizimin e një shtëpie të zotëruar rregullisht në Peru përbëhen nga 5 faza. Vetëm faza e parë përfshin 207 hapa.



STEP 207

STEP 1

FIGURA 2.2
Procedurat për legalizimin e pronës urbane informale në Filipine.
































RRENO	PROCEDIMIENTO PARA SUBDIVISIÓN DE TIERRAS	ADQUISICIÓN Y REGISTRO DE TIERRAS COMUNITARIAS	ADQUISICIÓN Y REGISTRO DE TIERRAS POR BENEFICIARIOS
			
			
			
			
			
			
			
			
			
			
	1,7-6,1 AÑOS	2,3 AÑOS	3,3 AÑOS

FIGURA 2.3

Procedurat për të marrë leje për qëllime ndërtimi në toka shkretëtirë dhe për regjistrimin e të drejtave të pronësisë në Egjipt (6-14 vjet)








FIGURA 2.4

Procedurat për të marrë kontratë shitjeje pas 5 vjetësh kontrate qiraje në Haiti





Në mënyrë të pashmangshme, emigrantët nuk e thyejnë ligjin aq sa ligji thyen ata – dhe ata vendosin t’i shmangen sistemit. Më 1976, 2/3 e individëve që punonin në Venezuelë ishin të punësuar në sipërmarrje të regjistruara ligjërisht; sot, kjo pjesë është më e vogël se gjysma. Tridhjetë vjet më parë, më tepër se 2/3 e shtëpive të reja të krijuara në Brazil kishin për qëllim të jepeshin me qira. Sot, vetëm 3 për qind e ndërtimeve të reja janë të renditura zyrtarisht në listat e ndërtesave për t’u dhënë me qira. Ku është zhdukur ky treg? Në zonat e jashtëligjshme të qyteteve braziliane të quajtura “*favelas*”, që veprojnë jashtë sistemit të rregulluar formal të ekonomisë dhe funksionojnë në bazë të ofertës dhe kërkesës. Nuk ekziston një kontroll për qiratë në “*favelas*”; qiratë paguhet në dollarë amerikanë dhe qiramarrësit që nuk paguajnë evakuohen me shpejtësi.

Kur këta të ardhur të rinj dalin jashtë sistemit, ata quhen “informalë”. Alternativa e vetme është të jetojnë dhe punojnë jashtë ligjit zyrtar, duke përdorur marrëveshjet e tyre informale për të mbrojtur dhe mobilizuar asetet e tyre. Këto marrëveshje burojnë nga një kombinim rregullash të huazuara në mënyrë të përzgjedhur nga sistemi ligjor zyrtar, nga improvizimi i rastit dhe zakonet e sjella nga vendi i origjinës ose të hartuara aty për aty. Ata bashkohen përmes një kontrate shoqërore që garantohej nga një bashkësi si e tërë dhe zbatohet nga autoritetet e përzgjedhura nga bashkësia. Këto kontrata shoqërore informale kanë krijuar një sektor kumbues por me deficit kapitali në qendrën e botës së varfër.

Sektori i dekapitalizuar

Megjithëse migrantët janë refugjatë të ligjit, ata nuk janë tërhequr në plogështi. Sektorët e dekapitalizuar në vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste gëlojnë nga puna dhe risitë. Industritë shtëpiake buzë rrugëve janë përhapur kudo,

duke prodhuar gjithçka, nga veshjet e këpucët deri te imitime të mirëfillta të orëve të dorës “Cartier” dhe çantave “Vuitton”. Ekzistojnë punishte që ndërtojnë dhe rindërtojnë makineri, makina, madje dhe autobusë. Të varfrit e rinj urbanë kanë krijuar industri dhe lagje të tëra që duhet të veprojnë me lidhje klandestine për të siguruar elektricitet dhe ujë. Ekzistojnë edhe dentistë që mbushin dhëmballë pa pasur licencë.

Kjo nuk është thjesht një histori e të varfërve që ndihmojnë të varfrit. Këta sipërmarrës të rinj po mbushin edhe hendeqet brenda ekonomisë formale. Autobusët, tramvajet dhe taksitë informale përbëjnë pjesën më të madhe të transportit publik në shumë vende në zhvillim. Në pjesë të tjera të Botës së Tretë, shitësit nga qytetet-kasolle furnizojnë pjesën më të madhe të lëndës ushqimore të tregut, përmes karrocave në rrugë e deri te stendat në ndërtesat që ngrenë.

Më 1993, Dhoma Meksikane e Tregtisë vlerësoi se numri i shitësve të rrugës në Distriktin Federal të Qytetit të Meksikos ishte 150,000, me 293,000 të tjerë në 43 qendrat e tjera meksikane. Këto baraka ku shesin janë mesatarisht 1.5 metra të gjera. Nëse shitësit e Meksikos do të rreshtonin barakat e tyre pa hapësira mes njëra-tjetrës në vijë të drejtë, do të krijonin një rresht të vazhdueshëm me gjatësi 210 kilometra. Mijëra e mijëra njerëz punojnë në sektorin informal – në rrugë, në shtëpi, si dhe në dyqanet, zyrat dhe fabrikat e paregjistruara të qytetit. Një vlerësim i Institutit Meksikan të Statistikave Kombëtare më 1994 në lidhje me numrin total të “mikrobizneseve” informale në gjithë vendin, nxori se ishin 2.65 milionë të tillë.

Të gjithë këta janë shembuj të vërtetë të jetës ekonomike në sektorin e dekapitalizuar të shoqërisë. Në vendet ish-komuniste mund të shihni aktivitete më të ndërlikuara, që nga prodhimi i kompjuterëve deri te prodhimi i avionëve luftarakë për shitje jashtë vendit.

Sigurisht, Rusia ka një histori ndryshe nga vendet e Botës së Tretë si Haiti dhe Filipinet. Megjithatë, që nga rënia e komunizmit, ish-vendet sovjetike kanë kaluar në të njëjtën situatë të pronësisë informale. Më 1995, gazeta “Business Week” raportonte se, 4 vjet pas rënies së komunizmit, vetëm “280,000 nga 10 milionë fermerë të Ruisë zotëronin tokën e tyre”. Një tjetër raport paraqet një pasqyrë të ngjashme për Botën e Tretë: “[Në ish-Bashkimin Sovjetik], të drejtat e pronës private, shfrytëzimit dhe tjetërsimit të pronës janë përcaktuar në mënyrë të paqartë dhe nuk mbrohen siç duhet nga ligji... Mekanizmat e përdorur në ekonomitë e tregut për të mbrojtur të drejtat e tokës janë ende në djep... Vetë Shteti vazhdon të kufizojë të drejtat e shfrytëzimit për tokën e padisponueshme”³. Vlerësimet e konsumit energjetik tregojnë se ndërmjet 1989 dhe 1994, aktiviteti jozyrtar në ish-vendet sovjetike u rrit nga 12 në 37 për qind të prodhimit total. Disa mendojnë se kjo përqindje është edhe më e lartë.

Asgjë e tillë nuk do të tingëllonte habitëse për ata që jetojnë larg Perëndimit. Mjafton të hapni dritaren ose të merrni një taksì për të shkuar nga aeroporti në hotel për të vënë re se periferitë e qyteteve janë mbuluar nga shtëpitë, ushtritë e tëra të shitësve që zaptojnë si fajkoj rrugët, punishtet gëluese pas dyerve të garazheve dhe autobusët e tejmbushur që i bien kryq e tërthor rrugëve të ndotura. Informaliteti perceptohet shpesh si një çështje “margjinale”, e ngjashme me tregjet e zeza në kombet e zhvilluara, ose me varfërinë apo papunësinë. Bota informale është si një vend ku gangsterët enden të lirë, ndërsa personazhet e dyshimtë janë policët, antropologët dhe misionarët.

Në fakt, është vetë ligjshmëria që është margjinale; informaliteti është bërë normë. Të varfrit kontrollojnë sasi të mëdha të pasurive të patundshme dhe të prodhimit. Ato agjenci ndërkombëtare që lëshojnë këshilltarët e tyre nëpër kullat me

xhama të shndritshëm të shesheve elegante të qyteteve për t'u takuar me “sektorin privat” lokal, flasin vetëm me një pjesë të vogël të botës sipërmarrëse. Fuqitë ekonomike të Botës së Tretë dhe asaj ish-komuniste që po dalin në pah përbëhen nga mbledhësit e plehrave, nga prodhuesit e pajisjeve elektrike dhe nga kompanitë e paligjshme të ndërtimeve të rrugës. E vetmja zgjedhje reale për qeveritë e këtyre vendeve është ose të integrojnë këto burime sipas një strukture ligjore, të rregullt dhe koherente, ose të vazhdojnë të jetojnë në anarki.

Sa kapital të vdekur ka?

Gjatë dekadës së fundit, kërkuesit e mi, të ndihmuar nga profesionistë vendas, kanë zhvilluar anketa në pesë qytete të Botës së Tretë - Kajro, Lima, Manila, Meksiko dhe Port-au-Prince - në kuadrin e një përpjekjeje për të matur vlerën e zotërimeve të këtyre njerëzve, të cilët janë ndarë nga ekonomia kapitaliste përmes ligjeve diskriminues (Këto rezultate janë përmbledhur në grafikët e Shtojcës). Për të qenë më të sigurt në lidhje me rezultatet tona, jemi përqendruar në asetet më të prekshme dhe të identifikueshme: pasuritë e patundshme.

Ndryshe nga shitja e ushqimeve dhe këpucëve, riparimi i automjeteve apo prodhimi i orëve të rreme “Cartier” - aktivitete që janë të vështira për t'u matur dhe akoma më tepër për t'u vlerësuar - ndërtesat nuk mund të fshihen. Vlera e tyre mund të njihet thjesht duke anketuar koston e materialeve të prodhimit dhe duke vëzhguar çmimin e shitjes së objekteve të ngjashme. Kemi shpenzuar mijëra ditë duke numëruar ndërtesat bllok pas blloku. Kur na e kanë lejuar, kemi botuar rezultatet e marra në çdo vend, në mënyrë që ato të diskutoheshin dhe kritikoheshin hapur. Në bashkëpunim me njerëzit që kemi gjetur rrugës, kemi testuar dhe ritestuar metodat dhe rezultatet tona.

Kemi zbuluar se mënyra sipas së cilës njerëzit ndërtojnë në sektorin e dekapitalizuar merr aq forma sa janë pengesat ligjore që duhen kaluar. Forma më e përhapur është kasollja e ndërtuar mbi tokën pronë shtetërore. Por, kërkuesit tanë kanë zbuluar shumë metoda të tjera për të anashkaluar ligjet e pasurive të patundshme. Për shembull, në Peru, njerëzit themelonin kooperativa bujqësore për të blerë tokat nga pronari i vjetër dhe për t'i shndërruar ato në banesa ose parqe industriale. Meqenëse nuk ka mënyra të thjeshta ligjore për të ndryshuar pronësinë e tokës, fermerët e kooperativave shtetërore ndanin në mënyrë të paligjshme tokën në parcela të vogla private. Si rezultat, shumë pak kanë dokumente pronësore të tokës. Në Port-au-Prince, edhe pronat e gjera ndryshojnë duar dhe askush nuk lajmëron zyrën e regjistrimeve, e cila gjithsesi është e mbyllur. Në Manila, shtëpitë mbijnë në zona tokësore të rezervuara për përdorim industrial. Në Kajro, banorët e shtëpive të vjetra katërkatëshe projektojnë dhe ndërtojnë tre kate të paligjshme mbi ndërtesë dhe apartamentet ua shesin të afërmve ose klientëve të tjerë. Po ashtu, në Kajro, pronarët e ligjshëm të apartamenteve, qirave të të cilave, në fillim të viteve '50, iu caktuan shuma që sot kanë një vlerë më të ulët se 1 dollar në vit, i ndajnë këto prona në apartamente më të vegjël dhe i japin me qira me çmimin e tregut.

Disa prej këtyre shtëpive kanë qenë informale që në ditën e parë kur janë ndërtuar në kundërshtim me gjithë llojet e ligjeve. Ndërtesa të tjera – shtëpitë e Port-au-Prince ose apartamentet me qira të kontrolluar të Kajros – e kanë pasur filluesën në sistemin ligjor, por dolën prej tij pasi përmbajtja ndaj ligjit u bë shumë e kushtueshme dhe e ndërlikuar. Nëpërmjet një forme ose një tjetre, pothuaj çdo banesë në qytetet që kemi anketuar doli si nga struktura ligjore edhe nga vetë ligjet që, në mënyrë hipotetike, mund t'u kishin siguruar pronarëve një përfaqësi

dhe një institucion për krijimin e kapitalit. Ende mund të ketë dokumente pronësie në duart e ndokujt, por vetë statusi i pronësisë së këtyre aseteve ka rrëshqitur nga sistemi zyrtar i regjistrimit, duke bërë që të dhënat dhe hartat të dalin të pavlefshme. Si rezultat, burimet e shumicës së njerëzve janë të padukshme nga pikëpamja tregtare dhe financiare. Askush nuk e di se kush e zotëron një copë tokë apo në ç'kohë, cili duhet të merret parasysh kur vjen puna për detyrimet, kush është përgjegjës për humbjet ose mashtrimet apo cilat mekanizma përdoren për të detyruar kryerjen e shpenzimeve për shërbimet dhe mallrat e siguruara. Si pasojë, shumë prej aseteve potenciale në këto vende nuk janë identifikuar apo realizuar; ka pak kapital të përdorshëm dhe ekonomia e shkëmbimit është e sforcuar dhe e amullt.

Kjo pasqyrë e sektorit të dekapitalizuar ndryshon nga opinionioni i krijuar në lidhje me botën në zhvillim. Por, ky është vendi ku jeton shumica e njerëzve. Është një botë ku pronësia e aseteve është e vështirë të gjurmohet dhe vlerësohet dhe nuk qeveriset nga ndonjë sistem ligjor i njohur; ku atributet e përdorshme ekonomike të aseteve nuk përshkruhen dhe nuk organizohen; ku asetet nuk mund të përdoren për të siguruar vlerë të shtuar përmes transaksioneve të shumta sepse natyra e tyre jofikse dhe e pasigurt krijon hapësira për keqkuptime, grumbullim të gabuar apo marrëveshje të kthyeshme. Ku, me pak fjalë, asetet janë kapital i vdekur.

Çfarë vlere ka ky kapital i vdekur?

Kapitali i vdekur, që është në sasi kolosale, shtrihet nëpër rrugët e çdo vendi në zhvillim apo ish-komunist. Në Filipine, sipas vlerësimeve tona, 57 për qind e banorëve qytetas dhe 67 për qind e atyre që banojnë në fshat jetojnë në banesa që përbëjnë kapital të vdekur. Në Peru, 53 për qind e banorëve

qytetas dhe 81 për qind e banorëve të fshatit jetojnë në banesa informale.

Të dhënat janë edhe më dramatike për Haitin dhe Egjiptin. Në Haiti, sipas anketave tona, 68 për qind e banorëve qytetas dhe 97 për qind e atyre të fshatit jetojnë në shtëpi pa dokumente të rregullta. Në Egjipt, shtëpitë e kapitalit të vdekur strehojnë 92 për qind të qytetasve dhe 83 për qind të banorëve të fshatit.

Shumë prej këtyre banesave nuk kanë vlerë të madhe sipas standardeve Perëndimore. Një kasolle në Port-au-Prince mund të arrijë një vlerë prej jo më shumë se \$500, një kabinë pranë një lumi të ndotur në Manila arrin \$2700, një banesë e banueshme në një fshat jashtë Kajros arrin \$5000 dhe, në kodrat përreth Limës, një shtëpi njëkatëshe modeste me garazh dhe pamje piktoreske nga dritarja kushton vetëm \$20,000. Por ka shumë banesa të tilla dhe vlera e tyre totale e kalon pasurinë e të pasurve.

Në Haiti, zotërimet e patundshme rurale dhe urbane vlejné së bashku \$5.2 miliardë. Për të marrë një vlerësim relativ, mund të themi se kjo shumë është 4 herë më e lartë se totali i gjithë asetëve të të gjitha kompanive që operojné në mënyrë të ligjshme në Haiti, 9 herë më e lartë se vlera e gjithë asetëve të zotëruara nga qeveria dhe 158 herë më e lartë se vlera e gjithë investimeve të huaja direkte gjatë gjithë historisë së Haitit që prej 1955. A përbën Haiti një përjashtim, duke qënë një pjesë e Afrikës Frankofone e vendosur gabimisht në hemisferën Amerikane, ku regjimi i Duvaljesë shpërfilli nevojën e një sistemi ligjor sistematik? Ndoshta.

Atëherë le të marrim Perunë, një vend spanjoll dhe indo-amerikan me një përbërje shumë të diversifikuar zakonore dhe etnike. Vlera e pasurive të patundshme informale, rurale dhe urbane, në Peru arrin \$74 miliardë. Kjo është 5 herë më e lartë se vlera e Bursës së Limës para krizës së 1998, 11 herë më e lartë se

TABELA 2.1 Kapitoli urban dhe rural i vdekur në pasuritë e patundshme në botë (1997)

URBAN

	Total Population (millions)	Urban Population (%)	Urban Population (millions)	Urban Dwellings (millions)	Informal Urban Dwellings ^{2/} (millions)	Value of Informal Urban Dwellings (trillion US\$)
ASIA	1,747	29%	503	101	85	1.75
AFRICA	525	32%	167	33	28	0.58
MIDDLE EAST & NORTH AFRICA	371	57%	211	42	36	0.74
SOUTH AMERICA	328	78%	256	51	44	0.89
MEXICO, CENTRAL AMERICA AND THE CARIBBEAN	161	64%	103	21	18	0.36
China, NIS and Eastern Europe	1,611	38%	619	124	105	2.16
SUBTOTAL	4,743		1,859	372	316	6.48
Other Developing Countries	191	39%	75	15	13	0.26
TOTAL	4,934		1,934	387	329	6.74

RURAL

	Rural Area (thousand ha)	Informality in Rural Areas (%)	Informal Rural Area (thousand ha)	Informal Rural Area: Croplands (thousand ha)	Informal Rural Area: Grasslands (thousand ha)	Value of Informal Rural Area ^{3/} (trillion US\$)
ASIA	489,586	44%	215,164	147,798	67,365	0.59
AFRICA	738,639	50%	368,792	88,166	280,626	0.39
MIDDLE EAST & NORTH AFRICA	444,665	40%	177,866	59,660	118,206	0.25
SOUTH AMERICA	607,407	49%	297,895	51,006	246,889	0.24
MEXICO, CENTRAL AMERICA AND THE CARIBBEAN	134,541	53%	71,025	20,813	50,212	0.09
China, NIS and Eastern Europe	1,151,280	47%	540,142	188,721	351,421	0.80
SUBTOTAL	3,566,118		1,670,884	556,164	1,114,719	2.36
Other Developing Countries	359,926	47%	169,165	56,308	112,857	0.24
TOTAL	3,926,044		1,840,049	612,472	1,227,576	2.60

TOTAL INFORMAL US \$ 9.34 trillion

1/ 179 vende në zhvillim dhe ish-komuniste.

2/ Estë vlerësuar se 85% e ngasrave janë informale. Ato ose: i) janë ndërtuar në kundërshtim me ligjet; ii) nuk përputhen me kërkesat për akses në atë terren; iii) fillimisht ishin të ligjshme por kalluan në informale; ose iv) janë ndërtuar nga qeveria pa plotësuar kërkesat ligjore.

3/ Janë përdorur këto vlera: 3,973 US\$ për hektar tokë bujqësore dhe 138 US\$ për hektar kullotë.

vlera totale e sipërmarrjeve dhe fabrikave shtetërore që mund të privatizohen dhe 14 herë më e lartë se vlera e gjithë investimeve të huaja direkte në vend gjatë gjithë historisë së dokumentuar. Ju ma ktheni që ekonomia formale e Perusë është trullësuar nga traditat e Perandorisë së lashtë Inkase, nga ndikimi i korruptuar kolonial spanjoll dhe lufta e tanishme kundër lëvizjes Maoiste Sendero Luminoso (Shtegu i Shndritshëm)?

Shumë mirë, atëherë le të marrim Filipinet, një ish-protektorat aziatik i Shteteve të Bashkuara. Vlera e pasurive të patundshme të paregjistruara është \$133 miliardë, 4 herë më e lartë se vlera e kapitalizuar e 216 kompanive vendase të renditura në Bursën e Filipineve, 7 herë më e lartë se totali i depozitave në bankat tregtare të vendit, 9 herë më e lartë se kapitali total në sipërmarrjet shtetërore dhe 14 herë më e lartë se vlera e gjithë investimeve të huaja direkte.

Mbase edhe Filipinet përbëjnë një anomali – mbase kjo ka të bëjë me Krishterimin e themeluar në ish-kolonitë spanjolle. Nëse është e vërtetë, le të marrim Egjiptin. Vlera e kapitalit të vdekur në Egjipt për sa u përket pasurive të paluajtshme, sipas anketave të kryera me kolegët tanë egjiptianë, arrin \$240 miliardë. Kjo vlerë është 30 herë më e lartë se vlera e gjithë aksioneve në Bursën e Kajros dhe, ashtu sikurse përmenda më parë, 55 herë më e lartë se gjithë investimet e huaja në Egjipt.

Në të gjitha vendet që kemi hetuar, zgjuarsia sipërmarrëse e të varfërve ka krijuar pasuri në një shkallë të gjerë – pasuri që, gjithashtu, përbën burimin më të madh të kapitalit potencial për zhvillim. Këto asete, jo vetëm që tejkalojnë në vlerë zotërimet shtetërore, vlerat e aksioneve në bursat vendase dhe investimet e huaja direkte, por janë shumë herë më të mëdha se gjithë ndihma e siguruar nga kombet e përparuara dhe kreditë e akorduara nga Banka Botërore.

Rezultatet janë edhe më shtangëse kur marrim të dhënat e katër vendeve që kemi studiuar dhe i projektojmë ato mbi vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste të marra bashkë. Vlerësohet se 85 për qind e parcelave urbane dhe 40 deri në 53 për qind e parcelave rurale në këto vende, mbahen në mënyrë të tillë që nuk mund të prodhojnë kapital. Nëse kërkohet një shifër, atëherë ajo do të ishte shumë e lartë. Por besojmë se vlerësimet tona janë të sakta dhe të qëndrueshme.

Sipas vlerësimit tonë, vlera totale e pasurive të patundshme të mbajtura në mënyrë të paligjshme nga të varfrit e vendeve të Botës së Tretë dhe atyre ish-komuniste arrin të paktën \$9.3 trilion (shihni tabelën 2.1).

Kjo vlerë është mirë të mesatarizohet: \$9.3 trilion është 2 herë më e lartë se oferta monetare totale e Shteteve të Bashkuara. Është pothuaj e barabartë me vlerën totale të gjithë kompanive të vlerësuara në bursat kryesore të njëzet vendeve më të zhvilluara të botës: Nju Jork, Tokio, Londër, Frankfurt, Toronto, Paris, Milano dhe NASDAQ*, si dhe shumë të tjera. Është më tepër se 20 herë më e lartë se investimet e huaja totale direkte në vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste në dhjetë vjet, që prej 1989; 46 herë më e lartë se kredia totale e Bankës Botërore në tri dekadat e fundit dhe 93 herë më e lartë se gjithë ndihma për zhvillim e akorduar nga gjithë vendet e përparuara për Botën e Tretë gjatë po të njëjtës periudhë.

Akra me Diamante**

Fjalët “varfëri ndërkombëtare” sjellin ndër mend shumë lehtë pamjet e lypsarëve varfanjakë në tortuaret e Kalkutës dhe fëmijët e uritur afrikanë që vdesin mbi rërë. Këto skena janë sigurisht reale dhe miliona njerëz, sikurse jemi edhe ne,

* *Indeks i Bursës së Nju Jorkut*

** *Një akër është afërsisht 0.4 hektar*

kërkojnë dhe meritojnë ndihmën tonë. Megjithatë, imazhi më i përvuajtur i Botës së Tretë nuk është më i sakti. Më keq akoma, ai largon vëmendjen nga arritjet e mundimshme të atyre sipërmarrësve të vegjël që kanë triumfuar mbi çdo pengesë të imagjinueshme për të krijuar pjesën më të madhe të pasurisë së shoqërisë së tyre. Një imazh më i vërtetë duhet të paraqiste një burrë dhe një grua që kanë kursyer pareshtur për të ndërtuar një shtëpi, për vete dhe fëmijët e tyre, dhe janë duke krijuar një sipërmarrje atje ku nuk mund ta imagjinonte njeri se mund të krijohet. Nuk më vjen mirë që sipërmarrja heroike e këtyre njerëzve të quhet kontribut në zgjerimin e problemit të varfërisë botërore.

Ata nuk janë problemi. Ata përbëjnë zgjidhjen.

Në vitet pas Luftës Civile Amerikane, një lektor i quajtur Russell Cowell i ra kryq e tërthor Amerikës duke përhapur një mesazh që bënte fajtorë miliona njerëz. Ai tregoi historinë e një tregtari indian të cilit një profet i kishte premtuar se një ditë do të bëhej me siguri më i pasur nga ç'mund të përfytyronte nëse vetëm do të kërkonte thesarin e tij. Tregtari shëtiti gjithë botën dhe u kthye në shtëpi i plakur, i mërzitur dhe i mundur. Teksa po hynte në shtëpinë e tij të braktisur, kishte nevojë për një gotë ujë. Por pusi i shtëpisë së tij ishte tharë. I këputur siç ishte, ai mori lopatën dhe nisi të gërmonte një të ri – dhe papritur i ra lopata mbi Golkondën, minierën më të madhe të diamanteve në botë.

Mesazhi i Conwell-it është i dobishëm. Udhëheqësit e vendeve të Botës së Tretë dhe atyre ish-komuniste nuk duhet të enden nëpër ministritë e jashtme dhe institucionet financiare të botës për të kërkuar pasuri. Në mes të lagjeve të varfra dhe qyteteve-kasolle brenda vendit të tyre gjenden – edhe pse jo akra diamantesh – trilionë dollarë, gati për t'u vënë në punë, sikur vetëm të zbulonim misterin e shndërrimit të aseteve në kapital të gjallë.

3

MISTERI I KAPITALIT

Ndjenja për botën duhet të shtrihet jashtë botës. Në botë çdo gjë është siç është dhe ndodh siç duhet të ndodhë. Nuk ka asnjë vlerë në këtë – dhe, nëse do të kishte, ajo do të ishte e pavlerë.

Nëse ekziston një vlerë pa vlerë, duhet të shtrihet jashtë çdo të ngjarë dhe të qeni-kësisoj. Pasi çdo e ngjarë apo të qeni-kësisoj është aksidentale.

Ajo që e bën joaksidentale nuk mund të shtrihet brenda botës, sepse përsëri do të ishte aksidentale.

Duhet të shtrihet jashtë botës.

LUDVIG VITGENSHTAJN, "Tractatus Logico-Philosophicus"

Ecni nëpër rrugët e Lindjes së Mesme, të ish-Bashkimit Sovjetik apo të Amerikës Latine dhe do të shihni shumë gjëra: shtëpi të përdorura për strehim, parcela toke që lërohen, mbillen e korren, mallra që blihen dhe shiten. Asetet, në vendet e botës në zhvillim dhe asaj ish-komuniste, u shërbejnë në plan të parë këtyre qëllimeve të menjëhershme fizike. Megjithatë, në Perëndim, të njëjtat asetete jetojnë një jetë paralele si kapital jashtë botës fizike. Ato mund të përdoren për të vënë në punë më tepër prodhim duke siguruar interesat e palëve të treta si "peng" për hipotekë, për shembull, ose duke siguruar ofrimin e formave të tjera të kredidhënies e të pasiveve të tjera publike.

Pse ndërtesat dhe toka në vendet e tjera të botës nuk mund të jetojnë një jetë të tillë paralele? Pse burimet e pafundme që hetuam në kreun e dytë - \$9.3 trilion kapital i vdekur - nuk mund të prodhojnë vlerë përtej gjendjes së tyre “natyrore”? Përgjigjja ime është se Kapitali i Vdekur ekziston sepse kemi harruar (ose mbase nuk e kemi kuptuar kurrë) se shndërrimi i një asemi fizik për të prodhuar kapital – duke përdorur shtëpinë për të marrë kredi për të financuar një sipërmarrje – kërkon një proces shumë të ndërlikuar. Nuk ndryshon shumë nga procesi që na ka mësuar Einstein, sipas të cilit një tullë e vetme mund të vendoset në mënyrë të tillë që të çlirojë një energji të pamatë në formën e një shpërthimi atomik. Për analogji, kapitali është rezultati i zbulimit dhe çlirimit të energjisë potenciale nga trilionë të tëra tullash që të varfrit kanë grumbulluar në ndërtesat e tyre.

Megjithatë, ekziston një dallim thelbësor mes çlirimit të energjisë nga një tullë dhe çlirimit të kapitalit nga ndërtesat me tulla: teksa njerëzimi (ose të paktën një grup i gjerë shkencëtarësh) ka përshtatur procesin e sigurimit të energjisë nga materia, ne duket se e kemi harruar procesin që lejon prodhimin e kapitalit nga asetet. Si rezultat, 80 për qind e botës është e dekapitalizuar; njerëzit nuk mund të krijojnë jetë ekonomike nga ndërtesat e tyre (apo ndonjë aset tjetër) për të prodhuar kapital. Më keq akoma, kombet e përparuara duket se nuk janë të afta t’ua mësojnë këtë. Fakti që asetet mund të prodhojnë mjaft kapital në Perëndim por shumë pak në pjesën tjetër të botës përbën një mister.

Të dhëna nga e kaluara (nga Smithi te Marksi)

Për të zbuluar misterin e kapitalit, duhet të shkojmë prapa në kohë deri në kuptimin fillestar të botës. Në latinishten mesjetare, “kapital” përdorej për të treguar kokët e gjedhëve

ose të kafshëve të tjera të fermës, të cilat kanë qenë burim i rëndësishëm pasurie, përveç mishit që prodhohet. Bagëtitë janë zotërime me nevojë të vogël për mirëmbajtje; janë të lëvizshme dhe mund të largohen nga rreziku; po ashtu janë të lehta për t'u numëruar dhe vlerësuar. Por, më me rëndësi akoma, nga bagëtia mund të sigurohet pasuri shtesë, ose vlerë e shtuar, përmes vënies në punë të industrive të ndryshme si qumështi, gëzofi, leshi, mishi dhe lënda djegëse. Po ashtu, bagëtitë kanë aftësi të riprodhohen. Kështu, termi “kapital” përdoret për dy qëllime në të njëjtën kohë, duke rrokur përmasat fizike të aseteve (bagëtime) si dhe potencialin e tyre për të prodhuar vlerë të shtuar. Prej stallës janë vetëm pak hapa deri te tryeza e zbuluesit të ekonomisë, i cili përgjithësisht e përkufizonte “kapitalin” si pjesë e aseteve të vendit që nxit prodhim shtesë dhe rrit prodhueshmërinë.

Ekonomistët e mëdhenj klasikë si Adam Smith dhe Karl Marks besonin se kapitali ishte një motor që fuqizonte ekonominë e tregut. Kapitali konsiderohej si pjesa thelbësore e ekonomisë si një e tërë – faktori më i rëndësishëm që qëndron mbi të tjerët ose madhor, siç mund të vihet re në fraza të tilla si çështje *madhore [kapitale]*, ndëshkimi më i rëndë *[kapital]*, kryeqyteti *[kapital]* i një vendi. Ata donin të kuptonin se çfarë është kapitali dhe si prodhohet dhe magazinohet ai. Bini apo nuk bini në një mendje me ekonomistët klasikë, edhe në rast se i perceptoni si të parëndësishëm (mbase Smithi nuk e kuptoi që Revolucioni Industrial ishte në lëvizje; mbase teoria e Marksit në lidhje me vlerën nuk ka zbatim praktik), nuk ka asnjë dyshim se këta mendimtarë hodhën themelet e mendimit mbi të cilin sot mund të qëndrojmë dhe të mundohemi të kuptojmë çfarë është kapitali, çfarë e prodhon atë dhe përse vendet joperëndimore prodhojnë kaq pak të tillë.

Sipas Smithit, specializimi ekonomik - ndarja e punës dhe shkëmbimi i prodhimeve në treg - ishte burimi i rritjes së prodhueshmërisë dhe kështu pra “pasuria e kombeve”. Ai që bënte të mundur specializimin dhe shkëmbimin ishte kapitali, të cilin Smith e përkufizonte si stok asetesh të grumbulluara për qëllime prodhuese. Sipërmarrësit mund të përdornin burimet e tyre të grumbulluara për të mbështetur sipërmarrjet e specializuara deri në çastin kur do të mund të shkëmbenin prodhimet e tyre me gjëra të tjera për të cilat kishin nevojë. Sa më shumë kapital grumbullohej, aq më shumë bëhej i mundur specializimi dhe aq më e lartë ishte prodhueshmëria e shoqërisë. Marksi binte dakord; për të, pasuria e kapitalizmit prodhon dhurata në formën e një magazinuesi të madh të mallrave.

Smithi besonte se fenomeni i kapitalit ishte pasojë e zhvillimit natyror njerëzor nga një shoqëri gjuetare, baritore e bujqësore, në një shoqëri tregtare ku, përmes ndërvarësisë, specializimit dhe tregtisë, individi mund të zmadhonte pafundësisht fuqitë e tij prodhuese. Kapitali ishte magjia që mund të fuqizonte produktivitetin dhe të krijonte vlerë të shtuar. “Sasia e industrisë”, shkruante Smith, “jo vetëm që zmadhohet në çdo vend sipas zmadhimit të stokut [kapitalit] që e vë në punë, por, si pasojë e këtij zmadhimi, e njëjta sasi e industrisë prodhon një sasi më të madhe pune”¹.

Smithi theksonte një pikë që ndodhet në thelb të misterit që po përpiqemi të zgjidhim: që asetet e grumbulluara të kthehen në kapital aktiv dhe të vënë në lëvizje prodhim shtesë, ato duhet të jenë të fiksuara dhe të realizuara në ndonjë objekt të veçantë “i cili jeton për një kohë të caktuar pasi puna të jetë përfunduar”. Pra, ekziston e magazinuar një sasi e caktuar pune për t’u përdorur nëse është e nevojshme në ndonjë rast të ardhshëm”². Smithi paralajmëronte se puna e investuar në prodhimin e aseteve nuk do të linte asnjë shenjë vlere nëse nuk do të fiksohej siç duhet.

Ajo që donte të thoshte realisht Smithi mund të bëhet objekt debati. Megjithatë, unë bie në një mendje me të për faktin se kapitali nuk është stoku i grumbulluar i asetëve, por potenciali që ky stok ka për të vënë në punë prodhim të ri. Sigurisht, ky potencial është abstrakt. Ai duhet të përpunohet dhe fiksohet në një formë të prekshme para se të çlirohet – ashtu sikurse energjia potenciale bërthamore që lind nga tulla e Einstein. Pa një proces konvertimi – i cili çliron dhe fikson energjinë potenciale që përmban tulla – nuk ka shpërthim; tulla mbetet thjesht tullë. Po ashtu, krijimi i kapitalit kërkon një proces konvertimi.

Ky nocion – që kapitali është pikë së pari një koncept abstrakt të cilit i duhet dhënë një formë fikse e prekshme për t’u bërë i përdorshëm – ka qenë i njohur edhe për ekonomistë të tjerë klasikë. Simond de Sismondi, ekonomisti zviceran i shekullit të 19-të, shkroi se kapitali është “një vlerë e qëndrueshme që shumëfishohet dhe nuk zhduket... Tani kjo vlerë ndahet nga produkti që e krijon; ajo kthehet në një sasi metafizike dhe thelbësore të brendshme që gjendet në pronësi të atij që e prodhon, për të cilin kjo vlerë [mund të fiksohet] në forma të ndryshme”³. Ekonomisti i madh francez Jean Baptiste Say besonte se “kapitali ka gjithmonë një natyrë jomateriale pasi nuk është lënda që prodhon kapitalin por vlera e kësaj lënde; dhe vlera nuk ka asgjë të prekshme në vetvete”⁴. Marksi ishte në një mendje; për të, tavolina mund të bëhej nga diçka materiale, si për shembull nga druri, “por, që në çastin që del si mall i tregtueshëm, ajo kthehet në diçka trashendente, që kapërcen përtej të qenit thjesht diçka materiale, fizike. Jo vetëm që është me këmbë në tokë, por, në lidhje me gjithë mallrat e tjera, qëndron me kokë lart dhe zhvillohet përmes trurit grotesk prej druri në diçka shumë më të mrekullueshme se punimi i tavolinave”⁵.

Ky kuptim thelbësor i kapitalit ka humbur diku në mjegullat e historisë. Tanimë kapitali ngatërrohet me paranë, që është vetëm një nga shumë format kalimtare. Është gjithmonë më e lehtë të mbahet mend një koncept i vështirë në një nga manifestimet e prekshme të tij sesa në thelbin e tij. Mendja kapet më lehtë pas “parasë” sesa pas “kapitalit”. Por, është gabim të mendohet se paraja është forma përfundimtare e fiksuar e kapitalit. Siç ka theksuar Adam Smithi, “paraja përbën ciklin e madh të qarkullimit”, por nuk përbën kapital sepse vlera “nuk mund të manifestohet në ato copa metalike”⁶. Me fjalë të tjera, paraja thjeshtëson transaksionet, duke na lejuar të shesim dhe të blejmë sende, por nuk është në vetvete promotori i prodhimit shtesë. Sikurse ka këmbëngulur edhe Smithi, “paraja e artë dhe e argjendtë, e cila qarkullon në çdo vend, mund të krahasohet shumë mirë me një rrugë, e cila megjithëse ndihmon që bari dhe misri i një vendi të qarkullojnë dhe të arrijnë në treg, nuk prodhon as edhe një njësi të këtyre dy mallrave”⁷.

Pjesa më e madhe e misterit të kapitalit zbulohet që në çastin kur nuk mendoni më për “kapitalin” si sinonim të “parave të kursyera për t’u investuar”. Dyshoj se keqinterpretimi, sipas të cilit është paraja ajo që fikson kapitalin, lind për shkak të faktit se biznesi modern shpreh vlerën e kapitalit në formë monetare. Në fakt, është e vështirë të vlerësohet vlera totale e një grumbulli asetesh të llojeve të ndryshme, si për shembull makineri, ndërtesa dhe tokë, pa i vënë në emëruesin e përbashkët të parasë. Në fund të fundit, për këtë qëllim është shpikur paraja; ajo krijon një tregues standard për të matur vlerën e mallrave, në mënyrë që të shkëmbehen asetet e ndryshme. Por, megjithëse është e dobishme, paraja nuk mund të fiksojë potencialin abstrakt të asetëve të veçanta në mënyrë që t’i kthejë ato në kapital. Kombet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste janë famëkëqija për faktin se krijojnë inflacion në ekonomitë e tyre përmes parasë duke mos qenë në gjendje të prodhojnë shumë kapital.

Energjia potenciale e aseteve

Çfarë është ajo që fikson potencialin e një aseti në mënyrë që prodhimi shtesë të vendoset në veprim? Çfarë ndan vlerën nga një shtëpi e thjeshtë dhe e fikson atë në një mënyrë të tillë që na lejon të realizojmë kapital?

Mund të gjejmë një përgjigje duke përdorur analogjinë me energjinë. Kini parasysh një liqen malor. Mund të mendojmë për këtë liqen në lidhje me kontekstin fizik dhe të zbulojmë disa përdorime fillestare si kanotazhin dhe peshkimin. Por, nëse mendojmë për këtë liqen si inxhinierë, përqendrohemi në aftësinë e tij për të prodhuar energji në formën e vlerës së shtuar, duke parë përtej formës fizike si një grumbull uji; dhe, papritur, shohim potencialin e krijuar nga pozita e lartë e liqenit. Sfida për inxhinierin është të zbulojë si të krijojë një proces që e lejon atë të shndërrojë dhe të fiksojë këtë potencial në një formë që të mund të përdoret për punë shtesë. Në rastin e një liqeni malor, ky proces përmbahet në një hidrocentral që lejon ujin e liqenit të lëvizë me shpejtësi në drejtim të poshtëm përmes forcës së rëndesës, duke shndërruar kështu energjinë potenciale të bashkëveprimit (të liqenit) në energji kinetike të ujit të lëvizshëm. Kjo energji kinetike e sapokrijuar mund të rrotullojë turbinat, duke krijuar energji mekanike që kthen elektromagnetet të cilët më pas e kthejnë në energji elektrike. Përmes elektricitetit, energjia potenciale e liqenit të palëvizshëm tashmë është e fiksuar në një formë të nevojshme për të prodhuar korrent të kontrollueshëm, i cili më pas mund të transmetohet përmes telave përcjellës në vende të largëta, për të vënë në punë prodhim të ri.

Kështu, një liqen i palëvizshëm në dukje mund të përdoret për t'i dhënë dritë dhomës suaj dhe për të vënë në punë makineritë në fabrika. Ai që kërkohej ishte një proces i jashtëm i krijuar nga njeriu, i cili na lejon fillimisht të identifikojmë

potencialin e peshës së ujit për të krijuar punë shtesë dhe, së dyti, të shndërrojmë këtë energji potenciale në elektricitet, e cila më pas mund të përdoret për të prodhuar vlerë shtesë. Vlera shtesë që sigurojmë nga liqeni nuk është vlera e liqenit në vetvete (si për shembull një xeheror i çmuar në brendësi të tokës), por më tepër është një vlerë e brendshme e një procesi të krijuar nga njeriu. Ky proces na lejon të shndërrojmë liqenin nga një vend kanotazhi dhe peshkimi në një vend prodhues të energjisë.

Kapitali, sikurse energjia, përbën një vlerë të fjetur. Zgjimi i tij kërkon që ne të shohim asetet përtej qenies së tyre dhe të mendojmë më tepër për atë që do të mund të bëhej me brendësinë e tyre. Për të fiksuar potencialin ekonomik të një asemi në mënyrë që të mund të përdoret për të vënë në punë prodhim shtesë, kërkohet një proces shndërrimi.

Megjithëse procesi që shndërron energjinë potenciale të ujit në elektricitet është i njohur, procesi që u jep aseteve formën e kërkuar për të vënë në punë prodhimin nuk është i njohur. Me fjalë të tjera, ndërsa dimë se janë portat e ujit, turbinat, gjeneratorët, transformatorët dhe përcjellësit e sistemit të energjisë hidrike ata që shndërrojnë energjinë potenciale të liqenit derisa të arrijë një formë fikse dhe të përdorshme, nuk dimë se ku të gjejmë procesin kyç që shndërron potencialin ekonomik të një shtëpie në kapital.

Kjo ndodh sepse ky proces kyç nuk është konceptuar për të prodhuar kapital, por për qëllimin e rëndomtë të mbrojtjes së pronësisë mbi tokën. Teksa sistemi pronësor i kombeve Perëndimore dilte në dritë, ato zhvilluan, në mënyrë të pavullnetshme, një tërësi mekanizmesh që kombinoheshin gradualisht në një proces, i cili çlironte kapital si kurrë më parë. Megjithëse këto mekanizma përdoren gjithmonë, ne nuk e kuptojmë se ato kanë funksione prodhuese kapitali, pasi

thjesht nuk kanë të varur këtë etiketë. Ne i shohim si pjesë të një sistemi që mbron pronën dhe jo si mekanizma puthitës për fiksimin e potencialit ekonomik të një asemi në mënyrë të tillë që ai të shndërrohet në kapital. Me fjalë të tjera, ajo që prodhon kapital në Perëndim është një proces i nënkuptuar, i varrosur në thellësi të sistemit formal të pronësisë.

Procesi i fshehur i shndërrimit në Perëndim

Kjo mund të tingëllojë shumë e thjeshtë ose shumë e ndërlikuar. Por mendoni mundësinë që kanë asetet për t'u përdorur në formë prodhuese nëse nuk i përkasin diçkaje ose dikujt. Ku e vërtetojmë tjetër ekzistencën e këtyre asetëve dhe të transaksioneve që i shndërrojnë ato dhe rrisin prodhueshmërinë e tyre, nëse nuk e bëjmë këtë në kontekstin e një sistemi formal të pronësisë? Ku regjistrohen tjetër tiparet e rëndësishme ekonomike të asetëve, përveçse në regjistrat dhe titujt e krijuar nga sistemi formal i pronësisë? Ku gjenden tjetër kodet e sjelljes që rregullojnë përdorimin dhe transferimin e asetëve, përveçse në strukturën e sistemit formal të pronësisë? Është pronësia formale ajo që krijon procesin, format dhe rregullat që fiksojnë asetet në kushte të tilla që na lejojnë t'i realizojmë si kapital aktiv.

Në Perëndim, ky sistem formal i pronësisë fillon të përpunojë asetet në kapital, duke përshkruar dhe organizuar aspektet më të dobishme ekonomike dhe sociale në lidhje me asetet, duke ruajtur këtë informacion në një sistem regjistrimi – sikurse shtojca në një libër llogarie ose direktoria në diskun kompjuterik – dhe duke i bashkuar më pas informacionet në formën e titullit të pronësisë. Një tërësi rregullash të sakta dhe të detajuara rregullon gjithë procesin. Regjistrimet dhe titujt e pronësisë formale përfaqësojnë konceptin e përgjithshëm të asaj që është ekonomikisht e qenësishme në lidhje me asetet. Ata

kapin dhe organizojnë të gjithë informacionin e rëndësishëm që kërkohet për të konceptualizuar vlerën potenciale të një asemi, duke na lejuar ta kontrollojmë atë. Prona është mbretëria ku ne identifikojmë dhe zbulojmë asetet, i kombinojmë ato dhe i lidhim me asetet e tjera. Ky është vendi ku lind kapitali.

Çdo aset, aspektet ekonomike dhe sociale të të cilit nuk janë të fiksuar në sistemin formal pronësor, është shumë e vështirë të lëvizet në drejtim të tregut. Si mund të kontrollohen ndryshe sasitë gjigande të aktiveve që ndërrojnë duar në një ekonomi moderne tregu, përveçse përmes një procesi formal të pronësisë? Pas një sistemi të tillë, çdo tregtim i një aktivi, për shembull i një cope prone të paluajtëshme, kërkon një përpjekje të stërmadhe vetëm për të përcaktuar themelet e transaksionit: a e zotëron shitësi pronën e paluajtëshme dhe a ka të drejtë ta transferojë atë? A mund ta lërë peng atë? A do të njihet pronari i ri nga ata që zbatojnë të drejtat mbi pronën? Cilat janë format efektive për të përjashtuar pretenduesit e tjerë? Në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste, këto pyetje është e vështirë të gjejnë përgjigje. Për pjesën më të madhe të mallrave, nuk ka vend për të kryer fiksimin. Kjo është arsyeja që shitja ose dhënia me qira e një shtëpie përfshin procedura të gjata dhe të rënda miratimi, të cilat përfshijnë fqinjët. Kjo është shpesh e vetmja mënyrë për të verifikuar se pronari zotëron me të vërtetë shtëpinë dhe nuk ka pretendime të tjera në lidhje me të. Kjo është arsyeja që shkëmbimi i pjesës më të madhe të aktiveve jashtë Perëndimit kufizohet në qarqe lokale partnerësh tregtarë.

Siç kemi vënë re në kreun paraardhës, problemi themeltar i këtyre vendeve nuk është mungesa e sipërmarrjes: të varfrit kanë grumbulluar trilionë dollarë në formën e pasurive të paluajtëshme në 40 vitet e shkuar. Ajo që u mungon atyre është sigurimi i lehtë i mekanizmave pronësorë që mund të fiksojnë në mënyrë të ligjshme potencialin ekonomik të aktiveve të tyre në mënyrë që ato të mund të përdoren për të prodhuar, siguruar

e garantuar vlerë më të madhe në tregun e gjerë. Në Perëndim, çdo aktiv – çdo copë tokë, çdo shtëpi, çdo plaçkë – është e fiksuar formalisht në regjistra të azhurnuar që rregullohen nga ligjet e përfshira në sistemin pronësor. Çdo rritje në prodhim, çdo ndërtesë e re, çdo produkt i ri ose çdo gjë tjetër me vlerë të tregtueshme është prona formale e dikujt. Edhe nëse asetet i përkasin një korporate, persona realë i zotërojnë ato në rrugë të tërthortë, përmes titujve që vërtetojnë se ata janë pronarë të korporatës si “aksionmbajtës”.

Ashtu sikurse energjia elektrike, kapitali nuk prodhohet nëse ndonjë nga mekanizmat kyçe që e prodhojnë dhe e fiksojnë nuk është në vend të vet. Ashtu sikurse liqeni ka nevojë për një hidrocentral për të prodhuar energji të përdorshme, asetet kanë nevojë për sistem formal pronësie për të prodhuar vlerë shtesë të rëndësishme. Pa një pronësi formale, që nevojitet për të nxjerrë potencialin e tyre ekonomik dhe për ta shndërruar atë në një formë që mund të transportohet dhe kontrollohet lehtë, asetet e vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste janë si uji në liqenet malore të Andeve – një stok i pahapur energjie potenciale.

Pse fillesat e kapitalit janë zhytur në të tillë mister? Pse kombet e pasura të botës, që janë gjithnjë të gatshme të japin këshilla ekonomike, nuk kanë spjeguar se pronësia formale është thelbësore për formimin e kapitalit? Përgjigjja është se procesi brenda sistemit të pronësisë formale që kthen asetet në kapital është shumë i vështirë për t’u bërë i dukshëm. Qëndron i fshehur në mijëra copëza legjislative, në statute, rregulla dhe institucione që qeverisin këtë sistem. Çdo individ i ngecur në një moçal të tillë ligjor do të kërkonte me ngulm të kuptonte si funksionon realisht procesi. E vetmja mënyrë për ta kuptuar është duke e parë nga jashtë sistemit – nga sektori jashtëligjor – ku, së bashku me bashkëpunëtorët e mi, unë kryej veprimtarinë time.

Ka disa kohë që e vështroj ligjin nga një pikëpamje jashtëligjore, për të kuptuar më mirë si funksionon dhe çfarë efektësh prodhon. Nuk është praktikë e çmendur. Siç ka argumentuar filozofi francez Michel Foucault, është më e lehtë të zbulohet kuptimi i diçkaje duke e vështruar nga bregu i kundërt. “Për të njohur se çfarë nënkupton shoqëria jonë me shëndet mendor”, ka shkruar Foucault, “mbase duhet të hetojmë çfarë po ndodh në fushën e çmendurisë. Dhe, për të njohur kuptimin e legalitetit duhet të hetojmë ilegalitetin”⁸. Për më tepër, prona, ashtu sikurse energjia, është një koncept; nuk mund të përjetohet drejtpërdrejtë. Energjia e pastër nuk është parë dhe nuk është ndezur kurrë. Dhe askush nuk mund të shohë pronën. Individit mund të përjetojë energjinë dhe pronën përmes efekteve të tyre.

Sipas pikëpamjes sime nga sektori jashtëligjor, kam vënë re se sistemet formale të pronës në Perëndim prodhojnë 6 efekte që u lejojnë qytetarëve të tyre të krijojnë kapital. Paaftësia e vënë re gjatë për të vënë në punë kapitalin lind nga fakti se shumica e banorëve të vendeve të Botës së Tretë dhe atyre ish-komuniste janë të përjashtuar nga ndikimi i këtyre efekteve thelbësore.

EFEKTI PRONËSOR NR. 1

Fiksimi i Potencialit Ekonomik të Aseteve

Vlera potenciale e mbyllur në një shtëpi mund të zbulohet dhe shndërrohet në kapital aktiv njëloj sikurse energjia potenciale gjendet në një liqen malor dhe më pas shndërrohet në energji të përdorshme. Në të dy rastet, kalimi nga një gjendje në një tjetër kërkon një proces, i cili zhvendos objektin fizik në një univers përfaqësues të krijuar nga individit, ku mund të shkëputet burimi nga gjendja e fjetur materiale dhe të përqendrohet në potencialin e tij.

Kapitali lind duke u përfaqësuar në formë të shkruar - në një titull pronësie, garanci hipotekare, kontratë ose në forma të tjera të regjistruara - cilësitë më të përdorshme ekonomike dhe sociale që kanë lidhje me asetet dhe duke lënë mënjanë aspekte që janë më tepër të dukshëm në lidhje me të. Këtu përshkruhet dhe regjistrohet paraprakisht vlera potenciale. Në çastin që përqendroni vëmendjen mbi titullin e pronësisë të një shtëpie, përshembull, dhe jo mbi vetë shtëpinë, keni kaluar automatikisht prej botës materiale në universin konceptual ku jeton kapitali. Ju po lexoni një përfaqësi që përqendron vëmendjen tuaj mbi potencialin ekonomik të shtëpisë duke filtruar gjithë dritëhijet e aspektit fizik dhe rrethinat lokale. Pasuria formale ju detyron të mendoni në lidhje me shtëpinë si koncept ekonomik dhe social. Ju fton të shkoni përtej konceptimit të shtëpisë si objekt i thjeshtë strehimi - pra një aktiv i vdekur - dhe të filloni ta vështroni atë si kapital të gjallë.

Prova se prona është koncept i pastër lind kur shtëpia ndërrohet duar; nuk ka asnjë ndryshim fizik. Kur shihni një shtëpi nuk jeni në gjendje të kuptoni se kush e zotëron atë. Një shtëpi që është e juaja sot, ngjan njëllonj siç ishte dje, kur gjendej në pronësinë time. Ajo duket njëllonj, pavarësisht nga fakti nëse unë e zotëroj, e shes apo ta jap ty me qira. Prona nuk është vetë shtëpia, por një koncept ekonomik në lidhje me shtëpinë, bashkangjitur me një përfaqësim ligjor. Kjo do të thotë se përfaqësia formale e pasurisë është diçka e ndarë nga aktivi që përfaqëson.

Ç'është ajo që i lejon përfaqësitë formale të pronësisë të kryejnë punë shtesë? A nuk janë ato thjesht dokumente të aktivitetit? Jo. E përsëris: një përfaqësi formale e pronësisë, siç është një titull pronësie, nuk është riprodhim i shtëpisë, si një fotografi, por një përfaqësim i konceptit tonë në lidhje me shtëpinë. Në mënyrë specifike, ajo përfaqëson cilësitë e

padukshme që kanë potencial për të prodhuar vlerë. Këto nuk janë cilësitë fizike të shtëpisë, por përbëjnë më tepër cilësitë e qenësishme ekonomike dhe sociale që ne njerëzit i kemi ngjizur shtëpisë (si aftësia për ta përdorur për një tërësi qëllimesh që mund të sigurohen përmes pengut, hipotekës, komoditetit ose angazhimeve të tjera).

Në kombet e përparuara, përfaqësia formale e pasurisë funksionon si metodë për të siguruar interesat e palëve të tjera dhe për të krijuar kontabilitet duke paraqitur të gjitha informacionet, referencat, rregullat dhe gjithë mekanizmat zbatues të nevojshëm. Në Perëndim, për shembull, pasuritë formale mund të përdoren lehtësisht si peng për të marrë kredi; si garanci në lidhje me investimet; si adresë për grumbullimin e borxheve, interesave dhe taksave; si një pikë grumbullimi për identifikimin e individëve për qëllime tregtare, gjyqësore ose qytetare; si dhe në formën e një terminali përgjegjës për të siguruar shërbime publike si energji, ujë të pijshëm, kanalizime, telefon dhe shërbime televizive satelitore. Teksa shtëpitë shërbejnë si objekt strehimi ose zyre në vendet e zhvilluar, përfaqësitë e tyre kryejnë një jetë paralele, duke kryer një tërësi funksionesh shtesë për të siguruar interesat e palëve të tjera.

Kështu pra, prona ligjore i ka dhënë Perëndimit mekanizmat e nevojshëm për të prodhuar vlerë shtesë përtej aktiveve fizike. Përfaqësitë pronësore kanë bërë që njerëzit të mendojnë rreth aktiveve jo vetëm përmes njohjes fizike, por edhe përmes përshkrimit të cilësive të tyre të fshehura ekonomike dhe sociale. Megjithëse në mënyrë të pavullnetshme, sistemi ligjor i pronësisë u bë shkalla që ngjitën këto kombe për të kaluar nga universi i aktiveve në gjendje natyrore, në universin konceptual të kapitalit, ku asetet mund të shihen nga këndvështrimi i potencialit të plotë prodhues.

Me pronësinë ligjore, kombet e përparuara të Perëndimit kishin tashmë çelësin për të kaluar në zhvillim modern; qytetarët e tyre tani zotëronin mekanizmat për të zbuluar, me thjeshtësi dhe dinamikë, cilësitë më të fuqishme prodhuese të burimeve të tyre. Sikurse e zbuloi Aristoteli 2300 vjet më parë, metodat e përdorimit të gjërave shumëfishohen kur përqendroni vëmendjen mbi potencialin e tyre. Duke mësuar se si të fiksonin potencialin ekonomik të aktiveve përmes regjistrimeve pronësore, Perëndimorët krijuan një binar për të zbuluar aspektet më prodhuese të zotërimeve të tyre. Pronësia formale u bë shkalla për t'u ngjitur në mbretërinë konceptuale, ku mund të zbulohet kuptimi ekonomik i gjërave dhe ku lind kapitali.

EFEKTI PRONËSOR NR. 2

Integrimi i Informacionit të Shpërndarë në një Sistem të Vetëm

Siç kemi vënë re në kreun paraardhës, shumica e njerëzve në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste nuk mund të hyjnë në sistemin ligjor pronësor, pavarësisht përpjekjeve të tyre. Për shkak se nuk mund t'i përfshijnë asetet e tyre në sistemin ligjor pronësor, ata i zotërojnë këto aktive në mënyrë jashtëligjore. Arsyeja që ka mundësuar triumfin e kapitalizmit në Perëndim dhe ka bërë që të dështojë në pjesën tjetër të botës është fakti se shumica e aktiveve të vendeve Perëndimore janë integruar në një sistem formal përfaqësimi.

Integrimi ka ndodhur në mënyrë të rastësishme. Me kalimin e dekadave të shekullit të 19-të, politikanët, ligjvënësit dhe gjykatësit kanë bashkuar faktet dhe rregullat e shpërndara që kishin rregulluar pronësinë në qytetet, fshatrat, ndërtesat dhe fermat, duke i integruar në një sistem. “Bashkimi” i përfaqësimeve

pronësore, një çast revolucionar në historinë e vendeve të zhvilluara, mundësoi depozitimin e gjithë informacioneve dhe rregullave që kishin të bënin me pasurinë e qytetarëve në një njësi bazë njohëse. Para se të ndodhte kjo, informacioni në lidhje me asetet ishte shumë pak i disponueshëm. Çdo fermë ose vendbanim regjistronte asetet dhe rregullat në regjistra rudimentarë, nëpërmjet simboleve ose përmes dëshmisë me gojë. Por ky informacion grimcohej, shpërndahej dhe nuk ishte i disponueshëm për çdo agjent në çdo çast të kohës. Siç e dimë mirë sot, një bollëk faktesh nuk do të thotë domosdoshmërisht bollëk njohurish. Në mënyrë që njohuria të bëhej funksionale, kombet e përparuara integruan në një sistem të përbashkët të gjitha të dhënat e shpërndara dhe të veçuara në lidhje me pronësinë.

Vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste nuk e kanë bërë këtë. Në gjithë vendet ku kam studiuar, nuk kam gjetur një sistem të vetëm ligjor por shumë, madje qindra të tillë, që menaxhoheshin nga gjithë llojet e organizatave, disa prej të cilave ligjore, të tjera jashtëligjore, që varionin nga grupet e vogla sipërmarrëse deri te organizatat e strehimit. Si rrjedhojë, përdorimi i pronës nga individët në këto vende është i kufizuar deri në caqet e imagjinatës dhe njohurisë së pronarëve. Në vendet Perëndimore, ku informacioni në lidhje me pronën është i standardizuar dhe i disponueshëm për të gjithë, ajo që njerëzit mund të bëjnë me pronën lidhet me imagjinatën kolektive të një rrjeti të gjerë individësh.

Për lexuesit Perëndimorë mund të jetë e habitshme që shumicës së kombeve të botës u duhet të integrojnë marrëveshjet e jashtëligjshme pronësore në një sistem të vetëm ligjor formal. Për Perëndimorët supozohet se ka vetëm një ligj – ai zyrtar. Megjithatë, mbështetja e Perëndimit në sistemet pronësore të integruara ka qenë një fenomen karakteristik

për 200 vitet e fundit. Në shumicën e vendeve Perëndimore, sistemet e integruara të pronësisë janë shfaqur vetëm 100 vjet më parë; integrimi i Japonisë ndodhi vetëm 50 vjet më parë. Siç do të shohim më vonë në mënyrë të detajuar, marrëveshjet e ndryshme informale në lidhje me pronësinë dikur ishin normë në çdo vend. Pluralizmi ligjor ka qenë standard në Evropën kontinentale deri në çastin kur u rizbulua ligji Romak, në shekullin e 14-të, dhe qeveritë bashkuan gjithë rrymat ligjore në një sistem të vetëm të koordinuar.

Që pas mësymjes për arin në 1849, në Kaliforni kishte rreth 800 juridiksione pronësore të ndara dhe secili kishte regjistrat dhe rregullat e veta të vendosura me konsensus vendor. Në Shtetet e Bashkuara, nga Kalifornia në Florida, shoqatat e pronarëve zbatonin rregullat e tyre dhe zgjidhnin zyrtarët e tyre. U deshën më tepër se 100 vjet që qeveria amerikane të kalonte statute të veçanta që integronin dhe formalizonin asetet amerikane, të gjitha këto në shekullin e 19-të. Duke miratuar më tepër se 35 statute industriale dhe minerare, Kongresi nisi gradualisht të integronte në një sistem të vetëm gjithë rregullat informale të pronësisë të krijuara nga miliona emigrantë e zaptues tokash. Si rezultat, u krijua një treg i integruar i pronës që lubrifikoi rritjen bombastike ekonomike amerikane në vitet e mëpasshëm.

Arsyeja pse kjo histori e integritit të sistemeve të shpërndara të pronës është kaq e vështirë të përsëritet, lidhet me faktin se ky proces ka ndodhur përgjatë një periudhe shumë të gjatë. Regjistrat formalë të pronës u shfaqën në Gjermani në shekullin e 12-të, por nuk u integruan para 1896, kur sistemi “Grundbuch” i regjistrimit të transaksioneve tokësore u fut në zbatim në shkallë kombëtare. Në Japoni, fushata kombëtare për të formalizuar pronën e fermerëve nisi në fund të shekullit të 19-të dhe përfundoi vetëm në fund të viteve '40. Përpjekjet

e jashtëzakonshme të Zvicrës në fillim të shekullit të 20-të, për të bashkuar sistemet e shpërndara që mbronin pronën dhe transaksionet e saj, janë ende të panjohura edhe për vetë zvicëranët.

Si rezultat i integritimit, qytetarët e vendeve të përparuara mund të sigurojnë përshkrimin e cilësive ekonomike dhe sociale të çdo aktivi edhe pa e parë fare aktivin. Ata nuk kanë më nevojë të udhëtojnë kryq e tërthor vendit për të takuar çdo pronar dhe fqinjët e tij; sistemi ligjor i pronësisë u mëson se cilat asetë janë të disponueshme dhe çfarë mundësisht ekzistojnë për të krijuar vlerë shtesë. Si rrjedhojë, potenciali i asetëve vlerësohet dhe shkëmbehet më lehtë, duke fuqizuar prodhimin e kapitalit.

EFEKTI PRONËSOR NR. 3

Verifikueshmëria e Njerëzve

Integrimi i gjithë sistemeve të pronësisë nën një ligj formal pronësor mundësoi kalimin e legjitimitetit të të drejtave të pronarëve nga konteksti i politizuar i bashkësive lokale në kontekstin impersonal të ligjit. Duke çliruar pronarët nga marrëveshjet kufizuese lokale dhe duke i afruar në një sistem ligjor më të integruar, u thjeshtua mundësia e verifikimit të tyre.

Ishte pronësia formale që krijoi individë nga masat, duke shndërruar individët me interesa pronësore në individë të verifikueshëm. Njerëzit nuk kishin më nevojë të mbështeteshin mbi marrëdhëniet me fqinjët apo të hartonin marrëveshje lokale për të mbrojtur të drejtat e tyre aktive. Të çliruar nga aktivitetet primitive ekonomike dhe kufizimet e rënda famullitare, ata mund të mendonin si të krijonin vlerë shtesë nga asetet e tyre. Por kjo kishte një çmim: pasi hynin në sistemin pronësor formal, pronarët humbitnin anonimitetin. Duke qenë të

ndërlidhur me pasurinë e paluajtëshme dhe bizneset që mund të identifikoheshin dhe lokalizoheshin me lehtësi, njerëzit hiqnin dorë nga mundësia për të humbur gjurmët brenda masës. Ky anonimitet pothuaj është zhdukur në Perëndim, ndërkohë që verifikueshmëria (dokumentueshmëria) e individëve është fuqizuar. Njerëzit që nuk paguajnë për të mirat dhe shërbimet që kanë konsumuar mund të identifikohen, të penalizohen, të gjobiten, mund t'u konfiskohen atyre asetet dhe t'u kufizohen mundësitë e kreditimit. Autoritetet janë në gjendje të njohin shkeljet e ligjit dhe kontratat e pazbatuara; ato mund të ndërpresin shërbimin, të rrethojnë pronat dhe të shfuqizojnë disa ose të gjitha privilegjet e pronësisë ligjore.

Respekti për pronën dhe transaksionet e lidhura me të nga ana e banorëve të Perëndimit nuk është diçka e koduar në ADN e tyre; është më tepër zotërimi i sistemeve formale pronësore të zbatueshme. Roli i pronësisë formale në mbrojtjen jo vetëm të disponibilitetit, por edhe të sigurisë së transaksioneve, nxit qytetarët e vendeve të zhvilluara të respektojnë titujt, të zbatojnë kontratat dhe t'i binden ligjit. Kur ndonjë qytetar vepron në mënyrë të padrejtë, shkelja regjistrohet në sistem, duke vënë në rrezik emrin e tij të mirë si partner i besueshëm për fqinjët, shërbimet komunitare, bankat, kompanitë e telefonisë, firmat e sigurimeve dhe pjesën tjetër të rrjetit me të cilin prona e mban të lidhur.

Kështu pra, sistemet formale të pronësisë në Perëndim dhurojnë një bekim të përzier. Megjithëse u japin qindra miliona qytetarëve interesa në lojën e kapitalit, ajo që e bën kuptimplotë këtë interes është fakti që mund të humbasë. Një pjesë e konsiderueshme e vlerës potenciale të pronësisë ligjore buron nga mundësia e konfiskimit. Si rrjedhojë, një pjesë e madhe e fuqisë së saj buron nga verifikueshmëria që ajo krijon, nga kufizimet që vendos, rregullat që rrezaton dhe sanksionet

që mund ta shoqërojnë. Duke u dhënë njerëzve mundësinë të shohin potencialin ekonomik dhe social të aseteve, pronësia formale ndryshoi perceptimin në vendet e përparuara jo vetëm në lidhje me përfitimet potenciale të përdorimit të aseteve, por edhe në lidhje me rreziqet që kjo sjell. Pronësia ligjore nxiti angazhimin.

Kështu pra, mungesa e pronësisë ligjore shpjegon pse qytetarët e vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste nuk mund të nënshkruajnë kontrata fitimprurëse me të panjohur dhe nuk mund të sigurojnë kreditim, sigurime apo shërbime komunitare: ata nuk zotërojnë asnjë pronë të cilën mund ta humbasin. Për faktin se nuk kanë pronë për të humbur, ata perceptohen si palë kontraktuale vetëm nga ana e familjes dhe e fqinjëve të afërt. Njerëzit që nuk kanë asgjë për të humbur mbeten të kyçur në bodrumet e errëta të botës kapitaliste.

Ndërkohë, qytetarët e vendeve të përparuara mund të nënshkruajnë kontrata për çdo gjë të arsyeshme, por çmimi që duhet të paguajnë për t'u përfshirë është angazhimi. Dhe angazhimi kuptohet më mirë nëse mbështetet nga një garanci pronësore, qoftë kjo kredi hipotekare (banese), garanci financiare ose çdo formë tjetër fletëgarancie që mbron palën kundërshtare kontraktuese.

EFEKTI PRONËSOR NR. 4

Shndërrimi i Aseteve në Pasuri të Tregtueshme dhe të Shkëmbyeshme

Një nga efektet më të rëndësishme të sistemit formal të pronësisë është shndërrimi i aseteve nga një gjendje më pak e disponueshme, në një më të disponueshme, në mënyrë që ato të mund të kryejnë punë shtesë. Ndryshe nga asetet fizike, përfaqësimet, në kuptimin e paraqitjeve të tjera të qenësishme të

një aset, mund të kombinohen, të ndahen, të mobilizohen dhe të përdoren me lehtësi për të nxitur shkëmbime tregtare. Duke shkëputur tiparet ekonomike të asetit nga gjendja e ngurtë fizike e tij, një përfaqësim e shndërron asetin në “të tregtueshëm dhe të shkëmbyeshëm (likuid)” – të mundshme për t’iu përshtatur dhe për t’u përfshirë në çdo lloj transaksioni.

Duke ndarë asetet në kategori standarde, një sistem i integruar formal i pronësisë lejon krahasimin nga pikëpamja arkitekturore të dy ndërtesave të ndryshme, të cilat janë ndërtuar për të njëjtin qëllim. Kjo i lejon individët të dallojnë me shpejtësi dhe pa shpenzime ngjashmëritë dhe ndryshimet mes asetëve, pa u marrë me to si qenësi unike.

Përshkrimet pronësore standarde në Perëndim janë në formë të shkruar për të thjeshtësuar kështu kombinimin e asetëve. Rregullat e pronësisë formale kërkojnë që asetet të përshkruhen dhe të kategorizohen në mënyrë të tillë që të vihet në dukje jo vetëm uniciteti i tyre, por edhe ngjashmëritë me asetet e tjera, duke bërë kështu më të dallueshme kombinimet potenciale. Përmes përdorimit të regjistrimeve të standardizuara, individit mund të përcaktojë (bazuar në kufizimin zonal, në faktin se cilët janë fqinjët e tij dhe çfarë bëjnë ata, në sipërfaqen e ndërtesave, në mundësinë e bashkimit të tyre etj.) se si të shfrytëzojë një copë të caktuar pasurie të paluajtëshme në mënyrë sa më fitimprurëse, qoftë si zyrë, dhomë hoteli, librari, fushë futbollit ose saunë.

Përfaqësimi, gjithashtu, lejon ndarjen e asetëve pa i prekur. Megjithëse një aset në formën e një fabrike mund të përbëjë një njësi të pandashme në botën reale, në universin konceptual të përfaqësisë formale të pronës mund të ndahet në disa nënnjësi. Qytetarët e vendeve të përparuara janë kështu në gjendje të ndajnë shumicën e asetëve të tyre në pjesë më të vogla, çdonjëra prej të cilave mund të zotërohet nga individë të ndryshëm me të drejta të ndryshme dhe të përdoret për qëllime të ndryshme.

Falë pronësisë formale, një fabrikë e vetme mund të zotërohet nga shumë investitorë, të cilët mund të heqin dorë nga prona e tyre pa ndikuar në integritetin e asetit fizik.

Në mënyrë të ngjashme, në një vend të zhvilluar, i biri i fermerit që dëshiron të ndjekë hapat e të atit mund të mbajë fermën duke blerë pjesët e vëllezërve dhe motrave që duan të shesin. Fermerët e vendeve në zhvillim nuk disponojnë mundësi të tilla dhe duhet që vazhdimisht të ndajnë fermat e tyre, brez pas brezi, deri në çastin kur parcelat bëhen kaq të vogla sa që nuk mund të punohen në mënyrë fitimprurëse, duke u lënë pasardhësve dy mundësi: të vdesin urie ose të vjedhin.

Përfaqësimet formale të pronës mund të shërbejnë edhe si zëvendësues të lëvizshëm për asetet fizike, duke i lejuar pronarët dhe sipërmarrësit që të simulojnë situata hipotetike në mënyrë që të zbulojnë përdorime të tjera fitimprurëse të aseteve – ashtu sikurse oficerët ushtarakë planifikojnë strategjitë e betejës duke lëvizur simbolet e trupave dhe armëve mbi hartë. Nëse mendoni mirë, janë përfaqësimet pronësore ato që lejojnë sipërmarrësit të simulojnë strategji tregtare për të zgjeruar kompanitë dhe për të krijuar kapital.

Po ashtu, të gjitha dokumentet standarde të pronësisë formale hartohen në mënyrë të tillë që të thjeshtojnë matjen e tipareve të asetit. Nëse përshkrimi standard i asetit nuk do të ishte i disponueshëm, kujtdo që do të donte të blinte, të merrte me qira apo të siguronte kredi duke lënë një pasuri peng, do t'i duhej të përdorte burime të shumta për të krahasuar dhe vlerësuar një aset në lidhje me të tjerat – dhe kësaj do t'i mungonte përshkrimi standard. Duke vendosur standarde, sistemet formale pronësore të Perëndimit kanë reduktuar ndjeshëm koston e transaksioneve të mobilizimit dhe përdorimit të aseteve.

Në çastin që asetet përfshihen në sistemin formal të pronësisë, ato u ofrojnë pronarëve një përparësi të madhe për faktin se kanë mundësi të ndahen dhe të bashkohen në shumë mënyra. Perëndimorët mund të përshtatin asetet e tyre në çdo situatë ekonomike për të prodhuar përzjerje vlerash që janë vazhdimisht fitimprurëse, ndërkohë që homologët e tyre të Botës së Tretë mbeten të mbërthyer në botën fizike të formave të ngurta dhe jolikuide.

EFEKTI PRONËSOR NR. 5

Ndërlidhja e Njerëzve në Rrjet

Duke i bërë asetet të shkëmbyeshme, duke lidhur pronarët me asetet, asetet me adresat dhe pronësinë me zbatimin e ligjit, si dhe duke vënë në dispozicion të dhëna në lidhje me historinë e pasurisë dhe pronarit, sistemet formale të pronësisë i kanë shndërruar qytetarët e Perëndimit në një rrjet agjentësh tregtarë individualisht të identifikueshëm dhe të dokumentueshëm. Procesi formal i pronësisë ka krijuar një infrastrukturë të tërë mekanizmash të ndërlidhur, të ngjashëm me ndarësin e binarëve në hekurudhë, i cili lejon që asetet (trenat) të kalojnë të sigurt nga një individ te tjetri (nga një stacion te tjetri). Kontributi i pronësisë formale ndaj njerëzimit nuk është mbrojtja e pronësisë; zaptuesit e tokës, organizatat e strehimit, mafia dhe fiset primitive janë në gjendje të mbrojnë në mënyrë efikase asetet e tyre. Zbulimi real i pronës është përmirësimi gradual i rrjedhës së komunikimit në lidhje me asetet dhe potencialin e tyre. Po ashtu, është fuqizuar statusi i pronarëve, të cilët janë shndërruar në agjentë ekonomikë të aftë të shndërrojnë asetet brenda një strukture të gjerë.

Kjo spjegon mënyrën se si pronësia ligjore nxit ofruesit e energjisë dhe ujit që të investojnë në mekanizma prodhues

dhe shpërndarës për ndërtesat. Duke lidhur në mënyrë ligjore ndërtesën ku do të arrijë shërbimi me pronarin e saj, i cili do të përdorë shërbimin dhe do të paguajë për të, sistemi formal i pronësisë kufizon rrezikun e vjedhjes së shërbimit. Po ashtu kufizon humbjet financiare nga grumbullimi i faturave nga njerëzit që janë të vështirë të gjenden, si edhe humbjet teknike që mund të vijnë nga vlerësimi i pasaktë i nevojave energjetike në zonat ku bizneset dhe banorët kanë natyrë klandestine dhe nuk janë të regjistruar. Pa njohur se cili ka të drejtë dhe pa një sistem ligjor të integruar ku aftësia për të zbatuar detyrimet të jetë e transferuar nga grupet e jashtëligjshme të qeveria, organizatat e shërbimeve nuk do të ishin në gjendje të ofronin shërbime në mënyrë fitimprurëse. Ndryshe, si do të mundnin ata të identifikonin përfituesit, të hartonin kontrata të përdorimit të shërbimeve, të vendosnin lidhjet e shërbimit dhe të kishin në dispozicion parcelat dhe ndërtesat? Si do të mund të zbatonin ndryshe sistemin e faturimit, leximin e matësve, mekanizmat e arkëtimit, kontrollin e humbjeve, kontrollin e shkeljeve, procedurat e tarifimit dhe shërbimet e detyrueshme ndaj veprimeve të papërgjegjshme si në rastin e stakimit të matësve?

Ndërtesat janë gjithmonë stacioni i fundit i shërbimeve publike. Ajo që i shndërron ato në pika fundore të verifikueshme dhe të përgjegjshme është pronësia ligjore. Kushdo që dyshon në lidhje me këtë mjafton të shohë situatën e shërbimeve publike jashtë Perëndimit, ku humbjet teknike dhe financiare si dhe vjedhjet e shërbimit përbëjnë 30 deri 50 për qind të shërbimit total të ofruar.

Po ashtu, pronësia ligjore në Perëndim u ofron bizneseve informacion mbi asetet dhe pronarët e tyre, adresat të verifikueshme, si dhe regjistrime objektive në lidhje me vlerën e pronës, gjë që çon në regjistrimin e kreditimit. Ky informacion dhe ekzistenca

e ligjit të integruar e bën riskun më të menaxhueshëm, duke e shpërndarë atë përmes mekanizmave të sigurimit, si dhe duke i mbledhur pronat për të siguruar borxhet.

Shumë pak vetë duket se e kanë vënë re që sistemi formal pronësor i një kombi të përparuar është qendra e një rrjete të dendur ndërlidhjesh që i lejon qytetarët e zakonshëm të krijojnë lidhje me qeverinë dhe sektorin privat, në mënyrë që të përfitojnë mallra dhe shërbime të tjera. Pa mekanizmat e pronësisë formale, vështirë se mund të mendohet ndonjë mënyrë për të nxjerrë nga asetet atë që nxirret prej tyre në Perëndim. Ndryshe, si mund të identifikohen kredimarrësit e besueshëm nga ana e organizatave financiare në shkallë të gjerë? Si mund të sigurohet një investim në fushën e industrisë në Çikago prej objekteve fizike, si lënda drusore në Oregon? Si mund të gjenden dhe të kontraktohen klientë që paguajnë faturat nga ana e kompanive të sigurimit? Ndryshe, si mund të sigurohet ndërmjetësimi i informacionit ose hetimi e verifikimi i shërbimeve në mënyrë efikase dhe të lirë? Ndryshe, si do të mund të grumbulloheshin taksat?

Është sistemi pronësor që nxjerr potencialin abstrakt prej ndërtesave dhe e fikson në akte përfaqësimi që na lejojnë t'i përdorim ndërtesat në forma të tjera veç strehimit. Sistemet e titujve në vendet në zhvillim nuk arrijnë të prodhojnë kapital sepse nuk njohin faktin se prona shkon përtej pronësisë. Këto sisteme funksionojnë thjesht si inventarë të pronës për certifikatat dhe hartat e asetëve, duke mos lejuar krijimin e ndonjë mekanizmi tjetër, i cili është i domosdoshëm për thurjen e një rrjeti ku asetet mund të kenë një jetë paralele në formën e kapitalit. Pronësia formale nuk duhet të ngatërrohet me këto sisteme inventarizimi që ngajjnë me Librin Anglez të Domesday të 900 viteve më parë ose me inventarin e bagazheve në një aeroport ndërkombëtar. Një sistem pronësor, i kuptuar dhe i

hartuar siç duhet, krijon një rrjet të gjerë përmes të cilit njerëzit mund të bashkojnë asetet e tyre në forma më të vlefshme.

EFEKTI PRONËSOR NR. 6

Mbrojtja e Transaksioneve

Një arsye e rëndësishme për të cilën sistemi formal pronësor i Perëndimit punon si strukturë është fakti se gjithë regjistrimet pronësore (titujt, marrëveshjet, dokumentet dhe kontratat që përshkruajnë aspektet e rëndësishme ekonomike të aseteve) gjurmohen dhe mbrohen vazhdimisht gjatë kalimit në kohë dhe hapësirë. Ndalea e parë është pranë agjencive publike, të cilat janë kujdestarët e përfaqësimeve në vendet e përparuara. Mbajtësit e regjistrave publikë administrojnë dokumentet që përmbajnë përshkrimet ekonomikisht të rëndësishme të aseteve, qofshin këto toka, ndërtesa, kasolle, anije, industri, miniera apo aeroplanë. Këto dokumente lajmërojnë çdo individ që kërkon të përdorë një aset në lidhje me kufizimet ose fuqizimet që përfshijnë realizimin e tij, si pengesat, thjeshtësimet, qiratë, fushat e përdorimit, falimentimet dhe hipotekat. Agjencitë, gjithashtu, garantojnë që asetet të jenë të përfaqësuar në mënyrë të qenësishme dhe të përpiktë sipas formatesh të përshtatshme, të cilat azhurnohen dhe janë të disponueshme për të gjithë.

Përveç sistemeve publike të mbajtjes së regjistrimeve, shumë shërbime të tjera private janë zhvilluar për të ndihmuar palët në fiksimin, lëvizjen dhe gjurmimin e përfaqësimeve, në mënyrë që këto të fundit të prodhojnë në mënyrë të thjeshtë dhe të sigurt vlerë shtesë. Këto përfshijnë ente private që regjistrojnë transaksionet, organizata të mbikëqyrjes dhe konkludimit të transaksionit, arshivistë, vlerësues, firmat e sigurimit të titujve dhe besueshmërisë, agjentë hipotekues, agjenci shërbimi të trusteve dhe kujdestarë privatë të dokumenteve. Në Shtetet

e Bashkuara, kompanitë e sigurimit të titujve ndihmojnë më tej në mobilizimin e përfaqësimeve duke nxjerrë politika të mbulimit të palëve për risqe specifike që variojnë nga defektet në lidhje me titujt deri te pamundësia e zbatimit të hipotekave e patregtueshmëria e titujve. Sipas ligjit, të gjithë këto ente duhet të ndjekin standarde operative të përpikta, të cilat rregullojnë kapacitetet mbajtëse të dokumenteve, infrastrukturat e ruajtjes fizike dhe organikën.

Megjithëse janë krijuar për të mbrojtur si sigurinë e pronësisë edhe atë të transaksioneve, është e qartë se sistemet Perëndimore vënë theksin mbi sigurinë e transaksioneve. Siguria përqendrohet fillimisht në prodhimin e besimit në transaksione, në mënyrë që njerëzit të bëjnë të mundur lehtësisht që asetet e tyre të ndjekin një jetë paralele si kapital.

Nga ana tjetër, në vendet në zhvillim, ligji dhe agjencitë zyrtare kanë ngecur në ligjin e hershëm kolonial e romak, i cili vë theksin për nga mbrojtja e pronësisë. Janë bërë mbrojtës të dëshirave të të vdekurve. Kjo shpjegon pse krijimi i kapitalit nga prona Perëndimore ndodhë kaq thjesht dhe përse pjesa më e madhe e aseteve në vendet në zhvillim dhe ish-komuniste kanë rrjedhur jashtë sistemit formal ligjor në kërkim të lëvizshmërisë.

Perëndimi vë theksin mbi sigurinë e transaksioneve, gjë lejon qytetarët të zhvendosin sasi të mëdha të aseteve me shumë pak transaksione. Si mund të shpjegohet ndryshe fakti se, në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste, njerëzit vazhdojnë të dërgojnë derra në treg, duke i tregtuar një nga një, sikurse kanë bërë për mijëra vjet, ndërkohë që në Perëndim, tregtarët marrin në treg dokumentet e përfaqësimit të të drejtave të tyre mbi derrat? Për shembull, tregtarët e Shkëmbimeve të Mallrave të Çikagos, merren vesh me dokumente, të cilët japin më tepër informacion në lidhje me derrat që tregtojnë, krahasuar me hetimin fizik të

çdo derri. Ata janë në gjendje të arrijnë marrëveshje për sasi të mëdha derrash, duke mos u shqetësuar shumë për sigurinë e transaksioneve.

Kapitali dhe Paraja

Gjashtë efektet e një procesi të integruar të pronësisë nënkuptojnë se shtëpitë Perëndimore nuk janë krijuar thjesht për të siguruar mbrojtje nga shiu dhe i ftohti. Të shoqëruara me një ekzistencë të përfaqësuar, këto shtëpi mund të ndjekin një jetë paralele, duke zhvilluar aktivitet ekonomik si kurrë më parë. Një sistem i mirëintegruar i pronës kryen në thelb dy funksione: së pari, redukton fuqishëm koston e njohjes së cilësive ekonomike të aseteve, duke i riparaqitur në mënyrë të tillë që të kapen shpejt nga shqisat tona; dhe, së dyti, thjeshtëson aftësinë për të rënë dakord në lidhje me përdorimin e aseteve për të krijuar prodhim të mëtejshëm dhe për të intensifikuar ndarjen e punës. Gjenialiteti i Perëndimit ka qenë krijimi i një sistemi që lejon njerëzit të kapin me mendje vlerat që nuk mund të shihen dhe të prekin gjëra që nuk kapen nga duart.

Shekuj më parë, studiuesit arsyetonin që ne përdorim fjalën “kapital” (nga fjala latine “kokë”) sepse koka është vendi ku ruajmë mekanizmat me të cilët krijohet kapitali. Kjo do të thotë se arsyeja pse kapitali ka qenë gjithmonë i zhytur në mister është fakti se, sikurse energjia, mund të zbulohet dhe menaxhohet vetëm me mendje. E vetmja mënyrë për të prekur kapitalin është që sistemi pronësor të regjistrojë aspektet ekonomike të tij në letër dhe t’i lidhë me një vendndodhje dhe pronar specifik.

Pra, prona nuk është thjesht letër, por një sistem ndërmjetësimi që rrok dhe ruan atë që është e nevojshme për të vënë në punë një ekonomi tregu. Prona hedh fillesat e sistemit, duke i bërë njerëzit të verifikueshëm e të dokumentueshëm dhe asetet të shkëmbyeshme, duke gjurmuar transaksionet dhe

duke vendosur në punë mekanizmat e nevojshëm që sistemi monetar dhe bankar të vihen në punë dhe investimet të funksionojnë. Lidhja mes kapitalit dhe parasë moderne kalon përmes pronës.

Sot janë regjistrimet e pronësisë dhe transaksioneve që u japin autoriteteve monetare dëshminë themeltare për të cilën ato kanë nevojë për të filluar një tender ligjor. Sikurse shkencëtarët konjektivë George A. Miller dhe Philip N. Johnson-Laird shkruanin më 1976: “Kartëmonedha e ka origjinën në shkrimin e dëftesave të borxheve. [Kështu pra,] paraja... presupozon institucionin e pronësisë”⁹. Dokumentacioni pronësor është ai që fikson tiparet ekonomike të aseteve në mënyrë që këto të fundit të përdoren për të siguruar transaksionet tregtare dhe financiare dhe përfundimisht të prodhojnë justifikime në bazë të të cilave banka lëshon paratë. Për të themeluar kreditin dhe për të prodhuar investime, njerëzit nuk lënë peng asete fizike, por përfaqësimet pronësore – titujt dhe aksionet e regjistruara – të cilat rregullohen në bazë të procedurave të zbatueshme në shkallë vendi. Paraja nuk krijon para. Ju keni nevojë për një të drejtë pronësie para se të merrni paratë. Edhe nëse jepni para hua, e vetmja mënyrë që të nxirrni fitime është të huazoni ose të investoni kundrejt ndonjë dokumenti pronësor që fikson të drejtat tuaja për principalin dhe interesat. Le ta përsërisim: Paraja presupozon pronësi.

Ashtu sikurse kanë theksuar ekonomistët modernë gjermanë Gunnar Heinsohn dhe Otto Steiger: “Paraja mund të krijohet vetëm e parë nga këndvështrimi pronësor, pronë e cila duhet të ekzistojë para se të lindë paraja”¹⁰. Duke vënë re ngjashmëritë mes punës së tyre dhe times, ata vunë në dukje një element të një neni që thotë se “interesi dhe paraja nuk mund të kuptohen pa institucionin e pronës”¹¹. Sipas tyre, kjo lidhje zbehet nga keqkuptimi i përhapur se bankat qendrore lëshojnë para dhe

garantojnë aftësinë e bankave tregtare për të kryer pagesa. Sipas pikëpamjes së Heinsohn dhe Steiger, ajo që i shpëton syrit është “fakti se gjithë paradhëniet jepen në saje të pengjeve bankare”¹² ose, sipas fjalëve të mia, kundrejt dokumenteve të pronësisë. Ata bien dakord me Harold Demsetz se themelet kapitalistike të lidhura me të drejtat pronësore merren si të mirëqena dhe vënë re se Jozeph Schumpeter aludonte se janë të drejtat pronësore ato që sigurojnë krijimin e parasë. Siç ka theksuar në mënyrë të saktë Tom Bethell në librin e jashtëzakonshëm “Triumfi më fisnik”, “bekimet e shumta të sistemit pronësor privat nuk janë analizuar kurrë siç duhet”¹³.

Kapitali, sikurse u argumentua më sipër, nuk krijohet nga paraja, por nga njerëzit, sistemet pronësore të të cilëve i ndihmojnë ata që të bashkëpunojnë dhe të mendojnë se si mund të shfrytëzojnë asetet e tyre për të vënë në punë prodhim shtesë. Rritja e konsiderueshme e rezervave të kapitalit në Perëndim gjatë dy shekujve të kaluar është pasojë e një sistemi pronësor të përmirësuar gradualisht, i cili i ka lejuar agjentët ekonomikë të zbulojnë dhe kuptojnë potencialin e asetëve dhe kështu të gjenden në kushtet e prodhimit të parave joinflacioniste me të cilat financojnë dhe vënë në punë prodhim shtesë.

Kështu pra, ne jemi diçka më tepër se ketra që magazinonjë ushqim për dimrin dhe kryejnë konsum të diferencuar. Përmes përdorimit të sofistikuar të institucioneve pronësore, ne dimë se si t’u japim gjërave që grumbullojmë një jetë paralele. Kur kombet e përparuara bashkuan gjithë informacionin dhe rregullat e njohura në lidhje me asetet dhe themeluan sistemet e pronësisë që gjurmonin vlerësimin ekonomik të asetëve, ata bashkuan në një urdhër të vetëm gjithë procesin institucional që lidhet me krijimin e kapitalit. Nëse kapitalizmi do të kishte tru, ky do të ndodhej në sistemin ligjor të pronësisë. Por, sikurse shumë gjëra të tjera që i përkasin mendjes, pjesa më e madhe e

“kapitalizmit” sot vepron në nivelin e të pandërgjegjshmes.

Pse ekonomistët klasikë, të cilët e dinin se kapitali është koncept abstrakt dhe duhet të fiksohet, nuk arritën të vendosin lidhjen mes kapitalit dhe pronës? Një shpjegim mund të jetë fakti se, në kohën e Adam Smithit dhe të Marksit, sistemet e pronësisë ishin ende të kufizuara dhe të pazhvilluara, kështu që rëndësia e tyre ishte e vështirë të konceptohej. Mbase, më me rëndësi akoma, lufta për të ardhmen e kapitalizmit ndërroi fushëbetejën nga studiot me libra të teoricienëve në një rrjet të gjerë sipërmarrësish, financierësh, politikanësh dhe juristësh. Vëmendja e botës u kthye nga teoritë në marrëveshjet reale që kryheshin në terren ditë pas dite, vit fiskal pas viti fiskal.

Në momentin që mekanizmi i gjerë i kapitalizmit ishte i fiksuar dhe themeluesit e tij ishin të zënë duke grumbulluar pasuri, pyetja që lidhej me krijimin e tij e humbi rëndësinë. Ashtu sikurse njerëzit që jetonin në pasuri ose në grykëderdhjet pjellore të ndonjë lumi të gjatë, avokatët e kapitalizmit nuk kishin ndonjë nevojë të ngutshme për të hetuar rrjedhën e sipërme të burimit të përparimit. Pse të shqetësoheshin? Megjithatë, me mbarimin e Luftës së Ftohtë, kapitalizmi u bë mundësia e vetme e qenësishme për zhvillim. Kështu që pjesa tjetër e botës iu kthye Perëndimit për ndihmë dhe u këshillua të imitonte kushtet jetësore pranë grykëderdhjeve të lumenjve: monedha të qëndrueshme, tregje të hapur dhe biznese private, gjithë objektivat, pra, të ashtuquajtura makroekonomike dhe reformat radikale strukturore. Të gjithë e harruan se arsyeja e jetës së pasur pranë grykëderdhjes zbulohet në rrjedhën e sipërme, atje ku zënë fill ujërat e pazbuluar. Sistemet ligjore pronësore lehtësisht të disponueshme përbëjnë lymën e rrjedhës së sipërme që lejon kapitalin modern të burojë lirshëm.

Kjo është një nga arsyet themelore për të cilat reformat makroekonomike nuk funksionojnë. Imitimi i kapitalizmit në

nivel grykëderdhjeje, duke importuar filiale të *McDonald's* dhe *Blockbuster*, nuk mjafton për të krijuar pasuri. Çka nevojitet është kapitali dhe një gjë e tillë kërkon një sistem të gjerë e të ndërlikuar ligjor pronësor i cili, në Perëndim, merret si i mirëqenë.

Kambana e Qelqtë e Braudel

Margjinalizimi i të varfërve në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste vjen nga paaftësia për të përfituar nga gjashtë efektet që ofron pronësia. Sfida me të cilën përballen këto vende nuk lidhet me faktin nëse duhet të prodhojnë ose të marrin para, por me faktin se a munden të kuptojnë institucionet ligjore dhe t'i bëjnë thirrje vullnetit politik të nevojshëm për të ndërtuar një sistem pronësor që bëhet lehtësisht i disponueshëm për të varfrit.

Për historianin francez Fernand Braudel përbënte një mister të madh fakti që, në fillimet e tij, kapitalizmi Perëndimor u shërbente vetëm pak të privilegjuarve, sikundër vepron sot në pjesën tjetër të botës:

Problemi kyç është të zbulohet pse ai sektor social i së kaluarës, të cilin nuk ngurroj ta quaj kapitalist, duhet të jetonte i mbyllur brenda në kambanë qelqi, i veçuar nga pjesa tjetër; pse nuk ishte në gjendje të zgjerohej dhe të pushtonte gjithë shoqërinë?... [Pse] një normë e konsiderueshme kapitali mund të formohej vetëm në sektorë të caktuar dhe jo në gjithë ekonominë e tregut të asaj kohe?... Mbase do të ishte disi paradoksale të mendohej se paraja nuk ishte me pakicë si gjithçka tjetër... pra ishte një epokë ku toka e të varfërve blihej kollaj dhe ndërtesat e mëdha provinciale ngriheshin mbi të, monumentet madhështore gdhendeshin dhe ekstravaganca kulturore finançohej... [Si] mund të kuptohet kontradikta... mes

klimës së rënies ekonomike dhe madhështisë së Firences nën Lorencon e Mrekullueshëm?”¹⁴.

Mendoj se përgjigjja e pyetjes së Braudel gjendet në disponibilitetin e kufizuar të pronësisë formale, ndodhur kjo në të kaluarën e Perëndimit dhe në të sotmen e vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste. Investitorët lokalë dhe të huaj zotërojnë kapital; asetet e tyre integrohen, likuidohen, përfshihen në strukturë dhe mbrohen nga sistemet formale të pronësisë. Por këta përbëjnë vetëm pakicën – ata që mund të përballojnë shpenzimet e avokatëve ekspertë, ata që kanë lidhje të brendshme dhe durimin e nevojshëm për t’u përballur me burokracinë e sistemit të tyre pronësor. Shumica e individëve, të cilët nuk arrijnë të mbledhin frytet e punës së përfaqësuar nga sistemi formal pronësor, jetojnë jashtë kambanës së Braudel.

Kambana e ka kthyer kapitalizmin në një klub privat, i cili qëndron i hapur vetëm për pak të privilegjuar dhe përjashton miliona të tjerë që e admirojnë nga larg. Aparteidi kapitalist do të vazhdojë në mënyrë të pashmangshme deri në çastin kur të përballemi me rrjedhjet kritike në sistemet ligjore dhe politike të shumë vendeve që pengojnë shumicën të përfshihet në sistemin formal pronësor.

Ka ardhur çasti të zbulohet se përse shumica e vendeve nuk kanë qenë në gjendje të krijojnë sisteme pronësore formale të hapura. Në kohën kur vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste po kryejnë përpjekjet më ambicioze për të zbatuar sisteme kapitaliste, ka ardhur çasti që të hapet kambana.

Por para se t’i përgjigjemi kësaj pyetjeje, duhet të zgjidhim pjesën tjetër të misterit që lidhet me faktin se përse qeveritë kanë qenë të ngadalta në njohjen e arsyes së ekzistencës së kambanës.

4

MISTERI I NDËRGJEGJËSIMIT POLITIK

*Dëgjoni, dëgjoni! Qentë po lehin,
Lypsarët po vijnë në qytet:
Disa me zhele e disa pa dhëmbë,
Dhe disa me xhybe të mëndafshhtë.*

(Vjershë angleze për fëmijë)

Zbehja e tipareve popullore dhe ligjeve mandative ka qenë një prirje e pakundërshtueshme në vendet në zhvillim për 40 vitet e shkuar dhe në ish vendet komuniste për 10 vitet e shkuar. Që kur filluan reformat ekonomike të Ten Hsiao Pin më 1979, 100 milionë kinezë kanë braktisur shtëpitë e tyre në kërkim të profesioneve në të zezë. Tre milionë emigrantë të paligjshëm kanë zaptuar Pekinin duke krijuar një lëmsh me punishte me krah të lirë pune në periferi të qytetit. Port-au-Prince është zgjeruar 15 herë; Guajakil 11 herë dhe Kajro 4 herë. Tregu i zi përbën 50 për qind të PKB në Rusi dhe Ukrainë, dhe ka arritur në 62 për qind në Gjeorgji. Organizata Botërore e Punës raporton se që prej 1990, 85 për qind e gjithë vendeve të reja të punës në Amerikën Latine dhe Karaibe janë krijuar

prej sektorit informal. Në Zambia, vetëm 10 për qind e fuqisë punëtore është e punësuar në formë të rregullt.

Si po kundërpërgjigjen këto vende ndaj këtyre fenomeneve? Shumë punë po kryhet. Zyrtarët kanë përveshur mëngët dhe i kanë hyrë punës, duke iu adresuar secilit problem në mënyrë individuale. Për shembull, në gusht 1999, autoritetet e Bangladeshit shëmbën 50,000 kasolle në kryeqytetin Daka. Atje ku fadroma nuk hyn, qeveritë kanë ndërtuar shkolla dhe trotuare për miliona zaptues që kanë pushtuar tokat publike dhe private. Në të njëjtën kohë, qeveritë kanë mbështetur programe të vogla financimesh për të ndihmuar punishtet me krah të lirë pune që po shndërrojnë zonat e banuara në qendra industriale në të gjithë botën. Zyrtarët kanë përmirësuar stendat e shitësve nëpër trotuare duke bllokuar rrugët, duke pastruar malet e mbeturinave e duke mbjellë lule në vend të tyre, kanë forcuar kodet e ndërtimit dhe sigurisë për të parandaluar rrëzimin e ndërtesave sikurse ka ndodhur në Turqi gjatë tërmetit të 1999. Qeveritë janë përpjekur të detyrojnë shoferët e pavarur të autobusëve dhe taksistët e pavarur që bllokojnë trafikun që t'i përmbahen standardeve minimale të sigurisë; ata po bllokojnë vjedhjet dhe humbjet në shpërndarjen e ujit të pijshëm dhe elektricitetit, si dhe po përpiqen që patentat dhe të drejtat e autorit të respektohen. Ata kanë arrestuar dhe ekzekutuar gangsterët dhe trafikantët e drogës që u kanë rënë në dorë (të paktën ata më të famshmit), si dhe kanë burgosur të tjerë (të paktën për disa kohë); ata kanë marrë masa sigurie për të kontrolluar ndikimin e grupeve politike ekstreme, që ushtrojnë ndikim mbi grupet popullore me rrënjë patriotike dhe që preken lehtë.

Secili problem shoqërohet me një specialitet akademik që merret me studimin e tij dhe hartimin e programit politik për t'u përballur me të. Shumë pak vetë duket se e kanë kuptuar

se ai me të cilin përballemi është një revolucion i stërmadh industrial botëror: një lëvizje madhore prej jetës së organizuar në shkallë të ngushtë drejt jetës së organizuar në shkallë të gjerë. Për mirë ose për keq, njerëzit jashtë Perëndimit po largohen nga shoqëritë e vetmuara dhe të veçuara në një përpjekje për të ngritur standardin e jetesës, duke u bërë të ndërvuarur në tregje shumë më të gjera.

Ajo që njihet botërisht është fakti se shoqëritë e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste po përjetojnë të njëjtin revolucion industrial që mbërriti në Perëndim më tepër se dy shekuj më parë. Ndryshimi është se ky revolucion i ri po përparon shumë më shpejt dhe po ndryshon jetën e shumë më tepër njerëzve. Britania administronte vetëm 8 milionë banorë kur 250 vjet më parë nisi kalimin nga ferma te kompjuteri portativ. Indonezia po kryen të njëjtin udhëtim vetëm në 4 dekada dhe ka një popullsi prej 200 milionë banorësh. Nuk është për t'u habitur që institucionet e saj nuk kanë qenë në gjendje të përshtaten. Por ato duhet të përshtaten. Një rrymë e tërë njerëzimi është zhvendosur prej bashkësive dhe familjeve të veçuara për t'u përfshirë në qarqet gjithnjë në rritje të shkëmbimeve ekonomike dhe intelektuale. Pikërisht kjo rrymë ka shndërruar Xhakartën, Meksikon, Sao Paolon, Nairobin, Bombein, Shangain dhe Manilën në megaqytete prej 10, 20 e 30 milionë banorë, duke mbingarkuar me punë institucionet politike dhe ligjore.

Dështimi i rendit ligjor për të ecur me një hap me kryengritjen ekonomike dhe sociale i ka detyruar emigrantët e rinj që të zbulojnë zëvendësues informale për ligjin e vendit. Ndërkohë që në vendet e përparuara janë përhapur të gjitha format e transaksioneve anonime tregtare, emigrantët e vendeve në zhvillim merren vesh vetëm me ata njerëz që njohin dhe të cilëve u zënë besë. Marrëveshje të tilla informale dhe kuturu nuk funksionojnë fort mirë. Sikurse ka theksuar Adam Smithi,

sa më i gjerë tregu, aq më e theksuar është ndarja e punës. Dhe ndërkohë që puna sa vjen e specializohet, ekonomia bëhet më efikase, ndërkohë që vlera e pagave dhe e kapitalit rritet. Një mospërputhje ligjore që pengon sipërmarrësit të ndërmjetësojnë me të panjohurit dëmton ndarjen e punës dhe shpejton sipërmarrësit e ardhshëm që të hyjnë në cikle të ngushta specializimi dhe prodhueshmërie të ulët.

Sipërmarrja ka triumfuar në Perëndim sepse ligji i ka integruar të gjithë nën një sistem të vetëm pronësie, duke u ofruar mekanizmat për të bashkëpunuar dhe për të prodhuar sasi të mëdha vlere shtesë në një treg të zgjeruar. Përparimet e Perëndimit, deri në rritjen e sotme të informacionit elektronik dhe të teknologjisë së telekomunikacioneve, kanë ndodhur vetëm për faktin se sistemet e së drejtës pronësore që janë të domosdoshme për këto arritje kanë qenë në vendin e duhur. Sistemet e integruara ligjore të pronësisë kanë shkatërruar grupet e mbyllura, duke nxitur ndërkohë krijimin e një rrjeti të gjerë ku potenciali për të krijuar kapital është rritur në mënyrë të konsiderueshme. Në këtë drejtim, prona i bindet të ashtuquajturit Ligj Metcalfe (që ka marrë emrin nga Bob Metcalfe, zbuluesi i Standardit Ethernet që lidh kompjuterët personalë). Sipas ligjit Metcalfe:

Vlera e një rrjeti – që përcaktohet në bazë të vlerës së krijuar për popullsinë – lidhet me numrin e përdoruesve të përfshirë në rrjet. Një shembull është rrjeti i telefonisë. Një telefon i vetëm është i papërdorshëm: kujt do t'i telefononit? Dy telefona janë më mirë; por jo shumë mirë. Vetëm në çastin kur shumica e popullsisë disponon telefona, fuqia e rrjetit arrin potencialin maksimal për të ndryshuar shoqërinë¹.

Ashtu sikurse rrjeti i kompjuterëve, i cili ka ekzistuar shumë kohë para se ndokush të lidhej me të, sistemet pronësore u bënë tmerrësisht të fuqishme kur u integruan në rrjet të gjerë. Vetëm në këtë çast, potenciali i një të drejte pronësore nuk është më i kufizuar brenda imagjinatës së pronarit, fqinjtit apo të njohurve të tij, por bëhet subjekt i një rrjeti të gjerë imagjinatash. Vetëm në këtë çast njerëzit do të pranojnë t'i nënshtrohen një kodi ligjor sepse do të kuptojnë se pa këtë kod nuk do të mund të përparojnë. Vetëm në këtë çast qeveria mund të fillojë të administrojë zhvillimin në vend që të rendë heroikisht duke u përpjekur të bllokojë gjithë rrjedhjet. Një qeveri moderne në një ekonomi tregu moderne nuk mund të jetë e shëndetshme pa një sistem të integruar pronësor formal. Problemet që janë shfaqur së fundmi në tregjet joperëndimore vijnë për shkak të fragmentimit të marrëveshjeve pronësore dhe mungesës së normave standarde që lejojnë asetet dhe agjentët ekonomikë të ndërveprojnë dhe qeveritë të drejtojnë përmes ligjit.

Kur emigrantët kalojnë prej vendeve në zhvillim e atyre ish-komuniste në kombet e përparuara, institucionet e përparuara i përfshijnë në mënyrë të pashmangshme brenda sistemit strukturor të pronës që i nxit të prodhojnë vlerë shtesë. Njerëzit që lëvizin brenda vendeve të tyre nuk rehatohen në këtë formë – të paktën jo kaq shpejt. Vendeve të varfra u mungojnë institucionet që integrojnë emigrantët në sektorin formal, fiksojnë asetet e tyre në formë të këmbyeshme, i bëjnë pronarët e tyre agjentë të verifikueshëm dhe u ofrojnë atyre mekanizmat për ndërlidhje dhe fuqizim që ndikojnë në ndërveprimin prodhues dhe krijimin e kapitalit brenda një tregu të gjerë ligjor. Kështu që emigrantët çajnë shtigje në kurriz të rendit ligjor, duke zbuluar një shumëllojshmëri marrëveshjesh informale për të zëvendësuar ligjet dhe institucionet për të cilët kanë nevojë për të bashkëpunuar në një treg të gjerë.

Kështu pra, verbëri politike do të thotë të mos jesh në dijëni se rritja e sektorit jashtëligjor dhe rrëzimi i rendit ligjor vijnë përfundimisht si pasojë e një zhvendosjeje gjigande nga jeta e organizuar në shkallë të ngushtë drejt jetës së organizuar në një kontekst më të gjerë. Ajo që nuk kuptojnë udhëheqësit kombëtarë është fakti se njerëzit po organizohen në mënyrë spontane në grupe të veçuar informale dhe do mbeten kështu deri në çastin që qeveria do t'u ofrojë një sistem ligjor pronësie.

Problemi themeltar për vendet joperëndimore nuk është fakti që njerëzit po shkojnë në qendrat urbane, që mbeturinat po bëhen mal, që infrastruktura është e pamjaftueshme apo që fshati po braktiset. Të gjitha këto kanë ndodhur në vendet e përparuara. Po ashtu, zgjerimi urban nuk është problem. Los Anxheles është zgjeruar më shpejt se Kalkuta në këtë shekull dhe Tokio është 3 herë më i madh se Delhi. Problemi themeltar është vonesa në njohjen e faktit se çrregullimi që po vjen jashtë Perëndimit është rezultat i një lëvizjeje revolucionare, e cila përmban më tepër premtime se probleme. Në çastin që do t'i vihen frena vlerave potenciale të lëvizjes, shumë probleme do të jenë më të thjeshta për t'u zgjidhur. Vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste duhet të zgjedhin që, ose të ndryshojnë qeverinë për t'ia përshtatur ndryshimeve të vazhdueshme të ndarjes revolucionare të punës, ose të vazhdojnë të jetojnë në amullinë informale – dhe kjo e dyta nuk është zgjedhje e mençur.

Pse të gjithë nuk e kanë kuptuar problemin e vërtetë? Sepse ka dy pika që njerëzit nuk arrijnë të kuptojnë. Së pari, shumica e njerëzve nuk vënë re se fryrja e popullsisë informale botërore gjatë 40 viteve të shkuar ka prodhuar një klasë të re sipërmarrësish me marrëveshjet e tyre ligjore. Autoritetet qeveritare shohin veç një fluks masiv njerëzish dhe punonjësish informale nga njëra anë dhe kërcënimin në rritje prej sëmundjeve dhe krimit nga

ana tjetër. Kështu pra, ndërkohë që ministria e strehimit merret me çështjet e saj dhe ministra e shëndetësisë dhe ajo e drejtësisë me problemet e tyre, askush nuk e vë re se shkakut real i amullisë nuk është popullsia, rritja urbane apo pakicat e varfra, por një sistem ligjor pronësor i dalë mode.

Njerëzit janë si puna e 6 të verbërve që qëndrojnë para një elefanti: Njëri prej tyre kap noçkën e lëvizshme dhe mendon se elefanti është gjarpër; një tjetër kap bishtin dhe mendon se është litar; i treti mahnitet nga veshët e mëdhenj që duken si vela; tjetri rrok këmbën dhe arrin në përfundimin se elefanti është pemë. Asnjëri nuk e vështron elefantin në gjithë madhësinë e tij dhe kështu ata nuk arrijnë të ndërtojnë një strategji për t'u përballur me problemin e madh që kanë përpara. Siç kemi vënë re, të varfrit e vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste përbëjnë 2/3 e popullsisë botërore – dhe nuk kanë rrugë tjetër veç të rrojnë jashtë ligjit. Po ashtu, të varfrit zotërojnë shumë gjëra, por të drejtat e tyre pronësore nuk rregullohen me ligj. Miliona sipërmarrës që mbulojnë 85 për qind të vendeve të punës në Amerikën Latine, 3 milionë kinezët që jetojnë jashtë Pekinit duke u marrë me punishtet me krah të lirë pune dhe ata rusë që krijojnë gjysmën e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (PPB) kombëtar, veprojnë në bazë të marrëveshjeve informale. Në shumicën e rasteve këto marrëveshje spontane pronësore bien direkt në kundërshti me ligjin zyrtar të shkruar. Kemi një elefant para syve.

Unë nuk besoj se shfaqja e vatrave të vogla të sektorëve të përparuar ekonomikë në mes të sektorëve të gjerë të pazhvilluar informalë karakterizon lindjen e një tranzicioni të pabarabartë por të pashmangshëm drejt sistemeve kapitaliste. Ekzistenca e vatrave të përparuara në një det varfërie më tepër fsheh një mangësi ogurzezë të kapacitetit kombëtar për të krijuar, respektuar dhe për t'i vënë në dispozicion shumicës së qytetarëve të drejta të pronësisë formale.

Pika e dytë që njerëzit nuk kuptojnë është fakti se shumë pak vetë e kuptojnë se problemet me të cilat ballafaqohen nuk janë të reja. Migrimi dhe informaliteti që pllakos qytetet në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste ngjan shumë me atë që përjetonin kombet e përparuar të Perëndimit gjatë revolucioneve të tyre industriale. Edhe ata u përpoqën të zgjidhnin problemet një nga një. Mësimi që del nga Perëndimi është se zgjidhjet gjysmake dhe masat e tërthorta që ndërmerren për të lehtësuar varfërinë nuk janë të mjaftueshme. Standardet e jetesës u ngritën vetëm kur qeveritë reformuan ligjin dhe sistemin që lidhej me pronën për të thjeshtuar kështu ndarjen e punës. Me aftësinë për të rritur prodhueshmërinë përmes efekteve pozitive të sistemeve të integruar të pronësisë, njerëzit e zakonshëm qenë në gjendje të specializoheshin nëpër tregje vazhdimisht në zgjerim dhe të rritnin kapitalin e krijuar.

PIKA E PAKUPTUAR 1

Jeta jashtë Kambanës Sot

Pse nuk e parashikuaam këtë revolucion të ri industrial? Në vitet '80, kur gjendesha me punë së bashku me kolegët e mi në Peru, shumë zyrtarë mendonin se pjesa jonë e botës kontrollohej në shkallë të gjerë nga ligji. Amerika Latine kishte një traditë të vjetër, të rafinuar dhe të respektuar ligjore. Pa dyshim, kishte njerëz të varfër që zinin vende pune dhe zotëronin prona në formë informale, por ky sektor informal konsiderohej relativisht i vogël dhe kështu përbënte një çështje "marginale". Vendet e përparuara kishin racionin e tyre të varfërisë, papunësisë dhe tregjeve të zeza, ne kishim tonin. Përballja me këto fenomene ishte më tepër çështje e policisë ose e një grupi sociologësh akademikë që ia kishin përkushtuar jetën studimit të veprimtarive ekzotike vendase. Në rastin më

të mirë, të varfrit përbënin model për programet e “National Geographic” dhe “Discovery Channel”.

Por askush nuk kishte të dhëna të sakta. Askush nuk dinte si të maste se çfarë po bënin realisht të varfrit ose se sa zotëronin ekzaktësisht. Kështu, së bashku me kolegët e mi vendosa të lija mënjanë librat dhe gazetat akademike, për të mos përmendur statistikat dhe hartat qeveritare, për të shkuar te ekspertët e vërtetë që merreshin me këto probleme: vetë të varfrit. Kur dolëm në rrugë për të parë e dëgjuar, nisëm të grumbullojmë fakte habitës. Për shembull: industria peruane e ndërtimit ishte në krizë. Ndërtimi po binte dhe punëtorët po pushoheshin nga puna. Megjithatë, për çudi, në pikat e shitjes së materialeve të ndërtimit, paraja vazhdonte të qarkullonte. Në fakt, sasia e çimentos së shitur ishte rritur. Thasë të tërë shiteshin çdo ditë. Pas një hetimi më të hollësishëm, ne zbuluam se të varfrit po blinin më tepër çimento se kurrë për projektet e tyre të ndërtimit – shtëpi, ndërtesa dhe biznese që nuk regjistroheshin e dokumentoheshin në formë ligjore duke mos arritur kurrë në kompjuterët e ekonomistëve dhe statistikienëve qeveritarë. Filluam të ndiejmë një ekonomi vibruese, të pavarur dhe zyrtarisht të padukshme, pra informale, që gëlonte në qytetet e botës në zhvillim. Për shembull, në Brazil, industria e ndërtimit raportonte një rritje 0.1 për qind për vitin 1995; e megjithatë shitja e çimentos për gjashtë muajt e parë të 1996 ishte rritur me 20 për qind. Arsyeja e kësaj anomalie, sipas analizës së “Deutsche Morgan Grenfell”, është fakti se 60 deri 70 për qind e ndërtimeve të rajonit nuk janë regjistruar kurrë².

Çështja e sektorit informal nuk ishte e vogël. Ishte shumë e madhe.

Qytetet në rritje

Lëvizja drejt qyteteve pësoi një rritje stratosferike, në vitet '60 për shumicën e vendeve në zhvillim dhe në vitet '80 për Kinën. Për arsye të ndryshme, bashkësitë e veçuara braktisën jetën e izoluar dhe nisën të integrohen nëpër qytete. Që prej viteve '80, miliona fshatarë kinezë janë grumbulluar në mënyrë të paligjshme rreth qyteteve në një shkallë të tillë, sa që e përditshmja "Beijing Youth Daily" shpalli se "menaxhimi i popullsisë migrative ka dalë jashtë kontrollit"³.

Ky fenomen është vënë re në vendet e Mesdheut. Sipas Henry Boldrick, pas Luftës së Dytë Botërore, migrantët ruralë të Turqisë u drejtuan për nga qytetet, duke ndërtuar vendbanimet mbi pronën qeveritare. Këto vendbanime spontane, të njohura si "gecekondus", strehojnë sot gjysmën e popullsisë urbane turke. Megjithëse një pjesë e "gecekondus" janë legalizuar pjesërisht duke siguruar kështu disa shërbime bashkiake, shumica e tyre mbeten informale⁴.

Në Filipine, gazeta "Business World" i bëri thirrje qeverisë "të frenonte rrymën e popullsisë që po ngjishej në qytete, të cilët kishin arritur pikën e shpërthimit... Mund të shihen kasolle të ndërtuara me beton dhe blloqe në formën e llogoreve - dhe nisim të mendojmë thellë. Çfarë po bën qeveria në lidhje me problemin e të pastrehëve dhe zaptimin që po ndodh në qytetet tona?"⁵.

Në Afrikën e Jugut, disa vëzhgues (duke përfshirë këtu edhe veten time) besojnë se sektori informal i pasurive të patundshme është në prag të një zgjerimi të dytë të madh. Më 1998, "Newsweek" raportonte se "gjithnjë e më shumë afrikano-jugorë të zinj po mbushin kampet e strehimit dhe qytetet-kasolle që rrethojnë qytetet jugafrikane. Nën aparteid, ligjet raciale ngjeshnin të zinjët në zonat rurale. Tashmë ata udhëtojnë lirshëm - por nuk ndihen rehat"⁶. Revista "Economist" vërteton

këtë prirje: “Megjithëse dhuna politike kundër të bardhëve nuk është shfaqur kurrë, fundi i ndarjes raciale ka thjeshtuar endjen e të zinjve të varfër në zonat e pasura të bardha”⁷.

Në Egjipt, intelektualët dhe teknokratët duket se janë ndërgjegjësuar për këtë çështje. Sipas një raporti të fundit, mes viteve 1947 dhe 1989, “popullsia totale urbane e Egjiptit është... rritur... nga 6.2 milionë në 23.46 milionë banorë”⁸. Të dhënat e grumbulluara nga Gerard Barthelemy tregojnë se popullsia e zonave qytetare të Port-au-Prince, në Haiti, është rritur nga 140,000 më 1950, në 1,550,000 në 1988 dhe tani po i afrohet shifrës 2 milionë. Barthelemy vlerëson se rreth 2/3 e këtyre banorëve jetojnë në qytete-kasolle ose në ato që haitianët i quajnë *bidonvilles*⁹.

Në Meksikë, sektori privat është bërë gjithnjë e më i ndërgjegjshëm ndaj fenomenit informal dhe është përfshirë aktivisht në veprimtari kundër tij. Sipas një raporti:

Një studim i vitit 1987, i kryer nga Qendra për Studimet Ekonomike të Sektorit Privat (CPSES), vlerësonte se sektori informal jashtëligjor vinte në punë një aktivitet që përfshinte 28 për qind deri në 39 për qind të PPB zyrtare meksikane dhe një studim i 1993... “vlerëson se numri i banorëve të përfshirë në “sektorin informal të paregjistruar” arrin 8 milionë nga 23 milionë banorë që përbëjnë fuqinë punëtore totale... “Për çdo biznes formal, ekzistojnë dy biznese informale”, thotë Antonio Montiel Guerrero, president i Dhomës Tregtare për Bizneset e Vegjël e Qytetit të Meksikos (CANACOPE), një grup që përfaqëson 167,000 biznese të vegjël të regjistruar formalisht. “Në Distriktin Federativ (Meksiko) gjenden rreth 350,000 biznese të vegjël informale me një popullsi totale të përfshirë prej 8 milionë banorësh”. Rezultati i derivuar për metropolin 20 milionë banorësh të Meksikos

është i dukshëm, sidomos duke pasur parasysh se qytetet me kasolle të paligjshme janë përqendruar jashtë qendrës boshtore të qytetit¹⁰.

Zonat informale në vendet në zhvillim karakterizohen nga shtëpi modeste që bashkohen pranë perimetrit të qyteteve, një pafundësi punishtesh, ushtri të tëra shitësish që shesin në rrugë dhe linja të vogla miniautobusësh që i bien kryq e tërthor qyteteve. Të gjitha këto duket se kanë dalë nga hiçi. Rryma të qëndrueshme zanatçinjsh me vegla në duar kanë zgjeruar diapazonin e aktiviteteve që kryen në qytet. Përshtatjet e zgjuara vendase i shtohen prodhimit të mallrave dhe shërbimeve të konsumit, duke shndërruar në mënyrë dramatike disa sektorë të prodhimit, shitjes me pakicë, ndërtimit dhe transporteve. Peizazhet pasivë që dikur rrethonin qytetet e Botës së Tretë janë kthyer në zgjerimin e fundit të metropoleve dhe qytetet e modeluara sipas stilit evropian kanë marrë një personalitet të zhurmshëm, të pleksur me imitime monotone të zonave tregtare nënurbane amerikane.

Përmasat e mëdha të këtyre qyteteve ofrojnë mundësi të veçanta. Pronarët e rinj të bizneseve kanë dalë mbi sipërfaqe dhe ndryshe nga paraardhësit e tyre, fillesat e tyre janë të dyshimta. Lëvizshmëria në drejtim të qendrës është rritur. Tiparet e konsumit dhe lukset ekskluzive të shoqërisë së vjetër urbane janë zëvendësuar nga forma të reja më të gjera.

Marshi drejt Qyteteve

Sigurisht migrimi është faktori kyç i rritjes urbane në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste. Megjithatë, shkaqet e tij janë të vështira për t'u kuptuar. Analistët e shumë vendeve ofrojnë shpjegime të ndryshme: lufta, programi i reformës agrare, mungesa në reformë agrare, një embargo e huaj mbi tregtinë

ndërkombëtare, hapja ndaj tregtisë ndërkombëtare, terrorizmi dhe veprimtaritë guerile, rënia morale, dështimi i kapitalizmit, dështimi i socializmit, madje shija e keqe (Nëse është kaq bukur në fshat, pse nuk qëndrojnë atje?).

Megjithatë, kohët e fundit, opiniononi është përqendruar rreth disa shkaqeve të përgjithshme. Shpjegimi më i dukshëm për valën e migrimit në botën në zhvillim është përmirësimi i rrugëve. Ndërtimi i rrugëve dhe urave dhe shndërrimi i shtigjeve të palidhshëm në rrugë të mira ka zgjuar popullsinë rurale për mundësinë e udhëtimit dhe kështu që ata nisën të lëvizin drejt qyteteve. Veçanërisht radioja nxiti parashikimet për konsum dhe të ardhura më të larta. Nga mijëra kilometra larg vijnë transmetime radiofonike që promovojnë mundësitë, komoditetet dhe përfitimet që vijnë nga jeta urbane. Modernizmi arriti në veshin e gjithë atyre që kishin guxim për të ulur kokën dhe për të vazhduar rrugën.

Po ashtu, ekziston një bindje e gjerë se krizat bujqësore kanë përbërë një faktor vendimtar në shumë vende. Modernizimi i bujqësisë dhe tregu i pasigurt për shumë të mbjella tradicionale që pasuan periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, nxitën braktisje masive të fermave dhe hoqën lakun nga gryka e një kontingjenti të gjerë njerëzish të përgatitur për të kërkuar një horizont të ri.

Gjithashtu, ishte edhe problemi i të drejtave pronësore në fshat. Procesi i gjatë dhe i vështirë i reformës agrare vetëm sa bashkoi - dhe përkeqësoi përfundimisht - vështirësitë tradicionale të zotërimit të tokës pjellore. Duke mos qenë në gjendje të zotërojnë tokë apo të gjejnë punë në fshat, shumë njerëz migruan për në qytete.

Një tjetër element i fuqishëm tërheqës ishte norma më e ulët e vdekshmërisë foshnjore në qytetet kryesore. Hendeku i vdekshmërisë foshnjore mes qytetit dhe fshatit u zgjerua

edhe më shumë, teksa shërbimet mjekësore në qytete nisën të përmirësoheshin pas Luftës së Dytë Botërore. Po ashtu, pagat më të mira përbënin një stimul tjetër. Për shembull, në Amerikën Latine, në vitin 1970, njerëzit që linin fshatin për të zënë vende pune gjysmë të specializuara në kryeqytete, arrinin të dyfishonin dhe trefishonin të ardhurat e tyre mujore. Një punë e rregullt e paguar mund të katërfishonte të ardhurat e tyre, ndërkohë që profesionistët dhe teknikët mund të siguronin gjashtë herë më tepër se fitimi nga bujqësia. Pagat më të larta nxitën riskun e papunësisë: Një emigrant që kishte mbetur i papunë për një vit, mund të rifitonte të ardhurat e humbura për dy muaj e gjysmë në qytet. Jeta në qytetet e largëta nuk dukej më e mirë; ishte më e mirë.

Edhe zgjerimi i burokracive kombëtare u kthye në nxitës për migracionin. Centralizimi i pushtetit në duart e zyrtarëve qeveritarë nënkuptonte se shumica e zyrave qeveritare që merreshin me konsultimin, që analizonin kërkesat, që lëshonin leje ose krijonin vende pune gjendeshin nëpër qytete. Për fshatarët e papunë, të cilët veç zgjuarsisë nuk kishin gjë tjetër, arsimimi përbënte një investim prodhues mjaft të vlefshëm. Qytetet grumbullonin pjesën më të madhe të të diplomuarve në shkollat e mesme si edhe studentë që studionin në qendra të trajnimit profesional, në shkolla dhe institute të arsimit të lartë dhe, gjithashtu, aplikues e studentë universitarë.

Kështu pra, migrimi nuk përbën një fakt irracional. Nuk ka të bëjë me konceptin “yxhym kush e kap i pari”. Është më tepër produkt i një vlerësimi të llogaritur dhe racional nga ana e banorëve ruralë të gjendjes së tyre aktuale krahasuar me mundësitë e hapura për ta gjetkë. Mirë apo keq, ata besonin se migrimi për në tregje të gjerë do të ishte fitimprurës për ta. Megjithatë, lëvizja nuk ishte e thjeshtë.

Njerëzit e Varfër shkojnë në Shtëpi

Migrantët që shkuan nëpër qytete u ballafaquan me një botë agresive. Shumë shpejt ata kuptuan se, megjithëse banorët urbanë ndanin një përfytyrim romantik dhe madje të ëmbël në lidhje me banorët ruralë, si dhe ishin të mendimit se gjithë qytetarët kanë të drejtë të jenë të lumtur, ata parapëlqenin që fermerët e mirë ta kërkonin lumturinë në shtëpinë e tyre. Fshatarët nuk duhet të vinin të kërkonin modernizmin. Në fund, çdo vend i botës në zhvillim dhe i asaj ish-komuniste zhvilloi programe zhvillimi që kishin për qëllim dërgimin e modernizmit në fshat.

Kundërshtia më e madhe ndaj emigrantëve vinte prej sistemit ligjor. Në fillim, sistemi mund t'i përthithte ose shpërfillte lehtësisht ata sepse grupet e vogla që vinin nuk ishin në gjendje të ndryshonin *status quo*-në. Megjithatë, ndërsa numrat e tyre rriteshin deri në atë pikë sa të mos shpërfilleshin më, të ardhurit e rinj e gjetën veten të veçuar nga aktivitetet ekonomike dhe sociale të themeluara ligjërisht. Ishte tmerrësisht e vështirë për ta të gjenin shtëpi, të hynin në bizneset formale apo të gjenin ndonjë vend pune të ligjshëm. Institucionet ligjore të pjesës më të madhe të Botës së Tretë janë zhvilluar në vite për t'i shërbyer nevojave dhe interesave të grupeve të caktuara urbane; përballimi i nevojave fshatare në zona rurale ishte një çështje tjetër. Për sa kohë që fshatarët nuk lëviznin nga vendi, diskriminimi ligjor i nënkuptuar nuk ishte i dukshëm. Megjithatë, kur ata vendoseshin nëpër qytete, përjetonin aparteidin e ligjit formal. Papritur, kambana u bë e dukshme.

Disa prej vendeve të ish Bashkimit Sovjetik shfaqin çrregullime në sistemin pronësor dhe të paktën disa elita po fillojnë të njohin përfitimet ekonomike të klasifikimit. Sipas një raporti të vitit 1996:

Mekanizmat... e nevojshëm për të mbrojtur të drejtat tokësore janë ende të rinj në Rusi... Në shumë rajone, toka duhet të regjistrohet pranë një agjencie të ndryshme nga ajo që regjistron ndërtesat. Për më tepër, mbrojtja ligjore që ofrohet nga regjistrimi është e paqartë... Procedurat dhe rregullat e mbrojtjes dhe përdorimit të të drejtave tokësore mbijnë nga hiri... Toka është mbase burimi më i vlefshëm i Rusisë, një burim mbi të cilin mund të bazohet e gjithë ekonomia dhe një shoqëri e tërë demokratike¹¹.

Kemi zbuluar se në Botën e Tretë aktivitetet informale gëlojnë në çdo vend ku sistemi ligjor vendos rregulla që frenojnë shpresat e të përjashtuarve. Sikurse kemi vënë re në Kreun 2, shumë vende krijojnë pengesa kaq të tmerrshme dhe të shtrenjta për t'u kaluar në sistemin ligjor të pronësisë, saqë shumë pak migrantë arrijnë të çajnë burokracinë - për këtë kërkohen 14 vjet, 77 procedura burokratike në 31 agjenci private dhe publike në Egjipt; 19 vjet dhe 176 hapa burokratike për të legalizuar blerjen e pronës private në Haiti.

Nëse ekzistojnë kosto për t'u bërë i ligjshëm, ekziston edhe një çmim për t'u paguar për të mbetur jashtë ligjit. Kemi vënë re se operimi jashtë profesioneve dhe bizneseve të ligjshëm është shumë i kushtueshëm. Për shembull, në Peru, kostoja e operimit në rrugë informale kërkon që 10 deri 15 për qind e të ardhurave vjetore të shkojnë për ryshfete dhe komisione në adresë të autoriteteve. Nëse i shtohet zarfeve kostoja e shmangies së dënimeve, transfertat jashtë kanaleve zyrtare dhe veprimtaritë pa kreditim nga vendndodhjet e largëta, jeta e sipërmarrësve informalë del shumë më tepër e kushtueshme dhe plot me pengesa krahasuar me jetën e afaristit të ligjshëm.

Mbase kostoja më thelbësore është shkaktuar nga mungesa e institucioneve që krijojnë stimuj për njerëzit që të kapin mundësitë ekonomike dhe sociale, si dhe të specializohen në treg. Kemi zbuluar se njerëzit që nuk mundin të veprojnë brenda ligjit, nuk mund të zotërojnë pronësinë në mënyrë efikase dhe nuk mund të zbatojnë kontrata për shkak të vendimeve gjyqësore; po ashtu nuk mund të reduktojnë pasiguritë përmes sistemeve të përgjegjësive së kufizuar dhe politikave të sigurimit (të pronës, etj.), si dhe nuk mund të krijojnë shoqëri aksionare për të tërhequr kapital shtesë dhe për të pakësuar riskun. Duke mos qenë të aftë të krijojnë para për investime, nuk mund të arrijnë ekonomi të shkallës ose të mbrojnë risitë përmes të drejtave të autorit dhe patentave.

Duke mos qenë në gjendje të hyjnë në kabanë, të varfrit nuk mund t'i afrohen kurrë mekanizmave të pronësisë ligjore që janë të nevojshëm për të prodhuar kapital. Efektet shkatërrimtare ekonomike të këtij aparateidi ligjor janë më të dukshme në kuadrin e mungesës së të drejtave pronësore formale mbi pasuritë e patundshme. Në çdo vend ku kemi kryer kërkime, kemi zbuluar se 80 për qind e parcelave tokësore nuk mbroheshin nga regjistrimet e azhurnuara dhe nuk zotëroheshin nga pronarë ligjorë të verifikueshëm (me dokumente). Pra, çdo shkëmbim i kësaj pronësie informale ishte i kufizuar për qarqe të ngushtë partnerësh tregtarë, të cilët i mbanin asetet e pronarëve informale jashtë tregut të zgjeruar.

Pronarëve të aseteve informale u është mohuar disponimi i kreditimit që do t'u lejonte të zgjeronin operacionet e tyre - një hap i rëndësishëm drejt krijimit dhe zgjerimit të një biznesi në vendet e zhvilluara. Për shembull, në Shtetet e Bashkuara, rreth 70 për qind e kredisë që sigurojnë bizneset e rinj, vjen nga përdorimi i titujve formalë si peng për hipotekat. Informaliteti nënkupton se stimujt për investime që vijnë nga siguria ligjore mungojnë.

Duke qenë të veçuar nga sistemi ligjor, garancia e vetme për përparim e emigrantëve qëndron në tokën e tyre. Atyre u është dashur të konkurrojnë jo vetëm me njerëzit e tjerë, por edhe me vetë sistemin. Nëse sistemet ligjore të vendeve të tyre nuk do t'i mirëprisnin, nuk u mbeteshin rrugë tjetër veç të krijonin sistemet e tyre informale. Sipas mendimit tim, këto sisteme informale përbëjnë rebelimin më të rëndësishëm kundër *status quo*-së në vendet në zhvillim që pas arritjes së pavarësisë dhe në vendet e ish bllokut sovjetik që prej rrëzimit të komunizmit.

Informaliteti në Rritje

Popullsia e pjesës më të madhe të qyteteve të Botës së Tretë pothuaj është katërfishuar në katër dekadat e fundit. Më 2015, më tepër se 50 qytete të botës në zhvillim do të kenë nga 5 milionë banorë ose më tepër¹², pjesa më e madhe e të cilëve do të jetojnë dhe punojnë në rrugë informale. Sektori informal është i kudondodhur në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste. Aktivitetet e reja kanë mbirë dhe gradualisht kanë zëvendësuar ato tradicionale. Nëse kaloni nëpër rrugë, do të hasni në dyqane informale, agjenci këmbimi valutë informale, mjete transporti informale dhe shërbime të tjera informale. Edhe shumica e librave që blini janë shtypur në formë informale.

Lagje të tëra janë blerë, zhvilluar dhe ndërtuar duke anashkaluar pjesërisht ose shpërfillur tërësisht rregullat qeveritare përmes vendbanimeve dhe bizneseve informale. Për çdo njëqind shtrëpi të ndërtuara në Peru, vetëm 30 prej tyre kanë tituj ligjorë; 70 të tjera janë ndërtuar në formë informale. Në Amerikën Latine kemi zbuluar se të paktën 6 nga 8 ndërtesa i përkisnin sektorit informal dhe se 80 për qind e pasurive të patundshme mbahej në formë jashtëligjore. Sipas vlerësimeve, sektori informal i vendeve në zhvillim përfshin 50 deri 75 për qind të popullsisë dhe është përgjegjës për 1/5 deri 2/3 e prodhimit total ekonomik në Botën e Tretë.

Kini parasysh Brazilin: Tridhjetë vjet më parë, më tepër se 2/3 e ndërtimeve shtëpiake jepej me qira; sot, banesat me qira përbëjnë vetëm 3 për qind të industrisë braziliane të ndërtimit. Pjesa më e madhe e tregut ka kaluar në pjesët informale të qyteteve braziliane – nëpër *favela*. Sipas Donald Stewart:

Njerëzit nuk janë të ndërgjegjshëm për vëllimin e aktivitetit ekonomik që operon nëpër *favela*. Këto ekonomi informale kanë lindur prej shpirtit sipërmarrës të fshatarëve të Brazilit Veri-Lindor, të cilët u tërhoqën nga qendrat urbane. Ata veprojnë jashtë ekonomisë formale të rregulluar në formë strikte dhe funksionojnë sipas ofertës dhe kërkesës. Me gjithë mungesën në dukje të burimeve, këto ekonomi informale funksionojnë në mënyrë efikase. Nëpër *favela* nuk ka kontroll të qirave, qiratë paguhen me dollarë amerikanë dhe ata që nuk paguajnë nxirren nga shtëpitë. Përfitueshmëria e investimeve është e mirë dhe, si rezultat, ka një tepricë oferte për shtëpi¹³.

Gazeta “Wall Street Journal” raportonte më 1997 se, sipas grupit “Miqte e Tokës”, vetëm 10 për qind e tokës së zënë në xhunglën braziliane të Amazonave mbulohet nga dokumente pronësorë¹⁴. Edhe në vende të tjera, informaliteti është në rritje.

Ndryshe nga vendet e zhvilluara, ku klasa “informale” përbën një pakicë të vogël që jeton në caqet e shoqërisë, në disa vende të tjera informaliteti ka përbërë gjithnjë rrjedhën kryesore. Për shembull, në shumë prej vendeve që kemi anketuar, vlera e pasurive të patundshme informale është shumë herë më e lartë se kursimet totale dhe depozitat me afat në bankat tregtare, gjithë investimet e huaja të marra bashkë dhe gjithë sipërmarrjet publike që janë privatizuar ose janë gati për privatizim. Në dukje, kjo nuk duhet të jetë e habitshme. Pasuritë e patundshme

përbëjnë 50 për qind të pasurisë kombëtare të kombeve të zhvilluara; në vendet në zhvillim, shifra arrin $\frac{3}{4}$. Vendbanimet informale janë shpesh i vetmi burim për investime në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste dhe kështu pra, përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të procesit të kursimit dhe formimit të kapitalit. Për më tepër, kontributi në rritje i qyteteve në Prodhimin e Përgjithshëm Bruto (PPB), nënkupton se shumë kapital dhe teknologji potenciale po grumbullohet në zonat kryesore urbane.

Informalët kanë ardhur për të mos ikur

Ky shpërthim aktiviteti informal në Botën e Tretë, largimi masiv nga zonat rurale dhe zgjerimi i qyteteve informale – *pueblos juvenes* në Peru, *favelas* në Brazil, *ranchos* në Venezuelë, *barrios marginales* në Meksikë dhe *bidonvilles* në ish kolonitë franceze si dhe qytetet-kasolle në ato britanike – nuk përbëjnë thjesht një rritje të popullsisë, varfërisë apo informalitetit. Këto rryma informale po godasin kambanën e privilegjit ligjor dhe mbase përbëjnë faktorin më të rëndësishëm që po detyron autoritetet që të mirëpresin revolucionin industrial dhe tregtar që po bie mbi to.

Qeveritë e shumë vendeve nuk janë në gjendje t'i bëjnë ballë fuqisë informale. Për sa u përket përmasave, sipërmarrjet informale kanë sprapsur përpjekjet qeveritare për të ofruar strehim për emigrantët dhe të varfrit. Për shembull, deri në fund të viteve '80 në Peru, investimet qeveritare në strehim për persona me të ardhura të ulëta ishin sa 2 përqindëshi i investimeve për strehim të sektorit informal. Duke përfshirë shpenzimet për strehim për klasën e mesme, qeveria është vetëm sa 10 përqindëshi i investimeve totale informale. Më 1995, në Haiti, vlera e pasurive të patundshme informale ishte rreth 10 herë më e lartë se të gjitha zotërimet e qeverisë haitiane.

Sektori informal përbën një zonë gri e cila krijon një kufi të gjatë me botën ligjore, një vend ku individët gjejnë strehim kur kostoja e nënshtrimit ndaj ligjit tejkalon përfitimet. Migrantët janë kthyer në informale për të mbijetuar: Ata dolën jashtë ligjit sepse nuk pranoheshin brenda tij. Për të jetuar, tregtuar, prodhuar, transportuar dhe konsumuar, banorëve u është dashur të veprojnë në formë informale.

Marrëveshjet informale që kanë nënshkruar janë detyrime të nënkuptuara të disa anëtarëve të shoqërisë për të krijuar siguri për pronën dhe aktivitetet e tyre. Ato përfaqësojnë kombinime rregullash të huazuara në formë të përzgjedhur nga sistemi zyrtar ligjor, improvizime të rastësishme dhe zakone të sjella nga vendet e tyre të origjinës ose të zbuluara në vend; dhe të gjitha këto bashkohen nga një kontratë shoqërore e garantuar nga bashkësia si një e tërë dhe që zbatohet nga autoritetet e përzgjedhura nga bashkësia. Mangësia e marrëveshjeve informale është se nuk janë të integruara brenda sistemit formal pronësor dhe, si rezultat, nuk janë të këmbyeshme financiarisht dhe të përshtatshme për pjesën më të madhe të transaksioneve; ato nuk lidhen brenda qarkut financiar dhe investues; pjesëtarët e tyre nuk janë të verifikueshëm për autoritetet që gjenden jashtë kontratave të tyre sociale.

Këto marrëveshje nënshkruhen nga një shumëllojshmëri organizatash, duke përfshirë shoqëritë e zhvillimit urban, konventat bujqësore, shoqëritë e tregtarëve të vegjël, organizatat e biznesit të vogël, bashkësitë e mikro-sipërmarrjes, federatat e transporteve, klubet e pronave të minatorëve, përfituesit e reformave agrare, kooperativat private të strehimit, organizatat e vendbanimeve, bordet e banorëve, komitetet bashkiake, komitetet përfituese të ndërtimeve shtetërore për strehim, bashkësitë vendase, shoqëritë e fermerëve të vegjël si dhe organizatat fshatare. Këto organizata kryejnë zgjerime

infrastruktura në tokë shkretinore, zgjerime infrastrukturore në tokë bujqësore, marrëveshje të veçanta për pjesë historike të qyteteve, nënndarje të strehimit publik, marrëveshje me kontraktues privatë, marrëveshje me kontraktues publikë, përvetësime përmes nënkontraktimit me miratimin e pronarëve, ndërtime shtetërore me dokumente të paplota, kontrata të paligjshme qiramarrjeje të shpallura para një noteri por të paregjistruara, marrëveshje kontraktuale të regjistruara por të padeklaruara para një noteri, marrëveshje të njohura nga “proceset kombëtare të paqes”, marrëveshje me banorët e transferuar si dhe marrëveshje me ofruesit e shërbimeve bazë ose me autoritetet tatimore por të paregjistruara pranë mbrojtësve zyrtarë të pronës.

Informaliteti nuk është një fenomen antishoqëror. “Krimet” që kryejnë informalët janë hartuar për të arritur qëllime të tilla si ndërtim shtëpish, ofrim shërbimesh ose sipërmarrje biznesesh. Duke mos qenë shkak i amullisë, ky sistem ligjor informal është e vetmja rrugë që kanë banorët për të rregulluar jetën dhe transaksionet e tyre. Si rezultat, asgjë nuk mund të jetë më e rëndësishme nga pikëpamja sociale sesa jetesja dhe puna e të varfërve. Megjithëse “ligjet” e tyre qëndrojnë jashtë ligjit formal, ata përbëjnë ligjet e vetme me të cilët njerëzit ndihen rehat. Këto ligje përbëjnë kontratat sociale mbi të cilat njerëzit jetojnë dhe punojnë.

Vendbanimet informale ku banojnë emigrantët mund të duken si të rrënuara, por janë shumë ndryshe nga lagjet e varfra në qendrat e qyteteve të vendeve të zhvilluara. Këto të fundit përbëhen nga ndërtesa dikur të përshtatshme që sot po rrëzohen tërësisht për shkak të lënies pas dore dhe varfërisë. Në botën në zhvillim, vendbanimet tipike të të varfërve mund të përmirësohen, rindërtohen dhe, në mënyrë progresive, të zotërohen. Ndërkohë që shtëpitë e të varfërve të vendeve të

zhvilluara humbasin vlerën me kalimin e kohës, ndërtesat e zonave të varfra të botës në zhvillim bëhen më të vlefshme dhe në pak dekada do t'i ngjajnë banesave të klasës së mesme në Perëndim.

Mbi të gjitha, banorët informalë, ndryshe nga përfytyrimi se ata janë të jashtëligjshëm, ndajnë dëshirën shoqërore për jetë paqësore dhe prodhuese. Sikurse ka shkruar Simon Fass në një përfundim të rrjedhshëm në lidhje me ekonominë e Haitit:

Këta njerëz të zakonshëm janë të jashtëzakonshëm vetëm në një aspekt. Të ardhurat e tyre janë shumë të ulëta, kaq të ulëta sa që një vendim i gabuar ose një akt i papritur fati të keq mund të kërcënojë mbijetesën familjare dhe ndonjëherë, të kërcënojë jetën e pjesëtarëve të familjes. Çka është e jashtëzakonshme nuk është varfëria në vetvete, por aftësia e këtyre njerëzve për të mbijetuar pavarësisht nga ajo... Gjithçka kryejnë ata është një proces që përzien në mënyrë produktive mbijetesën dhe rritjen dhe objektet e thjeshta që ata sigurojnë kanë funksione konkrete si faktorë të procesit të prodhimit¹⁵.

Teksa aktivitetet ekonomike me të cilat janë të lidhura janë zgjeruar dhe diversifikuar, edhe vetë këto organizata informale kanë nisur të marrin përsipër rolin e qeverisë. Në nivele të ndryshme, ato janë bërë përgjegjëse për sigurimin e infrastrukturave të tilla themeltare si rrugët, furnizimi me ujë të pijshëm, shtrirja e kanalizimeve, elektriciteti, krijimi i tregjeve, ofrimi i shërbimit të transporteve, madje dhe për administrimin e drejtësisë dhe ruajtjen e rendit publik.

Para këtyre arritjeve informale, qeveritë janë tërhequr. Por ato kanë prirje që çdo lëshim ta quajnë të përkohshëm deri në “çastin kur kriza të kalojë”. Megjithatë, në realitet, kjo strategji

është vetëm një mënyrë për të shtyrë humbjen e pashmangshme. Në disa raste, qeveritë kanë bërë përjashtime për disa sipërmarrje informale, përmes vatrave ligjore, ku këto sipërmarrje informale mund të veprojnë të papenguara nga ligji – por duke mos i integruar ato në mënyrë që të gëzojnë mbrojtjen dhe përfitimet e sistemit ligjor. Këto arnime shmangin përballjen e hapur dhe, si të tilla, mund të quhen një lloj traktati tranzitor paqeje i ligjshëm. Për shembull, në Egjipt, ekspertët po fillojnë të flasin për “strehimet gjysmë-formale”:

Strehime të tilla jo vetëm që rrisin numrin total të banesave brenda vendit dhe ofrojnë strehim relativisht të lirë, por tërheqin një pjesë të madhe të popullsisë urbane duke i ofruar një aset në të cilin të investojë. Këto lloje banesash kanë një shkallë informaliteti. Strukturat strehuese nuk krijohen përmes procedurave të njohura dhe të rregullta dhe ata që i ndërtojnë, nuk njihen nga institucionet e strehimit. Këto banesa ndërtohen kryesisht mbi tokë bujqësore, e cila është ndarë në mënyrë të paligjshme në ngastra të vogla prej ndërtuesve privatë...

Qeveria zakonisht përfshihet në procesin e përvetësimit të pronës brenda strehimeve gjysmë-informale. Në zonat me banesa gjysmë-formale, ku është kryer anketimi, ish-in organet qeveritare ato që nisin ndërtimin dhe kjo nxiste ndërtuesit privatë që të ndanin tokën në formë të paligjshme në ngastra të vogla në një fazë të mëvonshme. Përdorimi i tokës kaloi nga forma bujqësore në atë rezidenciale përmes ndikimit të fshehur të qeverisë. Banorët e këtyre zonave zakonisht përvetësojnë tokën përmes një procesi informal nënndarjeje dhe përmes tregtimit informal të tokës. Hager El Mawatayah, Exbet Abou Soliman dhe Ezbet El Sid janë shembujt më tipikë të këtyre zonave në qytetin e Aleksandrisë¹⁶.

Edhe në zonat më të pamenduara, ekzistojnë dëshmi se qeveria po njeh se institucionet ligjore nuk janë përshtatur me kushtet e sotme ekonomike. Më 1992, shërbimi mediatik “Reuters” raportoi se udhëheqësi i Libisë, Mu’ammarr Gadhafi, kishte shkruar dokumentet tokësore të Libisë. “Të gjithë regjistrimet dhe dokumentet e regjistrave të vjetër tokësor, të cilët vërtetonin se një sipërfaqe e caktuar i përkiste këtij apo atij fisi, është djegur” – raportoi koloneli Gadhafi në një takim të ministrisë së drejtësisë. “Ato u dogjën sepse bazoheshin në shfrytëzim, mashtrim dhe grabitje”¹⁷.

Në disa vende, sektori informal është futur thellë në rrënjët e sistemit social. Popujt e Tubës në Senegal, që shihen duke u kujdesur për trotuaret e Nju Jorkut dhe qyteteve të tjera të mëdha amerikane, janë shpesh pjesë e një sektori të ndërlikuar Islamiko-Afrikan që kanalizon miliona dollarë të ardhura në qytetet e tyre të origjinës. “Newsweek” e përshkruan Tubën si

“Një shtet brenda shtetit, i veçuar në shkallë të gjerë nga ligjet e Senegalit... [dhe] qyteti me rritjen më të shpejtë në vend. Fshatra të tërë janë zhvendosur këtu, duke ngritur kasolle të vogla mes vilave të të pasurve... Qyteti pa doganë është gllavina e perandorive senegaleze të transporteve dhe pasurive të patundshme, e sektorit informal që po zgjerohet dhe e tregtisë së kikirikut, burimi kryesor i shkëmbimit me jashtë”¹⁸.

Në pjesë të tjera të botës, shqetësimi i informalëve për humbjen e pronës mund të nxisë konflikt të hapur. Një rast i tillë është Indonezia, ku këto probleme kanë përbërë objekt mediatik në vitet e fundit. Para 6 vitesh, “Economist” paralajmëronte:

Njerëzit e varfër janë në prag të humbjes së pronës sepse urbanizimi dhe industrializimi po krijojnë kërkesë për tokë, në një vend, në të cilin pronësia tokësore përbën një biznes shumë të errët. Vetëm 7 për qind e tokës në arkipelagun e Indonezisë ka një pronar të rregullt.

Në mënyrë të pashmangshme, ekziston një tregti e gjerë e certifikatave të ligjshme dhe të paligjshme. Njerëzit që përpiqen të blejnë parcela tokësore shpeshherë gjejnë para vetes shumë pronarë. Dhe bankat nuk para pranojnë që toka të vendoset si peng për të marrë kredi¹⁹.

Në vende të tjera, informaliteti shoqërohet me mjerimin: "Në Bombei... 2/3 e 10 milionë banorëve të qytetit jetojnë në kasolle me nga një dhomë ose mbi dysheme"²⁰. Megjithatë, informalët e vendeve të tjera po ngjisin shkallët ekonomike. Sipas Organizatës së Vlerësimeve Teknike të Perusë (Cuerpo Tecnico de Tasaciones del Peru), vlera e tokës në sektorin informal të Limës arrin në 50 dollarë për metër katror, ndërsa në Gamarra, ku ka qendrën një pjesë e madhe e sektorit prodhues informal të Perusë, vlera e metrit katror arrin 3,000 dollarë. Në Aviacion, një tjetër qendër informale në Limë, vlera e tokës është 1,000 dollarë për metër katror; ndërkohë që në Kimu të seksionit Zarate, arrin 400 dollarë për metër katror. Nga ana tjetër, në Miraflores dhe San Isidro, zonat më të mrekullueshme të Limës, vlera e pronësisë ligjore të dokumentuar varion nga 500 në 1,000 dollarë për metër katror²¹.

Është një Histori e Vjetër

Kur qeveritë të kuptojnë që të varfrit kanë tashmë nën kontroll sasi të mëdha pasurie të patundshme dhe njësisht ekonomike prodhuese, atëherë do të jetë e qartë se shumë prej problemeve me të cilat përballen janë rezultat i mungesës së harmonisë midis ligjit të shkruar dhe mënyrës se si vendi i tyre

funksionon realisht. Është e qartë se, nëse ligji i shkruar bie në konflikt me ligjin sipas të cilit jetojnë njerëzit, pakënaqësia, korrupsioni, varfëria dhe dhuna do të vazhdojnë.

E vetmja çështje që mbetet pezull është se kur qeveria do të nisë të legalizojë këto zotërime informale duke i integruar ato në një strukturë ligjore të rregullt dhe koherente. Alternativa do të ishte nxitja e një anarkie ligjore në të cilën sistemi ligjor i të drejtave ekzistuese pronësore do të konkurronte në mënyrë të vazhdueshme me atë informal. Nëse këto vende duan të arrijnë një sistem të vetëm ligjor, ligji zyrtar duhet të përshtatet me realitetin e shtytjes masive informale drejt të drejtave të gjera pronësore.

Ana pozitive është fakti se reformuesit ligjorë nuk do të bien në greminë. Sfida me të cilën përballen, megjithëse është masive, është përballur më parë në vende të tjerë. Vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste po përballen (megjithëse në përmasa shumë më dramatike) me të njëjtat sfida që u përballën kombet e zhvilluar në periudhën mes shekullit XVIII dhe Luftës së Dytë Botërore. Informaliteti masiv nuk përbën një fenomen të ri. Ndodh gjithmonë kur qeveria nuk arrin të përshtatë ligjin me mënyrën e jetesës dhe punës së njerëzve.

Kur në Evropë nisi Revolucioni Industrial, qeveritë u goditën nga migracioni i pakontrollueshëm, rritja e sektorit informal, varfëria urbane dhe çrregullimet sociale. Edhe këto vende u përballën me problemet një e nga një.

RRUGA QORRE II

Jeta jashtë Kambanës të së Djeshmes

Lëvizja drejt qyteteve

Shumë studiues e lidhin shpërthimin e revolucionit të madh industrial e tregtar në Evropë me masat e migrantëve që vinin

në qytet, rritjen e popullsisë si rezultat i eliminimit të murtajes dhe pakësimin e të ardhurave rurale krahasuar me ato urbane²². Në shekullin e XVII dhe XVIII, punonjësit e qyteteve nisën të siguronin paga më të larta krahasuar me ata të zonave rurale, duke u marrë me zbatimin e projekteve të ndërtimit hartuar nga klasa udhëheqëse. Në mënyrë të pashmangshme, gjithnjë e më shumë fshatarë ambiciozë migronin nëpër qytete, të nxitur nga perspektiva e pagave më të larta.

Në Angli, vala e parë e migracionit nisi në fund të shekullit të XVI. Të shqetësuar nga rritja e popullsisë qytetase dhe përshkallëzimi i çrregullimeve, autoritetet u munduan të mbanin hapin me masa të tilla lehtësuese si shpërndarja e ushqimit për popullsinë e varfër. Po ashtu u zbatuan masa radikale për t'i bindur njerëzit të ktheheshin në fshat. Një seri ligjesh të miratuara më 1662, 1685 dhe 1693 kërkonin që qytetarët të ktheheshin në vendin e lindjes ose në banesën e mëparshme si parakusht për të siguruar ndihmë. Qëllimi ishte parandalimi i migracionit në qytet i familjeve dhe punëtorëve që kërkonin të punësoheshin. Më 1697, u miratua një ligj që lejonte migrantët të lëviznin nëpër Angli vetëm nëse dispononin një certifikatë strehimi nga autoritetet e qendrës së re ku shkonin. Megjithëse këto ligje shkurajuan migracionin e familjeve dhe të të pafuqishmëve, djemtë e rinj, të pamartuar, me shtat të hedhur dhe me ambicie çanë shtigje të reja për t'u kthyer nëpër qytete. Ata kishin brumin e sipërmarrësit të suksesshëm - ose ishin revolucionarë të dhunshëm.

Shumica e migrantëve nuk gjetën vendet e punës që kishin shpresuar. Rregullat kufizuese, sidomos vështirësitë në sigurimin e lejeve për të zgjeruar ose diversifikuar aktivitetet, frenuan kapacitetet e bizneseve formale për t'u zgjeruar dhe për të krijuar vende pune për punëtorët e rinj. Disa prej këtyre të fundit gjetën vende pune të përkohshme ose u përfshinë në

shërbimin shtëpiak²³. Shumë prej tyre u detyruan të banonin në kushte të mjerueshme në rrethinat e qyteteve të Evropës, nëpër “periferi”, në vendbanime informale të kohës, duke pritur për leje në shoqëritë ose profesionet e biznesit ligjor.

Çrregullimet sociale ishin të pashmangshme. Migracioni nëpër qytete kishte pak kohë që kishte nisur dhe institucionet politike ekzistuese ngelën prapa realitetit që ndryshonte shpejt. Ashpërsia e ligjit dhe rregullave tregtare nuk i lejonte emigrantët të realizonin potencialin e plotë ekonomik të tyre. Mbipopullimi nëpër qytete, sëmundjet dhe vështirësitë e pashmangshme të fshatarëve për t’u përshtatur me jetën në qytet përshkallëzuar më tej konfliktin social. D. C. Coleman vëren se, në shekullin e XVI, kishin arritur ankesa para Parlamentit Anglez në lidhje me “shtimin e lypsarëve” si dhe me rritjen e “batakçinjve, vagabondëve dhe hajdutëve” nëpër qytete²⁴.

Në vend që të përshtatej me këtë realitet të ri urban, qeveria shtoi ligjet dhe rregullat për të frenuar këto ngjarje. Rregullat e reja sollën më shumë shkelje – dhe shumë shpejt ligjet e reja u miratuan për të ndëshkuar ata që thyenin ligjet e vjetra. Ligjet riprodhoheshin pa kriter; kontrabanda dhe falsifikimi ishin përhapur gjerësisht. Qeveria mori masa të dhunshme shtypëse.

Lindja e Informalitetit

Gradualisht, emigrantët evropianë që nuk kishin arritur të gjenin punësim të ligjshëm nisën të hapin punishte të jashtëligjshme në shtëpitë e tyre. Aktiviteti bazë ishte “përpunim direkt me pak kapital, përmes veglave të thjeshta të dorës”²⁵. Banorët e vjetër të qyteteve përbuznin punën që kryhej jashtë shoqërive dhe sistemit industrial zyrtar.

Sigurisht, emigrantët nuk mund të ishin nazeqarë; puna informale ishte i vetmi burim të ardhurash dhe sektori informal i shoqërisë nisi të zgjerohej shpejt. Eli Heckscher vlerëson një

koment të Oliver Goldsmith më 1762: “Nuk ekziston një anglez i vetëm që të paktën një herë në ditë të mos thyejë ndonjë ligj të shkruar... dhe nuk ka të korrupsuar apo mercenar që të mos përpiket ta zbatojë atë”²⁶. Dy dekrete franceze (në vitet 1687 dhe 1693), citon Heckscher, njohën se arsyeja e mosrespektimit të kërkesave prodhuese ishte fakti se punëtorët, që ishin edhe më të paarsimuar se ata të vendeve në zhvillim sot, nuk arrinin të përmbushnin as kërkesat minimale ligjore, ndërkohë që prodhuesit e tekstileve nuk vendosnin emrat e tyre mbi etiketat e rrobave. Megjithatë, këta punëtorë emigrantë ishin efikasë. Dikur, Adam Smith theksoi: “Nëse kërkonti që puna juaj të kryhet në nivel të pranueshëm, duhet ta bëni në periferi ku punëtorëve, duke mos pasur asnjë privilegj, u ngelet të varin shpresat vetëm mbi karakterin e tyre dhe më pas prodhimin duhet ta kontrabandoni në qytet në formën më të sigurt të mundshme”²⁷.

Autoritetet dhe bizneset e ligjshëm nuk habiteshin nga konkurrenca që shtangte Adam Smithin. Në Angli, gjatë dekadave pas rivendosjes së monarkisë më 1660, disa tradicionalistë nisën të ankohen në lidhje me shtimin e çikërrimtarëve dhe shitësve të rrugës, çrregullimet që ndodhnin para stendave të dyqaneve dhe shfaqjen e shumë dyqanxhinjve të rinj në shumë qytete të vegjël. Tregtarët formalë u përpoqën më kot të hiqnin qafe të ardhurit e rinj. Në Paris, beteja ligjore mes rrobaqepësve dhe shitësve të rrobave të dorës së dytë zgjati më shumë se 300 vjet. U ndal vetëm nga Revolucioni Francez.

Ligjet dhe rregullat e reja që dilnin në këtë epokë shpesh nuk përputheshin me ligjet dhe rregullat e mëparshme. Sipas Heckscher, basmat e importuara nga India u ndaluan në Angli gjatë viteve 1700 për të mbrojtur industrinë angleze të leshit. Prodhuesit sipërmarrës anglezë prodhonin basmat e tyre, duke arritur të gjenin përjashtime dhe shtigje brenda ligjit. Një mënyrë

për t'iu shmangur ligjit të prodhimit të tekstileve të pambukta ishte përdorimi i cohës së rëndë – basma angleze prodhuar përmes një liri të përdredhur. Po ashtu, Spanja përndiqte dhe ndëshkonte sipërmarrësit informalë. Më 1549, perandori Charles I hartoi 25 urdhëresa me qëllim goditjen e bizneseve informalë. Një ligj kërkonte që autoritetet të dëmtonin ato produkte informale duke dëmtuar buzët ku shkruhej emri i prodhuesit, në mënyrë që blerësit ta dinin se po blinin mall informal. Një gjë e tillë kishte për qëllim turpërimin e shpërndarësve.

Shtypja e qeverisë në drejtim të informalëve ishte e plotë, e ashpër dhe, sidomos në Francë, vdekjeprurëse. Në mes të shekullit të XVIII, ligjet që ndalonin publikun francez të prodhonte, importonte apo të shiste prodhime të pambukta përmbanin ndëshkime që varionin nga skllavërimi e deri te burgimi i përjetshëm. Informalët nuk u frenuan. Heckscher vlerëson se, gjatë një periudhe 10-vjeçare të shekullit të XVIII, francezët ekzekutuan më tepër se 16,000 kontrabandistë dhe prodhues klandestinë për prodhimin ose importimin e paligjshëm të basmave. Një numër edhe më i madh u dënuan të punonin si vozitës nëpër anije ose u ndëshkuan me forma të tjera. Vetëm në qytetin e Valencës, 77 sipërmarrës informalë u varën në litar, 58 u gjymtuan me rrotën e torturës dhe 631 u dënuan të vozitnin nëpër anije luftarë. Autoritetet lanë të lirë vetëm një informal.

Sipas Robert Ekelund dhe Robert Tollison, arsyeja pse autoritetet përndiqnin kaq ashpër informalët nuk lidhej thjesht me faktin se donin të mbronin industrinë ligjore; basmat shumëngjyrëshe vështirësonin edhe grumbullimin e taksave²⁸. Megjithëse ishte i lehtë identifikimi i prodhuesve të tekstileve njëngjyrëshe për të vërtetuar nëse paguanin apo jo taksat, basmat, përmes një procesi të ri ngjyrimi, mund të bëheshin me ngjyra të ndryshme, duke vështirësuar identifikimin e origjinës.

Shteti mbështetej fuqishëm mbi shoqëritë - funksioni parësor i të cilave ishte kontrolli i sipërmarrjes ligjore - për të identifikuar shkelësit e ligjit. Por, duke i bërë ligjet më të ashpra dhe duke përjashtuar kështu prodhuesit informalë, autoritetet detyronin sipërmarrësit që të vendoseshin në periferitë informale. Kur Statuti Anglez i Mjeshtërve dhe Çirakëve i vitit 1563 fiksoi pagat e punonjësve dhe detyroi indeksimin e tyre vit pas viti sipas çmimeve të mallrave të caktuara, shumë prej informalëve të hershëm zhvendosën bizneset e tyre në qytetet provinciale ose themeluan periferi të reja ku mbikëqyrja shtetërore ishte më pak strikte dhe rregullat më fleksibël ose tërësisht të pazbatueshme. Duke u tërhequr në periferi, informalët i shpëtuan syrit vëzhgues të shoqërive, juridiksioni i të cilave arrinte deri në kufijtë e qyteteve.

Kështu pra, konkurrenca informale arriti një pikë ku pronarët e bizneseve formale nuk kishin rrugëzgjdhje tjetër veç të nënkontraktin një pjesë të prodhimit pranë punishteve periferike - duke ngushtuar bazën tatimore dhe duke ndikuar kështu në rritjen e barrës tatimore. Nisi kështu një rreth vicioz me pasoja: taksat më të larta shtuan papunësinë dhe çrregullimet, duke nxitur edhe më shumë migracion në periferi dhe më tepër nënkontraktim pranë prodhuesve informalë. Disa informalëve u eci aq mirë puna, saqë fituan të drejtën për t'u përfshirë në biznesin formal - duke paguar ryshfet dhe duke ushtruar trysni politike.

Shoqëritë u kundërpërgjigjën. Nën drejtimin e Tudorëve, ligje të shumta angleze ndaluan punishtet informale dhe shërbimin informal nëpër periferi. Por numri i madh i informalëve dhe aftësia e tyre për t'u shpëtuar ligjeve shfuqizoi këto përpjekje. Një nga dështimet më të njohura është ai i shoqërive të kapelave dhe mbulesave të Noruiçit, të cilat, pas një fushate të zgjatur dhe të fuqishme kundër operatorëve informalë, nuk

qenë në gjendje të zbatonin të drejtat e tyre ekskluzive ligjore për të prodhuar kapele dhe mbulesa²⁹. Konkurrenca i kishte shkundur mirë këto shoqëri. Coleman mendon se dështimi i tyre ka ardhur si pasojë e “rritjes së ofertës së punës, ndryshimit të tipareve të kërkesës dhe zgjerimit të tregtisë; si dhe për shkak të rritjes së industrive të reja dhe zgjerimit të madh të industrisë prodhuese rurale”³⁰.

Shkërmoja e Rendit të Vjetër

Qeveritë evropiane u detyruan vazhdimisht të tërhiqen para informalitetit në rritje – sikurse po bëjnë sot qeveritë e vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste. Në Suedi, duke mos qenë i aftë të ndalonte krijimin e vendbanimeve informale, mbretit Gustavus Adolfus iu desh të vizitonte çdo banesë informale dhe t’i jepte bekimin e tij për të treguar se qeveria kishte situatën nën kontroll. Në Angli, shteti u detyrua të njohë fillimisht industritë e reja që po lindnin në vende ku nuk kishte shoqëri apo kufizime ligjore; në të vërtetë, informalët kishin krijuar periferitë dhe qytetet e tyre pikërisht për të shmangur kontrollin e shtetit dhe shoqërive. Për më tepër, industritë informale ishin më efikase dhe të suksesshme. U njoh botërisht se industria e tekstileve të pambukta kishte arritur kulmin sepse nuk kishte rregulla strikte sikurse i kishte industria e leshit. Shumë shpejt njerëzit vunë re se banesat informale prodhonin mallra dhe shërbime më të mira se konkurrentët e tyre të ligjshëm brenda kambanës. Më 1588, një raport i paraqitur para Lordit Cecil, ministër i Mbretëreshës Elizabeth I, përshkruante qytetarët e Halifaksit, një nga vendbanimet e reja informale:

Ata shkëlqejnë në politikë dhe industri, shkëlqejnë në përdorimin e tregtisë dhe tokës dhe, në kuadër të metodave të ashpra dhe arrogante të vendit të tyre, ia

kalojnë të tjerëve për zgjuarsi dhe pasuri. Ata përbuzin zakonet e vjetra nëse gjejnë zakone të reja më komode, parapëlqejnë risitë dhe jo t'u bashkëngjiten ceremonive të vjetra... [Ata] zotërojnë një zjarr natyror që lidhet me risitë e një industrie që nuk dorëzohet kurrë³¹.

Informalët nisën të ndërtojnë edhe brenda qyteteve. Në Gjermani, ku ishte i nevojshëm kalimi i një testi dhe sigurimi i një lejeje ligjore për të ndërtuar, “gjendeshin lagje të tëra ku shtëpitë ishin në ndërtim e sipër, megjithëse në atë lagje nuk kishte person të kualifikuar ligjërisht për të ndërtuar”³².

Numri i madh i informalëve, këmbëngulja dhe suksesi i tyre nisën të shkundin themelet e rendit tregtar. Suksesi që kishin ishte siguruar pavarësisht ndikimit shtetëror dhe ishin të prirur të shiheshin nga autoritetet si armiq. Në ato vende ku shteti nxirrte jashtë ligjit dhe përndiqte sipërmarrësit informalë në vend që të rregullonte sistemin për të përthithur sipërmarrjen e tyre, jo vetëm që u vonua përparimi ekonomik, por u rritën pakënaqësitë që arritën deri në dhunë. Manifestimet më të njohura janë revolucioni Francez dhe ai Rus.

Megjithatë, ato vende që u përshtatën shpejt, kryen një tranzicion paqësor në drejtim të ekonomisë së tregut. Në çastin kur shteti kuptoi se një sektor informal punues parapëlqehet shoqërisht, politikisht dhe ekonomikisht nga një numër gjithnjë e më i madh emigrantësh, autoritetet nisën të mos mbështesin më shoqëritë. Si rezultat, në Angli, gjithnjë e më pak njerëz aplikonin për t'u përfshirë nëpër shoqëri, duke i hapur rrugë shtetit që të ndryshonte mënyrën e drejtimit të biznesit.

Po ashtu, edhe pushteti i shtetit ra. Çdo sistem ligjor që ishte po aq i ashpër sa ai që i parapriu Revolucionit Industrial, u dëmtua nga korrupsioni. Një urdhëresë e 1692 e Anglisë theksonte se inspektorët tatimorë të shumë zonave shëtisnin

deri te punishtet dhe fabrikat vetëm për të mbledhur taksën për të cilën qe rënë dakord pa hetuar asnjëherë mallin për të përcaktuar se sa zotëronte pronari. Shumë mbikëqyrës të prodhimit, qofshin ata pjesë e shoqërive ose të caktuar nga shteti, akuzoheshin vazhdimisht për korrupsion dhe abuzim të postit, situatë kjo e lidhur me këndvështrimin qytetar të ligjit.

Edhe vetë pjesëtarët e Parlamentit, të cilët në fund të shekullit të 17-të kishin pushtet për të autorizuar krijimin e bizneseve, dihej se merrnin rryshfete për favore të veçanta. Autoritetet vendore ishin më keq. Më 1601, një drejtues seance në Dhomën e Përfaqësuesve e cilësonte një gjyqtar (oborri asokohe) “si një Krijesë e gjallë që për 5-6 pula nuk do të kursehej të hiqte dore nga një duzinë e tërë Statutesh Penale”. Zyrtarët publikë nuk fajësonin ligjet, por zbatimin jo efikas për sa u përket dështimeve legjislative.

“Në këtë pikë jam i mendimit se nuk mund të hartohen dhe zbatohen ligje më të mira”, shkruhej në një broshurë të 1577. Josef Reid argumenton se rendi i vjetër u shkërmoq për faktin se korrupsioni u përhap nëpër të gjithë institucionet, duke ndarë njerëzit që mund t’ia hidhnin sistemit nga ata që nuk mund ta bënin këtë. Po ashtu, ai argumenton se një sistem ligjor që nxit elementë të caktuar të thyejnë ligjin ndërkohë që të tjerët vuajnë, humbet në mënyrë të pashmangshme prestigjin brenda dy grupeve³³. Drejtësia periferike e paqes jepte pak stimuj për të zbatuar ligjin e qyteteve dhe këto ligje ishin të papranueshme për banorët e periferive. Në fund të shekullit të XVIII i gjithë aparati ligjor ishte dobësuar dhe, në disa vende të tjera, ishte tërësisht i korrumpuar.

Në një kohë kur qeveria kontrollonte gjithçka, njerëzit vinin shpresat e tyre ekonomike mbi qeverinë. Një gjë e tillë nxiti një tipar tipik të parakapitalizmit: Kur pagat u rritën më shpejt se çmimi i ushqimeve, tregtarët kërkuan vendosjen e

tavanit për pagat; kur çmimi i ushqimeve rritej më shpejt se pagat, punonjësit kërkonin një pagë minimale dhe një çmim tavan për ushqimet. Çmimet, të ardhurat dhe pagat u fiksuan përmes trysnisë dhe veprimet politik, një situatë që shkuraonte prodhimin dhe punësimin industrial dhe bujqësor. Kështu pra, as çmimet maksimale dhe as ato minimale nuk mund të zgjidhnin problemin e cilësisë së ulët, mungesës së ushqimeve dhe papunësisë. “Kjo epokë”, shkruan Charles Wilson, “karakterizohet nga dhuna; është një epokë në të cilën qëllimet ekonomike kërkojnë vazhdimisht përdorimin e forcës për t’u përmbushur”³⁴. Ishte një epokë e përshtatshme për beteja ideologjike dhe partizane, si në parlament, ashtu edhe në rrugë.

Në vitin 1680, një lloj fatalizmi kishte lindur për shkak të pamundësisë së dukshme për të arritur zhvillim të qenësishëm ekonomik: “Shumica e prodhuesve të varfër mendojnë se nuk vlejnë dy grosh...; dhe, nëse për të mbajtur nivelin e prodhimit u duhet të punojnë tri ditë në javë, ata nuk do të punojnë katër ditë”³⁵.

Mes kësaj krize ekonomike dhe kësaj amullie sociale, njerëzit më të fuqishëm dhe me më shumë besim në vetvete vendosën të migrojnë ose të përfshihen në lëvizje revolucionare. Mes shekujve të 17-të dhe 19-të, qindra mijëra italianë, spanjollë, francezë dhe evropianë të tjerë emigruan në toka të tjera për të pasur një të ardhme më të mirë. Në Francë, përndjekja e kalvinistëve dhe informalëve të sektorit të tekstileve bëri që shumë sipërmarrës dhe punëtorë të aftë të largoheshin nga vendi, kryesisht për në Angli dhe Holandë, ku vendasit u krijonin kushte për të përparuar.

Më në fund – Pas Treqind Vjetësh

Ndërsa rregullat e strukturuarra gabim ndrydhnin bizneset formale dhe ndërsa informalët shkelnin hapur ligjin dhe kundërshtonin zhvendosjen në periferi, u krijuan kushte që politikanët të përshtateshin me faktet e reja. Ligji nuk zbatohet në mënyrë të vazhdueshme teksa vendbanimet e emigrantëve rrethonin qytetet. Dhe, ndërsa çikërrimtarët, lypsarët dhe hajdutët pushtnin rrugët, teksa informalët prodhonin ose kontrabandonin mallra me të cilat tregu ishte i ngopur, korrupsioni zyrtar u bë i papërmbajtshëm dhe dhuna shkatërroi shoqërinë civile.

Në shumë vende të Evropës Perëndimore, gjatë shekullit të 19-të dhe të 20-të, ligji nisi të përshtatej me nevojat e njerëzve të zakonshëm, duke përfshirë këtu pikëpamjet e tyre në lidhje me të drejtat pronësore. Në këtë kohë, evropianët kishin arritur në përfundimin se ishte e pamundur të qeverisej Revolucioni Industrial dhe prania e informalëve të shumtë përmes rregullimeve të vogla të improvizuara. Më në fund, politikanët kuptuan se problemi nuk gjendej tek njerëzit, por te ligji, i cili shkuraonte dhe ndalonte njerëzit që të ishin produktivë.

Megjithëse imazhi i shoqërisë parakapitaliste dhe rrethanat e shkërmoqjes së saj janë të ngjashme në shumë vende evropiane, pasojat nuk janë gjithmonë të njëjtat. Vendet që bënë përpjekje ligjore për të integruar sipërmarrjet informale përparuan më shpejt se ato vende që vetëm kundërshtonin ndryshimin. Duke thjeshtësuar hyrjen në pronësinë formale, duke pakësuar pengesat e krijuara nga rregullat e dala mode dhe duke lejuar që marrëveshjet ekzistuese lokale të ndikonin mbi ligjin, politikanët evropianë eliminuan kontradiktat e sistemeve ligjore dhe ekonomike dhe lejuan kombet e tyre që të arrinin kulmin e Revolucionit Industrial.

E kaluara e Evropës ngjan në mënyrë të dukshme me të tashmen e vendeve në zhvillim dhe të atyre ish-komuniste. Problemi themeltar është fakti se grupi i dytë nuk po përballet thjesht me popullsinë që sulmon dhe mbytet qytetet, me shërbimet publike që janë bërë të papranueshme, me mbeturinat që janë bërë mal, me fëmijët e varfër që lypin nëpër rrugë apo me përfitimet e reformave makroekonomike që nuk po shijohen nga shumica. Shumë nga këto vështirësi kanë ekzistuar edhe në Evropë (si edhe në Shtetet e Bashkuara) dhe janë kapërcyer. Problemi i vërtetë është fakti se nuk kuptojmë se këto vështirësi përbëjnë një ndryshim të madh të shpresave të njerëzve: Teksa të varfrit vijnë në qytet dhe hartojnë kontrata sociale informale, ata detyrojnë një rishpërndarje më të gjerë të fuqisë. Në çastin që qeveritë e vendeve në zhvillim dhe të atyre ish-komuniste do të pranojnë këtë fakt, do të fillojnë të përshtaten dhe jo t'i rezistojnë ndryshimit.

5

MËSIMET E HUMBURA TË HISTORISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA

*Kjo tokë është bekuar për faktin se duhet të rrëzojë vetëm një tirani:
atë të status quo-së.*

-MILTON DHE ROS FRIDMAN

Teksa interesohesha shumë në rolin e sistemeve formale të pronësisë në zhvillimin ekonomik, kam kryer udhëtime të shumta nëpër kombet e përparuara për të zbuluar se si veprojnë ekspertët e të drejtave pronësore në lidhje me integrimin e asetëve kombëtare informale në një sistem të vetëm ligjor të pronësisë. Pas 13 vjetësh, mijëra kilometrash të përshkuar dhe pasi flokët më kanë marrë bojë gri, kam vizituar çdo organizëm të lidhur me pronën në kombet e përparuar – që nga miqtë e Regjistrisë Tokësore të Madhërisë së Saj, te Autoritetet Ligjore të Alaskës dhe Toki Bo-së Japoneze. Asnjëri nuk dinte të përgjigjej. Të gjithë ekspertët që kam pyetur, të gjithë profesionistët e

institucioneve të shumta të lidhura me pronën që kam vizituar, pranonin se kurrë nuk e kishin menduar këtë pyetje.

Njerëzit që menaxhojnë sistemet e pronësisë në kombet e zhvilluara kanë probleme të tjera. Ata janë të shqetësuar për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e pronësisë. Megjithatë, shqetësimi kryesor i imi nuk është e drejta e pronësisë në vetvete, por “meta-të drejtat” – disponibiliteti ose të drejtat për të pasur të drejta pronësie. Ndërkohë që ne kemi shumë çështje me interes të përbashkët, si për shembull mënyrat e rregullimit të organizatave regjistruese për të integruar informacionin e mbledhur në terren në një bazë të dhënash, ose mënyrat se si mund të hartohen disa procedura për të dixhitalizuar kufijtë në hartat bazë, ekspertët e pronësisë nuk më treguan se si mund të përfshihen në sistemin ligjor të pronësisë të gjithë ata njerëz që zotërojnë asetet e tyre përmes marrëveshjeve informale. Si mund t’u jepen njerëzve të drejta për të pasur të drejta ligjore pronësie?

Nga ajo pak histori perëndimore që kam lexuar, duket qartë se në një çast të caktuar në të kaluarën, kombet Perëndimore kanë kryer një tranzicion prej marrëveshjeve të shpërndara informale në një sistem të integruar të ligjshëm të pronësisë. Atëherë përse nuk hetova historinë për të zbuluar se si Perëndimi zhvilloi sistemin e pronësisë? Miqtë e mi ishin në një mendje dhe historianët e Regjistrimit Tokësor të Madhërisë së Saj dhe Shoqata Gjermane e Anketuesve të Licencuar më treguan librat e tyre të parapëlqyer.

Pasi lexova mijëra faqe, arrita në përfundimin themeltar se tranzicioni drejt sistemeve të integruara ligjore të pronësisë nuk kishte të bënte me teknologjinë (megjithëse teknologjia luan një rol të rëndësishëm mbështetës, sikurse do të shohim në kreun 6). Ndryshimi thelbësor lidhej me përshtatjen e ligjit me nevojat sociale dhe ekonomike të shumicës së popullsisë.

Gradualisht, kombet Perëndimore qenë të afta të kuptonin se kontratat sociale të nënshkuara jashtë ligjit zyrtar përbënin një burim legjitim të ligjit dhe kështu, nisën të gjenin metoda për të përthithur këto kontrata. Kështu, ligji u përshtat për t'i shërbyer formimit të kapitalit popullor dhe rritjes ekonomike. Pikërisht kjo u ka dhënë gjallëri institucioneve Perëndimore të pronës. Për më tepër, ky revolucion i pronës ka qenë gjithmonë një fitore politike. Në çdo vend, janë shfaqur disa burra të ndritur që kanë vendosur se ligji zyrtar nuk kishte kuptim nëse një pjesë shumë e madhe e popullsisë jetonte jashtë tij.

Historitë e shumta në lidhje me pronën në Evropën Perëndimore, në Japoni dhe në Shtetet e Bashkuara japin një mësim të rëndësishëm në lidhje me shqetësimet aktuale të vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste. Në çdo vend, mungesa e ligjit nuk lidhej me krimin, por me një përplasje mes vendosjes së rregullave në nivel bazë tek masat popullore dhe atij në instancat e larta. Në çdo rast, revolucioni zhvillonte shkrirjen graduale të dy sistemeve.

Megjithatë, historitë e detajuara të këtyre vendeve do të ishin të tepërta në këtë libër. Kështu pra, kam vendosur të përqendrohem në Shtetet e Bashkuara, sepse, më tepër se 150 vjet më parë, përbënin një komb të Botës së Tretë. Qeveritë dhe pushtetet gjyqësore të shteteve të reja që ende nuk ishin bashkuar plotësisht, po përpiqeshin të përballeshin me ligjin dhe amullinë e migrantëve, zaptuesve, kërkuesve të arit, bandave të armatosura, sipërmarrësve informalë dhe gjithë personazhet e tjerë piktoreskë të cilët e bënë banimin në Perëndimin Amerikan kaq të egër e megjithatë, po ta shohësh hollë-hollë, kaq romantik. Për një banor të Botës së Tretë sikurse jam unë, ky imazh i së kaluarës së egër është fort i njohur. Megjithëse së bashku me kolegët e mi kam vështirësi të gjej pika të përbashkëta me 11,000 banorët e Dow Jones, ne ndihemi mjaft komodë

me zaptuesit e qytezës Thomas Jefferson në Virxhinia dhe me vendbanimet-kasolle të qytezës Daniel Bun në Kentaki.

Sikurse autoritetet e Botës së Tretë sot, qeveritë amerikane u përpoqën të frenonin zgjerimin bombastik të zaptuesve dhe marrëveshjeve informale; por ndryshe nga autoritetet e Botës së Tretë, ato pranuan, sipas fjalëve të një deputeti amerikan, që: “sistemi tokësor është rrëzuar... dhe në vend që të hartojmë ligje kundër tyre, duhet të hartojmë ligje për ta deri në Malet Shkëmbore të Oqeanit Paqësor”. Ajo që kuptuan politikanët amerikanë, sipas fjalëve të Francis Filbrik, ishte fakti se “forcat që ndikojnë në ndryshimin e ligjit në mënyrë të tërthortë veprojnë jashtë tij”¹. Edhe akti i famshëm Homestead i 1862, i cili pajiste banorët me 160 akra tokë të lirë vetëm për të jetuar mbi të dhe për ta zhvilluar, nuk përbënte thjesht një akt të bujarisë zyrtare, por njohjen e një fakti të kryer: amerikanët kishin banuar – dhe përmirësuar – tokën në formë informale për dekada të tëra. Politikanët e tyre gradualisht ndryshuan ligjin për të integruar këtë realitet në sistemin zyrtar ligjor dhe duke vepruar kështu ata fituan disa pikë politike. Duke ndryshuar kështu ligjet e tyre për t’iu përshtatur marrëveshjeve informale ekzistuese, zyrtarët amerikanë krijuan kushte që asetet e banorëve dhe minatorëve amerikanë të mund të shndërroheshin në kapital. Ashtu sikurse Shtetet e Bashkuara të shekullit të XIX, sfida e kapitalizimit të të varfërve në vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste përbën në fund të fundit një sfidë politike, e cila duhet të reformohet përmes mekanizmave ligjorë.

Kur të filloj të përshkruaj evoluimin e pronësisë në Shtetet e Bashkuara në këtë kre, nuk mendoj të rishkruaj historinë e Amerikës; sikurse adashi im legjendar, thjesht po përpiqem ta zbuloj atë. Siç do të shihni, në këtë proces, kam gjetur shumë shembuj që më kanë kujtuar vendet e sotme në zhvillim dhe ato ish-komuniste: migrime masive, shpërthim të aktivitetit

informal, amulli politike dhe pakënaqësi të përgjithshme në lidhje me një sistem ligjor të dalë mode, i cili refuzon të pranojë se doktrinat dhe formulat e tij nuk kanë ndikim të madh në botën reale. Po ashtu, kam zbuluar se si ligji amerikan ka integruar gradualisht marrëveshjet informale për të vendosur një rend paqësor – duke vërtetuar mendimin e Justice Holmes se është “eksperienca” që i jep gjallëri ligjit dhe duke ilustruar, sikurse do të shohim në kreun tjetër, se ligji duhet të përputhet me mënyrën se si njerëzit menaxhojnë jetën e tyre. Që ligji të mbetet gjallë, ai duhet të mbajë lidhje me kontratat sociale të cilat janë hartuar nga njerëz të vërtetë në realitet.

Paralelizmi me Historinë Amerikane

Duke përzgjedhur në mënyrë të rastësishme për të lexuar periudha të ndryshme të historisë amerikane, është e vështirë të kuptohet sa e rëndësishme ka qenë trysnia amerikane dhe sa i rëndësishëm ka qenë reagimi politik në Shtetet e Bashkuara. Po ashtu, nuk do të jetë e thjeshtë për politikanët dhe teknokratët reformatorë që të zbulojnë atë pjesë të historisë amerikane për të cilën kanë më tepër nevojë, pra, lidhjen mes legalizimit të pronësisë dhe krijimit të kapitalit. Për të qenë shoqërisht dhe politikisht e dobishme, historia duhet grumbulluar në mënyrë të tillë që të ilustrojë problemin në fjalë. Në shkallë të gjerë, specialistët e pronës nuk kanë shkruar shumë në lidhje me tranzicionin nga të drejtat informale te sistemi i integruar ligjor i pronësisë. Për këtë ka shumë arsye.

Së pari, procesi historik nuk është përfunduar ende. Ndryshe nga ajo që beson popullsia, sistemet pronësore të hapura për gjithë qytetarët përbëjnë një fenomen të vonë – jo më shumë se 200-vjeçar – dhe nënkuptimet e plota të tranzicionit duhet ende të shkrihen. Në shumë prej kombeve të Perëndimit, detyra madhore e reformës së gjerë të pronës u përfundua vetëm një

shekull më parë; në Japoni, është plotësuar vetëm 50 vjet më parë. Meqë procesi që krijoi sisteme pronësore të integruara ishte më tepër rezultat i zhvillimit të pandërgjegjshëm sesa i planifikimit të ndërgjegjshëm, nuk është për t'u habitur që duhet kohë, në mënyrë që gjithë mësimet e dobishme për krijimin e pronësisë në kombet e zhvilluara të bëhen të kapshme për njerëzit e vendeve në zhvillim.

Së dyti, pronësia, tradicionalisht, është parë nga këndvështrimi i kombeve të përparuar. Një pjesë e madhe e literaturës së sotme gëluese në lidhje me pronën merr si të mirëqena fillesat e saj në Perëndim.

Arsyeja e tretë pse procesi i krijimit të pronësisë formale është i vështirë për t'u kuptuar, lidhet me vështirësinë e ndjekjes së fillit të shoqërisë. Përthithja e ngadaltë e praktikave, traditave dhe normave të informalëve brenda ligjit formal është errësuar nga ngjarje të tjera historike. Njohja e të drejtave formale të pronësisë së banorëve dhe zaptuesve në Shtetet e Bashkuara, faktor që hodhi themelet e prodhimit të kapitalit dhe transaksioneve në tregun e gjerë, trajtohet si një strategji tipike politike për të nxitur ambicinet imperialiste amerikane, për të ndihmuar pionierët në shfrytëzimin e burimeve të gjera të vendit dhe për të lehtësuar tensionet sektoriale. Pikërisht këto hapa, të cilat mund t'u kenë lejuar Shteteve të Bashkuara që të kapërcejnë konfliktin mes sistemit ligjor dhe marrëveshjeve informale të zaptuesve dhe pionierëve të tjerë, nuk ka përbërë pikë referimi për specialistët e pronës.

Më lejoni ta theksoj edhe një herë se ajo që synoj në këtë kre nuk është rishkrimi i historisë së Shteteve të Bashkuara, por rimodelimi i historisë së njohur në një mënyrë të tillë që do të na lejojë të kuptojmë se kaosi i dukshëm në kombet në zhvillim dhe ato ish-komuniste përbën në vetvete një kërkim të rendit të ri ligjor. Le të vështrojmë, pra, kalimin e "ligjit" informal prej

pyjeve dhe fushave të Shteteve të reja Amerikane në fletoret zyrtare.

Lënia pas e Ligjit Britanik Demode

Shekulli i 16-të dëshmoi nisjen e një migracioni të pashembullt të Evropiano-Perëndimorëve për në brigjet e Amerikës së Veriut dhe të Jugut – atë që historiani Bernard Bailyn e ka quajtur “një nga ngjarjet më të jashtëzakonshme të historisë së njohur”². Sipas Hoffer-it, në Amerikën Britanike të Veriut, “një grumbull i ftohur, i lodhur dhe i shqetësuar burrash dhe grash... u grumbulluan në bregdetin perëndimor të Atlantikut, duke u shfaqur në një botë të egër dendësisht të pyllëzuar. Duke shtrënguar pas vetes puthjet e lamtumirës dhe Biblat, disa prej tyre mund të kenë përmendur kujtime të botës që kishin lënë pas”³.

Mes këtyre kujtimeve ekzistonin nocione në lidhje me ndërtimin dhe ruajtjen e bashkësive, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përvetësimin e tokës dhe krijimin e institucioneve qeveritare. Sistemi ligjor luajti një rol të spikatur në zgjidhjen e konflikteve të lindur prej këtyre veprimeve. Me të vërtetë, ligji “shëtiste lirshëm” në Amerikën e hershme teksa “qeveritë e para koloniale bazoheshin në dokumente të formës së “kartave”... Ekonomitë koloniale funksiononin përmes ligjit duke rregulluar çmimet, pagat dhe cilësinë e artikujve. Ligji u ofroi njerëzve mekanizma për të shitur tokën ose për t’ia lënë atë trashëgimi të tjerëve, themeloi një forum për paraqitjen e argumenteve në lidhje me rrëzimin e rrethimeve dhe humbjen e bagëtive, dhe madje u mësoi njerëzve si të adhuronin, si të martoheshin, si të edukonin fëmijët dhe si të trajtonin shërbëtorët dhe fqinjët e tyre”⁴.

Fillimisht, kolonët u përpoqën të përshtatnin doktrinat e ligjit anglez të pronës për të vendosur rregull. Por ligji i përbashkët anglez nuk ishte parashikuar për një shoqëri që prodhonte vazhdimisht forma të reja sigurimi të pronës pa themelimin dhe njohjen e një sistemi të titullarizimit. Për shembull, ligji i përbashkët anglez nuk tregonte se si duhet të vepronin gjykatat në lidhje me çështje që përfshinin njerëz që kishin blerë ose trashëguar një tokë me dokumente të dyshimtë. Si rezultat, “u bënë shumë të nevojshme seancat e hapura për titujt e pronësisë në gjykatat e vendit. Të gjitha palët e interesuara ishin në gjendje të dëshmonin dhe vendimi i gjyqësorit përbënte një garanci relativisht efektive dhe publike mbi të cilën nuk ekzistonte asgjë tjetër”⁵.

Megjithatë, shumë prej këtyre kolonëve nuk kishin njohuri në lidhje me thelbin teknik të ligjit anglez. Shumë prej tyre nuk njihnin dhe nuk donin të njihnin dallimet mes urdhrave gjyqësore të shkruar, ligjit dhe drejtësisë, si dhe hollësive të tjera. Ç’është më e rëndësishme, ligji i përbashkët anglez i pronësisë shpesh nuk ishte i hartuar për t’u përballur me problemet që nxirrnin kolonët. Një bollëk i madh tokësor në Amerikën Britanike të Veriut u jepte banorëve mundësi që ishin të pakconceptueshme në Evropën që kishin lënë pas. Kur “mbërritën në një kontinent ku pjesa më e madhe e tokës ishte pastruar në formë natyrore ose prej indianëve, anglezët dhe [evropianë të tjerë] rendën të shpërndanin burimin e ri të pasurisë... Si rezultat, kujdesi strikt në lidhje me detajet u anashkalua lehtësisht. Pasaktësia në ndarje dhe regjistrim u tolerua dhe shumë pak kujdesiu kushtua planeve të rregullta, të cilat, sipas [autoriteteve koloniale], duhet të ndiqeshin rregullisht”⁶. Jo gjithë sipërfaqja tokësore ishte pjellore, e drenazhuar siç duhet ose pranë kullotave që do të ushqenin gjedhin dhe kuajt e banorëve⁷. Në kërkim të një toke të përshtatshme, kolonët amerikanë kaluan nëpër fusha

të mbjella jashtë kufijve, duke ndërtuar atje shtëpi – dhe më pas e braktisnin këtë zonë për të kaluar nëpër territore të tjerë pjellore.

Si rezultat, për sa u përket të drejtave të pronës, kishte shumëllojshmëri dhe informalitet. Në analizën e tij të ndryshimeve ligjore në Masaçusetsin kolonial, David Thomas Konig paraqet një konturim të dështimeve burokratike dhe teknike të cilët përshkallëzuan problemet e migracionit. Për shembull, mungesa e një sistemi uniform mbikëqyrës krijoi divergjenca dhe parregullsi. Në Masaçusets, autoritetet koloniale shpeshherë nuk binin dakord në lidhje me ndarjen e tokës. Për shembull, “nuk kishte rakordim për sa i përket përdorimit të vijave të drejta ose tipareve natyrore për të ndarë zotërimet tokësore”. Një kolon “mendonte se granti i tij prej 300 akra në Riding kishte formë drejtkëndore por, për fatin e tij të keq, më pas zbuloi se ngastra e fqinjit të tij në qytetin fqinj kishte “formë rrethore” dhe perimetri përfshinte një pjesë të zotërimit të tij”⁸. Mangësitë teknike në procedurat e mbikëqyrjes i shtoheshin pasigurisë dhe amullisë. Konig vë re se vështirësitë në kompensimin e variacioneve meridiane në Amerikën e Veriut shpesh krijonin pretendime territoriale të mbivendosura, deri në çastin kur John Winthrop IV hartoi një tabelë të variancave për mbikëqyrjen tokësore më 1763⁹.

Përmes strukturimit të vendimeve në lidhje me një shumëllojshmëri marramendëse mosmarrëveshesh pronësore, natyra e të cilave nuk kishte precedentë në Angli, autoritetet koloniale nuk mund t’i nënshtroheshin lehtësisht jurisprudencës angleze. Përkundrazi, “shpesh gjykatat i drejtoheshin zakoneve qytetase duke i shndërruar në një organ të ri ligjor, i cili do të mund të stabilizonte çështjet e tokës”¹⁰. Për çështje që varionin nga autonomia politike e brendshme deri te përdorimi dhe shpërndarja e tokës, kolonët nisën të devijonin dukshëm nga ligji anglez, i cili kishte fare pak ose aspak lidhje me realitetin

e jetës koloniale. Sikurse ka theksuar Peter Charles Hoffer: “Teorikisht ishin pjesë e zotërimit personal të mbretit dhe [nën varësi të ligjeve të tij], por faktet rrëzonin teorinë. Shumë larg Anglisë, kolonitë me popullsi të rrallë, të pasura në burime natyrore dhe të zëna nga burra dhe gra që ishin qeveri më vete dhe që zinin mundësitë sapo i nuhatnin në ajër, po shkonin drejt vetëqeverisjes¹¹.

Një traditë e hershme amerikane – zaptimi i tokës

Megjithëse emigrantët e hershëm ishin kryesisht shtetas anglezë dhe i bindeshin ligjit anglez, kur mbërritën në Amerikë, një realitet i ri dhe një mënyrë e re e krijimit të marrëdhënieve i ndryshoi. Në Angli, zënia e një ngastre tokësore për një kohë të gjatë pa titull pronësie – “zaptimi i tokës” – ishte i paligjshëm. Në Shtetet e Bashkuara, zaptimi i tokës së disponueshme u bë shpejt një praktikë e zakonshme duke pasur parasysh që nuk hasi në rezistencë dhe në kuadrin e mundësive të mëdha të krijuara. Zaptimi i tokës është më i hershëm se vetë kombi. Sipas një studimi të Amelia Ford në lidhje me precedentët kolonialë të sistemit tokësor amerikan, “para mbërritjes së *Massachusetts Bay Company* në Nju England, ekzistonin banorë pa karta ose grante që banonin në zona të ndryshme brenda kufijve të Bay-it... Banorët e parë të Konektikatit përbënin shkelës të ligjshëm të territorit dhe mund të mbështesnin të drejtat e tyre vetëm mbi zaptimin dhe blerjen e tokës prej indianëve”¹². Gjatë viteve të hershëm të Merilendit, francezë dhe banorë të tjerë joanglezë qëndronin mbi një tokë të cilën nuk ishin në gjendje ta zotëronin sipas kushteve të grantit. Dhe më 1727, ligjvënësit e Pensilvanisë protestuan kundër “atyre që zinin vend në çdo Tokë të lirë që u zinte syri”. Këta zaptues kolonialë amerikanë kishin zënë dhe përmirësuar 100,000 akra tokë pa “asnjë të drejtë”, sikurse thoshte një historian¹³.

Në Nju England, politikanët e kamur në tokë nuk shihnin asnjë virtyt në aktivitetin e zaptuesve, të cilët i konsideronin thjesht si shkelës të paligjshëm. Më 1634, në Masaçusets, Gjykata e Lartë u përpoq të kufizonte zaptimin e tokës duke urdhëruar “që të gjitha grantet tokësore që u jepeshin njerëzve të lirë të regjistroheshin dhe që përfituesve t’u dërgohej një kopje e regjistrimit. Në çdo qytet duhet të kryheshin anketime përmes një kryeoficeri dhe katër banorëve të tjerë të lirë”¹⁴. Edhe kjo nuk bëri punë. Mosrespektimi i “vendimeve gjyqësore të 1634 dhe 1635 prej atyre që zinin tokën, detyroi Gjykatën e Lartë që më [1637] të vepronte edhe një herë, duke “kërkuar që njerëzit të mësoheshin se si të regjistronin tokën dhe të gjobiteshin nëse nuk e bënin këtë”¹⁵.

Megjithatë, nuk kishte mekanizma efektivë ligjorë për të shuar konfliktet e shumta që u shfaqën. Si rezultat, zaptuesit iu kthyen mekanizmave *de facto* që krijonin të çara për legalizimin e tokave të zaptuara. Shumë prej konflikteve më të thekshëm ndodhën në territoret e gjerë të lirë që sot përbëjnë Vermontin dhe Main. Para Revolucionit Amerikan, Nju Jorku dhe Nju Hampshir nxorën pretendime në lidhje me territorin e Vermontit¹⁶. Për të hedhur poshtë pretendimin e Nju Jorkut, guvernatori Benning Wentworth i Nju Hampshirit, “duke vepruar në përputhje me parimin se zotërimi duhet të ishte sa 9/10 e sipërfaqes së parashikuar në ligj... lëshoi grante të lirë në këtë rajon për qytetarët e Nju Hampshirit dhe Masaçusetsit... [Si rezultat, mes viteve 1764 dhe 1769], 131 territore qytetare iu dhanë në formë granti më tepër se 6,000 vetëve... grup individësh të përzgjedhur”¹⁷.

Duke ndjekur masat, zaptues që nuk kishin lidhje me asnjë shtet pushtuan territorin. Me të vërtetë, “banorët nisën të vërshojnë në Vermont duke u vendosur ku t’ua kishte qejfi”¹⁸. Menjëherë, ata kuptuan rëndësinë e veprimit kolektiv

dhe nisën “të dërgonin peticione, fillimisht para guvernatorit të Nju Hampshirit dhe më pas para atij të Nju Jorkut, duke pretenduar grante tokësore që përfshinin vendbanimin e tyre ose një urdhëresë që të vërtetonte pronësinë e tyre në lidhje me tokën”¹⁹. Megjithëse të dyja kolonitë u përpoqën të anashkalonin pretendimet e zaptuesve duke nxjerrë vazhdimisht procedura përjashtuese kundër tyre, mbizotërimi i tokave të zaptuara të territorit ishte aq i plotë, saqë Ethan Allen dhe “pasuesit e tij zaptues” arritën ta bëjnë Vermontin shtet pas përfundimit të Revolucionit. Një rezultat i parë i triumfit të jashtëzakonshëm të “fuqisë zaptuese” ishte njohja formale e marrëveshjeve të tyre pronësore.

Shpesh, zaptimi nxitej nga dëshira e politikanëve të kamur në tokë për të zbuluar dhe shfrytëzuar burimet koloniale. Në shumë prej kolonive, politikanët besonin se zhvillimi territorial mund të arrihej vetëm përmes imigracionit. Për të arritur këtë qëllim, politikanët kolonialë u akorduan grante individëve dhe grupeve popullore për t’u vendosur në toka të pazbuluara, duke bërë propagandë në lidhje me pajisjen me tituj zënieje dhe zbulimi. Në Virxhinia, sipas Fordit, “zbatimi i aktit nënkuptonte ndërtimin e një shtëpie, mbjelljen e një akre tokë dhe magazinimin e prodhimit për një vit; nëse një gjë e tillë nuk kryej për 3 vjet, toka i kalonte shtetit”²⁰. Sipas ligjit të Masaçusetsit, detyrat e banorit “përfshinin marrjen e zotërimit aktual dhe ndërtimin e një shtëpie me përmasa të caktuara, zakonisht 167 deri 185 metër katror, si dhe pastrimin e 5 deri 8 akra për kositje dhe lërim, të gjitha këto brenda tre vjetësh”²¹.

Në Merilend, gjatë viteve ’70 të shekullit të XVII, Lordi Baltimore përdori zaptuesit “për të shuar disa mosmarrëveshje territoriale në pjesën bregdetare mbi brigjet e Isteri Shor dhe Delavar Bei”²². Për të mbajtur konstante rrjedhën e të ardhurave të tyre, pensilvanezët e Pensilvanisë “dërguan direktiva që njerëzit që ishin vendosur në

çfarëdolloj toke mund ta përvetësonin atë tokë me çmimin e tregut në çastin e zaptimit, plus interesat e maturuara nga ai çast, minus vlerën e shtuar; ata që nuk e bënëin këtë detyroheshin të paguanin një kompensim në përpjestim me koston e blerjes”²³. Megjithatë, sikurse zbuluan shumë shpejt pensilvanezët, një direktivë e atillë vështirë se mund të zbatohet nëse zaptuesit nuk kishin dëshirë të paguanin. Në fakt, “nëse me këta burra të vendosur, të uritur për tokë dhe që nuk donin të largoheshin, nuk arrihej ndonjë lloj mirëkuptimi, sasi të mëdha të ardhurash do të humbitnin në mënyrë të pashmangshme... Si rrjedhojë, zyra Pensilvaneze e tokës pranoi ose lejoi përdorime të tokës që nuk ishte në gjendje t’i ndalonte dhe në këtë çast, përveç të drejtave të rregullta zyrtare, lindën edhe tituj të veçantë vendorë mbi tokat”²⁴.

Pasi siguruan të drejtat që kishin shpresuar përmes këtyre politikave mirëkuptuese, zaptuesit arritën në përfundimin se sistemi formal ishte tepër i rëndë dhe i ndërlikuar. Gjithashtu, Amelia Ford vëren se “zyra e tokës ishte tepër e largët, çështjet ishin tepër të ngatërruara dhe metodat tepër të ngadalta për t’iu përshtatur zaptuesve praktikë”²⁵. Ligjet britanike po bëheshin shumë të papërshtatshme për jetën dhe punën e njerëzve.

Kontrata e Re shoqërore: “Të Drejtat Tomahok”

Në kaosin që rrethonte ligjin, tokën dhe pronësinë, migrantët arritën në përfundimin se, nëse kërkonin të jetonin në paqe më vetveten, duhet të vendosnin një lloj rendi, edhe pse ai duhet të ekzistonte jashtë ligjit zyrtar. Zaptuesit nisën të krijonin titujt e tyre pronësorë informalë të quajtur “të drejta tomahok”, “të drejta kabinash” dhe “të drejta misri”. “Të drejtat tomahok” siguroheshin duke mbjellë disa pemë pranë një burimi dhe duke shënuar mbi lëvore inicialet e personit që kishte kryer këtë veprim. Në vitet ’60 të shekullit të XVII, zaptuesit e Merilendit

zhvilluan traditën e vulosjes së drurëve që qëndronin mbi tokën që kërkonin të përvetësonin para se kjo tokë të anketohej me lejen e “anketuesit të përgjithshëm” të kolonisë²⁶. Në fund të Revolucionit Amerikan, praktika e vulosjes së pemëve për të drejta zotërimi të tokës ishte bërë kaq e përhapur, saqë një oficer i ushtrisë i shkroi sekretarit të luftës: “Këta burra të kufirit janë mësuar të vendosen në tokat më të mira, duke siguruar një të drejtë tomahok ose një përmirësim, duke menduar se një gjë e tillë do të jetë e mjaftueshme për të siguruar titull pronësie”²⁷.

“Të drejtat e kabinës” dhe “të drejtat e misrit” nënkuptonin përvetësim të tokës përmes ndërtimit të një kabine prej druri ose mbjelljes së një fushe me misër. Në thelb, këto të drejta informale bliheshin, shiteshin dhe transferoheshin – ashtu sikurse titujt zyrtarë²⁸. E megjithëse të drejtat e kabinës e të misrit nuk i jepnin ligjrisht tokë askujt, nuk ka pikë dyshimi se këto të drejta informale të pronësisë shmangnin mosmarrëveshjet, pranoheshin gjerësisht në bashkësitë kufitare amerikane dhe u bënë burimi i titullarizimit ligjor shumë vite më vonë.

Me gjithë miratimin e nënkuptuar të marrëveshjeve informale nga ana e politikanëve lokalë, zaptuesit përballeshin ende me një botë kërcënuese. Ata shkaktunin vazhdimisht konflikt me Vendasit Amerikanë duke pushtuar tokat e tyre. Por zaptuesit përbënin kërcënim edhe për elitën që kishte frikë se mos humbiste prona të gjera. Për këtë arsye, një anëtar i elitës – George Washington – u ankua më 1783 për “Banditët që kundërshtojnë hapur çdo Autoritet ndërkohë që cenojnë dhe shfuqizojnë Ajkën e Vendit për llogari të shumicës”²⁹.

Shënjestrimi i Sherifëve

Migrantët nisën të vendoseshin nëpër kufij, nisën të plugonin tokat, nisën të ndërtonin shtëpi, nisën të transferonin tokë dhe nisën të vendosnin kreditim shumë kohë para se qeveritë t’u

jepnin të drejta për këto veprimtari. Megjithatë, pavarësisht sipërmarrjes së tyre, shumë autoritete mbetën të bindura se këta amerikanë të rinj po shkelnin në mënyrë flagrante ligjin dhe duhet të përndiqeshin. Por një gjë e tillë nuk ishte e lehtë. Edhe në çastin kur George Washington, babai i Shteteve të Bashkuara, u përpoq të evakuonte banorët që kishin zaptuar fermat e tij në Virxhinia, avokati e paralajmëroi se “nëse kishte sukses në lidhje me padinë e ngritur kundër banorëve të vendosur në tokë të tij, ata me siguri do të digjnin hangarët dhe gardhet e tij”³⁰.

Marrëdhëniet mes zaptuesve të shteteve të tjera dhe atyre vendas nisën të tejnxeheshin. Edhe përpara Revolucionit, migrantët e Masaçusetsit kishin nisur të vendoseshin në Mein, territor të cilin Masaçusetsi e kishte pretenduar që prej 1691. Fillimisht, politikanët e Masaçusetsit toleruan rritjen e numrit të zaptuesve në Meinin e largët. Megjithatë, pas Revolucionit, kur thesari ishte boshatisur dhe monedha ishte zhvlerësuar, politikanët e Masaçusetsit e vështronin tokën e gjerë të Meinit si burim i madh të ardhurash të reja³¹. Papritur, zaptuesit e Meinit përbënin një pengesë për shitjen e ngastrave të mëdha të tokës. Më 1786, guvernatori nxori një shpallje e cila ndalonte zaptimin e tokës në Mein³².

Për të siguruar blerësit e mundshëm, Masaçusetsi emëroi një komitet për të hetuar dhe kërkuar pagesat prej “shkelësve” informale³³. Megjithatë, shumica e zaptuesve thjesht refuzonin të zhvendoseshin ose të paguanin për tokat e tyre. Në vend që të arrinte një kompromis me zaptuesit, shteti u urdhëroi sherifëve të zbatonin procedurat e ligjshme të përjashtimit, duke nderur fitilin për atë që një historian e quajti “diçka e ngjashme me luftën e hapur”.

“Tipari më i spikatur i karakterit të [zaptuesit] është urrejtja e dhunshme dhe e paepur kundër ligjit”, komentoi

një avokat i Meinit më 1800. “Sherifi i vendit dhe oficerët e tij të kthyer në viktima për t’u sakrifikuar, si dhe ekzekutimi i urryer i [urdhëresave gjyqësore në lidhje me procedurat e përjashtimit] nuk i tmerron më. Ata shpallin se profesioni i ligjit duhet hedhur poshtë, se avokatët duhen përzënë dhe zyrat e tyre të bëhen hi”³⁴. Dhe, në kohën kur një sherif u vra ndërkohë që përpiqej të largonte një zaptues, juritë refuzuan të dënonin vrasësin e akuzuar. Pjesërisht si rezultat i përçarjes së politikanëve për shkak të dhunës së ardhur nga ana e zaptuesve të Meinit, Masaçusetsi njohu shtetin e Meinit më 1820”³⁵.

Edhe koloni të tjera u përpoqën në maksimum të shtypnin zaptimin e tokës publike dhe private. Në Pensilvani, zaptuesit skocezë-irlandezë nisën të lëviznin drejt tokave indiane që prej vitit 1730 dhe Vendasit Amerikanë nisën të kundërshtojnë. Autoritetet koloniale paralajmëronin vazhdimisht banorët “që të mos vidhnin tokën indiane dhe në kuadër të urdhëresave dogjën kabinat e tyre”³⁶. Me të vërtetë, prej vitit 1763 deri më 1768, Asambleja e Pensilvanisë u përpoq të frenonte zaptimin e tokës përmes dënimit “me vdekje”, ndërkohë që guvernatori William Penn urdhëroi ushtarët që të përzinin banorët informalë³⁷. Pavarësisht nga këto masa, numri i zaptuesve u dyfishua. Si kundërpërgjigje, sipas fjalëve të një historiani të kohës, “guvernatori i tërbuar shpalli se banorët e vendosur mbi tokën indiane do të ekzekutoheshin. Por, për këta të burgosur nuk kishte trup gjykues, nuk kishte juri dhe nuk kishte burgje”³⁸.

Arritja Ligjore: “Parablerja”

Në një vend ku çdo banor ishte ose emigrant ose kishte lidhje me një të tillë, zaptuesit kishin nevojë për mbështetje nga ana e autoriteteve koloniale, të cilat duhet të kuptonin se sa

i vështirë do të ishte zbatimi i ligjit të përbashkët anglez për banorët e rinj. Sipas ligjit anglez, edhe nëse dikush zaptonte dhe përmirësonte tokën e dikujt tjetër, nuk mund të mblidhte frytet e punës që kishte kryer. Megjithatë, në disa koloni, duke pasur parasysh mungesën e një qeverisjeje efektive dhe të regjistrimeve e anketimeve të besueshme, autoritetet ishin të shtrënguara të pranonin se përmirësimet e tokës, taksat e paguara dhe marrëveshjet lokale përbënin në vetvete burime të besueshme të të drejtave të pronësisë. Më 1642, kolonia e Virxhinias lejonte që një përvetësues i paligjshëm të përfitonte nga ana e pronarit të vërtetë vlerën e përmirësimeve të kryera. Statuti i Virxhinias vërente se “nëse çdo individ ose grup individësh vendosej në çdo plantacion ose tokë që i përkiste ndonjë individi tjetër”, “një vlerësim i vlefshëm [duhet] të miratohej nga gjykimi i dymbëdhjetë burrave”³⁹. Për më tepër, nëse pronari i ligjshëm nuk dëshironte të rimbursonte zaptuesit për përmirësimet e kryera, zaptuesi mund të blinte tokën me një çmim të vendosur nga një juri vendore⁴⁰. Ky statut u kopjua shumë shpejt edhe nga koloni të tjera. Këto klauzola vërtetonin edhe një herë pëlqimin e paktë që kishin elitat për njerëzit që kërkonin të prodhonin vlerë shtesë nga toka e tyre.

Kjo risi ligjore e lejimit të banorit për të blerë tokën që kishte përmirësuar përpara se të ofrohej hapur në treg njihej me emrin “parablerje” – një parim që do të përbënte çelësin e integritit të marrëveshjeve informale të pronësisë në ligjin Amerikan gjatë 200 viteve të ardhshëm. Politikanët dhe juristët nisën të interpretonin “përmirësimet” në një mënyrë të tillë që favorizonte zaptuesit. Në Karolinën e Veriut dhe në Virxhinia, të drejtat e kabinave dhe misrit konsideroheshin si përmirësime⁴¹. Në Masaçusets u integruan të drejtat tomahok⁴². Në thelb, përfshirja e marrëveshjeve të tilla informale brenda ligjit “nuk përbënte thjesht një njohje të lëshimeve që duhet t’u bëheshin zaptuesve të parë për kostot dhe rrezikun që kishin marrë

përsipër; përbënte një shprehi ligjore të një ndjenje të përhapur gjerësisht... se zaptuesi ishte realisht një bamirës i shtetit dhe jo një shfrytëzues i tij⁴³. Në periudhën e Revolucionit Amerikan, të drejtat e misrit të zaptuesve endacakë ishin shndërruar në të drejta pushtimi të pionierëve të ashpër. Edhe ndërsa George Washington ankohej në lidhje me “banditët” që kishin pushtuar tokën e tij, gjetkë në Virxhinia, në shtëpinë e tij, politikanë të tjerë po nxitnin zaptuesit duke mbrojtur titujt e tyre informalë.

Për shtetet me financa të dobëta, parablerja përbënte një burim të ardhurash. Këto shtete tatonin zaptuesit për anketimin e tokës së përmirësuar dhe për lëshimin e titujve ligjorë. Si rezultat, ligjet e parablerjes u shumuan para dhe pas Revolucionit. Më 1777, Karolina e Veriut hapi një zyrë të tokës për një rajon perëndimor, duke lejuar zaptuesit të siguronin 640 akra dhe duke shfaqur kështu pëlqim për njerëzit që po zaptonin sipërfaqen e tyre tokësore⁴⁴. Dy vjet më vonë, Virxhinia miratoi një ligj që u jepte zaptuesve të kufijve perëndimorë të drejtën e parablerjes së tokës që kishin përmirësuar⁴⁵.

Pengesa të tjera ligjore – informalë të tjerë

Megjithatë, pasi kishin fituar shumë beteja, zaptuesit amerikanë nuk kishin fituar ende luftën. Ambivalenca në lidhje me informalët vazhdoi edhe gjatë shekullit të parë të Shteteve të Bashkuara, dhe në asnjë vend tjetër nuk ishte parë ndonjëherë që qeveria e re federative të zotëronte papritur një sipërfaqe kaq të madhe toke publike. Prej vitit 1784 deri më 1850, Shtetet e Bashkuara siguruan rreth 900 milionë akra përmes pushtimit dhe blerjes: blerja e Luizianës (1803) solli 500 milionë akra; blerja e Floridës (1819), 43 milionë akra; dhe lufta me Meksikën (1848) solli 334 milionë akra⁴⁶. Si rrjedhojë, më 1802, qeveria federative kishte siguruar gjithë territoret perëndimore të shteteve të bregut lindor.

Duke filluar nga viti 1784, Kongresi i shteteve të konfederuara ristas (megjithëse ende jo të bashkuara nga pikëpamja konstitucionale), nisi të formulonte plane për të kufizuar disponibilitetin dhe të drejtat në lidhje me zotërimet kombëtare. Vendimi më i rëndësishëm ishte krijimi i vendbanimeve në Territorët Veriperëndimore, të cilët do të bëheshin përfundimisht shtete me të njëjtat të drejta dhe privilegje të trembëdhjetë shteteve të parë⁴⁷. Më 1785, Kongresi shtriu urdhëresat e viteve të mëparshme, duke krijuar një sistem të anketimit dhe shitjes së tokës publike. Duke ndjekur modelin e përdorur në kolonitë e Nju England, sistemi i anketimit ndau tokën në qytete me sipërfaqe 6 milje katrore, ndërkohë që qytetet ndaheshin në 31 nënseksione me sipërfaqe 1 milje katrore ose 640 akra. Pasi sipërfaqja anketohet, këto seksione prej 640 akra shiteshin me çmimin 1 dollar për akër.

Dy vjet më vonë, më 1787, Kongresi përforcoi urdhëresat paraprake në Urdhëresën e Veriperëndimit, e cila mundësoi ndarjen e Territorit të Veriperëndimit në shumë seksione dhe përshkallëzoi tri faza për rritjen e nivelit të përfaqësisë, i cili do të mund të siguronte statusin e shtetit. Mund të theksohet se ligji zbuloi konceptin e “pronësisë së thjeshtë honorare” (pronat zotëroheshin të shoqëruara me pushtetin e pakufizuar për të shitur e dhuruar) dhe siguroi garancinë e parë të kontratave të lira në Shtetet e Bashkuara⁴⁸. Megjithëse këto ligje federative vendosën një strukturë elegante të ligjit formal për shpërndarjen e tokave publike – historianët e shohin Urdhëresën Veriperëndimore si arritjen e parë drejt qeverisë amerikane parakushtetuese – ato nuk arritën të kontrollonin ose kufizonin numrin në rritje të njerëzve që migronin në periferi të kombit. Një problem madhor ishte çmimi ndalues i tokës federative. Të përballur me një çmim fiks prej 640 dollarësh – një shumë tepër e lartë për atë kohë – mijëra

emigrantë amerikanë u përjashtuan nga tregu federativ i tokës⁴⁹. Megjithatë, hartuesit e Urdhëresës së Veriperëndimit supozuan se investitorët e pasur do të kryenin shitje të parcelave të vogla, do të lejonin mundësi kreditimi ose do të ofronin tokën me një qira të pranueshme. Edhe këto supozime spekulative tejkalonin mundësitë e pionierëve⁵⁰. Përkundrazi, migrantët “zgjodhën pasiguritë e zaptimit të paligjshëm”⁵¹. Dhe kështu, dhjetëra mijëra amerikanë të tjerë u kthyen në zaptues në bazë të marrëveshjeve informale.

Menjëherë, qeveria federative nisi punën për të mënjanuar e ndëshkuar këta zaptues. Ata u sulmuan në mënyrë të fortë gjatë debateve për përshtatjen e Urdhëresës së Veriperëndimit. William Butler i Nju Jorkut shkruante: “Besoj se Këshilli është njohur me dashakeqësinë e Njerëzve të këtij Vendi, të cilët po vërshojnë nga të gjitha Anët, duke zaptuar e përvetësuar jo vetëm tokën e Shteteve të Bashkuara por edhe tokën e këtij shteti. Qindra të tillë kanë kaluar Lumenjtë dhe po afrohen dita-ditës së bashku me familjet e tyre. Mendoj se Këshilli do të jetë i aftë të përballet me një të keqe kaq të madhe në rritje”⁵².

Të nxitur nga një ndjenjë e tillë, anëtarët e Kongresit vepruan për të larguar zaptuesit, shpesh përmes masave të dhunshme. Më 1785, Kongresi miratoi një rezolutë e cila ndalonte në mënyrë të qartë zaptimin e zotërimeve publike dhe i jepte Sekretarit të Luftës fuqinë për të larguar banorët e jashtëligjshëm prej tokave federative të Territorit Veriperëndimor. Politika hyri në fuqi në verë të 1785 në juridiksionin që mbulonte zonën e bashkimit të lumenjve Muskingum dhe Ohajo, vend ku ushtria e Shteteve të Bashkuara largoi dhjetë familje duke shkatërruar shtëpitë e tyre dhe duke ndërtuar në vend të tyre fortesa për të parandaluar kthimin e tyre⁵³. Katër vjet më vonë, presidenti Washington urdhëroi shkatërrimin e kabinave dhe largimin e familjeve që ishin vendosur në kufirin e Pensilvanisë zotëruar nga Vendasit Amerikanë⁵⁴.

Megjithatë, edhe pse shumë politikanë donin të zbatonin ligjin e vendosur nga kombi i ri sovran, shumë prej tyre nuk ishin të bindur se ai mund të zbatohet në mënyrë të tillë që të ishte në interesin më të mirë të vendit. Për këtë arsye doli mbi sipërfaqe çështja e parablerjes⁵⁵. Gjatë seancës së parë të Kongresit të ri, më 1789, një anëtar përmendi me mprehtësi zgjedhjet me të cilat ballafaqoheshin zaptuesit:

Në këtë çast, kemi një numër të madh njerëzish të cilët kanë dëshirë të zotërojnë përmes blerjes tokën mbi të cilën janë vendosur. Çfarë do të mendonin këta njerëz, të cilët janë vendosur në një vend të lirë duke pritur me shqetësim një rregullim Qeveritar, nëse e drejta e tyre e parablerjes do të eliminohej përmes blerjes së një milion akra? A mendoni se ata do të lejojnë të shndërrohen në pre gahu?... Ata do të bëjnë dy gjëra: ose do të kalojnë në një territor spanjoll, në të cilin nuk janë krejtësisht të pafuar, duke u shndërruar kështu në një burim force për një komb të huaj i cili ka krijuar një kufi të rrezikshëm me ne; ose do të ndjekin këtë shteg, do të kalojnë në territorin e Shteteve të Bashkuara dhe do të arrijnë zotërimin e tokës pa miratimin tuaj. Si do të jetë situata atëherë? Ata nuk do t'ju paguajnë para. A do të ngrini ju një fuqi në këmbë për t'i dëbuar? Është bërë edhe kjo përpjekje; u mblodhën trupa dhe u dërguan... për të arritur këtë qëllim. Ata dogjën kabinat, rrëzuan gardhet dhe shkatërruan të mbjellat me patate, por tri orë pasi ishin larguar trupat, këta njerëz u kthyen përsëri, riparuan dëmtimet dhe tani jetojnë mbi këtë tokë duke sfiduar hapur Unionin”⁵⁶.

Një gjë tipike në lidhje me ambivalencën e Kongresit të kohës e përbënin pikëpamjet e Komitetit të Tokave Publike

dhe Dhomës së Përfaqësive. Duke i rekomanduar Kongresit më 1801 që të hidhte poshtë kërkesën e zaptuesve për të drejta parablerjeje, komiteti njihte se zaptuesit “ishin vendosur, kishin mbjellë dhe kishin përmirësuar me shumë punë dhe vështirësi disa toka të caktuara... [dhe kështu që] jo vetëm që kishin rritur vlerën e tokave ku ishin vendosur, por edhe atë të tokave fqinje, një gjë kjo shumë fitimprurëse për Shtetet e Bashkuara”. Duke shpërfillur këtë, komiteti argumentonte se “bërja e lëshimeve të tilla do të nxiste shkëlqen e tokës publike dhe do të përbënte një sakrificë të pajustificueshme për interesin publik”⁵⁷. Dhe kështu, shumica e deputetëve mendonin se duhej mohuar çdo e drejtë.

Në dy dekadat që pasuan krijimin e këtij organi në përputhje me Nenin 1 të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara, Kongresi ishte i palëkundur në antagonizmin e tij në drejtim të banorëve që ishin vendosur në formë të paligjshme mbi zotërimin publik. Më 1796, Kongresi rriti çmimin minimal për tokat publike nga 1 dollar për akër, vendosur sipas Urdhërësës së Tokës më 1785, në 2 dollarë për akër⁵⁸. Më 1807, Kongresi miratoi një masë e cila parashikonte gjoba dhe burgim për çdo zaptues që nuk zbatonte ligjin, si dhe urdhëronte dhe autorizonte largimin e zaptuesve të paligjshëm nëse ishte e nevojshme⁵⁹. Një dokument i 1812 i Dhomës së Komitetit të Pronës Publike vërente: “Vendosja e shthurur dhe e paautorizuar mbi tokat publike është në shumë aspekte e dëmshme për interesin publik”⁶⁰.

Megjithatë, problemi ishte se Kongresi, ashtu sikurse shumë vende sot, i kishte prerë lidhjet me realitetin: Ai nuk kishte asnjë njohuri në lidhje me trysninë e ushtruar nga zaptuesit dhe as mundësi për të imponuar mandatimet e veta. Edhe Zyra e Përgjithshme e Tokës, themeluar më 1812 për të anketuar, shitur dhe regjistruar tokat publike, nuk arrinte të kryente detyrën e saj. Agjencia e re federative, e cila merrej me

vërtetimin e patentave të lëshuara nga zyrat e distriktit, duhej edhe të mbikëqyrte regjistrimin e blerjeve të kryera me kredi. Ligjvënësit shpresonin se Zyra e Tokës do të vepronte si qendër informimi për t'i shërbyer qytetarëve që kërkonin tokë. Por gjithë këto detyra nuk mund të kryheshin nga stafi i vogël, i cili shumë shpejt ngeli prapa në lidhje me zbatimin e tyre⁶¹. Sikurse thekson Patricia Nelson Limerick, vetë deputetët kishin rol në problemet e Zyrës së Tokës: “Në emër të zgjedhësve të tyre, deputetët ankoheshin në lidhje me ngadalësinë me të cilën punonte zyra; deputetët kryen shumë kërkesa për informacion për përdorim personal dhe një gjë e tillë shteroi kohën e nëpunësve; dhe, në emër të ekonomisë dhe shpirtit të kursimit, deputetët refuzuan të akordnin fondet e kërkuara nga zyra”⁶².

Si rrjedhojë, në epokën e hershme, Shtetet e Bashkuara zotëronin burime financiare të kufizuara dhe duhet të kërkonin grante tokësore për të kompensuar grupe të caktuara të popullsisë. Shumë historianë mendonin se, sipas praktikës së lëshimit të “kuponëve tokësorë”, që është quajtur “ekuivalenti i tollonave ushqimorë të shekullit të XIX” – një dokument që mund të shndërrohej në tokë – qeveria nxiste informalitetin dhe zaptimin e tokës⁶³. Prej 1780 deri më 1848, Kongresi lëshoi 2 milionë akra tokë për ushtarët që luftuan në Revolucion, 5 milionë për veteranët e Luftës së 1812 dhe 13 milionë për ata që luftuan kundër Meksikës. Prej 1851 deri më 1860, Kongresi shtoi 44 milionë akra të tjerë për shërbim në Luftën Revolucionare, në Luftën e 1812, në Luftërat Indiane dhe në Luftën Meksikano-Amerikane⁶⁴. Kur u analizua nga ana e Kongresit Kontinental gjatë Luftës së Pavarësisë, politika e kuponëve tokësorë kishte një logjikë, pasi mundësonte qeverinë amerikane që të shpërblente oficerët dhe ushtarët për shërbimet e kryera. Po ashtu, Kongresi i druhej kërcënimit të vazhdueshëm ushtarak të popullsisë vendase, të cilat me vullnet personal ose

si mercenarë të paguar nga anglezët ose francezët, i kanoseshin republikës së re. Qëllimi i vendosjes së ish-ushtarakëve në zonat kufitare ishte zgjidhja njëkohësisht e të dy problemeve.

Megjithatë, në mes të shekullit të XIX, lindi një treg i madh i zi i kuponëve, i cili nxiste zaptimin dhe spekulimin. Nga çdo 100 ushtarë që siguronin kuponë tokësor, 84 prej tyre shisnin të drejtat në tregun e zi – një situatë e ngjashme me atë që paraqitet në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste, të cilat kanë ofruar strehim publik për disa grupe qytetarësh⁶⁵. Sikurse ka vërejtur një historian, “askush nuk e parashikonte se gjysmë milion vejusha dhe burra pleq do të siguronin [kuponë] për të vendosur një pengesë kundër një pushtimi të huaj”⁶⁶.

Qeveria federative lëshoi miliona akra tokë të lirë për ndërtimin e hekurudhës së re që do t’i binte kryq e tërthor vendit. Gjatë shekullit të XIX, mbi 318 milionë akra – rreth 1/5 e gjithë zotërimit federativ – iu lëshua ose drejtpërdrejt kompanive private të hekurudhave ose shteteve që më pas do ta rishpërndanin në përfitim të hekurudhave. Mendohej se përmes këtyre lëshimeve masive do të nxitej krijimi i vendbanimeve të rregullta në zonat kufitare. Megjithëse një pjesë e mirë e tokës kishte vlerë të vogël, në shumë vende kishte minerale ose toka ishte e punueshme⁶⁷. Pjesa dërrmuese i shkoi hekurudhave ndërkontinentale, të cilat morën çdo copëz tokë nga kalonin, duke krijuar kështu një shoqërizim të qeverisë me tokën hekurudhore. Kongresi besonte se hekurudhat do ta shisnin tokën për të cilën nuk kishin nevojë me një çmim të lirë dhe shpejt, për të nxitur banimin⁶⁸. Megjithatë, edhe një herë, realiteti i vendosjes binte në kundërshti me shpresat e politikanëve. Sipas një studiuesi, marrëveshja e krijuar, “vononte banimin e miliona akra të tokës më të mirë dhe i kishte mbyllur dyert për përvetësimin”⁶⁹. Shpeshherë një gjë e tillë çonte në luftë të hapur. Stephen Schwartz raporton në lidhje

me një konflikt të shpërthyer më 1880 në Luginën San Hoakin në Kaliforni, në zonën e quajtur Mussel Slough, ku fermerët dhe kaubojt e vendosur mbi prona hekurudhore kundërshtuan ndryshimet e propozuara në marrëveshjet e blerjes kur vinte puna për të paguar. Kompanitë e hekurudhave kishin vendosur se çmimi i shitjes duhet të përfshinte gjithë përmirësimet e kryera si ndërtesa apo kanalizime. Kjo çoi jo vetëm në urdhëresa gjyqësore, të cilat nuk zgjidhën çështjen, por edhe në goditjen për vdekje të pesë banorëve dhe disa dëbuesve⁷⁰, ku mareshali përgjegjës pranoi se “nuk ishte i sigurt se kush kishte qëlluar i pari”. Duke vënë incidentin në faqe të parë me kryetituj, “San Francisco Chronicle” dënoi hekurudhat, duke theksuar: “Pavarësisht nga të drejtat strikte ligjore, është e pamohueshme se drejtësia ishte me banorët”. Forca fizike ishte, po ashtu, nga ana e banorëve. Zyrtarët vlerësuan se zhvendosja e tyre do të kërkonte 200 deri 1000 ushtarë të stërvitur⁷¹.

Përpjekjet e qeverisë federative për të krijuar një sistem të rregullt të tokës nuk mund të kapërcenin vullnetin e njerëzve të zakonshëm për të siguruar të drejta mbi zotërimin kombëtar. Një zaptues i qartë argumentonte: “Dëshmoj se çdo individ, sipas çdo kushtetute të hartuar në Amerikë, ka të drejta të padiskutueshme për t’u vendosur në çdo vend të lirë dhe... Kongresi nuk e ka pushtetin për t’i ndaluar ata”⁷². Gjatë dekadave të para të shekullit të XIX, politikanët dhe zaptuesit nuk binin dakord në lidhje me kualifikimin e të drejtave të pronësisë. Mes politikanëve, “lindte pyetja: ‘Çfarë duhet bërë?’ ‘Lërjani këtë punë ushtarëve’, thoshin disa. ‘Përdorini për të shlyer borxhin kombëtar’, thoshin të tjerë. ‘Mbajeni për përdorim të ardhshëm’, këshillonte një tjetër dhe kishte të tjerë që mendonin se kushdo që dëshironte mund të vendosej mbi një tokë të caktuar⁷³.

Paligjshmëri apo Përplasje Sistemesh Ligjore?

Në fillim të shekullit të XIX, sistemi pronësor i Shteteve të Bashkuara ishte në gjendje amullie. Ligji ekzistues i pronësisë dhe ligjvënësit antagonistë vetëm sa përshkallëzonin krizën që lidhej me emigrantët kombëtar. Në studimin e detajuar të zaptuesve dhe ligjeve të tokës në Virxhinia dhe Kentaki, Pol Gates argumenton se ligji formal ndikonte në “kostot gjithmonë në rritje për tituj të pastër, në largimin e njerëzve me pretendime kontradiktore dhe në mbrojtjen e tokës nga shkelja dhe grabitja”. Kombinuar me “taksat gjyqësore dhe normat e larta të interesit të kapitalit të marrë hua”, papërshtatshmëria e ligjit formal “përbënte një kërcënim të vazhdueshëm kundër sigurisë së investimeve dhe mbante palët ndërluftuese në amulli të vazhdueshme”.⁷³

Në mënyrë të parashikueshme, emigrantët që vendoseshin në këto toka, në shumicën e rasteve, nuk kishin tituj formalë për pronën e tyre dhe shpesh atyre u duhej të negocionin për titull pronësie, jo me një, por me dy pronarë; dhe më tej, edhe pasi e kishin blerë tokën e kishin kryer përmirësimet, ata mund të përballeshin me procedura përjashtimi të ndërmarra nga individë me të drejta më të larta.⁷⁴ Një vizitor i huaj që udhëtonte nëpër Kentaki më 1802, vuri re se në çdo shtëpi ku kishte ndaluar, pronari shprehej me dyshim për titujt e fqinjit të tij”.⁷⁵

Mes 1785 dhe 1890, Kongresi i Shteteve të Bashkuara miratoi më tepër se 500 ligje të ndryshme për të reformuar sistemin e pronësisë, bazuar gjoja mbi idealin Xhefersonian të dorëzimit të tokës në duart e qytetarëve privatë. Megjithatë, procedurat e ndërlikuara që lidheshin me këto ligje, shpeshherë pengonin arritjen e këtij qëllimi. Për të ndërlikuar edhe më tej çështjen, shtetet individuale hartonin rregullat e tyre për pronësinë dhe shpërndarjen e tokës, të cilat favorizonin dukshëm elitat pronare

vendase. Si rezultat, përpjekjet për të reformuar sistemin e pronësisë vetëm sa theksonin vështirësitë tokësore të vendit, duke i bërë emigrantët objekt të humbjes së tokës, pavarësisht nga titujt që mund të zotëronin. Duke komentuar reformën në Kentaki, një studiues bashkëkohor theksonte se “shumë banorë nxjerrin sigurinë e pronave të tyre prej kësaj amullie... [dhe si rrjedhojë], shumë nuk guxojnë të vlerësojnë të drejtat e tyre duke iu druajtur pagimit të dëmshpërblimeve të konsiderueshme”.⁷⁶ Gjatë shekullit të 18-të dhe në fillim të shekullit të 19-të, “teksta zgjidheshin problemet e vjetra, të reja dilnin mbi sipërfaqe”. Kishte vështirësi të shumta në përcaktimin e titujve... [teksta titulli i pronësisë bëhej një koncept më i pakuptueshëm sesa gjatësia, më i errët sesa trangu i pemës ose përroi. Titulli i pronësisë u bë acarues dhe i vështirë, sa edhe ligji i shfuqizuar për zotërimin”.⁷⁷ Shkurt e shqip, institucionet ligjore të Shteteve të Bashkuara nuk arritën që në thelb të përballeshin në mënyrë efektive me popullsinë gëluese migruese.

Më 1820, sistemi pronësor themeltar i Shteteve të Bashkuara ishte në një gjendje të tillë të çoroditur, saqë gjykatësi i Gjykatës së Lartë, Jozeph Story shkruante: “Brezat e ardhshëm do të vuajnë shumë para se të mbyllen mosmarrëveshjet në lidhje me ligjet amerikane të pronësisë... Do të mbetet gjithmonë një kod i panjohur me dialekt të çuditshëm, i pamundur për t’u zbuluar e studiuar, sikurse edhe jurisprudenca e ndonjë kombi të huaj”.⁷⁸ Mund të vihet re ironia në fjalët e gjykatësit Story, sipas së cilës Shtetet e Bashkuara “nuk ishin një shoqëri e vjetër konservatore, por një shtet i ri në periferi të ligjit”.⁷⁹

Ligjet amerikane u bënë kaq të rënda saqë përbënin një pengesë të madhe për banorët që kërkonin të siguronin të drejta pronësie dhe të dilnin nga statusi i “zaptuesit”. Atyre nuk u ngelej gjë tjetër veç të hartonin “ligjet” e tyre, sidomos ata që kishin të bënë me ligjin, duke shkruar ligjin anglez e

traditat ligjore vendase amerikane me logjikën e tyre. Rezultati ishte “një grup të drejtash pronësore absolute”⁸⁰ në dy sisteme ligjore dhe ekonomike, njëri prej të cilëve ishte kodifikuar dhe përfshirë në libra, ndërsa tjetri vepronte në terren. Dhe kështu Shtetet e Bashkuara e gjetën veten me një sistem ligjor pluralist, në të cilin shumë të drejta të pronësisë, si dhe marrëveshjet pronësore, përcaktoheshin nga ligji informal.

Institucionet politike dhe ligjore u gjendën mes besnikërisë ndaj ligjit formal dhe simpatizimit të nevojave të banorëve për të krijuar marrëveshjet e tyre. Një fjalim i Thomas Jefferson rrok në mënyrë të përkryer ambivalencën që ndienin politikanët për sa u përket marrëveshjeve informale. “Kaq piktoreske ishin këto [marrëveshje]... saqë asnjë parim ligjor ose i drejtësisë nuk mund të zbatohet për përcaktimin e tyre; shumë prej tyre bazoheshin mbi tradita dhe zakone të themeluara në një Konte të caktuar, bazoheshin mbi modele që privilegjonin vetveten dhe, meqë përfshiheshin në çdo titull pronësie, nuk mund të anashkaloheshin”.⁸¹

Përpjekjet shtetërore për të hequr kambanën

Në këtë pikë, politikanët amerikanë ballafaqoheshin me tri zgjedhje. Ata mund të vazhdonin të sulmonin ose shpërfillnin informalët, të bënin lëshime me mosdashje ose të bëheshin mbrojtës të të drejtave të informalëve. Përhapja e ligjeve të zotërimit – të cilat njihnin të drejtën e tokës bazuar në përmirësimet që i bëheshin asaj – përmes Shteteve të Bashkuara në 60 vitet e parë të shekullit të 19-të, të linte të mendoje se politikanët anonin vazhdimisht për nga zgjedhja e tretë. Historia e përshtatjes së ligjeve të zotërimit në Shtetet e Bashkuara është historia e ngritjes së informalëve si forcë politike.

Pika e kthesës ishte shteti i ri i Kentakit, sistemi pronësor i të cilit, sikurse në shumë shtete të tjera, ishte në amulli të

plotë. Guvernatori ankohej se pretendimet tokësore në shtetin e ri kërkonin trefishin e tokës që dispononte. Historiani Paul Gates argumenton se kjo ndodhi për faktin se politikanët, mes viteve 1797 dhe 1820, miratuan legjislacione që ndihmonin në kushtetueshmërinë e informalëve. Këto masa ndikuan në “dy parime të larta të drejtësisë së ligjit statutor amerikan: E drejta e zotëruesve... në lidhje me përmirësimet dhe e drejta e banorëve mbi tokën e zotëruar privatisht duhet të mbeteshin të padiskutuara dhe, mbi këtë pronësi, duhet të paguheshin tatime, në bazë të nënshkrimit ose të një titulli pronësie të parevokueshëm për tokën pavarësisht nga ekzistenca e titujve të ndryshëm në qarkullim”.⁸² Megjithatë, rëndësia e legjislacionit të Kentakit nuk lidhet me kontributin në drejtim të doktrinës ligjore, por me atë në pasqyrimin e fuqisë politike në rritje të pionierëve. Në thelb, trysnia që ushtronin këta banorë informalë mbi zyrtarët e zgjedhur detyruan shumë qeveri shtetërore të hidhnin poshtë një vendim të Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara i cili godiste popullsinë e gjerë informale të vendit.

Më 1821, Gjykata shpalli se ligji i zotërimit në Kentaki ishte antikushtetues.⁸³ Çështja përfshinte trashëgimtarët e një pronari të madh tokash, John Green, dhe një zaptues që ishte vendosur në formë të paligjshme mbi pronën e Grinn, Richard Biddle. Toka në fjalë përfshihej fillimisht në Virxhinia, por tashmë bënte pjesë në Kentaki. Në çështjen Green kundër Biddle, Gjykata e Lartë u shpreh kundër ligjit të zotërimit të Kentakit duke vënë theksin mbi “rregullat e pronësisë” të vendosura në bazë të precedentëve të ligjit të përbashkët anglez.⁸⁴

Ky vendim favorizonte drejtpërdrejt vetëm ata individë që zotëronin tituj të ligjshëm për tokën që kishin në dispozicion. Sipas Gjykatës, ligji i Kentakit “vepronte në formë të paligjshme dhe shtypëse sepse pronari i ligjshëm detyrohej të paguante jo vetëm për përmirësimet aktuale të tokës dhe vlerën e shtuar, por

edhe për shpenzimet e kryera nga zaptuesi për përmirësimin e arritur, pavarësisht nga fakti nëse këto përmirësimë ishin vërtet të dobishme apo thjesht imagjinare, dhe pavarësisht nga fakti nëse shija apo zbukurimi ishin thjesht fryt i tekave apo kapriçove të tij”.⁸⁵ Pasi rishqyrtoi çështjen Green kundër Biddle më 1823, Gjykata mbështeti vendimin e mëparshëm, duke theksuar se ligjet e zotërimit prironin “pronarin ligjor të tokës nga qiratë dhe përfitimet e siguruara nga zaptuesi”.

Politikanët që kishin kultivuar mbështetjen në drejtim të informalëve, sulmuan furishëm Biddle duke e konsideruar “shkatërrimtar” dhe shkaktues “alarmi” për kentakasin.⁸⁶ Gjykata e Lartë mund të kishte qenë e pavëmendshme ndaj realitetit të ri politik – dhe ligjor – që po merrte formë në kufirin amerikan që zgjerohej dita-ditës, por politikanët Perëndimorë duhet të tregonin vëmendje dhe të shihnin se sa shpejt po ndryshonte vendi. Në atë kohë, dhjetëra mijëra emigrantë të ashpër kishin lëvizur drejt perëndimit nga kolonitë e maleve Apalashë për t’u vendosur në toka të virgjëra dhe pjellore në fillim të shekullit të 19-të. Popullsia e Shteteve të Bashkuara ishte dyfishuar çdo 20 vjet. Më 1620 kishte rreth 5,000 të ardhur në gjithë Amerikën Veriore Britanike. Më 1860, popullsia amerikane ishte 30 milionë banorë dhe në rritje të vazhdueshme. Pesëdhjetë për qind e popullsisë amerikane jetonte në perëndim të maleve Apalashë.

Këta migrantë dëshironin që gjykatat t’u njihnin të drejtat në lidhje me pronat që kishin përvetësuar.⁸⁷ Kështu, lëkundja e Gjykatës së Lartë e shfaqur në çështjen Green kundër Biddle në Kentaki, përbënte një fitore të madhe për informalët, të cilët menjëherë zunë pozita sulmi. Sipas politikanëve dhe botuesve vendas të gazetave, armiku ishte Gjykata e Lartë e Shteteve të Bashkuara. Një gazetë vendase shkruante në lidhje me “menaxhimin tradhëtor” të drejtësisë, i cili kërcënonte

të “shfaroste” të drejtat e “jorezidentëve dhe të huajve”.⁸⁸ Në kuadër të kësaj armiqësie të shfaqur kundër autoritetit të gjykatës, i plotfuqishmi i Kentakit, Richard M. Johnson, shpalli përmes një fjalimi para Senatit se “ky vendim do të përmbyste politikën e përgjithshme të Kentakit... dhe, nëse nuk rishikohej, do të prodhonte pasojat më shkatërrimtare përmes nxitjes së shumë konflikteve në vende ku problemet zgjidheshin prej kohësh, dhe do të krijonte një amulli në lidhje me çdo aspekt të lidhur me pronësinë e tokës”.⁸⁹ Një tjetër senator, dhe mbase më i fuqishëm, i Kentakit, Henry Clay, i cili kishte qenë për një kohë të gjatë kundërshtar i lëshimit të të drejtave për zaptuesit, pranoi: “Ata ndërtojnë shtëpi, mbjellin kopshtet, mbjellin fusha, mbjellin tokën dhe edukojnë familje rreth tyre. Ndërkohë, batica e migracionit rrjedh mbi ta, mbi vlerën e shtuar të fermave të përmirësuara. Para tyre paraqitet një kërkesë. Ata u shesin të ardhurve të rinj në parapagim dhe vazhdojnë rrugën më tej për në perëndim... Në këtë mënyrë, dhjetëra mijëra po përmirësojnë mjedisin rrethues dhe kushtet e tyre”.⁹⁰ Guvernatori dhe legjislatura e Kentakit ngritën zërin kundër vendimit të Gjykatës së Lartë.⁹¹

Që prej krijimit, Gjykata ka qenë një shënjestër kryesore e kritikës politike drejtuar autoritetit të një grupi elitar gjykatësish, të cilët nuk ishin zgjedhur nga askush. Por, në një kthesë spektakolare të ngjarjeve, gjykatësit e Kentakit hodhën poshtë vendimin e Gjykatës së Lartë. Në një rast të ngjashëm dy vjet më vonë, një gjykatës i Kentakit vuri re se rasti Green kundër Biddle nuk mund të shërbente si precedent sepse “vendimi u mor vetëm nga tre prej shtatë gjykatësve që përbënin Gjykatën e Lartë të Shteteve të Bashkuara; dhe fakti se ky vendim përputhet me mendimin e një grupi të gjykatësve që nuk përbëjnë shumicën, nuk nënkupton se një parim kushtetues ka zënë vend”.⁹² Më 1827, një tjetër gjykatës i Kentakit kundërshtoi Biddle, duke

theksuar se ligji për pretendentët ishte kushtetues në “shumë e shumë raste të shpeshte në numër për t’u cituar”.⁹³

Në prag të furtunës që i drejtohej çështjes Green kundër Biddle, politikanët dhe demokratët perëndimorë nga i gjithë vendi, nisën të shihnin rritjen e nivelit të kushtetueshmërisë në lidhje me zaptuesit përmes një prizmi të ndryshëm. Ata nuk ishin më kriminelë të rreckosur që thithnin ajkën e tokës së kombit, por “pionierë bujarë” që ndikonin në zhvillimin e vendit. Sigurisht, ata përbënin edhe votues të fuqishëm.⁹⁴ Një deputet nga Kansasi theksoi se “në gjithë shtetin e tij, banorët kishin zënë toka publike, kishin kryer përmirësime, kishin paguar faturat dhe më pas ishin përjashtuar nga toka, për një arsye apo një tjetër, nëpërmjet një vendimi korrigjues të Sekretarit për Punët e Brendshme”.⁹⁵

Përpjekjet federale për të hequr kabanën

Gjatë periudhës së konfliktit Green kundër Biddle, Andrew Jackson, një hero i luftës së 1812 kundër britanikëve dhe një mbështetës i hapur i pionierëve, pothuaj fitoi në garën për president. Katër vite më vonë, Jackson më në fund u bë president. Gjatë dy mandateve të administratës së tij, teksa kërkesat pronësore për të votuar apo kandiduar për një post zyrtar u zhdukën, teksa shkollat publike u shtuan, teksa shteti zbuti kodet penale dhe mbylli burgjet e debitorëve, simpatia në lidhje me të drejtat e zaptuesve u rrit. Po ashtu, u rrit mospëlqimi publik në adresë të gjykatësve dhe avokatëve, të cilët perceptoheshin si agjentë energjikë të të pasurve dhe të fuqishmëve.⁹⁶

Më 1830, 13 shtetet fillestare ishin bërë 24, duke përfshirë 7 shtete të Perëndimit, përfaqësuesit e të cilave në Uashington ishin tërësisht të angazhuar për hartimin e politikave që favorizonin zaptuesit. Për të fituar mbështetjen e këtij blloku, interesi i të

cilit ishte në rritje, shtetet Veriore dhe Jugore konkurronin për të treguar sesa pro Perëndimit ishin.⁹⁷ Shtetet Perëndimore dhe zaptuesit që mbizotëronin në këto toka, nisën të tendosnin muskujt politikë dhe rezultatet ishin mbresëlënëse. Mes vitit 1834 dhe 1856, Misuri, Alabama, Arkansasi, Miçigani, Ajoua, Misisipi, Uiskonsin, Minesota, Oregon, Kansas dhe Kalifornia përshtatën ligje përvetësimi të ngjashëm me ligjin e Kentakit, i cili hodhi poshtë vendimin e Gjykatës së Lartë në çështjen Green kundër Biddle.⁹⁸ Paul Gates argumenton se “asnjë çështje tjetër e diskutuar nga Gjykata e Lartë nuk ishte hedhur poshtë në mënyrë të tillë nga legjislacioni shtetëror e gjykatat shtetërore, nga paaftësia e gjykatave federale për të menaxhuar çështjen dhe përfundimisht nga akti i pakundërshtueshëm i Kongresit për të kaluar juridiksionin e çështjeve të zaptuesve, sikurse ndodhi me Green kundër Biddle, në adresë të gjykatave federative”.⁹⁹

Më në fund, Uashingtoni nisi të merrte mesazhin. Megjithëse më 1806 Komiteti i Tokave Publike fajësoi zaptuesit për vuajtjet e tyre, më 1828, i njëjti komitet i raportonte Dhomës së Përfaqësive se zaptuesi amerikan kishte kryer një shërbim publik të vlefshëm për të cilin meritonte të kompensohej.¹⁰⁰ Zaptuesi, dikur i urreyer, tashmë ishte dikush “i cili, përmes sipërmarrjes dhe industrisë, kishte krijuar një shtëpi në mes të natyrjetës së egër për veten dhe familjen [dhe] duhet të siguronte një titull pronësie në përfitim të tij. Ai kishte krijuar mekanizma për shitjen e tokës publike dhe kishte krijuar mundësi konkurrimi për tokat, të cilat përndryshe nuk do të meritonin asnjë çmim dhe për të cilat nuk do të kishte blerës, në qoftë se nuk do të ishin përmirësimet e kryera nga ai”.¹⁰¹

Anëtarë të ndryshëm të Kongresit nisën të hartonin legjislacione që ndihmonin në lehtësimin e përthithjes së marrëveshjeve të zaptuesve brenda sistemit ligjor. Në qendër të tij ishte mekanizmi ligjor që pat qenë shpëtimi i zaptuesve gjatë

periudhës koloniale (të cilin Kongresi i Shteteve të Bashkuara e kishte kundërshtuar fuqishëm) – parablerja. Më 1830, një koalicion i Kongresmenëve Perëndimorë dhe Jugorë miratoi një akt të gjerë parablerjeje që “zbatohet për çdo banor ose zaptues të tokave publike... i cili kishte zotërimin e tokës dhe, gjatë vitit 1829, kishte mbjellë në një pjesë çfarëdo të kësaj toke”.¹⁰³ Një zaptues mund të pretendonte për 160 akra tokë, duke përfshirë këtu tokat që kishte përmirësuar, për 1.25 dollarë për akër. Kërkohej që pagesa të derdhej para se toka të dilte në ankand publik dhe ndalohej rreptësisht transferimi apo shitja e të drejtave të parablerjes.

Më 1832, 1838 dhe 1840, Kongresi rishikoi aktin e përgjithshëm të parablerjes të 1830. Në çdo rast, ky organ përpiquej të fuqizonte më tej të drejtat e zaptuesve më të rëndomtë, ndërkohë që përpiquej të ndalonte disa prej abuzimeve ndaj parimit të parablerjes. Për shembull, akti i 1832 zvogëlonte sipërfaqen minimale të tokës që mund të blihej nga një zaptues, nga 160 në 40 akra.

Më 1841, parimi i parablerjes kishte hedhur rrënjë kaq të thella, sa që Kongresi dekretoi një projekt-ligj për parablerjen në perspektivë. Akti i 1841 përfshinte jo vetëm zaptuesit ekzistues, por “edhe çdo individ... i cili më vonë do të krijonte një vendbanim mbi një tokë publike”.¹⁰⁴ Toka e banuar duhet të anketohet, por edhe ky kufizim u eliminua me kalimin e kohës.¹⁰⁵

Përpjekjet e informalëve për të hequr kabanën

Shumë zaptues, të cilët ishin gjeografikisht të veçuar nga debatet politike dhe kushtetuese mbi pronën, bënë sa mundën për të siguruar tokën që kishin zënë; disa prej tyre paguan dyfish për të njëjtën ngastër toke, ndërkohë që të tjerë, i paguan tarifa shumë të larta avokatëve që ta bënë të ligjshme tokën

e tyre.¹⁰⁶ Shumë prej tyre nuk kishin mundësi të mbulonin kostot e sistemit zyrtar ligjor, kështu që hartuan marrëveshjet e tyre informale, duke krijuar mekanizma të rinj për sigurimin dhe mbajtjen e pronës në pjesën kufitare amerikane. Për sa u përket qëllimeve praktike, ata e morën ligjin në dorë të tyre - dhe detyruan instancat ligjore që t'u vinin pas. Politikanëve iu desh pak kohë që të zgjoheshin dhe të kuptonin se, paralel me ligjin zyrtar, kishin marrë formë kontrata sociale informale për pronën dhe këto përbënin një pjesë thelbësore në sistemin e të drejtave kombëtare të pronësisë. Për të vendosur një sistem ligjor tërësor i cili të mund të zbatohet në gjithë kombin, ata duhet të mësoheshin me mënyrën se si njerëzit përcaktonin, përdornin dhe shpërndanin të drejtat e pronësisë.

Dy shembuj të rëndësishëm shërbejnë për të ilustruar nevojën emergjente të organizatave informale për të mbrojtur të drejtat pronësore të siguruara në formë informale: shoqëritë e pretendimeve që u shumëfishuan në Midwestin Amerikan gjatë gjysmës së parë të shekullit të 19-të, si dhe distriktet e minierave, të cilët bombarduan Perëndimin Amerikan pas zbulimit të arit në Kaliforni. Sipas shumë historianëve amerikanë, shoqëritë e pretendimeve dhe rregulloret e minierave përfaqësonin “shpalosjen e aftësisë së burrave kufitarë për veprim demokratik”.¹⁰⁷ Të tjerë argumentuan se këto organizata vepronin “si tym për të errësuar vjedhjen e tokës nga ana e pronarëve në mirëbesim”.¹⁰⁸ Ky nuk është argumenti im. Ajo që më ka interesuar në lidhje me shoqëritë e pretendimeve dhe organizatat e minierave lidhet me faktin se këto tregojnë se grupet informale luajtën një rol të rëndësishëm në përcaktimin e të drejtave të pronësisë në Shtetet e Bashkuara si dhe në shtimin e vlerës së tokës. Megjithëse teknikisht ishin shkelës në zotërim publik, këta zaptues zotëronin, sipas fjalëve të historianit Donald Pisani, “një logjikë ligjore të rrënjësuar

në bindjen se... ‘njerëzit’ kanë një të drejtë më të lartë për të përcaktuar dhe interpretuar rregullat në krahasim me ekspertët ligjorë”.¹⁰⁹ Përfundimisht, organizatat informale kryenin një shumëllojshmëri funksionesh, nga ndërmjetësimi me qeverinë deri në regjistrimin e pronave dhe të drejtave që pretendonin të kishin zaptuesit.

Shoqëritë e pretendimeve

Shoqëritë e pretendimeve të Midwestit Amerikan u themeluan fillimisht nga zaptuesit për të mbrojtur të drejtat e tyre nga spekulatorët ose kërcënuesit. Për shembull, dy organizata pretendimesh në Ajoua, pranuan përmes statuteve që të mbronin pretendimet e çdo pjesëtari për një periudhë dy-vjeçare që nga çasti i shitjes së tokës.¹¹⁰ Allan Bogue vëren se “zaptuesi priste që shokët e tij të klubit të vinin ta ndihmonin në rastet kur një kërcënues kërcënonte zotërimin e tij dhe ... miqtë e tij frikësonin spekulatorët, të cilët mund të kërkonin të paraqisnin një ofertë më të lartë në ankandin e tokës”.¹¹¹ Një historian vendas i Ajouas vinte re se “kur një banor ekzistues – i cili kërkonte tokën për të ndërtuar shtëpi dhe për ta zotëruar menjëherë... vendosej në ndonjë pjesë të ndonjë zotërimi të [shoqërisë], hetuesit shkonin menjëherë tek ai, duke i kërkuar që ose të hiqte dorë menjëherë nga pretendimi ose të paguante për atë që konsiderohej e drejtë e shoqërisë”. Nëse “banori dyshonte në lidhje me pretendimin fillestar të shoqërisë, kjo e fundit kishte gjithmonë gati një ose më shumë dëshmitarë për të dëshmuar në favor të interesit të saj”.¹¹²

Këto shoqëri zbatonin drejtësinë e tyre strikte dhe primitive. Dikur, një pastor vendas pyeti një pjesëtar të shoqërisë se çfarë do të ndodhte nëse ndonjë kërcënues arrinte të blinte tokën për të cilën ai kishte pretendim. Zaptuesi iu përgjigj: “Çfarë do të bëhet, do ta vras; dhe sipas marrëveshjes së banorëve

jam i mbrojtur dhe, nëse dal para gjyqit, nuk ka juri që të nxjerrë vendim kundër meje”.¹¹³ Megjithatë, shoqëritë tipike të pretendimeve shpалosnin të paktën iluzionin e procesit të drejtë, duke grumbulluar juri – të përbëra nga zaptues të tjerë – që të merreshin me çështjet e pretendimeve të kërcënuesve. Në një konte të Ajouas, një kërcënues që u përpoq të zinte një tokë dytësore të lirë dhe pronë të një anëtarit të shoqërisë së pretendimeve, “brenda një ore” u dërgua para një jurie banorësh, i shtyrë nga “një turmë burrash të acaruar dhe të inatosur”.¹¹⁴

Por, funksioni i shoqërive të pretendimeve shtrihej përtej mbrojtjes nga palët e treta e arrinte deri te ligji zyrtar. Për shembull, anëtarë të ndryshëm të shoqërisë, “të cilët zakonisht ishin zaptues që kishin zënë të parët një tokë të caktuar, binin dakord që të mos lëshonin oferta kundër njëri-tjetrit gjatë ankandëve të tokës dhe të ndalonin të jashtëmit të lëshonin oferta kundër pjesëtarëve të [shoqërisë]”.¹¹⁵ Hyrja e statutit të një shoqërie pretendimesh, përshkruan në mënyrë të ëmbël misionin:

Nëse, sipas sanksioneve Qeveritare, bëhemi banorë të një toke dhe shpenzojmë kohë dhe para për ta përmirësuar atë, ndiejmë se kemi të drejtë ta blejmë atë me një çmim të rregullt. Dhe, në këtë proces, mund të ekzistojnë individë që vendosin të ndërhyjnë me të drejtat tona, duke krijuar kështu mosbesim, shqetësim dhe gjendje alarmi. Kështu pra, Vendoset se, në situatën tonë, siguria gjendet vetëm brenda Unionit – dhe kështu, pra, vendosim të zgjidhim në formë miqësore çdo mosmarrëveshje mes nesh, të alternojmë koncesionet dhe të shmangim çdo faktor që mund të ketë tendencë të krijojë mosbesim dhe shqetësim – të pajtohemi me komitetet e ndryshme dhe t’i mbrojmë

në kuadër të lëshimeve që mund të bëjnë për sa u përket detyrave që u janë caktuar.¹¹⁶

Ky dokument është tipik në ngjashmërinë me “kontratat e banimit” që grupe zaptuesish hartojnë në shumë pjesë të Botës së Tretë sot.

Çdo shoqëri pretendimesh hartonte statutin e vet dhe, sipas ligjit, zgjidhte zyrtarët operacionalë, vendoste rregulla për shuarjen e mosmarrëveshjeve dhe hartonte një procedurë për regjistrimin dhe mbrojtjen e pretendimeve.¹¹⁷ Për shembull, statuti i shoqërisë së pretendimeve të Kontesë Xhonson në Ajoua, caktonte një president, një zëvendës president, një nëpunës dhe një regjistruer; lejonte zgjedhjen e shtatë gjyqtarëve, ku çdo pesë nga të cilët mund të formonin një gjykatë dhe të zgjidhnin mosmarrëveshjet; lejonte zgjedhjen e dy mareshalëve të cilët merreshin me zbatimin e rregullave të shoqërisë; dhe lejonte përvijimin e një procedure që përcaktonte të drejtat pronësore të tokës.¹¹⁸ Sipas Allan Bogue, një historian i këtyre “klubeve pretenduese” të Ajouas, shumica e “rregulloreve mbulonin aspektet e lejuar të pretendimeve; përfshinin direktiva për shenjëzimin, regjistrimin dhe transferimin e pretendimeve; si dhe përfshinin procedurën që duhej ndjekur kur anëtarët e klubit kontestonin të drejtat e njëri-tjetrit, kur anëtarët kërcënoheshin nga kërcënuesit dhe kur afrohej data e shitjes së tokës”.¹¹⁹

Kontratat e vendbanimit të shoqërive të pretendimeve vepronin qartësisht për të shtuar vlerën e tokës që pretendoheshin nga zaptuesit. Në kontetë Poueshiek, Xhonson dhe Uebster të Ajouas, shoqëritë e pretendimeve hartonin “rregullore specifike për të përshkruar shkallën e përmirësimit të pretendimit nga ana e anëtarit”.¹²⁰ Po ashtu, shoqëritë vendosnin kufij maksimalë e minimalë në lidhje me sipërfaqen e tokës së pretenduar që duhej

mbrojtur dhe shumë prej tyre lejonin anëtarët që të shisnin pretendimet për të rrokur vlerën e pronës së tyre. Megjithatë, shumë anëtarë “nuk mbeteshin të kënaqur me sipërfaqen e tokës që u caktonte statuti dhe shpeshherë lëshonin pretendime kaq të gjera për një pjesë të territorit, saqë, në shumë raste, bëhej e vështirë për një blerës që të gjente vend bosh”.¹²¹ Kjo praktikë kishte mbështetjen e heshtur të shumicës së anëtarëve të shoqërisë. Megjithëse anëtarët e shoqërive të pretendimeve denonconin spekulatorët e mëdhenj, ata vetë, sikurse thekson Bogue, “ishin spekulatorë në shkallë të ngushtë”.¹²² Shoqëritë e pretendimeve që janë përfshirë në historinë amerikane, nuk ishin thjesht një skemë për të mbrojtur ngastrat e tokës së dhënë nga shteti; ato përdorëshin për të mbrojtur edhe tregtinë e pretendimeve.¹²³

Dhe kështu, shoqëritë e pretendimeve ndihmuan në “krijimin e ligjeve të përbashkëta.. hartuar përmes konsensusit të përbashkët për nevoja të përbashkëta”.¹²⁴ Sikurse një historian i zaptuesve ka theksuar, “megjithëse ligji i pretendimit nuk ka ardhur nga instancat e larta të Shteteve të Bashkuara apo nga libri statutor i territorit, përbën ligjin e hartuar dhe amenduar nga vetë sovranit dhe mandati ligjor është i parevokueshëm”.¹²⁵

Megjithatë, banorët nuk e zëvendësuan plotësisht ligjin zyrtar. Marrëveshjet e tyre informale shërbenin si stacione të ndërmjetme në rrugën drejt respektueshmërisë ligjore.

Organizatat e minatorëve

Më 24 janar 1848, James Marshall dhe një grup indianësh e mormonësh zbuluan ar përgjatë lumit amerikan të Kalifornisë. Megjithëse minatorët u betuan se do të ruanin sekretin, në krye të katër muajve lajmi i këtij zbulimi kishte mbërritur në gazetat e San Franciskos. Ky zbulim “ka mundësi të ketë nxitur migracionin më të madh vullnetar njerëzor deri në këtë çast,

përmes një mësymjeje për arin në Kaliforni”.¹²⁶ Ndikimi i menjëhershëm që i thellë: “Fermerët braktisën plugjet nëpër fusha. Ushtarët dhe marinarët braktisën pozicionet e tyre. Dyqanxhinjtë braktisën bizneset e tyre. San Francisko u shndërrua menjëherë në një qytet fantazmë”.¹²⁷ Brenda një viti, në Kaliforni mbërritën 100,000 minatorë; dy vjet më vonë ishin bërë 300,000.

Kur këta individë me shpresë nxituan për në Kaliforni për të përvetësuar pasuritë e saj, “ata nuk gjetën as gardhe dhe as kulla rojesh”.¹²⁸ Megjithatë, ligjërisht, ata ishin shkelës meqenëse, për tokën ku kishin mbërritur, ishin ngritur interesa të shumta nga shumë palë”.¹²⁹ Në periudhën e mësymjes për arin, pjesa më e madhe e tokës zotërohej prej qeverisë federative, 9 për qind e sipërfaqes së përgjithshme të Kalifornisë mbulohej nga grantet tokësore meksikane, ndërkohë që pjesa tjetër ishte shkretinore, malore dhe gjithsesi e pabanuar.¹³⁰ Dhe, megjithëse qeveria federative po nxirrte qindra statute që rregullonin përdorimin e tokës, sikurse kemi vënë re, Shtetet e Bashkuara nuk kishin një ligj që të rregullonte shitjen ose dhënien me qira të tokës federative që mbante minerale të çmuar nën vete.¹³¹ Për më tepër, Kongresi përjashtoi në mënyrë të drejtpërdrejtë “tokat minerare” nga Akti i përgjithshëm i parablerjes i 1841.

Seria e vazhdueshme e granteve tokësore meksikane, largimi i pronarëve, ekzistenca e banorëve të uritur për tokë dhe mungesa e një ligji federal të imponueshëm, krijoi nevojën e menjëhershme për marrëveshje informale. Historianë të tillë si Pisani mendonin se banorët nuk kishin shumë mundësi për të zgjedhur. Nëse “vendoseshin mbi një tokë me pretendime meksikane me shpresën se pretendimi në lidhje me të do të shfuqizohej, ata ballafaqoheshin me problemin e humbjes së përmirësimeve që kishin kryer. Por, nëse blinin tokën nga një pretendues, kufijtë e të cilit ishin të përcaktuar qartë, mund

të humbitnin vlerën e tokës, si dhe atë të përmirësimeve”.¹³² Ndërkohë që banorët hartonin marrëveshjet e tyre, qeveria u përpoq të gjente një zgjidhje bazuar në ligjin zyrtar ekzistues. Problemi ishte se qeveria ishte tepër e ngadaltë. Më 1851, Kongresi krijoi një komision për të dhënë gjykim në lidhje me fuqinë ligjore të granteve tokësore meksikane dhe spanjolle. Megjithëse mandati zyrtar i komisionit zgjaste deri më 1856, gjykatat dhe Zyra e Përgjithshme e Tokës hoqën dorë nga vendimi përfundimtar vetëm shumë vite më pas. Si rezultat, banorëve u duhej të mbështeteshin vazhdimisht në ligjin informal për të ruajtur një ndjenjë rregulli. Ata ishin të detyruar sepse, sipas fjalëve të një historiani ligjor, “sa më afatgjatë të ishte procesi i konfirmimit, aq më shumë hapësira krijoheshin për mosmarrëveshje dhe dhunë”.¹³³

Ashtu sikurse klubi i pretendimeve të zaptuesve në Midwest, minatorët kishin dy precedentë që i ndihmonin: të drejtën e parablerjes dhe të drejtën e zotërimit të përmirësimeve.¹³⁴ Kështu që ata themeluan organizata për të rregulluar të drejtat e tyre informale dhe për të përcaktuar detyrimet që minatorët kishin individualisht në adresë të tokës së pushtuar. Këto kontrata banimi njiheshin si “rregulla të distriktit të minierave”. Minatorët e kuptonin se, nëse hartonin rregullat me kujdes, duke pasqyruar sa më shumë ligjin ekzistues, herët a vonë, qeverisë do t’i duhej të arrinte një marrëveshje me ta.

Minatorët nuk donin që të linin ndonjë hapësirë boshe. Shumica e rregulloreve të distrikteve të minierave përfshinte përgjithësisht nëntë faza të dallueshme. Së pari, përhapën lajmin ose fjalën për një takim masiv në një vend të njohur gjerësisht për themelimin e një distrikti të ri. Së dyti, në hapje të rendit të ditës së biznesit, minatorët përcaktonin kufijtë dhe juridiksionin e distriktit duke i vënë edhe emrin (zakonisht emri përcaktohej në bazë të tipareve gjeografike të zonës, në bazë të

pretendimit të parë të lëshuar apo në nder të individit që kishte organizuar distriktin). Së treti, minatorët vendosnin kufizime në lidhje me pronësinë për sa i përket numrit të pretendimeve të mbajtura ose të blera. Në shumë distrikte minierash, zbulimi i një xeherori të ri përgjithësisht lejonte një pretendim të dyfishtë, ndërkohë që, për ata ekzistues, lejohej vetëm një. Zakonisht nuk kishte kufizim për pretendimet e blera, nëse vërtetohej që blerja ishte kryer “në mirëbesim duke marrë parasysh dokumentet e regjistruar dhe certifikatat e pronësisë lëshuar nga regjistruesi”.

Së katërti, distriktet e minierave mundësonin anëtarësimin dhe të drejtat vetëm për qytetarët amerikanë ose për ata që sipas ligjit do të bëheshin qytetarë. Kështu pra, meksikanët dhe aziatikët përjashtoheshin në kuadër të paragjykimit racial të kohës. Minatorët meksikanë ose aziatikë akuzoheshin se nuk kishin kontribuar “në mirëqenien e njerëzve, pasurinë e djersitur të të cilëve kishin përvetësuar” dhe se rrezikonin moralin e “burrave të rinj [amerikanë]... të cilët kishin këputur lidhjet me shtëpinë”. Së pesti, rregullorja fiksonte përmasat e pretendimit mineral, i cili varionte nga 150 deri në 300 këmbë gjatësi për pretenduesit e mëdhenj, deri në gjatësi që barazoheshin me lopatën e minatorit në rastin e gërmimeve të vogla. Sipas rregullit, në çdo anë të zonës së pretenduar lejohej ndërtimi i tuneleve që zgjateshin pa u përplasur me të drejtat e pretenduesit fqinj. Së gjashti, rregulloret vendosnin edhe procedura për mënyrën se si minatorët do të identifikonin kufijtë e zotërimit të tyre. Zakonisht, pretendimi fillohej duke vendosur një lajmërim në lidhje me vendin, i cili përmbante emrin e krijuesit, të distriktit dhe kontesë.

Së shtati, rregulloret caktonin zyrën e regjistruesit, ku mbaheshin regjistrat zyrtarë të distriktit, dhe detajonin se si duhet të regjistroheshin pretendimet. Shpesh, regjistruesit zgjidheshin me mandat 1-vjeçar. Për më tepër, rregulloret

kërkonin që minatorët “të skedonin lajmërimin e veprimit pranë regjistruesis 5-13 ditë nga data e lëshimit të pretendimit dhe regjistruesi urdhërohej të mbante një libër të këtyre skedimeve duke regjistruar transferimin e titujve brenda distriktit”. Së teti, rregulloret përcaktonin kërkesat në lidhje me zhvillimin e zonave të pretenduara duke përcaktuar “kohën, shtrirjen dhe karakterin” e punës që duhej kryer për të zotëruar një zonë të pretenduar. “Dënimi për moszbatim ishte mundësia e konfiskimit”. Së fundi, rregulloret hartonin një sistem për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.¹³⁵

Të përballur me një hapësirë ligjore në ligjin federativ për minierat, minatorët, duke treguar mendjemprehtësi ligjore, krijuan një ligj veprues për minierat. Duke ndërmjetësuar me njëri-tjetrin, ata punuan për të mbrojtur të drejtat dhe për të shtuar vlerën e pronës deri në çastin kur qeveria të vendoste të ligjëronte pretendimet e tyre. Vendosja e të drejtave pronësore përmes metodave informale nuk ishte rastësi. Informaliteti – sikurse sot në Botën e Tretë – ishte i parashikuar. Në vitet pas zbulimit të arit, Kalifornia kishte rreth 800 juridiksione të pavarura, secili me rregulloret e veta.¹³⁶ Çdo juridiksion siguronte legjitimitetin dhe fuqinë fillestare nga konsensusi mes anëtarëve. Historiani Charles Howard Shinn vëren se “asnjë [kryebashkiak] autoritar, asnjë këshill dhe asnjë organ i drejtësisë nuk mund të ushtronte autoritetin mbi një distrikt përmes një fuqie të jashtme. Në shumë rajone, distrikti përbënte një njësi të organizimit politik, shumë kohë pas krijimit të shtetit; dhe delegatët e distrikteve fqinje takoheshin për t’u këshilluar në lidhje me kufijtë apo për çështje të qeverisjes vendore, dhe raportonin pranë përfaqësive të tyre përmes takimeve të mbajtura në vende të hapura, si në kodra apo anës lumenjve”.¹³⁷

Shumë politikanë nisën të mbështetnin pretendimet e minatorëve dhe gjykatat nisën të sanksiononin marrëveshjet

e tyre informale. Më 1861, një gjykatës i Gjykatës së Lartë të Kalifornisë komentoi në lidhje me legjitimitetin e marrëveshjeve informale pas çështjes Gore kundër McBreyer: “Është më se e mjaftueshme që minatorët të bien dakord – qoftë në takime publike, qoftë me paralajmërim – lidhur me ligjet e tyre lokale dhe që këto ligje të njihen si rregullat e fqinjësisë, me përjashtim të rasteve kur rezulton ndonjë mashtrim ose kur ka ndonjë arsye tjetër për t’i hedhur poshtë këto rregulla”.¹³⁸

Një arsye e lehtësisë së pranimit të rregulloreve të distrikteve të minatorëve ishte fakti se, shpeshherë, këto rregullore hartoheshin në bazë të parimeve, ideve dhe procedurave, të cilat nuk ishin shumë të ndryshme nga ato të ligjit zyrtar. Lejs thekson se rregulloret e distriktit “pasqyronin njohuritë dhe traditat e grumbulluara... gjatë Mbledhjeve të Minierave të minatorëve të kallajit të Cornwall; praktikat e Distriktit Haj Pik dhe të Gjykatës Barmot të Derbishajërit; organizatën dhe praktikat e Burgermajsterit të Saksonisë; ordinancat Koloniale Spanjolle të përfaqësive mbretërore në Spanjën e Re dhe në Peru; dhe disa praktika prej distrikteve të minatorëve të rripit të plumbit të Misurit”.¹³⁹ Për shembull, “kur një minator paraqiste pretendimet e tij para rregullave dhe traditave, zotërimi aktual i një pjese të tokës së pretenduar me kufij të përcaktuar i jepte atij të drejta zotërimi për të gjithë zonën e pretenduar. Ky do të ishte një zbatim... i [një aspekti] të ligjit për zotërimin e pafavorshëm”.¹⁴⁰ Një avokat i minatorëve diskutonte se si ligji i tyre shkonte paralel dhe thjeshtësonte sistemin e të drejtave formale të pronësisë:

Sipas ligjit të minatorëve, vlerësuesi është oficeri ekzekutiv i cili merr grantin, i jep vetes një titull pronësie, fikson kufijtë dhe e shpall veten pronar... Shpallja është zëvendësuese e aplikimit të shkruar; caktimi i kufijve i

përgjigjet qëllimit të anketës; ligji i minierave përbën koncesionin dhe regjistrimin pranë zyrtarit lokal të regjistrimeve. I vetmi zyrtar i pushtetshëm është publiku i gjerë, i cili përfaqësohet nga minatorët dhe ligjet e të cilit janë të patundur.¹⁴¹

Kjo shkrirje e modeleve informale me ata ligjorë ekzistues mbushi hapësirën e ligjit formal në tokat me minerale të shumta të Amerikës – sikurse bëjnë sot organizatat e zaptuesve në Botën e Tretë. Gjatë viteve '50 të shekullit të 19-të, Kongresi nuk kreu asnjë përpjekje për të përvetësuar burimet minerare të Perëndimit. Historianët spekulojnë se suksesi i minatorëve në vetëqeverisje ka mundësi të lidhet me filozofinë politike të ditës, ose me faktin që kombi ishte tepër i shqetësuar në lidhje me çështjen e skllavërisë dhe kërcënimit e shkëputjes së shteteve Jugore.¹⁴² Ka mundësi që avokatët që përbënin ligjvënësit amerikanë, thjesht e njihnin një hartim të përpiktë të ligjit kur e shihnin. Megjithatë, një gjë është e qartë: Mungesa e veprimit nga ana e Kongresit thjesht i shtoi kredibilitet kontratave sociale të cilat, jo vetëm që ishin hartuar nga minatorët, por ishin vënë në punë prej tyre.¹⁴³

Megjithatë, në vitet '60 të shekullit të 19-të, Lufta Civile, nevoja për fonde për ta vazhduar atë dhe shqetësimet e investitorëve për Kaliforninë, Nevadën dhe Koloradon, detyruan Kongresin të merrte në konsideratë konsolidimin e mijëra ligjeve të minatorëve brenda një sistemi të integruar. Shqetësimi i investitorëve në lidhje me titullin e pronësisë të tokës luajti një rol shumë të rëndësishëm në këtë çështje. Një bashkëkohës vuri re se, për shkak të mungesës së një sistemi standard të titujve, “kapitalistët nuk kishin dëshirë të shpenzonin paratë e tyre nëpër puse të kushtueshëm dhe për makineri e ndërtesa të shtrenjta për të vlerësuar një xeheror, i

cili, sipas ligjit të minatorëve, mund të nëndahej pafundësisht sipas vlerës së tij”.¹⁴⁴ Qeveria federative nisi të merrte seriozisht në konsideratë metodat për rregullimin e aktivitetit minerar në tokën federative.¹⁴⁵ Sipas Lacy, një nga shqetësimet më të mëdha të anëtarëve të Kongresit në lidhje me Perëndimin, “ishte kërkesa për sigurinë e titujve dhe aftësia për të blerë toka minerare me një çmim të arsyeshëm”.¹⁴⁶

Më 1866, për herë të parë Kongresi shpalli hapjen zyrtare të tokave minerare kombëtare ndaj zbulimit nga ana e qytetarëve amerikanë – tetëmbëdhjetë vjet pas kohës kur qindra mijëra minatorë kishin nisur kërkimin e arit në tokat federative të Kalifornisë. Statuti i 1866 theksonte në mënyrë eksplicite se gjithë zbulimet për minerale do t’i nënshtroheshin “zakoneve dhe rregullave të minatorëve të distrikteve të ndryshme”, të cilat nuk gjendeshin në kushte konflikti me ligjet e Shteteve të Bashkuara.¹⁴⁷ Qëllimi i ligjit nuk ishte shkatërrimi i të drejtave të lindura në formë informale, por fuqizimi i tyre “me disa rregullore të plota në lidhje me metodat e zotërimit dhe përpunimit të tyre, rregullore që nuk binin në konflikt me ligjet ekzistuese minerare, por që thjesht i jepnin uniformitet dhe qëndrueshmëri gjithë sistemit”.¹⁴⁸ Një tjetër aspekt thelbësor i këtij ligji të ri minerar ishte fakti se “baza e projekt-ligjit vinte drejtpërdrejt nga rregullat për damarët e xeherorëve të Distriktit Valei Majning në kontenë Nevada të Kalifornisë... dhe të Distriktit Minerar Gold Mauntin në kontenë Stori të Nevadës”.¹⁴⁹ Gjatë miratimit të ligjit, Kongresi arriti deri në atë pikë sa lavdëroi gjenitë amerikanë për krijimin e marrëveshjeve informale:

Është thelbësore që ky sistem i madh i krijuar nga njerëzit në kuadër të aftësive të tyre primare, i cili dëshmon, përmes dëshmisë më të lartë të mundshme, gjenialitetin

karakteristik të popullit amerikan për themelimin e një perandorie dhe vendosjen e një rendi, të ruhet dhe legjitimohet. Sovraniteti popullor shpaloset në një nga aspektet e tij më të rëndësishme dhe thjesht na fton, jo që ta shkatërrojme, por që të vendosim mbi të vulën e pushtetit dhe autoritetit të pakushtëzuar kombëtar.¹⁵⁰

Dhe kështu pra, legjislacioni i 1866 jo vetëm që njihje legjitimitetin e kontratave sociale të lindura jashtë ligjit zyrtar, por përfshinte parimet dhe të drejtat e siguruara nga banorët në kuadër të pretendimeve të parablerjes dhe vendosjes. Po ashtu, ligji akordonte të drejtat e patentës për çdo individ ose shoqatë që kishte shpenzuar 1,000 dollarë në punë dhe përmirësime mbi tokën e pretenduar, qoftë kjo e anketuar apo jo. Kjo përbënte një njohje të drejtpërdrejtë të faktit se vlera e shtuar e aseteve ishte diçka të cilën ligji duhet ta nxiste dhe mbronte.

Më 10 maj 1872, Kongresi miratoi ligjin e përgjithshëm të minierave, duke themeluar një strukturë formale themeltare të ligjit amerikan të minierave që është përçuar deri në ditët e sotme. Ky ligj përmbante dy parimet më të rëndësishme të aktit të 1866: njohjen e ligjeve të minatorëve dhe njohjen e të drejtës së çdo individi që përmirësonte një minierë për të blerë titull pronësie nga qeveria me një çmim të arsyeshëm.¹⁵¹ Në një hapësirë kohore 20-vjeçare, të drejtat dhe marrëveshjet e hartuara informalisht nga ana e minatorëve ishin integruar brenda një sistemi të ri formal. Edhe Gjykata e Lartë, armiqësia e së cilës kundër të drejtave informale nxiti një kundërsulm pro-zaptuesve, rikonfirmoi vlefshmërinë e ligjeve federative të minierave të viteve 1866 dhe 1872 në çështjen Jennison kundër Kirk. Sipas Gjykatës, dy statutet “lëshonin sanksionin qeveritar për të drejtat e zotërimit të siguruara sipas zakoneve

lokale, ligjeve dhe vendimeve të gjykatave lokale... [dhe] njihnin detyrimin e qeverisë për të respektuar të drejtat private që ishin zgjeruar përmes miratimit dhe nxitjes së saj të heshtur. Qeveria nuk propozoi ndonjë sistem të ri, por sanksionoi, rregulloi dhe përcaktoi një sistem ekzistues, pranë të cilit ishin bashkuar njerëzit”.¹⁵² Në vitet '80 të shekullit të 19-të, rregullat dhe zakonet e distrikteve minerare informale ishin integruar brenda një sistemi koherent të ligjit për pronësinë formale.¹⁵³

* * *

Në fund të shekullit të 19-të, politikanët dhe gjykatësit amerikanë kishin mbërritur, pas një kohe të gjatë, në një zonë me ligje prone – dhe ishin pikërisht zaptuesit ata që i kishin drejtuar deri atje. E njëjta gjë vlente edhe për strehimin: Më 1862, kur Kongresi miratoi “Aktin Homestead”, të evokuar fuqishëm, i cili i akordonte 160 akra tokë çdo banori i cili dëshironte të jetonte dhe të përmirësonte një tokë për 5 vjet, ky organ thjesht po sanksiononte atë që banorët e kishin bërë vetë”.¹⁵⁴ Me gjithë famën legjendare të Aktit Homestead, shumë vendbanime ishin krijuar para se ky ligj të miratohej. “Mes viteve 1862 dhe 1890, popullsia e Shteteve të Bashkuara kishte arritur në 32 milionë banorë – por, vetëm 2 milionë prej tyre ishin vendosur në 372,649 fermat e pretenduara përmes Aktit Homestead”.¹⁵⁵ Në kohën kur Kongresi më në fund e miratoi atë, banorët kishin shumë alternativa ligjore për të siguruar tituj të tokës publike.¹⁵⁶ Megjithatë, historikisht, Akti Homestead ka një vlerë të lartë simbolike, që nënkupton fundin e një lufte të gjatë, të mundimshme dhe të ashpër mes ligjit elitar dhe një rendi të ri, të sjellë nga migrimet masive dhe nevojat për një shoqëri të hapur dhe të fortë. Duke rrokur përfundimisht shumë prej marrëveshjeve informale të banorëve, ligji formal

legjitimoi vetveten, duke u bërë rregull dhe jo përjashtim për shumicën e popullsisë së Shteteve të Bashkuara.

Rëndësia për kombet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste

Për vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste që përpiqen të hedhin hapat e tranzicionit për në kapitalizëm, eksperiencia amerikane është shumë kuptimplotë. Njohja dhe integrimi i të drejtave informale të pronësisë ka qenë një element kyç në Shtetet e Bashkuara që po ktheheshin në ekonominë e tregut më të rëndësishme në botë dhe në prodhuesit e kapitalit më të fuqishëm të botës. Sikurse ka theksuar Gordon Wood, gjatë kësaj kohe “po ndodhte diçka e mrekullueshme në shoqëri dhe kulturë, e cila po çlironte aspiratat dhe energjitë e njerëzve të zakonshëm si kurrë ndonjëherë më parë në historinë amerikane”.¹⁵⁷

Kjo gjë “e mrekullueshme” ishte një revolucion i të drejtave për të pasur të drejta pronësie. Amerikanët, megjithëse jo gjithmonë me energji dhe në mënyrë të vullnetshme, po legjitimonin gradualisht normat dhe marrëveshjet pronësore informale, të cilat ishin krijuar nga amerikanët më të varfër, si dhe po i integronin ato brenda ligjit të tokës. Në fillim të shekullit të 19-të, informacionet në lidhje me pronësinë dhe rregullat që e qeverisnin atë u shpërndanë, u bënë hi dhe u shkëputën. Kjo ndodhi me librat e vjetër të llogarive, me vërejtjen personale, me statutet informale, me rregulloret e distrikteve, me dëshmitë gojore nëpër ferma, miniera apo vendbanime urbane. Sikurse në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste sot, një pjesë e madhe e këtij informacioni lidhej vetëm me bashkësitë vendase dhe nuk ishte përfshirë në asnjë rrjet të qëndrueshëm përfaqësimesh të sistemuara. Megjithëse zyrtarët amerikanë nuk kishin këtë qëllim dhe nuk e kishin parashikuar kur hartuan ligjet kombëtare, sikurse ishin aktet

e parablerjes dhe të minierave, ata po krijojnë formatet e përfaqësimit që ndikuan në integrimin e gjithë informacionit të shpërndarë dhe të veçuar të pronësisë brenda një sistemi të ri formal të pronësisë.

Nuk ishte një detyrë e thjeshtë dhe e shpejtë; dhe jo çdo gjë u menaxhua paqësisht. Por eksperiencia amerikane është shumë e ngjashme me atë që po ndodh sot në vendet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste: Ligji zyrtar nuk ka qenë në gjendje të mbajë hapin e iniciativës popullore dhe qeveria ka humbur kontrollin. Si rezultat, njerëzit joperëndimorë jetojnë në një botë paradoksesh dhe nuk ndryshojnë shumë nga ata të përshkruar prej historianit Edward G. White: “Kur minatori braktisi kasollen dhe shkoi të punonte, ai vuri në punë risinë më të fundit teknologjike. Kur fermeri doli nga hambari i tij, ai shpesh përdorte makineritë bujqësore më moderne”.¹⁵⁸ Banorët e Botës së Tretë jetojnë dhe punojnë, gjithashtu, në kasolle dhe lagje të varfra së bashku me aparate televizivë dhe makina llogaritëse. Edhe ata janë organizuar nëpër klube pretendimesh. Edhe qeveritë e tyre kanë nisur t’u lëshojnë të drejta parablerjeje.

Por, ajo që u mungon është e drejta ligjore efektivisht e hartuar për të mundësuar integrimin e pronës së tyre në një sistem formal ligjor që u lejon ta përdorin për të prodhuar kapital. Përmes zënies, parablerjes, banimit, ligjeve të minierave etj., amerikanët krijuan një koncept të ri në lidhje me pronën, “i cili theksonte aspektet dinamike të pronës duke i lidhur me rritjen ekonomike” dhe i cili zëvendësoi një koncept “që theksonte tiparin e ngurtë të pronës duke e lidhur me sigurinë prej ndryshimeve të mprehta”.¹⁵⁹ Pronësia amerikane ndryshoi nga një formë e ruajtjes së një rendi të vjetër ekonomik, në një mekanizëm të fuqishëm për vendosjen e një rendi të ri. Rezultatet ishin tregjet e gjerë dhe kapitali i nevojshëm për të

ushqyer rritjen bombastike ekonomike. Ky ishte ndryshimi “i mrekullueshëm” që ende nxit rritjen ekonomike amerikane.

Së fundi, mësimet e tranzicionit të Shteteve të Bashkuara drejt formalitetit nuk gjenden tek detajet teknike, por në ndryshimet e qëndrimit politik dhe në prirjet e gjera ligjore. Gjatë miratimit të ligjeve të integritit të popullsisë informale, politikanët amerikanë shprehën idenë revolucionare, sipas së cilës, institucionet ligjore mund të mbijetojnë vetëm nëse i përgjigjen nevojave sociale.¹⁶⁰ Sistemi ligjor amerikan fitoi fuqi sepse u ndërtua mbi eksperiencën e amerikanëve të thjeshtë dhe mbi marrëveshjet informale të krijuara prej këtyre të fundit, ndërkohë që hodhi poshtë doktrinat e ligjit të përbashkët anglez, të cilat nuk jepnin zgjidhje për problemet tipike amerikane. Gjatë procesit të gjatë dhe të rëndë të integritit të drejtave informale të pronësisë, ligjvënësit dhe juristët amerikanë krijuan një sistem të ri i cili përshtatej shumë më mirë me një ekonomi tregu prodhuese dhe dinamike. Ky proces përfaqësonte një revolucion të nxitur nga shpresat normative të njerëzve të zakonshëm, të cilat qeveria i zhvilloi në një strukturë formale të sistemuar dhe profesioniste.

Kjo nuk do të thotë se kombet në zhvillim dhe ato ish-komuniste duhet të imitojnë pikë për pikë tranzicionin e Shteteve të Bashkuara. Në eksperiencën amerikane ka shumë pasoja negative, të cilat duhet të shmangen me kujdes. Por, sikurse kemi vënë re, ka shumë për të mësuar. Mësimi fillestar është se të pretendosh se marrëveshjet informale nuk ekzistojnë ose të provosh t'i gjurmosh pa një strategji e cila të përfshijë kanalizimin e tyre brenda sektorit ligjor, është diçka pa bërëqet – sidomos në botën në zhvillim ku, sikurse kemi vënë re në kreun 2, sektori informal përfshin shumicën e popullsisë dhe mbulon trilionë të tërë dollarë kapital të vdekur.

Përpjekjet për të nxitur një revolucion të pronës në Botën e Tretë dhe vendet ish-komuniste do të kenë kërkesa, pengesa dhe mundësi specifike. Duhet konkurruar me revolucionet e tjera në zhvillim, si ata në fushën e komunikacioneve, teknologjisë së informimit dhe urbanizmit masiv. Por situata bazë është e njëjtë. Sot, në shumë kombe në zhvillim dhe ish-komuniste, ligji i pronës nuk ndikon më mbi jetën dhe punën e shumicës së njerëzve. Si mund të arrijë legjitimitet një sistem ligjor nëse përjashton 80 për qind të popullsisë? Sfida e vërtetë është korrigjimi i këtij dështimi ligjor. Eksperienca amerikane tregon se kjo detyrë ka natyrë të trefishtë: Duhet zbuluar kontratat e vërteta sociale të pronësisë, duhen integruar në ligjin zyrtar dhe duhet hartuar një strategji politike që të mundësojë reformën. Se si qeveritë e ndryshme ballafaqohen me këto sfida do ta paraqesim në kreun e ardhshëm.

6

MISTERI I DËSHTIMIT LIGJOR

Jeta e ligjit nuk ka qenë logjikë; ka qenë eksperiencë.

*Gjykatësi i Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara
Oliver Wendel Holmes*

Pothuaj çdo vend në zhvillim ose ish-komunist zotëron një sistem formal të pronësisë. Problemi është se shumica e qytetarëve nuk mund të depërtojnë në këtë sistem. Ata janë përplasur me qelqin e kampanës së Fernand Braudel, atë strukturë të padukshme të së kaluarës së Perëndimit e cila rezervonte kapitalizmin për një sektor shumë të ngushtë të shoqërisë. Alternativa e tyre e vetme, sikurse vumë re në kreun 2, është që të tërhiqen së bashku me asetet e tyre në sektorin informal, ku mund të jetojnë dhe të ngrënë një biznes – por pa qenë në gjendje të shndërrojnë asetet e tyre në kapital.

Para se të heqim kambanën, duhet të kuptojmë se nuk jemi të parët që përpiqen ta bëjnë këtë. Sikurse do të shohim në këtë kre, qeveritë e vendeve në zhvillim janë përpjekur për 180 vjet që ta bëjnë sistemin e pronësisë të arritshëm për të varfrit.

Pse kanë dështuar? Arsyeja është se zakonisht, qeveritë veprojnë sipas pesë koncepteve të gabuara:

- Të gjithë individët që maskohen në sektorët informalë dhe klandestinë e bëjnë këtë për të shmangur pagimin e taksave;
- Asetet e pasurive të patundshme nuk mbahen ligjërisht sepse nuk janë anketuar, identifikuar në hartë dhe regjistruar siç duhet;
- Dekretimi i ligjit mandativ të pronës është veprim i mjaftueshëm dhe qeveritë mund të shpërfillin kostot e pajtimit me ligjin;
- Marrëveshjet ekzistuese informale ose “kontratata sociale” mund të shpërfillen;
- Gjërat themeltare, sikurse janë bindjet e njerëzve për mënyrën e mbajtjes së asetëve ligjërisht dhe joligjërisht, mund të ndryshohen pa ndonjë drejtim politik të nivelit të lartë.

Të shpjegosh ekonomitë informale të këtyre vendeve, ku aderon 50 deri 80 për qind e popullsisë, në terma tatimorë është pjesërisht veprim i gabuar. Shumica e njerëzve nuk kalojnë në sektorin informal sepse është një paradise tatimore, por sepse ligji ekzistues, megjithëse është qëndisur bukur, nuk i adresohet nevojave dhe shpresave të tyre. Në Peru, ku skuadra ime hartoi një program për përfshirjen e sipërmarrësve të vegjël informalë brenda sistemit ligjor, rreth 276,000 sipërmarrës të tillë regjistruan biznesin e tyre në formë vullnetare në zyrat e reja

të regjistrimit që kishim ngritur – megjithëse nuk kishin marrë premtime për shkurtime tatimore. Bizneset e tyre klandestine nuk kishin paguar asnjëherë tatime. Katër vjet më vonë, të ardhurat totale nga tatimet e grumbulluara prej bizneseve ish-informale arrinin 1.2 miliardë dollarë.

Ne korrëm sukses sepse modifikuam ligjin për biznesin dhe pronësinë për t'iu përshtatur nevojave të sipërmarrësve që ishin mësuar me rregulla informale. Po ashtu, shkurtuam në mënyrë dramatike kostot e burokracisë për regjistrimin e bizneseve. Por, prodhuesit dhe dyqanxhinjtë informalë – të cilët sigurojnë të ardhura margjinale të ulëta që maten me qindarka dhe jo me dollarë – i njihnin bazat e matematikës. Ajo që duhet të bënim ishte të garantonim që kostot e veprimtarisë së ligjshme ishin më ulëta sesa kostot e mbijetesës në sektorin informal, të thjeshtonim dokumentacionin për legalizimin, të bënim përpjekje për të transmetuar përparësitë e programit dhe më pas të shihnim qindra mijëra sipërmarrës të hiqnin dorë me kënaqësi nga klandestiniteti.

Ndryshe nga ajo që mendon popullsia e gjerë, veprimtaria në klandestinitet nuk është pa kosto. Bizneset informale tatohen për shkak të mungesës së ligjit të mirëfilltë të pronës dhe duhet të fshehin vazhdimisht veprimtarinë nga autoriteti. Për faktin se nuk kanë krijuar korporata, sipërmarrësit informalë nuk mund të joshin investitorët duke shitur aksione; nuk mund të sigurojnë kredi formale me interes të ulët sepse nuk kanë as adresa ligjore. Ata nuk mund të reduktojnë riskun duke deklaruar përgjegjësi të kufizuar apo duke përfutur mbulim nga sigurimet. I “vetmi” sigurim për ta është ajo që sigurohet prej fqinjëve dhe mbrojtja e shitur prej “të fortëve” të lagjes ose prej organizatave mafioze. Për më tepër, për shkakun se sipërmarrësit informalë jetojnë me frikën e zbulimit nga qeveria dhe zhatjes prej zyrtarëve të korruptuar, ata shpërndajnë dhe copëzojnë infrastrukura

prodhuese në shumë zona, duke mos arritur kurrë ekonomi të rëndësishme të shkallës. Në Peru, 15 për qind e të ardhurave bruto nga prodhimi në sektorin informal shkon për ryshfete, që variojnë nga “kampionët e lirë” e mallrat “dhuratë”, deri te paraja e thatë nën dorë. Duke qenë gjithmonë të vëmendshëm për policët, sipërmarrësit klandestinë nuk mund të bëjnë reklama për të tërhequr klientelën apo të bëjnë dorëzime në bllok më pak të kushtueshme për konsumatorët.

Kërkimi që kemi zhvilluar ka vërtetuar faktin se në shumicën e vendeve, çlirimi nga kostot dhe ngatërresat ligjore të sektorit ekstraligjor është ekuivalent me pagimin e taksave. Si të jeni brenda kambanës, si të jeni jashtë saj, do të taksoheni. Ajo që përcakton qëndrimin jashtë përbën koston oportune të të qenit i ligjshëm.

Një tjetër koncept i gabuar është fakti se asetet e pasurisë së patundshme nuk mund të regjistrohen në formë ligjore nëse nuk anketohen, identifikohen në hartë dhe regjistrohen me një teknologji të informimit gjeografik numër 1 në botë. Edhe kjo është pjesërisht e vërtetë. Evropianët dhe amerikanët arritën të regjistronin të gjithë asetet e pasurive të patundshme shumë dekada para se të zbuloheshin kompjuterët dhe sistemet e informimit. Sikurse kemi vënë re në kreun e fundit, gjatë shekullit të 19-të, anketimi i tokave të reja të banuara në Shtetet e Bashkuara ishte shumë prapa tjetërsimit të të drejtave të pronësisë. Në Japoni, kam hetuar dokumentacionin e zyrave të regjistrimit dhe kam vënë re se si disa asete tokësore janë regjistruar në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore duke përdorur harta të periudhës Edo – e cila është tre ose katër shekuj më e vjetër se shpikja e fotografimit ajror dhe e sistemeve globale të pozicionimit.

Kjo nuk nënkupton se sistemet e zhvilluara të informimit kompjuterik dhe gjeografik nuk janë shumë të rëndësishme për

qeveritë në kuadër të hapjes së sistemit pronësor për të varfrit. Kjo nënkupton se dekapitalizimi i gjerë, zaptimi informal i tokës dhe strehimi i paligjshëm në botën joperëndimore nuk vjen si shkak i mungesës së teknologjisë së përparuar të informimit dhe hartografimit.

Kambana e Braudelit nuk përbëhet nga tatime, harta dhe kompjuterë, por nga ligje. Ajo që ndalon shumicën e njerëzve në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste që të përdorin pronësinë formale moderne për të krijuar kapital është sistemi i keq ligjor dhe administrativ. Brenda kambanës gjenden grupe elitare që mbajnë pronë duke përdorur ligje të kodifikuara të marrë hua nga Perëndimi. Jashtë kambanës, atje ku jeton shumica e njerëzve, prona përdoret dhe mbrohet përmes gjithë llojeve të marrëveshjeve informale që i kanë rrënjët në konsensusin informal të shpërndarë përmes një territori të gjerë. Këto kontrata sociale lokale përfaqësojnë një mirëkuptim kolektiv për pronësinë e sendeve dhe marrëdhëniet mes pronarëve. Krijimi i një kontrate sociale kombëtare në lidhje me pronën përfshin kuptimin e proceseve psikologjike dhe sociale – bindjet, dëshirat, qëllimet, zakonet dhe rregullat – që përmbahen në këto kontrata sociale, dhe më pas përdorimin e mekanizmave të ligjit profesional për t'i bashkuar ato brenda një kontrate të vetme formale sociale ndërkombëtare. Pikërisht këtë kanë arritur kombet Perëndimore jo shumë kohë më parë.

Pika kyçe që duhet kuptuar është se prona nuk përbën diçka fizike që mund të fotografohet ose vizatohet mbi hartë. Pronësia nuk është një cilësi primare e asetëve, por shprehia ligjore e një konsensusi ekonomikisht kuptimplotë në lidhje me asetet. Ligji është instrumenti që fikson dhe realizon kapitalin. Në Perëndim, ligji është më pak i interesuar për përfaqësimin e realitetit fizik të ndërtesave ose pasurive të patundshme, dhe më i interesuar për të krijuar një proces ose tërësi rregullash që lejojnë shoqërinë të

nxjerrë vlerë shtesë potenciale prej këtyre aseteve. Pronësia nuk përbën vetë asetin, por një konsensus mes njerëzve për mbajtjen, përdorimin dhe shkëmbimin e këtyre aseteve. Sfida e shumë vendeve joperëndimore sot nuk është vendosja në të njëjtën hartë e gjithë tokave dhe ndërtesave të kombit (gjë që mund të jetë arritur tashmë), por integrimi i bindjeve formale ligjore brenda kambanës nëpërmjet informalëve që jetojnë jashtë.

Asnjë anketim ose vizatim në hartë nuk mund ta sigurojë këtë. Asnjë lloj kompjuterizimi nuk mund të shndërrojë asetet në një formë të tillë që i lejon të përfshihen në tregjet e gjerë për t'u bërë kapital. Sikurse kemi vënë re në kreun 3, vetë asetet nuk kanë ndikim mbi sjelljen sociale: Ato nuk prodhojnë stimuj, nuk i bëjnë njerëzit kontabël, nuk zbatojnë kontratat. Asetet nuk janë "likuide" në thelb – nuk mund të ndahen, kombinohen apo mobilizohen për t'iu përshtatur transaksioneve. Të gjitha këto cilësi rrjedhin prej ligjit modern të pronësisë. Është ligji ai që shkëput dhe fikson potencialin ekonomik të aseteve si vlerë të veçuar nga vetë aset material dhe i lejon njerëzit të zbulojnë dhe realizojnë këtë potencial. Është ligji ai që lidh asetet përmes qarqeve financiare dhe të investimeve. Dhe është përfaqësimi i aseteve, i cili fiksohet në dokumentet ligjorë të pronësisë, që u jep atyre fuqinë për të krijuar vlerë shtesë.

Më tepër se 60 vjet më parë, historiani i njohur i jurisprudencës, C. Reinold Noyes shkruante:

Qarqet e lojës ekonomike sot nuk janë të mirat fizike dhe shërbimet aktuale, që paraqiten gjerësisht në literaturën ekonomike, por përpunimet e marrëdhënieve ligjore që i quajmë pronësi... Pronësia kuptohet duke studiuar zhvillimet e saj për të konceptuar realitetin shoqëror si një rrjet lidhësh të paprekshme – një pëllhurë filamentesh të padukshme – i cili rrethon dhe angazhon individin

duke organizuar në këtë mënyrë shoqërinë... Dhe procesi i rrokjes së botës aktuale në të cilën jetojmë, është procesi i objektivizimit të këtyre marrëdhënieve.¹

Pra, heqja e kambanës përbën parimisht një sfidë ligjore. Rendi zyrtar ligjor duhet të ndërveprojë me marrëveshjet informale jashtë kambanës për të krijuar një kontratë shoqërore për pronën dhe kapitalin. Për të siguruar këtë integrim, janë të nevojshme shumë disiplina të tjera: Ekonomistët duhet të llogarisin siç duhet kostot dhe numrat; planifikuesit urbanë dhe agronomët duhet të përcaktojnë përparësitë; hartuesit e hartave, ekspertët e mbijetesës dhe ekspertët kompjuterikë janë shumë të nevojshëm për të vënë në punë sistemet e informacionit. Por, përfundimisht, një kontratë sociale kombëtare e integruar duhet të konkretizohet vetëm përmes ligjeve. Gjithë disiplinat e tjera kanë vetëm funksion mbështetës.

Mos vallë kjo nënkupton se avokatët duhet të drejtojnë procesin e integritit? Jo. Zbatimi i ndryshimeve të mëdha ligjore është një përgjegjësi politike. Ka shumë arsye për këtë. Së pari, ligji merret kryesisht me mbrojtjen e të drejtave të pronësisë. Megjithatë, detyra kryesore e vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste nuk është të përsosin të drejtat ekzistuese, por t'u japin njerëzve të drejta për të siguruar të drejta pronësie – e thënë ndryshe “meta të drejta”. Dhurimi i këtyre meta të drejtave, emancipimi i njerëzve prej ligjit të keq, përbën një detyrë politike. Së dyti, grupet e vegjël por të fuqishëm të interesit – që kryesisht përfaqësohen prej avokatëve tregtarë më të mirë të vendit – kanë të ngjarë të kundërshtojnë ndryshimin nëse nuk binden për të kundërtën. Afrimi i njerëzve me njohje dhe para në këtë sipërmarrje nuk kërkon këshilltarë të angazhuar për t'i shërbyer klientëve të tyre, por politikanë të angazhuar për t'i shërbyer popullit të tyre. Së treti, krijimi i një sistemi të integruar nuk ka lidhje me hartimin e ligjeve dhe

rregulloreve të qëndisura bukur në letër, por me përvijimin e normave të rrënjosura në besimet e njerëzve, të cilat kanë më tepër prirje të imponojnë bindje dhe zbatim. Ruajtja e lidhjeve me njerëzit realë është një detyrë politike. Së katërti, stimulimi i ekonomive klandestine për t'u bërë të ligjshme, përbën një detyrë të madhe politike. Qeveritë duhet të bindin qytetarët më të varfër – të cilët nuk kanë besim te qeveria dhe mbijetojnë përmes marrëveshjeve të ngushta provinciale – dhe disa prej organizatave mafioze që i mbrojnë, që të blejnë një biletë për të marrë pjesë në një lojë më të madhe dhe më të lirë. Po ashtu, qeveritë duhet të bindin majtistët e fuqishëm, të cilët në shumë vende qëndrojnë pranë bazës, se t'u mundësojnë zgjedhësve të tyre prodhimin e kapitalit është mënyra më e mirë për t'i ndihmuar ata. Qytetarët që gjenden brenda dhe jashtë kambanës kanë nevojë që qeveria t'i bindë për faktin se një sistem i ridimensionuar dhe i integruar i pronësisë ka kosto më të ulët, është më efikas dhe më i mirë për kombin krahasuar me marrëveshjet anarkike ekzistuese.

Nëse nuk korr suksese në këto fronte ligjore dhe politike, asnjë komb nuk do të jetë në gjendje të kapërcejë aparteidin ligjor mes atyre që mund të krijojnë kapital dhe atyre që nuk mund ta bëjnë këtë. Pa pronësi formale, shumica e njerëzve nuk do të jenë në gjendje të përparojnë në një shoqëri kapitaliste, pavarësisht nga numri i aseteve që grumbullojnë dhe puna e rëndë që kryejnë. Ata do të mbeten jashtë radarit të ligjvënësve, jashtë regjistrave zyrtarë dhe kështu do të mbeten ekonomikisht të padukshëm.

Qeveritë Perëndimore kanë korrur sukses në hapjen e kambanës, por procesi ka qenë i çrregullt e i pavullnetshëm dhe ka zgjatur 100 vjet. Së bashku me kolegët kam sintetizuar atë që mendojmë se kanë kryer përmes një formule që e quajtmë “procesi i kapitalizimit” dhe përmes së cilës po ndihmojmë

qeveritë anembanë botës. Formula paraqitet në Figurën 6.1. Shpjegimi i detajeve nuk është objekt i librit, por lexuesit që do të parapëlqenin një përshkrim teknik të të gjithë planit janë të ftuar të shohin dokumentet e pabotuar pranë Institutit për Liri dhe Demokraci. Në pjesën e mbetur të kreut do të përqendrohemi mbi dy përbërësit e nevojshëm të formulës: sfida ligjore dhe sfida politike.

PJESA I

Sfida Ligjore

Në gjendjen aktuale, krijimi i një sistemi pronësor të integruar nuk është i mundur në kombet joperëndimore. Marrëveshjet informale të pronësisë janë të shpërndara përmes dhjetëra qindra bashkësisht; të drejtat dhe informacione të tjera janë të njohura vetëm për anëtarët e brendshëm ose fqinjët. Pavarësisht nga kjo, marrëveshjet pronësore informale të paorganizuara, karakteristike për kombet e Botës së Tretë dhe ato ish-komuniste, duhet të përfshihen brenda një sistemi të vetëm, prej të cilit rrjedhin parimet e përgjithshme të ligjit. Me pak fjalë, kontratat e shumta sociale që gjenden “sa andej këtej”, duhet të integrohen brenda një kontrate të vetme gjithëpërfshirëse sociale.

Si mund të arrihet kjo? Si mund t'i zbulojë qeveria marrëveshjet pronësore informale? Pikërisht kjo pyetje mu bë nga pesë pjesëtarë të kabinetit indonezian. Unë gjendesha në Indonezi për të lançuar botimin e përkthyer të librit të mëparshëm në rajonin Bahasa Indonezian dhe ata më ftuan të flisja në lidhje me format e zbulimit të pronarëve mes 90 për qind të indonezianëve të cilët përfshiheshin në sektorin informal. Duke u druajtur se mos humbisja dëgjuesit për shkak të një shpjegimi të hapur teknik mbi hedhjen e një ure lidhëse mes sektorëve informalë dhe formalë, zbulova një mënyre të

re, tipike indoneziane, për t'iu përgjigjur pyetjeve të tyre. Gjatë publikimit të librit, kisha marrë disa ditë pushim për të shëtitur Balin, një nga vendet më të bukur mbi tokë. Teksa i rashë lart e poshtë fushave me oriz, nuk e kisha idenë se ku mund të gjendeshin kufijtë e pronave. Por qentë e dinin këtë. Sa herë që kaloja nga një fermë te tjetra, një tjetër qen lehte. Mbase këta qen indonezianë nuk i njihnin ligjet formale, por e dinin se cilët asete zotëronte i zoti i tyre.

U thashë ministrave se qentë indonezianë zotëronin informacionin bazë që ishte i nevojshëm për të krijuar një sistem formal të pronësisë. Duke udhëtuar përmes rrugëve të qyteteve dhe fshatrave dhe duke dëgjuar lehtë e qenve ata mund të ngjiteshin gradualisht, përmes hardhisë së përfaqësimeve informale të përhapura anembanë vendit, deri sa të arrinin te kontrata sociale sunduese. “Ah”, u përgjigj një prej ministrave, “Jukum Adat (ligji i njerëzve)!”

Përmes zbulimit të “ligjit të njerëzve”, kombet Perëndimore hartuan sistemin e tyre formal të pronësisë. Çdo qeveri që e ka seriozisht ridimensionimin dhe sundimin e marrëveshjeve informale brenda një kontrate të vetme kombëtare formale për pronësinë, duhet të dëgjojë qentë që lehin. Për të integruar gjithë format e pronësisë brenda një sistemi unik, qeveritë duhet të zbulojnë si dhe përse funksionojnë konventat sociale dhe sa të fuqishme janë ato.

Mosarritja e kësaj, shpjegon pse përpjekjet e kaluara për ndryshim ligjor në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste kanë dështuar. Njerëzit kanë prirje ta shohin “kontratën sociale” si një abstraksion të padukshëm hyjnor i cili gjendet vetëm në mendjet e vizionarëve si Locke, Hume dhe Rousseau. Por, së bashku me kolegët, kam zbuluar se kontratat sociale të sektorit informal nuk janë thjesht detyrime sociale të nënkuptuara të cilat përmbushen përmes sjelljes sociale; janë edhe marrëveshje

që dokumentohen drejtpërdrejt nga njerëzit realë. Si rezultat, këto kontrata sociale informale mund të preken dhe mund të bashkohen për të ndërtuar një sistem të pronësisë dhe formimit të kapitalit i cili njihet dhe zbatohet nga vetë shoqëria.


Kalimi prej Sistemit Parakapitalist te ai Kapitalist i Pronësisë

Pa një sistem të integruar formal të pronësisë, një ekonomi moderne e tregut është e pakonceptueshme. Nëse kombet e përparuar të Perëndimit nuk do të kishin integruar gjithë aktet e përfaqësimit në një sistem të vetëm të standardizuar të pronësisë dhe nëse nuk do ta kishin bërë të disponueshëm këtë sistem për të gjithë, ata nuk do të kishin qenë në gjendje të specializonin dhe ndanin punën për të krijuar rrjetin e gjerë të tregut dhe kapitalit, i cili ka prodhuar pasurinë që kanë sot. Mangësitë e tregjeve joperëndimore lidhen me copëtimin e marrëveshjeve të pronësisë dhe mungesën e akteve standarde të përfaqësimit. Kjo mungesë integrimi kufizon ndërveprimin jo vetëm mes sektorit formal dhe informal, por edhe mes të varfërve. Bashkësitë informale shkëmbejnë me njëra-tjetrën, por me shumë vështirësi. Këto janë si flota detare që ruajnë formacionin duke lundruar në mënyrë të koordinuar me njëra-tjetrën dhe jo duke ndjekur një pikë të përbashkët referimi si yjet apo busullat magnetike.

Standardet e përbashkët përbëjnë një organ ligjor të nevojshëm për të themeluar një ekonomi moderne të tregut.² Sikurse ka theksuar C. Reinold Noyes:

Natyrë njerëzore kërkon rregullsi dhe siguri, dhe kjo nevojë kërkon që këto gjykime primitive të jenë të qëndrueshme dhe të lejohet të kristalizohen përmes rregullave të caktuara - në "një grup dogmash ose

FIGURA 6.1



A. STRATEGJIA E NJOHJES SË GJËNDJES

A.1 Identifiko, përcakto vendndodhjen dhe klasifiko asetet ekstraligjore (kapitalet e vdekur)

A.1.1 Ndërmer veprime specifike në terren për të kuptuar dhe depërtuar në brendësi të sektorit ekstraligjor.

A.1.2 Përcakto shkaqet për grumbullimin e asetëve ekstraligjore me qëllim për të modeluar tipologjitë e tyre.

A.1.3 Përcakto pozicionin e sektorëve ekonomikë dhe të zonave gjeografike ku mbizotëron sektori ekstraligjor.

A.2 Vlerëso vlerën aktuale dhe atë potenciale të asetëve ekstraligjorë (kapitali i vdekur)

A.2.1 Zhvillo metodologji të përshatshme për të përcaktuar vlerën e asetëve duke përdorur informacionin ekzistues dhe të dhënat e grumbulluara në terren.

A.2.2 Përcakto kriteret e mbledhjes dhe pëpunimit të informacionit dhe konfirmo rezultatet.

A.2.3 Bëj të qartë rëndësinë e vlerës së asetëve ekstraligjore.

A.3 Analiza ndërvlerësimin e sektorit ekstraligjor me pjesën tjetër të shoqërisë:

A.3.1 Studjo lidhjet e vlefshme dhe të mundshme midis qeverisë dhe asetëve ekstraligjore.

A.3.2 Shqyrto lidhjet e mundshme midis biznesit të ligjshëm dhe asetëve ekstraligjore.

A.3.3 Identifiko proceset ku qeveria ja ka dalë që tani të trajtojë me sukses çështje që kanë të bëjnë me asetet ekstraligjore.

A.4 Identifiko normat ekstraligjore që qeverisin pasuritë/ pronat ekstraligjore

A.4.1 Zbulo dhe zbrërthe normat ekstraligjore që përcaktojnë mënyrën me të cilën ruhet dhe zbatohet e drejta e pronësisë nga komunitetet e ndryshme ekstraligjore të vendit.

A.5 Përcakto kostot e sektorit ekstraligjor në gjithë vendin

A.5.1 Kostot për vetë sektorin ekstraligjor.

A.5.2 Kostot për sektorin e biznesit të ligjshëm.

A.5.3 Kostot për vetë qeverinë.

B. Strategjia politike dhe ligjore

B.1 Sigurohu që niveli më i lartë politik të marrë përsipër përgjegjësi për kapitalizimin e të varfërve.

B.2 Bëj të funksionueshme agjensitë që do të mundësojnë ndryshimet e shpejta.

B.2.1 Identifiko dhe përfshi në procesin e kapitalizimit institucionet e ndryshme që aktualisht meren me të drejtën e pronësisë apo që kanë aftësinë për gjenerimin e vlerës së shtuar.

B.2.2 Koncepto dhe mer miratimin për të vënë në punë agjensitë që do të lejojnë mundësimin e shpejtë të ndryshimeve në proceset e ndryshme që kërkohen për të realizuar legalizimin. Në se është e mundur, krijo një institucion të vetëm me mandatin për të legalizuar/ kapitalizuar asetet, dhe decentralizo zyrat në bazë për të dhënë shërbime në të gjithë vendin.

B.2.3 Sigurohu që procesi i legalizimit të përfshijë si përparësi politike të qeverisë, astu edhe një konsensus brenda shoqërisë, gjë që e bën procesin lehtësisht të zbatueshëm.

B.3 Elimino kufizimet administrative dhe ligjore

B.3.1 Llogarit kostot e legalizimit të asetëve ekstraligjore, duke përfshirë:

B.3.1.1 Kërkesat për leje në të gjitha nivelet e qeverisjes.

B.3.1.2 Kërkesat për shumën e pagesave për këto leje.

B.3.1.3 Numri i formularëve dhe dokumentave të tjera që nevojiten.

B.3.1.4 Kërkesa të tjera që nuk mund të plotësohen në praktikë.

B.3.1.5 Gjithë kostot e tjera të transakcioneve, përfshi vonesat kohore.

B.3.2 Shmang kufizimet administrative dhe ligjore duke identifikuar dhe modifikuar institucionet, statutet, ligjet dhe praktikat që krijojnë shanse për korrupsion.

B.4 Ndërto konsensus midis sektorëve ligjorë dhe ekstraligjorë

B.4.1 Përcakto pikat ku normat ekstraligjore përputhen me ligjin, në mënyrë që pastaj të bëhet e mundur për të përgatitur statute/ligje që i njohin provat ekstraligjore të pranueshme të pronësisë me mbështetjen e vetë komuniteteve ekstraligjore.

B.4.2 Siguro që projekt-normat/standartet ligjore, të cilat përfshijnë edhe pasuritë ekstraligjore, e bëjnë këtë pa kompromentuar nivelin e sigurisë që garanton aktualisht rregulli ekzistues i ligjit në fuqi, sipas të cilit çdo pronë regjistrohet dhe kontrollohet në mënyrë të saktë, me qëllim që të mbrohet legjitimiteti i sektorit ligjor.

B.5 Përgatit statute/ligje dhe procedura që i ulin kostot për mbajtjen ligjërisht të një aseti/prone poshtë nivelit të mbajtjes së tyre në mënyrë ekstraligjore

B.5.1 Vër në veprim ligje të cilat kërkojnë që të gjithë pronat në vend të qeverisen nga një strukturë e vetme ligjore dhe procedurash.

B.5.2 Gjenero përkufizimin e konceptit 'provë e pronësisë' me qëllim që kjo t'u përshatet proceseve të reja dhe të konsolidohet brenda paketave ligjore dhe të procedurave administrativisht të menaxhueshme, të cilat do të udhëneqin procesin e legalizimit/kapitalizimit.

B.5.3 Legjisacionin e shpërndarë mblidhe në një ligj të vetëm.

B.5.4 Zhvillo institucionet dhe procedurat që u lejojnë gamës së ekonomike të gjitha aktivitetet të cilat përbëjnë procesin e legalizimit dhe kapitalizimit.

FIGURA 6.1 (vazhdimi)

- B.5.5 Krijohet një alternativë të ligjshme me kosto të ulët, të shpejtë dhe praktike kundrejt ndërtimit abuziv dhe pa leje, dhe gjithë formave të tjera të posedimit ekstraligjor. Konsolido procesin dhe respektin për ligjin, duke vendosur stimuj motivues dhe dekurajues që synojnë inkurajimin e nismave ligjore dhe dekurajimin e nismave ekstraligjore;
- B.5.6 Projekto dhe zbatohet procese administrative ose private, për të zëvendësuar proceset juridike atje ku është e mundur, në mënyrë që të inkurajohet zgjidhja e konflikteve brenda ligjit.
- B.6 Krijohet mekanizma që paksojnë rrezikun e lidhur me investime private, përfshi besueshmërinë e titujve të pronësisë dhe mungesën e detyrimeve për shërbime publike.**
- C. Strategjia operacionale**
- C.1 Projekto dhe zbatohet strategji, procedura, personeli, pajisjet, zyra, trajnimet dhe manuale mbi mënyrën se si operohet në terren, për t'i mundësuar qeverisë të njohë dhe trajtojë të drejtat individuale të pronësisë në sektorin ekstra ligjor**
- C.1.1 Projekto mekanizma për të siguruar pjesëmarrje masive të banorëve të lagjeve me ndërtime informale, ilegale dhe ekstraligjore, me qëllim uljen e kostos së legalizimit/kapitalizimit.
- C.1.2 Organizohet kurse trajnimi për institucionet që do të merren me legalizimin/kapitalizimin, për të pasqyruar tipet ekstraligjore që do të shqyrtohen.
- C.1.3 Përgatit manuale që u spjegojnë drejtuesve dhe popullit të komunitetit në lagjet me ndërtime informale/ilegale (ekstraligjore) mënyrën se si ata mund të marrin pjesë në grumbullimin dhe përzgjedhjen e provave të pronësisë.
- C.1.4 Përgatit për legalizim komunitetet ekstraligjore.
- C.1.4.1 Identifikohet dhe trajno aktivistët vendorë brenda çdo komuniteti.
- C.1.4.2 Zbatohet një fushatë promovimi vendor brenda çdo komuniteti (ekstraligjor).
- C.1.4.3 Edukohet çdo komunitet rreth provave që kërkohen për të vërtetuar pronësinë e pretenduar.
- C.1.4.4 Trajnojë drejtuesit vendorë të komunitetit për të evidentuar/ regjistruar informacionin për asetet/pronat sipas formularëve të përgatitur.
- C.1.4.5 Identifikohet dhe trajno verifikuesit privatë (vlerësues/ kolaudues) për të provuar informacionin e grumbulluar prej komunitetit.
- C.1.5 Grumbullo dhe përpuno informacionin për asetet fizike.
- C.1.5.1 Siguro ose përgatit harta që tregojnë kufijtë e ngastrave individuale (atje ku është e nevojshme përgatit harta me bazë dixhitale për regjistrimin e informacionit për kufijtë).
- C.1.5.2 Verifikohet nëse hartat që tregojnë kufijtë e ngastrave individuale korrespondojnë me gjendjen faktike në terren.
- C.1.5.3 Depozitohet të dhënat e hartave në sisteme kompiuterike.
- C.1.6 Grumbullo dhe përpuno informacionin e pronësisë.
- C.1.6.1 Grumbullo informacionin e pronësive/aseteve dhe regjistrohë në formularë regjistrimit.
- C.1.6.2 Verifikohet që të drejtat e pronësisë janë të vlefshme edhe sipas ligjeve të reja që aprovohen.
- C.1.6.3 Depozitohet informacionin e pronësisë në sisteme kompiuterike.
- C.1.6.4 Regjistro zyrarisht të drejtat e pronësisë.
- C.1.6.5 Shpërndaj certifikatat e pronësisë tek përfituesit, nëpërmjet ceremonive publike
- C.2 Zbatohet strategji komunikimi duke përdorur organe të përshatshme të medias për të inkurajuar pjesëmarrjen e sektorit ekstraligjor, mbështetjen e komunitetit të biznesit dhe të qeverisë, duke ruajtur status quo-në e balancës midis tyre dhe interesave që ato përfaqësojnë.**
- C.2.1 Zbatohet një fushatë për secilin lloj të veçantë komuniteti të sektorit ekstraligjor për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në proces.
- C.2.2 Evidentohet mekanizmat që u dëshmojnë përfituesve të procesit të legalizimit/kapitalizimit që asetet e tyre mbrohen nga i njëjti kuadër institucional që mbrohet të drejtat e investitorëve privatë, vendas dhe të huaj. Kjo do t'u japë këtyre pronarëve një arsye për të respektuar kontratat që qeverisen nga rregulli vendor ligjor.
- C.2.3 Organizohet fushatë specifike për komunitet legjale që mund të ndihen të dobëta ose të pa-përkrahura.
- C.2.4 Projekto mjetet e komunikimit me sektorin legjor për të kuptuar përfitimet e tyre nga procesi i legalizimit/ kapitalizimit, duke vënë theksin në reduktimin e rrisqeve dhe sqarimin se kapitalizimi nuk do të ndikojë të drejtat ekzistuese të pronësisë, dhe nuk do të kompromentojë të drejtat e palëve të treta.
- C.2.5 Ndërmerr një fushatë spjeguese për profesionistët që lidhen me përcaktimin ekzistues të pronës, duke shpjeguar rolin e tyre të ardhshëm dhe angazhimin në rritje brenda një sektori legjor të zgjeruar pas procesit të legalizimit/kapitalizimit.
- C.3 Rikoncepto/ristrukturo institucionet dhe procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në mënyrë që ato të mund të bashkohen të gjitha të dhënat ekonomiksht të dobishme mbi asetet ekstraligjore të vendit dhe t'i integrojnë ato në një tërësi të dhënash/informacioni bazuar në një sistem të kompiuterizuar**
- C.3.1 Strukturo institucionin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përfshi mënyrën e brëndshme të funksionimit të tij; thfishëso procesin e regjistrimit; vendos specifikime për informacionin e automatizuar; projekto dhe zbatohet një sistem kontrolli për cilësinë e punës; përzgjidh dhe kualifikojë personelin; dhe përcakto procedurën për të bërë të sigurtë se sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme është i aftë të administrojë një program legalizimi/kapitalizimi në nivel kombëtar.
- C.3.2 Ndëro sisteme informacioni gjeografik (GIS), për të siguruar kapacitete analitike hapësinore.
- C.3.3 Vendos mekanizma kontrolli për të garantuar që kostot e regjistrimit dhe shërbimeve të regjistrimit janë mjaftueshmërisht efektive dhe efektive nga pikëpamja e kostos, në mënyrë që përdoruesit e tij të mos motivohen sërisht të rreshqojnë drejt informallitetit/ekstralegallitetit.
- C.3.4 Grupi karakteristikat përkrahuese të pronësisë ekstraligjore në një mënyrë/formë regjistrimi sa më të thjeshtë (mundësisht të informatuar) ku pronat mund të dallohen qartë, të regjistrohen dhe administrohen mundësisht në një mjedis/sistem të vetëm kompiuterik.
- C.3.5 Klasifikojë informacionin që mbahet në mënyra tradicionale, në kategori të thjeshta që të mund të depozitohen në programe kompiuterike dhe të sistematizohen, për të patur akses sa më të thjeshtë, pasi të sigurohet ndikimi për procedurat ekzistuese të grumbullimit të informacionit mbi bazën e aprovimeve ligjore.
- C.3.6 Lehtëso përditësimin e informacionit të kompiuterizuar të pasurive të paluajtshme, duke vendosur qendra të depozitimit të të dhënave sa më pranë përfituesve. Qëllimi është që të pakësohen kostot e transportit dhe transakcioneve ligjore për pasuritë e paluajtshme të regjistruara dhe bizneset e lidhura me pronësinë, duke mbrojtur statusin e tyre ligjor.
- D. Strategjia komerciale**
- D.1 Zbatohet mekanizma informacioni dhe detyrimi që do të bëjnë të mundur:**
- D.1.1 Vepërimit bankare/hipotekë/kredit
- D.1.2 Shërbimet publike (energj, ujë, sistem kanalizimi, telekomunikacion)
- D.1.3 Sistemi i mbledhjes së: kredive, tarifave, taksave
- D.1.4 Shërbimet për të dhënat bazë (database/informacion)
- D.1.5 Produktet e sigurancionit (dëmtim prone, sigurim jete, sigurim krediti, pengjet, sigurim titulli)
- D.1.6 Sistemet kombëtare të identifikimit
- D.1.7 Strehimi dhe infrastruktura
- D.1.8 Sigurimi kombëtar

predikimesh sistematike që përbëjnë ligjin”... Lehtësia praktike e publikut... çon në përpjekjet e vazhdueshme për sistemimin e organit të ligjeve. Kërkesa për kodifikim është kërkesë e njerëzve për t’u çliruar nga misteri dhe pasiguria e ligjit të pashkruar dhe të pazbatueshëm.³

Arritja e tranzicionit prej një gjendjeje ku njerëzit mbështeten mbi një shumëllojshmëri praktikash informale të vendosura përmes konsensusit të përbashkët në një sistem ligjor të kodifikuar, përbën një sfidë të tmerrshme. Sikurse kemi vënë re, pikërisht këtë bënë kombet e Perëndimit për të kaluar prej “gjkimeve primitive” parakapitaliste në një organ të sistemuar të ligjeve. Në këtë mënyrë ata hapën kampionin. Megjithatë, me gjithë suksesin e korrur, këto kombe nuk ishin gjithmonë të ndërgjegjshëm për atë që po bënin dhe nuk lanë pas asgjë të shkruar. Edhe në Britani, etja për të zmadhuar përfitimet e Revolucionit Industrial, bëri që përpjekjet reformatore të vazhdonin për një shekull të tërë (prej 1829 deri më 1925) para se qeveria të ishte e sigurt se asetet e pasurive të patundshme mund të regjistroheshin dhe transferoheshin lirshëm. John C. Payne përmbledh vështirësitë dhe çrregullimin e reformës pronësore në Angli:

Një numër i madh statutesh u miratua dhe ligji pronësor anglez u riformulua fund e krye. Pjesa më e madhe e reformës përbëhej nga improvizimi i rastësishëm dhe mund të lindte përshtypja se udhëheqësit e lëvizjes nuk kishin gjithmonë një ide të qartë të asaj që po bënin apo të arsyes pse po e bënin. Ligji anglez i tokës ishte bërë aq teknik dhe ishte amenduar aq shumë përmes shekujve, sa që kjo detyrë në fillim mund të jetë dukur e paralizueshme. Vështirësia qëndronte se kishte kaq shumë detaje për të cilët duhej treguar kujdes, sa që qe

mjaft e vështirë të arrihej në thelb të çështjes. Kështu pra, reformatorët anglezë nisën të punonin me shumë energji, por me pak qartësi në lidhje me konceptin. Në fund të fundit puna e tyre doli me sukses, por iu desh një shekull për ta përmbushur dhe në retrospektivë kryen shumë eksperimente të dështuar dhe u detyruan që përfundimisht të pranonin shumë kompromise.⁴

Dështimi i Ligjit Mandativ

Dikush mund të mendojë se sot do të ishte relativisht e thjeshtë hapja e kambanës në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste. Në fund të fundit, e drejta për të pasur pronë njihet nga pothuaj çdo kushtetutë e botës si dhe nga shumë konventa ndërkombëtare. Programet e pajisjes së të varfërve me pronë ekzistojnë në çdo vend në zhvillim dhe ish-komunist. Ndërkohë që reforma e shekullit të 18-të dhe 19-të në Perëndim hasi qëndresë të fortë intelektuale dhe morale kundër ndarjes së të drejtave formale të pronësisë, disponibiliteti i pronësisë konsiderohet pjesë e të drejtave themeltare të njerëzimit sot. Shumë traktate ndërkombëtare bashkëkohore, që variojnë prej Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut më 1948 dhe katekizmit të Kishës Katolike deri te Konventa e 169-të e Zyrës Ndërkombëtare të Punës në lidhje me Popullsitë Vendase dhe Fisnore në Vendet e Pavarura, mbajtur më 1989, këmbëngulin se prona përbën një të drejtë njerëzore themeltare të qëndrueshme. Në shkallë të ndryshme, gjykatat dhe ligjet anembanë botës e shohin këtë të drejtë si një parim të rëndësishëm ligjor. Tradita e vjetër e ushtrive pushtuese për të plaçkitur pronën është ndaluar rreptësisht përmes ligjit ndërkombëtar që prej Konventës Ndërkombëtare të Hagës më 1899. Kështu pra, ligji ndërkombëtar i trajton të drejtat e pronësisë të individëve si

më të shenjta se të drejtat sovrane të shtetit, duke theksuar se, edhe nëse qeveritë humbasin toka, pronarët e tokave të këtyre territoreve nuk do të humbasin tokat e tyre.

Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Japonia dhe Evropa – 25 vendet e përparuara të botës – kanë përparuar më shumë se ato vende që nuk kanë pasur një sistem formal të disponueshëm të pronësisë dhe sot, askush nuk mund të japë propozime serioze për zgjidhje ekonomike që nuk marrin parasysh nevojën e pronësisë formale. Për këtë arsye, kombet në zhvillim dhe ato ish-komuniste e njohin parimin e disponibilitetit të përgjithshëm të të drejtave të pronësisë si një përbërës të mirë dhe të rëndësishëm për programet makroekonomike dhe të reformës së tregut.

Qëllimi politik për të legalizuar asetet e të varfërve është shenjtëruar përmes ligjit Latino-Amerikan që prej dy shekujve. Kushtetuta e parë Peruane, shkruar më 1814, vetëm dy vjet pas arritjes së pavarësisë nga Spanja, shpallte hapur se të varfrit, shumica e të cilëve ishin kryesisht peruanë me origjinë vendase, ishin pronarë legjitimë të tokës së tyre. Kur u bë e qartë se elita peruane po shpronësonte të varfrit vendas, qeveria nxori disa ligje që përforconin qëllimin e kushtetutës peruane. Asnjë prej këtyre ligjeve nuk dha rezultat. Popullsia vendase siguroi statute të cilët vërtetnin se asetet e tyre u përkisnin ligjërisht atyre. Çfarë u mungonte ishin mekanizmat që do t'u lejonin të fiksonin të drejtat ekonomike të aseteve përmes akteve të përfaqësimit të mbrojtura nga ligji.

Arsyeja është shumë e qartë tashmë: Në Peru (dhe në shumë vende të tjera joperëndimore), shumica e procedurave ligjore për krijimin e pronësisë formale nuk janë konceptuar për të përpunuar provat informale të pronësisë, të cilave u mungon ndonjë formë e dukshme titulli pronësie – i cili, sigurisht, përbën të vetmen provë që zotërojnë të varfrit. Po ashtu, ligji

ekzistues nuk mund të ndjekë dhe të regjistrojë ndryshimet e vazhdueshme të titullit të pronësisë të asetit teksa transaksionet vazhdojnë të modifikojnë marrëdhëniet e pronësisë me kalimin e kohës. Sikurse vumë re në kreun 2, sot, në rrethanat më të mira ku zotërohen harta, kompjuterë dhe organizata të të drejtave të njeriut në gatishmëri, si dhe gjithë vullneti i mirë i botës mbarë i angazhuar, procedurat ligjore për regjistrimin e titujve dhe ndryshimeve mund të kërkojnë 20 vjet. Në kuadër të këtyre provave të zbuluara, duket se vendasit e Perusë së shekullit të 19-të, përballeshin me vonesa të cilat mund të kenë qenë edhe më të gjata. Për këta njerëz që përballeshin me pengesa të tilla, krijimi i rregullave informale për të mbrojtur asetet ishte mbase gjëja më e mençur që duhej bërë.

Kur u bë e qartë se ligjet mandative nuk po ndihmonin popullin vendas të Perusë në konkretizimin e të drejtave, grupet elitare ekonomike kaluan në veprim, duke shpikur trille të reja për të anashkaluar qëllimin e ligjit. Atje ku nuk ekzistonin titujt zyrtarë, njerëzit me lidhje së bashku me avokatët e tyre nisën t'i shpiknin, duke rimodeluar provat dokumentare dhe duke detyruar autoritetet dhe noterët lokalë që të lëshonin tituj ligjorë në favor të tyre (*titulos supletorius*, sikurse quheshin). Edhe njëherë, elita shpronësoi vendasit peruanë ose i detyroi të shisnin me çmim të lirë. Qeveria, në vend që të hetonte se përse të varfrit nuk ishin në gjendje të përdornin ligjin në përfitim të tyre, arriti në përfundimin se problemi nuk ishte ligji, por të varfrit ishin inferiorë nga natyra. Kështu që, në vend që të përmirësonin ligjin, ata morën disa të varfër dhe ngritën gardhe rreth tokës së tyre. Më 1924, Peruja miratoi një ligj të gjerë për mbrojtjen e vendasve nga dredhitë ligjore duke vendosur mijëra të tillë në bashkësitë bujqësore të fshatit ku transferimi i të drejtave të tokës ndalohej rreptësisht. Kështu, ndërkohë që mbronte vendasit nga marifetet dhe mashtrimet e

elitave, qeveria u mori, megjithëse në mënyrë të paqëllimshme, mekanizmat themeltarë për krijimin e kapitalit.

Megjithatë, vatrat rurale mbanin vetëm një përqindje të vogël të popullsisë vendase. Në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70, shumica e mbetur ishte ende e prekshme dhe e mërztur dhe, si rrjedhojë, një klasë potencialisht e paqëndrueshme u bashkua me lëvizjet e fuqishme dhe të mirëorganizuara majtiste. Për të shuar këtë kërcënim të ri, qeveria peruane, sikurse qeveri të tjera të Botës së Tretë, hartoi programe të reformës agrare të cilat mundësuan konfiskimin e sipërfaqeve të gjera të tokës prej fermave dhe rençeve (*haciendas*), për të krijuar më tepër se 600 kooperativa bujqësore për fermerët, të drejtuara nga shteti. Edhe njëherë qëllimi ishte fisnik: të mundësohej disponibiliteti i pasurive të patundshme për vendasit. Ajo që ndikoi në dështimin e këtyre përpjekjeve ishte fakti se vendasit nuk parapëlqenin të punonin nën një burokraci të imponuar. Ata ndanë kooperativat në parcela të vogla dhe private toke dhe iu kthyen edhe një herë marrëveshjeve informale fleksibël dhe të njohura për të mbrojtur të drejtat e reja që kishin siguruar. Qeveria nuk kishte marrë parasysh faktin se, pasi populli siguronte më në fund pronësinë, ai kishte idetë e tij për përdorim dhe shkëmbim të saj. Nëse sistemi ligjor nuk thjeshton nevojat dhe ambiciet njerëzore, njerëzit do të dalin prej këtij sistemi.

Historia peruane jep një mësim të rëndësishëm për reformatorët me ngjyrimë të ndryshme politike. Programet qeveritare për t'u dhënë pronë të varfërve kanë dështuar për 150 vjet, megjithëse ndiqnin prirjet e së djathtës (të drejta për pronë private përmes ligjeve mandative) apo të së majtës (mbrojtja e tokës së të varfërve përmes kooperativave shtetërore). Programet e shkërmoqura politike "të së majtës kundër së djathtës" nuk kanë rëndësi për nevojat e njerëzve në vendet në zhvillim.

Këta njerëz dolën jashtë ligjit jo sepse ligji i privatizoi apo i kolektivizoi, por thjesht sepse ligji nuk i adresojë nevojat e tyre. Nevojat e tyre mund të variojnë. Shpeshherë atyre u duhet të kombinojnë pronat dhe shpeshherë u duhet t'i ndajnë ato. Nëse ligji nuk i ndihmon, atëherë ata ndihmojnë veten jashtë ligjit. Ajo që karakterizon armiqët e pronës dhe të formimit të kapitalit në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste, nuk është bindja e majtë apo e djathtë, por fakti nëse janë mbështetës të *status-quo*-së. Qeveritë e vendeve në zhvillim nuk duhet të jetojnë me paragjykimet e Perëndimorëve që kanë ngecur te mizoria e rrethimit (mbylljes) dhe krijimit të pronës shekuj më parë në Britani, apo te shpronësimet e përgjaksme ndaj amerikanëve vendas në Amerikën e Veriut. Këto detyrime morale duhet të paguhen në Perëndim, jo jashtë tij. Ajo që duhet të bëjnë qeveritë e vendeve në zhvillim është të dëgjojnë të lehurat e qenve brenda bashkësive të tyre dhe të zbulojnë se si prononcohet ligji në lidhje me këtë. Vetëm në këtë çast, njerëzit do të reshtin së jetuari jashtë ligjit.

Ligji formal po humbet vazhdimisht legjitimitetin e tij tekta njerëzit vazhdojnë të krijojnë prona të pidentifikueshme. Të dhënat e jashtme treguan se, prej viteve '60 deri në vitet '90, sektori informal ishte zgjeruar jo vetëm në Peru, por edhe në vendet e tjera në zhvillim dhe në ato ish-komuniste. Duke supozuar se dështimi i ligjit mandativ nuk ka qenë një fenomen peruan, më 1994, së bashku me një skuadër speciale kërkimi u përpoqa të zbuloj nëse në 30 vitet e fundit institucionet financiare ndërkombëtare kishin zbatuar ndonjë program masiv dhe të suksesshëm "formalizimi" në Botën e Tretë - program në të cilin të gjitha asetet përfaqësoheshin dhe integroheshin brenda një sistemi të vetëm për të prodhuar kapital. Me gjithë shohitjen metodike të regjistrimeve të Thesarit të Shteteve të Bashkuara dhe të organizatave ndërkombëtare, nuk gjetëm

asnjë informacion për ndonjë sukses që të ishte sado pak i krahasueshëm me atë të kombeve të përparuar.

Ajo që zbuluam ishte se gjatë katër dekadave të fundit, qeveri të ndryshme kishin nisur shumë programe të tilla, duke rezervuar miliarda dollarë për të financuar një shumëllojshmëri të gjerë aktiviteteve të lidhur me pronën si anketim dhe shenjzim në hartë e në sisteme regjistrimi të kompjuterizuar. Këto projekte kishin dy tipare themelore të përbashkëta: Një pjesë e mirë e tyre ishin pezulluar para kohe për shkak të rezultateve të varfra (menaxheri i një projekti qeveritar në Brazil raportonte se “kishte shumë harta dhe kompjuterë të rinj, por shumë pak pronarë të rinj të legjitimuar”); dhe, me përjashtim të disa programeve të certifikimit pronësor në zonat rurale të Tajlandës, asnjë prej këtyre përpjekjeve nuk kishte mundur të legalizimin e aseteve informale. Askund nuk kemi gjetur prova të aseteve që ktheheshin në kapital.

Mos vallë qeveria nuk donte t’ia dinte? Sigurisht që jo. Për shembull, në Peru, qeveritë janë përpjekur të formalizojnë pronën të paktën 22 herë në 400 vjet që nga koha e sundimit spanjoll. Treguesi i suksesit: zero. U vumë në kontakt me autoritetet e titullarizimit të vendeve në zhvillim dhe morëm përgjigje të ngjashme: Programet e gjera kishin dështuar apo kishin pasur ndikim fare të vogël. Për më tepër, askush nga individët me të cilët kemi folur nuk mund të pretendonte se një numër i caktuar titujsh të lëshuar kishin karakter likuid dhe ishin fiksuar në mënyrë të tillë që të bënin pjesë në një rrjet të integruar ku mund të ngjante formimi i kapitalit.

Dëshmitë janë tronditëse: Me gjithë përpjekjet e vendeve në zhvillim e të atyre ish-komuniste, me gjithë qëllimet fisnike, ekzistojnë dëshmi të shumta në lidhje me hendekun mes asaj që urdhëron ligji mandativ dhe asaj që duhet bërë për të vënë në punë ligjin. Ligji mandativ nuk është i mjaftueshëm. Sikurse ka theksuar Andrzej Rapaczynski:

Nocioni sipas të cilit institucionalizimi i një regjimi të përshtatshëm ligjor mjafton në vendosjen e një tërësie të drejtash pronësore që mund të sendërzojnë një sistem modern ekonomik është i papranueshëm, sepse pjesa më e madhe e të drejtave të pronësisë mund të zbatohet vetëm përmes një sistemi ligjor. Bërthama e institucionit të pronësisë është një tërësi praktikash sociale dhe ekonomike të pakundërshtueshme dhe gjerësisht të pandërgjegjshme të cilat duhet të jenë të rrënjosura në zhvillime joligjore. Ky përbën një problem të vjetër Hobesian: kur pjesa më e madhe e njerëzve i bindet ligjit, qeveria e imponon atë me efektivitet dhe [relativisht] me kosto të ulët të ata pak që e thyjnë. Por, kur bindja shkërmoqet në shkallë të gjerë, asnjë autoritet nuk është aq i fuqishëm sa t'ua rrijë mbi kokë si polic. Në një mjedis të tillë, teksa imponimi bëhet gjithnjë e më efektiv, individët kanë një stimul për të ndjekur interesat e tyre, duke shpërfillur çdo kufizim në letër.⁵

Gjatë historisë aktuale, vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste nuk u ka munguar vullneti politik, buxhetet, manifestimet ndërkombëtare apo ligjet mandative të mbështetura mbi qëllimin e drejtpërdrejtë të akordimit të të drejtave mbi asetet e shumicës së qytetarëve. Problemi qëndron se kur qeveritë vendosin të garantojnë të drejtat pronësore të njerëzve të varfër, ato sillen sikur po udhëtojnë në një vend ku ka boshllëk pronësor, si rasti i uljes mbi hënë. Ato mendojnë se do të jetë e mjaftueshme mbushja e boshllëkut me ligj mandativ. Megjithatë, në shumë raste nuk ka boshllëk. Njerëzit disponojnë një sasi të madhe pronësie përmes marrëveshjeve informale. Megjithëse asetet e të varfërve mund të gjenden jashtë ligjit zyrtar, të drejtat mbi këto asete qeverisen nga kontrata sociale me natyrë tipike. Dhe, nëse ligji nuk përshtatet

me këto konventa informale, palët e përfshira në këto konventa do të bëhen të ndjeshme dhe do të përjashtojnë të paftuarit.

Rrënjësja e Ligjit në Kontratat Sociale

Kontratrat sociale informale të pronës përforcojnë të gjithë sistemet e pronësisë dhe janë pjesë e realitetit të çdo vendi, edhe në Shtetet e Bashkuara sot.⁶ Sikurse na kujton Richard Posner, prona hartohet në formë shoqërore.⁷ Kjo nënkupton se marrëveshjet pronësore funksionojnë më mirë kur njerëzit lidhin një konsensus në lidhje me pronësinë e aseteve dhe rregullat që qeverisin përdorimin dhe shkëmbimin. Jashtë Perëndimit, kontratat sociale informale dalin fitimtare për një arsye të mirë: Ato kanë arritur të përshtaten më mirë se ligji formal me konsensusin aktual mes njerëzve në lidhje me qeverisjen e aseteve. Çdo përpjekje për të krijuar një sistem pronësor të unifikuar që nuk merr parasysh kontratat kolektive që rregullojnë marrëveshjet ekzistuese pronësore, duhet të ketë rrënjë në të drejtat mbi të cilat shumë njerëz mbështeten për të zotëruar asetet. Përpjekjet për të reformuar të drejtat e pronësisë dështojnë sepse zyrtarët e ngarkuar me hartimin e normave të reja ligjore nuk arrijnë të kuptojnë se shumica e qytetarëve kanë vendosur rregullat e tyre përmes kontratës sociale.

Koncepti sipas të cilit kontratat sociale përfundojnë me ligje të suksesshme shkon deri në kohën e Platonit, i cili mësonte se legjitimiteti duhej gjetur në ndonjë formë kontrate sociale. Edhe Immanuel Kant, në deklaratimet kundër Locke, shkruante se një kontratë sociale duhet t'i paraprijë pronësisë reale; të gjitha të drejtat e pronësisë lindin nga njohja sociale e legjitimitetit të pretendimit. Për të qenë legjitime, një e drejtë nuk duhet të përkufizohet domosdoshmërisht përmes ligjit formal; fakti që një grup njerëzish mbështet fuqishëm një bindje të caktuar

mjafton që kjo e fundit të mbahet si e drejtë dhe të mbrohet nga ligji formal.

Për këtë arsye, ligji the titujt e pronësisë, të imponuar pa marrë parasysh kontratat sociale ekzistuese, dështojnë vazhdimisht: Ata kanë mungesë legjitimiteti. Për të siguruar legjitimitet, duhet të lidhen me kontratat sociale informale, të cilat përcaktojnë të drejtat pronësore ekzistuese. Sigurisht, problemi qëndron në faktin se këto kontrata sociale janë përhapur në qindra juridiksione informale, përmes fshatrave dhe lagjeve të shumta qytetase. E vetmja mënyrë sistematike për të integruar këto kontrata sociale brenda një sistemi formal të pronësisë, është krijimi i një strukture ligjore dhe politike, ose ndryshe i një ure, e cila të jetë kaq e rrënjosur në marrëveshjet informale të njerëzve, saqë ata të dëshirojnë të kalojnë tek kjo kontratë e re dhe gjithëpërfshirëse formale sociale. Por, kjo urë duhet të jetë aq e qëndrueshme sa të mos thyhet e t'i kthejë të gjithë këmbadoras tek marrëveshjet informale. Ura duhet të jetë aq e gjerë sa askush të mos humbasë ekuilibrin e të bjerë. Pikërisht këtë ka bërë Perëndimi për njëqind vjet. Harold Berman na kujton:

Sistemimi i ligjit brenda bashkësive të shumta... që i mundur vetëm për shkakun se, fillimisht, ishte zhvilluar një strukturë informale e marrëdhënieve ligjore të këtyre bashkësive... Tradita ligjore e Perëndimit ka lindur – gjatë së kaluarës – prej një strukture ndërvepruese sociale dhe ekonomike e cila i ka fillësat tek brendësia e grupeve të terrenit. Tiparet sjellore të ndërvarësisë kanë arritur përmasa normative: përdorimet u shndërruan në zakone... dhe zakoni në ligj.⁸

Ndërtimi i një ure ligjore dhe politike prej kontratave sociale të “terrenit” deri në ligjin kombëtar, është pikërisht veprimi i kryer nga Eugen Huber në Zvicër në fillim të shekullit të 20-të. Huber rregulloi doktrinat romake të ligjit statutor ziceran për t’iu përshtatur zakonet, rregullat dhe sjelljet e ndryshme të qyteteve, qytezave dhe fermave të vendit. Ai bashkoi të gjitha konventat në lidhje me pronën brenda një ligji të koduar i cili siguronte të drejtat dhe detyrimet e njerëzve sipas normave lokale me të cilat ata ishin të njohur. Huber pëlqente të përmendte një thënie të vjetër gjermane: “*Das Gesetz muss aus dem Gedanken des Volkes gesprochensein*”, e cila përkthehet: “Ligji duhet të dalë nga goja e njerëzve”. Sikurse vumë re në kreun 5, ligji amerikan shfaqti të njëjtin respekt në adresë të kontratave ekzistuese sociale. Fuqia nuk qëndronte te doktrina apo koherenca profesionale, por te dobishmëria në duart e autoriteteve të cilat kërkonin të shndërronin asetet e pazhvilluara në asete produktive.

Kalimi prej marrëdhënieve informale te prona formale e unifikuar në vendet e zhvilluara nuk është ndërtuar në ajër. Sistemimi i ligjeve që rregullojnë sistemet moderne të të drejtave të pronësisë u mundësua vetëm për faktin se autoritetet lejuan që, shpeshherë, marrëdhëniet informale paraekzistuese të grupeve të terrenit të zëvendësonin ligjin: “Ligji evoluon nga strukturat dhe zakonet e gjithë shoqërisë”, ka shkruar Berman, “dhe lëviz poshtë në drejtim të politikave dhe vlerave të rregullave të shoqërisë. Ligji ndihmon në integrimin e këtyre dy palëve”.⁹

Duke rrënjosur ligjin formal të pronësisë tek kontratat sociale pas të cilave janë angazhuar njerëzit, qeveritë e Perëndimit arritën miratimin e gjerë popullor të nevojshëm për të kapërcyer qëndresën. Si rezultat, u krijua një sistem ligjor për pronësinë. Kur kjo u arrit, ato qenë në gjendje të nisnin integrimin e konventave të përhapura brenda një kontrate

sociale kombëtare. Dhe, atje ku dikur vetëm pronari i shtëpisë dhe fqinjët e tij mund të përcaktonin nëse shtëpia i përkiste pronarit, me mbërritjen e pronësisë formale, i gjithë kombi e dinte se kush ishte pronari. Titujt e pronësisë formale lejuan njerëzit të zhvendosin frytet e punës së tyre nga një hapësirë e ngushtë vlerësimi tek tregu i gjerë. Kombet Perëndimore kishin ndërtuar kështu një stacion energjetik për t'i dhënë fuqi një sistemi modern të tregut dhe kapitalit.

Tani që pronësia njihej jo vetëm përmes marrëveshjeve lokale, por edhe nga një rend më i gjerë marrëdhëniesh ekonomike dhe sociale, ligji dhe biznesi u bënë më të thjeshtë. Njerëzit nuk kishin më nevojë të mbështeteshin mbi politika të mundimshme provinciale për të mbrojtur të drejtat e aseteve. Pronësia formale i çliroi ata prej marrëveshjeve lokale që kërkonin shumë kohë, të cilat ishin pjesë e shoqërive të mbyllura. Tashmë ata mund të kontrollonin asetet e tyre. Po ashtu, duke pasur dokumente të përshtatshëm përfaqësimi, ata mund të përqendroheshin mbi potencialin e aseteve ekonomike. Dhe, për faktin se pasuria e patundshme dhe bizneset mund të njiheshin lehtësisht dhe të identifikoheshin në nivel kombëtar, pronarët humbën anonimitetin duke u bërë kontabël. Gradualisht, këto mekanizma të pronësisë ligjore hodhën themelet për tregjet e gjerë dhe krijimin e kapitalit që përfshinin një numër të madh lojtarësh.

Qëndrueshmëria e Kontratave Sociale Parakapitaliste

A kanë kontratat sociale informale, të cilat mbizotërojnë në vendet në zhvillim sot, një themel të fortë për të krijuar një ligj zyrtar? Padyshim që po. Ekzistojnë shumë prova të cilat vërtetojnë se zyrtarët qeveritarë, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, pajtohen me kontratat sociale informale kur

veprojnë në sektorin e dekapitalizuar. Raportet e organizatave ndërkombëtare të donatorëve i referohen vazhdimisht, edhe pse në formë të tërthortë, konventave informale. Si do të mundnin qeveritë të zhvillonin projekte rigjenerimi bujqësor dhe urban në zonat më të varfra të vendeve të tyre nëse nuk do të pajtoheshin me organizatat e përfituesve informale? Fakti që qeveritë dhe institucionet financiare ndërkombëtare ndikojnë që vendbanimet e zaptuesve të përfshihen brenda sektorit të shërbimeve publike (rrugë, elektricitet, ujë dhe shkolla), në kundërshti me ligjin e pronës, përbën një njohje të drejtëpërdrejtë të marrëveshjeve informale të pronësisë. Sikurse kanë vënë re Robert Cooter dhe Thomas Ulen, “kushtet e [të drejtave të pronësisë] janë më efektive kur njerëzit binden me vullnet të lirë në lidhje me to, sesa kur ligjvënësi ua imponon”.¹⁰

Kontratat sociale informale mbështeten mbi një tërësi zakonesh, mbi improvizimin e rastësishëm dhe mbi rregullat e huazuara në mënyrë të përzgjedhur prej sistemit zyrtar ligjor. Në mungesë të mbrojtjes ligjore nga shteti, është ligji informal ai i cili, në shumë vende në zhvillim, rregullon asetet e shumicës së qytetarëve. Kjo mund të tingëllojë paradoksale apo shkatërruese për lexuesit Perëndimorë që mendojnë se ka vetëm një ligj të cilit duhet t’i binden të gjithë. Por, eksperiencia e fituar nga vizitat dhe puna e kryer në shumë vende në zhvillim më ka qartësuar se ligjet formale dhe informale bashkëjetojnë kudo. Sikurse përmbledh Margaret Gruter:

Ligji është... jo thjesht një tërësi rregullash të folura, të shkruara apo të formalizuara të cilave u binden qorrazi të gjithë njerëzit. Më tepër, ligji përfaqëson formalizimin e rregullave të sjelljes mbi të cilat bien dakord një përqindje e lartë njerëzish dhe të cilat reflektojnë prirje sjellore dhe ofrojnë përfitime potenciale për të gjithë ata që i zbatojnë.

(Kur njerëzit nuk njohin ose nuk besojnë në këto përfitime potenciale, ligjet shpërfillen ose shkelen).¹¹

Një tjetër studiuës ligjor ka vënë re se “mbështetja moderne e Perëndimit mbi qeverinë për hartimin e ligjit dhe vendosjen e rendit nuk përbën një normë historike”.¹² Ligje të ndryshme brenda një kombi nuk janë një fenomen i ri. Pluralizmi ligjor ka sunduar mbi Evropën kontinentale deri në çastin e rizbulimit të ligjit Romak në shekujt e 13-të dhe 14-të kur të gjitha rrymat ligjore u përfshinë gradualisht brenda një sistemi të koordinuar.

Pra, nuk duhet të habitemi kur zbulojmë se aktiviteti informal në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste rrallëherë përbën rrezik. Gjatë lëshimit të titujve formalë për qindra mijëra shtëpi dhe pronarë biznesesh në Peru, organizata që drejtoj kurrë nuk ka hasur në një grup informal i cili të mos respektonte rregulla konsensuale të përcaktuara qartë. Sa herë që kemi vizituar një zonë të dekapitalizuar në Azi, Amerikë apo Lindje të Mesme, kurrë nuk kemi shkelur në tokë të egër. Duke vëzhguar me kujdes, kemi qenë gjithmonë në gjendje të identifikojmë tipare të rregullave. Në rastet më të këqija kemi gjetur kopshte të mbajtur keq – por jo xhungla.

Sikurse paraardhësit Perëndimorë, sektorët e dekapitalizuar të vendeve të Botës së Tretë dhe atyre ish-komuniste kanë prodhuar në mënyrë spontane tërësi rregullash pronësore. Për të mbrojtur të drejtat themeltare të pronës prej të tjerëve, ata kanë qenë të detyruar të përpilojnë institucione informale për veten e tyre. Kujtoni, nuk është mendja ajo që ju jep të drejta të caktuara ekskluzive mbi një aset specifik, por mendje të tjera të cilat, në lidhje me të drejtat, mendojnë njëlloj si ju. Këto mendje kanë nevojë që të mbrojnë dhe kontrollojnë asetet e tyre përmes njëra-tjetrës. Për më tepër, njerëzit kanë nevojë të hartojnë kontrata sociale edhe më të forta se ligji formal për të

sprapsur të huajt, sidomos qeverinë. Kushdo që ka dyshime në lidhje me fuqinë e kontratave sociale, duhet vetëm të sfidojë ndonjë prej këtyre të drejtave informale. Qëndresa do të jetë e zjarrtë.

Marrëveshjet informale janë bërë shumë të përhapura gjatë 40 viteve të shkuar. Raportet në lidhje me “sektorin informal gëlues” janë bërë po aq të zakonshme sa rezultatet e futbollit nëpër gazetat e çdo qyteti të Botës së Tretë. Arsyeja është se ligji formal nuk ka qenë në gjendje të kënaqë marrëveshjet informale që evoluojnë shpejt. Për shembull, në sektorin e pasurive të patundshme, kontratat sociale informale lindin jo vetëm nga zaptimi i jashtëligjshëm i tokës prej emigrantëve, por edhe nga programet deficitare reformatore të strehimit, urbanizimit apo bujqësisë, shkërmoqja graduale e programeve të kontrollit të qirave dhe blerja apo dhënia me qira në formë të paligjshme e tokës për qëllime strehimi ose industrie. Shumica e kontratave sociale thjeshtohen prej agentëve aktivë: “ndërmjetës të pasurive të patundshme” të motivuar nga pikëpamja tregtare, politike apo fetare, të cilët ose kanë diçka për të fituar ose diçka për të mbrojtur prej këtyre transaksioneve. Emëruesi i përbashkët i klientëve është se nuk janë në gjendje të paguajnë kostot e sigurimit të ligjshëm të pronësisë. Në disa vende që kam vizituar, filialet e forcave të armatosura kanë caktuar oficerë ushtarakë për të siguruar pasuri të patundshme në mënyrë informale për t’u përdorur si qendra strehimi për nënoficerët. Po ashtu, për habinë time, kam parë autoritete bashkiake që merreshin me titullarizimin dhe operacionet e regjistrimit të pasurive të patundshme, duke organizuar zaptim informal për t’u ofruar anëtarëve të unionit të tyre shtëpi të përshtatshme për të banuar. Një vendbanim i madh zaptuesish që kam vizituar kohët e fundit, ishte themeluar nga këshilli bashkiak për të siguruar shtëpi për 7,000 familje të të punësuarve qeveritarë. Në një vend tjetër, një

gazetë lokale, e habitur nga provat tona në lidhje me zotërimet e gjera informale të pasurive të patundshme, kreu kontrollë për të zbuluar nëse ndonjë rezidencë e kreut të shtetit ishte e pajisur me dokumente të regjistruar titullorë. Gazeta satirizoi faktin se ligjet e kombit po nxirreshin nga një infrastrukturë informale.

Në çastin që të drejtat tokësore krijohen në mënyrë informale, ata që përfshihen në këtë krijojnë një institucion për të administruar kontratën sociale të hartuar: Bizneset informale dhe organizatat e strehimit takohen rregullisht, marrin vendime, sigurojnë dhe mbikëqyrin investime infrastrukturore, ndjekin procedura administrative dhe lëshojnë kredenciale. Këto zotërojnë zyra të përgjithshme ku gjenden hartat dhe regjistrat udhëzues. Tipari më kureshtar i këtyre institucioneve të botës është dëshira për t'u integruar brenda sektorit formal. Në zonat urbane, ndërtesat dhe bizneset informale evoluojnë me kalimin e kohës deri sa arrin një çast kur nuk dallohen prej pronësisë që është tërësisht ligjore. Në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste që kam vizituar, një kufi i gjatë ndan formalen nga informalja. Përgjatë tij, ekzistojnë pika kalimi ku organizatat informale takohen me zyrtarët qeveritarë, pika në të cilat organizatat informale luftojnë për të arritur pranim zyrtar, ndërsa zyrtarët qeveritarë përpiqen të arrijnë njëfarë rendi.¹³ Zakonisht, organizatat informale gjejnë një mënyrë për të bashkëjetuar me njëfarë formacioni qeveritar, përgjithësisht në nivel bashkiak ose vendor. Shumica e grupeve përpiqen të ndërmjetësojnë për një qoshe ligjore ku të mbrojnë të drejtat e tyre, ndërkohë që grupe të tjera kanë arritur njëfarë marrëveshjeje për të stabilizuar situatën jashtë rrjedhës ligjore. Një tjetër fakt dëshmon se informalët dëshirojnë të hyjnë e të ngrohen: Udhëheqësit promovues dhe diplomatikë që zgjidhen për të ndërmjetësuar në emër të këtyre grupeve informale, nuk janë mafiozë rrugësh.

Dëgjimi i Qenve që Lehin

Shumica e qeverive të vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste janë të gatshme të njohin se arsyeja për të cilën sektori informal bëhet gjithnjë e më i gjerë nuk lidhet me faktin se njerëzit kanë braktisur papritur respektin për ligjin, por sepse ata nuk kanë alternativë tjetër për të mbrojtur pronën dhe jetesën. Kur qeveria të pranojë këtë fakt të jetës moderne, atyre do t'u duhet të arrijnë një marrëveshje. Megjithëse informalët janë të gatshëm të kalojnë urën drejt njohjes ligjore, ata do ta bëjnë këtë nëse qeveria u siguron një udhëtim të lehtë, të sigurt dhe të lirë. Pronarët e aseteve të sektorit informal janë organizuar mirë tashmë; po ashtu ata janë “të pajtueshëm me ligjin”, megjithëse ligjet që zbatohen nuk janë ata të qeverisë. Është në dorë të qeverisë të zbulojë çfarë nënkuptojnë këto marrëveshje informale dhe të gjejë një mënyrë për t'i integruar ato brenda sistemit formal të pronësisë. Por këtë nuk do ta arrijë duke pajtuar avokatët e zyrave të Delhit, Xhakartës apo Moskës për hartimin e ligjeve të reja. Atyre do t'u duhet të shëtitin rrugët dhe rrugicat duke dëgjuar qentë që lehin.

Ligji që sundon sot në Perëndim nuk ka lindur prej librave me pluhur apo statuteve zyrtare qeveritare. Ligji përbën një un të gjallë, lindur në botën reale dhe rritur nga njerëz të zakonshëm shumë kohë para se të binte në duart e avokatëve profesionistë. Ligji duhet të zbulohet para se të sistemohet. Sikurse studiuesi ligjor Bruno Leoni na kujton:

Romakët dhe Anglezët kishin idenë e përbashkët se ligji është diçka që duhet zbuluar e jo lëshuar dhe askush nuk është kaq i fuqishëm sa të identifikojë vullnetin personal me ligjin e tokës. Detyra e “zbulimit” të ligjit u ishte besuar në të dy vendet respektivisht këshilltarëve juridikë

dhe gjykatësve – dy kategori individësh të krahasueshëm në njëfarë mase me ekspertët shkencorë të sotëm.¹⁴

“Zbulimi i ligjit” ka qenë pikërisht ajo që kam kryer me kolegët e mi në shumë vende për 15 vjet, si një hap i parë drejt asistimit të qeverive të vendeve në zhvillim për krijimin e sistemeve formale të pronësisë të cilat rrokin gjithë popullin. Nëse heqim dorë nga paragjykimet hollivudiane në lidhje me banorët e Botës së Tretë dhe ata të vendeve ish-komuniste, të cilët konsiderohen si shitës rrugësh, guerilas me mustaqe apo banditë sllavë, do të zbulojmë se ka shumë pak dallime mes kulturës së Perëndimit dhe kulturave të tjera, kur vjen puna për mbrojtjen e aseteve dhe zhvillimin e biznesit. Pas vitesh studime në shumë vende, jam bindur se shumica e kontratave sociale informale në lidhje me pronësinë janë thelbësisht të ngjashme me kontratat sociale kombëtare të kombeve Perëndimore. Të dyja këto kontrata kanë prirje të përfshijnë disa rregulla të drejtpërdrejta ose të heshtura në lidhje me faktin se cili ka të drejtë dhe në lidhje me kufizimet e të drejtave dhe të mundësisë për të kryer transaksione; po ashtu përfshijnë kufizime në lidhje me regjistrimin e pronësisë së aseteve, procedurat për zbatimin e të drejtave dhe pretendimeve pronësore, simbolet për përcaktimin e vendndodhjes së kufijve, norma për rregullimin e transaksioneve, kritere për përcaktimin e çështjeve që kanë nevojë për autorizim dhe atyre që nuk kanë nevojë për autorizim, udhëzues për përcaktimin e dokumenteve përfaqësues të rregullt, mekanizma për të nxitur njerëzit që të zbatojnë kontratat dhe të respektojnë ligjin dhe kritere për të përcaktuar shkallën e anonimitetit të autorizuar për çdo transaksion.

Kështu pra, është e drejtë të mendohet se njerëzit janë të përgatitur për të menduar në lidhje me të drejtat e pronësisë në mënyrë të ngjashme. Kjo nuk është e papritur; bindjet

popullore janë përhapur gjithmonë në formë spontane përmes analogjive nga një vend në një tjetër. Për më tepër, migrimet masive të 40 viteve të fundit, për të mos përmendur revolucionin ndërkombëtar në komunikacione, nënkuptojnë se po ndajmë gjithnjë e më tepër vlera dhe ambicie. (Banorët e Botës së Tretë shohin televizion; edhe ata shkojnë në kinema, përdorin telefonin dhe kërkojnë që fëmijët e tyre të marrin një arsim të mirë dhe të sigurojnë njohuri për kompjuterin). Është e pashmangshme që kontratat sociale informale individuale, në të njëjtin vend, të jenë më tepër të ngjashme sesa të ndryshme.¹⁵

Problemi me kontratat sociale informale lidhet me faktin se dokumentet përfaqësues të pronës nuk janë të kodifikuara dhe likuide aq sa duhet për të mundësuar një variacion të gjerë përdorimesh jashtë parametrave të tyre gjeografikë. Sistemet pronësore informale janë të qëndrueshme dhe kuptimplota për ata që janë pjesë e grupit, por veprojnë në një nivel sistematik më të ulët dhe nuk kanë përfaqësitë e nevojshme për t'i lejuar të ndërveprojnë lehtësisht mes njëri-tjetrit. Edhe njëherë, kemi një ngjashmëri me të kaluarën e Perëndimit, ku titujt zyrtarë nuk ekzistonin. Për shembull, në Evropë, para shekullit të 15-të, megjithëse ekzistonin disa regjistra të veçuar në disa pjesë të Gjermanisë së sotme, shumica e rregullave zyrtare në lidhje me funksionimin e transaksioneve të pronësisë ishin të pashkruar dhe të njohur vetëm përmes traditave gojore.

Shumë individë i shohin këto rituale dhe simbole si paraardhës përfaqësues të titujve zyrtarë, të aksioneve dhe regjistrave të sotëm. Sipas filozofit dhe historianit britanik të shekullit të 18-të, David Hume, në disa pjesë të Evropës gjatë kësaj kohe, pronarët e tokave shkëmbenin dhë e gurë mes tyre për të festuar shkëmbimin e tokës; fermerët formalizonin shitjen e grurit duke dorëzuar çelësat e hambarit ku ruhej. Pergamenat e shkruara që dëshmonin transaksionet pronësore të tokës,

fiksoheshin ritualisht mbi tokë për të vërtetuar marrëveshjen. Në mënyrë të ngjashme, shumë shekuj më parë, gjatë Romës perandorake, ligji Romak siguronte se bari dhe degët duhet të kaloheshin dorë më dorë për të vërtetuar transfertën ligjore të të drejtave të pronës. Edhe japonezët kishin modelet e tyre për të vërtetuar transaksionet; për shembull, në rajonin e Guma Kodzukes, gjatë periudhës Tokugava, e cila zgjati prej shekullit të 17-të deri në shekullin e 19-të, ku ligji i tokës bujqësore ndalohej me ligj, pronarët e tokave transferonin asetet, duke vërtetuar këto marrëveshje informale përmes dokumenteve të shkruar e të vulosur nga të afërmit e shitësit dhe drejtuesi i fshatit.

Gradualisht, dokumentet e shkruar grumbulloheshin nëpër regjistrat lokalë. U desh shumë kohë para se këto akte përfaqësimi të merrnin formë nëpër libra. Por vetëm gjatë shekullit të 19-të, këta regjistra pronësorë dhe këto kontrata të ndryshme sociale që i rregullonin, u standardizuan dhe u bashkuan për të krijuar sistemet e integruara formale të pronësisë, të cilat karakterizojnë sot Perëndimin.

Vendet ish-komuniste dhe ato të Botës së Tretë gjenden pikërisht në kushtet që karakterizojnë Evropën, Japoninë dhe Shtetet e Bashkuara disa qindra vjet më parë. Sikurse Perëndimi, ato duhet të identifikojnë dhe të grumbullojnë dokumentet pronësore ekzistuese të përfaqësimit të shpërndara anembanë vendeve të tyre dhe t'i afrojnë ato në një sistem të vetëm të integruar, për t'u dhënë kështu asetëve të të gjithë qytetarëve likuiditetin, mekanizmat burokratikë dhe rrjetin e nevojshëm për të prodhuar kapital.

Deshifrimi i Ligjit Informal

Kur, së bashku me kolegët e mi, u ballafaqova për herë të parë me detyrën e integritetit të marrëveshjeve pronësore

parakapitaliste në një sistem formal kapitalistik pronësor, model kemi pasur Perëndimin. Por, kur nisëm të kërkonim informacione në lidhje me mënyrën se si kombet e përparuara kishin integruar marrëveshjet e tyre informale brenda ligjit, nuk kishte skema të gatshme ku të mbështeteshim. Mënyra e përdorur nga Perëndimi për të identifikuar cilat kategori të provave informale të pronësisë do të përbënin emëruesit e përbashkët të një sistemi të standardizuar formal të pronësisë është dokumentuar shumë varfër. John Payne shpjegon gjendjen në Angli:

Prova formale e një titulli pronësie si pjesë e transaksioneve tregtare të tokës është një zhvillim i fundit në ligjin anglez, por informacioni i disponueshëm është kaq i paktë, sa që një hipotezë e tillë mbetet në ajër. Për historianët përbën një burim pezmatimi fakti që, ndërkohë që ngjarjet e mëdha dokumentohen në detaje, njerëzit rrallë e ndiejnë të nevojshme të regjistrojnë aktivitetet shtëpiake të përditshme në të cilat angazhohen. Të bësh këtë mund të duket e rëndomtë dhe banale, pasi askush nuk kërkon të kujtohet për atë që është e qartë. Si rrjedhojë, ajo që mbetet e mirëqenë për të gjallët në një epokë, është e panjohur në tjetrën dhe rindërtimi i procedurave të rregullta kërkon bashkimin e durueshëm të burimeve të konceptuara për një qëllim tjetër. Kjo vlen për praktikën e tjetërsimit, pasi, deri në shekullin e 19-të kemi vetëm njohuri të kufizuara mbi zhvillimin aktual të punës nga ana e tyre.¹⁶

Të drejtuar nga regjistrimet e pakta historike që mundëm të gjenim dhe duke mbushur hapësirat boshe përmes kërkimeve tona empirike, çamë rrugën përmes botëve informale dhe mësuam se si të arrijmë te kontratat sociale që shtresojnë të

drejtat pronësore në këto vende. Zbulimi i këtyre marrëveshjeve nuk është njëllor si kërkimi i provave të pronësisë në një sistem formal ligjor, ku mund të mbështetesh mbi një sistem regjistrimi, i cili me kalimin e viteve ka krijuar një gjurmë të dokumentuar, “një zinxhir titujsh”, i cili lejon zbulimin e fillesave. Në sektorin e dekapitalizuar, zinxhiri i titujve është tepër i mjegullt për t’u marrë parasysh. Ndër të tjera, sektori i dekapitalizuar nuk disponon burokracinë e centralizuar të regjistrimit dhe gjurmimit, e cila qëndron në qendër të një shoqërie formale. Çfarë kanë njerëzit e sektorit të dekapitalizuar është mirëkuptimi i fortë, i qartë dhe i detajuar mes njëri-tjetrit për përcaktimin e pronarit sot.

Si rrjedhojë, e vetmja mënyrë për të gjetur kontratën sociale informale të pronës në një zonë të caktuar është vënia e lidhjeve me ata që punojnë dhe jetojnë përmes saj. Nëse prona ka formën e pemës, sistemi formal i pronësisë është diakronik, në kuptimin që lejon gjurmimin në kohë të fillesave të çdo gjetheje, që prej sythit e degës deri te trungu e, më në fund, rrënjët. Afrimi i pronësisë informale duhet të jetë i sinkronizuar: E vetmja mënyrë që një i jashtëm të përcaktojë përkatësinë e të drejtave është prerja e pemës në trung për të përcaktuar gjendjen e çdo dege e gjetheje në përputhje me ato fqinje.


Sigurimi i informacionit të sinkronizuar kërkon punë në terren: të shkosh drejtpërdrejt në ato zona ku prona nuk është e regjistruar zyrtarisht (ose jo siç duhet) dhe të vendosësh lidhje me autoritetet lokale ligjore dhe informale për të zbuluar se cilat janë marrëveshjet pronësore. Nuk është aq e rëndë sa duket. Megjithëse traditat gojore mund të mbizotërojnë në pyjet rurale të disa vendeve, shumica e njerëzve të sektorit të dekapitalizuar urban kanë gjetur mënyra për të përfaqësuar pronën e tyre në formë të shkruar sipas rregullave që ata respektojnë dhe të cilët qeveria detyrohet t’i pranojë në një masë të caktuar.

Për shembull, në Haiti askush nuk besonte se do të gjenim dokumente që fiksonin përfaqësitë mbi të drejtat pronësore. Haiti është një nga vendet më të varfër të botës; 55 për qind e popullsisë është analfabete. Megjithatë, pas një ankete intensive në zonat urbane të Haitit, nuk kemi gjetur asnjë ngastër toke, asnjë kasolle dhe asnjë ndërtesë informale, pronari i së cilës të mos kishte të paktën një dokument për të mbrojtur të drejtën e tij – madje edhe “të drejtën e zaptimit”. (shihni Figurën 6.2 e cila paraqet një përzgjedhje të titujve informalë të Haitit). Kudo në botë, shumica e informalëve zotërojnë gjithsesi ndonjë lloj dokumenti të sajuar për të përfaqësuar dhe mishëruar e pretendimin e tyre mbi pronën. Dhe, mbi bazë të këtyre përfaqësimeve informale, si edhe mbi bazë të regjistrimeve dhe intervistave, jemi në gjendje të nxjerrim në pah kontratat sociale që realizojnë pronësinë.

Megjithëse burimet informale të informacionit për identifikimin e bindjeve të pronësisë janë të rëndësishme, ekzistojnë edhe burime zyrtare dhe ligjore. Politikanët e instancave të larta rrallëherë janë të ndërgjegjshëm për shkallën e kontakteve që kanë individët e niveleve më të ulëta administrative të qeverisë me sektorin informal. Autoritetet bashkiake, planifikuesit urbanë, nëpunësit e higjienës publike, policia dhe shumë të tjerë duhet të sigurojnë një vlerësim zyrtar për shkallën e informalitetit të vendbanimeve të paligjshme dhe grupeve të bizneseve të reja, të cilat po mbijnë si kërpudha anembanë distrikteve të tyre. Ne kemi kuptuar se si të lexojmë dokumentacionin zyrtar për të identifikuar zonat ku mbizotërojnë kontratat sociale informale.

Në çastin kur qeveritë të dinë se si të kërkojnë përfaqësitë informale dhe t’i prekin ato, do të ketë gjetur fillin e Arianës drejt kontratës sociale. Dokumentet e përfaqësimit burojnë nga një konsensus i respektueshëm i arritur prej një grupi të caktuar

FIGURA 6.2
 Dokumenta pronésie të përdorura për zonat informale në Haiti



njerëzish, konsensus i cili lidhet me atë që është pronësia dhe atë që mund të bëjë pronari me të. Leximi i dokumenteve të përfaqësimit dhe nxjerrja e kuptimit prej tyre nuk kërkon një doktoraturë në arkeologji. Këto dokumente nuk përmbajnë kode të mistershëm për t'u deshifruar. Njerëzit me qëllime afariste përparimtare i kanë shkruar këto dokumente për të qartësuar në mënyrë absolute, për të gjithë personat e interesuar, se ç'lidhje kanë të drejtat që pretendojnë me asetet specifike që kontrollojnë. Ata kanë dëshirë të komunikojnë legjitimitetin e të drejtave të tyre dhe janë të përgatitur për të paraqitur sa më shumë prova mbështetëse që të jetë e mundur. Dokumentet e përfaqësimit nuk fshehin asgjë; janë hartuar për t'u njohur për atë që janë. Kjo nuk është gjithmonë e dukshme sepse, për fat të keq, kur merremi me të varfrit kemi prirje të marrim mungesën e infrastrukturave të centralizuara regjistruese për injorancë. Sikurse përmbyll në mënyrë korrekte John P. Powelson në botimin "Historia e Tokës", edhe në zonat rurale primitive të vendeve në zhvillim, njerëzit kanë qenë avokatët më të mirë të vetvetes dhe gjithmonë kanë pasur aftësitë për të përfaqësuar veten në mënyrë inteligjente.¹⁷

Kur qeveritë sigurojnë prova të dokumentuara të përfaqësive, atëherë mund t'i "shpërbëjnë" për të identifikuar parimet dhe rregullat që përbëjnë kontratën sociale që i mbështet këto dokumente. Pasi zbatuesit e ligjit të kenë arritur këtë, do të kenë në dispozicion gjithë pjesët e rëndësishme të ligjit informal. Detyra e ardhshme është kodifikimi i tyre – organizimi në statute të përkohshëm formalë në mënyrë që të hetohen dhe krahasohen me ligjin formal ekzistues. Po ashtu, edhe kodimi i sistemeve të shpërndara nuk përbën problem. Në fakt, hartimi i teksteve ligjore të njëjta për gjithë vendin (si Kodi Tregtar i Unifikuar i Shteteve të Bashkuara) ose mes vendeve në nivel ndërkombëtar (sikurse janë kodet e shumta të integruara mandative nxjerrë nga Bashkimi Evropian ose

Organizata Botërore e Tregtisë), nuk është shumë ndryshe nga procedurat qeveritare. Duke krahasuar kodet informale dhe ato formale, udhëheqësit qeveritarë kuptojnë se si dy grupet duhet të rregullohen për t'iu përshtatur njëri-tjetrit dhe më pas të hartojnë një strukturë rregullatore për pronësinë – një bllok të përbashkët ligjor për gjithë qytetarët – e cila të mund të quhet inteligjente dhe e vetëzbatueshme për faktin se pasqyron realitetin ligjor dhe atë informal. Pikërisht këtë drejtim duhet të ndjekin vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste për t'iu përballur me sfidën ligjore dhe ky ka qenë drejtimi i krijimit të ligjit në Perëndim: duke hequr dorë gradualisht nga gjithçka që ishte e padobishme dhe e pazbatueshme, si dhe duke përthithur gjithçka që ishte funksionale.

Nëse gjithë kjo tingëllon më tepër si një aventurë antropologjike sesa si një themel për reformë ligjore, kjo ndodh për faktin se njohuria për të varfrin është monopolizuar nga akademikët, gazetarët dhe aktivistët, nxitur nga keqardhja apo kureshtja intelektuale, dhe jo nga detajet e realizimit të reformës ligjore. Ku kanë qenë avokatët? Pse nuk kanë vëzhguar ligjin dhe rregullat e prodhuara nga populli i tyre? E vërteta është se avokatët e këtyre vendeve janë shumë të zënë me studimin dhe zbatimin e ligjit Perëndimor. Ata janë mësuar me idenë se praktikat vendase nuk janë ligjërisht të mirëfillta, por përbëjnë një terren romantik që i duhet lënë folkloristëve. Por, nëse avokatët duan të luajnë rol në hartimin e ligjeve të mira, duhet të dalin prej bibliotekave ligjore dhe të shkojnë në sektorin informal, i cili përbën të vetmin burim të informacionit për të cilin kanë nevojë për të ndërtuar një sistem të mirëfilltë, legjitim, formal e ligjor. Duke hetuar këtë “ligj të popullit” dhe duke kuptuar logjikën e tij, reformatoret mund të kapin thelbin e asaj që u nevojitet për të krijuar një sistem ligjor të vetëzbatueshëm.

Pasi të kenë arritur këtë, qeveritë praktikisht do të kenë prekur kontratën sociale. Ato do të kenë siguruar informacionin e nevojshëm për të integruar të varfrit dhe zotërimet e tyre brenda një strukture ligjore dhe kështu, këta të fundit, do të mund të kenë interesa në sistemin kapitalist. Pra, zbatimi i reformës ligjore nënkupton ngacmim të *status quo*-së. Kjo përbën një detyrë të lartë politike.

PJESA II

Sfida Politike

Askush nuk e kishte planifikuar evoluimin nga sistemet feudale dhe patrimoniale, te sistemet moderne të pronësisë që ekzistojnë në Perëndim sot. Megjithatë, në shtegun e gjatë revolucionar drejt modernizmit, në ato faza të udhëtimit kur reformuesit morën përsipër programe për ta bërë pronësinë më të prekshme për një pjesë më të gjerë të qytetarëve, këto programe qenë të suksesshme sepse mbështeteshin mbi strategji politike të menduara siç duhet. Pikërisht këtë kreu Thomas Jefferson në Virxhinia në fund të shekullit të 18-të, kur rriti nivelin e likuiditetit të pronës duke shfuqizuar, ndër të tjera, praktikën e lënies në trashëgimi me kusht mostjetërsimi (paaftësia për të transferuar pronën jashtë familjes). Kur Stein dhe Hardenberg krijuan kushtet për të drejta pronësie universale në Gjermaninë e fillimit të shekullit të 19-të dhe kur Eugen Huber nisi të integronte gjithë sistemet e shpërndara pronësore të vendit të tij në Zvicrën e fillimit të shekullit të 20-të, ata vunë në punë strategji të planifikuara me kujdes për të rrëzuar barrikatad e *status quo*-së. Ata u armatosën me një legjislacion të qëllimeve të zgjuara, i cili lejoi qeverinë të krijojë revolucione paqësorë të mbështetur nga populli, të cilët nuk mund të ndaleshin.

Pse nevojitet një strategji politike sot? Kush do t'i kundërvihet rrëzimit të një aparateidi ligjor i cili është kaq i padrejtë? Në fakt, shumë pak vetë do të ishin kundër nevojës së reformës. Por, një pakicë e vogël dhe e fuqishme do të kuptojë se reforma hartohet për të ngacmuar qoshet e tyre të vogla dhe këta do të qëndrojnë fuqishëm dhe kërcënueshëm. Po ashtu ka një problem që lidhet me këtë fakt: Shumë prej statuteve që pengojnë sigurimin e kapitalit nga shumica e njerëzve, mund të përmbajnë kufizime që mbrojnë interesat jetësore të grupeve të fuqishme. Hapja e kapitalizmit për të varfrit nuk është e thjeshtë si të pish një gotë ujë. Është e ngjashme me ri-rregullimin e gjithë degëve dhe barërave të folesë së shqiponjës – pa acaruar shqiponjën. Megjithëse ky ri-rregullim nxjerr në pah vetëm pengesa të vogla ndaj kësaj pakice shumë të vogël, kur e krahason me përfitimet në shkallë kombëtare të afrimit të kapitalit pranë të varfërve, ata që preken nuk do të vërejnë këtë gjë nëse reforma nuk drejtohet nga një iniciativë e fuqishme politike e pajisur me mesazhin dhe numrat për të mbështetur veten.

Në mënyrë të qartë, kjo është një detyrë për agjentë politikë me eksperiencë, të pajisur me mjete të sofistikuara për të rregulluar follenë e shqiponjës pa u gërricur prej saj. Ata janë të vetmit në pozitat e përshtatshme për të sinkronizuar ndryshimin për shumicën dhe qëndrueshmërinë për pakicat e ndryshme. Një strategji e kapitalizimit të të varfërve duhet të integrojë dy sisteme pronësore, në dukje kontradiktorë, brenda të njëjtit organ ligjor. Nëse synohet suksesi, një president ose kryeministër i cili është diçka më tepër se teknokrat, duhet të ndër marrë sulmin dhe të formojë një kolonë për politikën qeveritare. Reforma mund të sigurojë mbështetje të fortë vetëm nga ana e nivelit më të lartë politik, dhe kështu mund të ndalojë inercinë e vullnetshme të *status quo*-së. Vetëm maja e qeverisë mund të ndalojë paralizimin e progresit të reformës

nga ana e burokracive kontradiktore dhe konflikteve politike. Kur një komb vendos të kryejë një ndryshim të madh, qoftë ky stabilizim i monedhës, privatizim i agjencive qeveritare apo hapje e shkollës për të gjitha racat, kryetari i shtetit bën një hap para dhe drejton sulmin. Emancipimi i të varfërve bie pas përgjegjësive të kryetarit të kombit.

Historia dhe eksperiencia personale na mësojnë se, për të drejtuar një revolucion pronësor, një udhëheqës duhet të kryejë të paktën tri detyra specifike: të shohë perspektivën e të varfërve, të pajtojë elitën dhe të ballafaqohet me burokracitë ligjore dhe teknike që mbyllin kambanën e qelqtë.

Kuptimi i perspektivës së të varfërve

Të gjithë përfitojnë nga globalizimi i kapitalizmit brenda një vendi, por përfituesi më i dukshëm dhe më i madh do të jetë i varfëri. Me të varfrin nga ana e tij, lideri me qëllim reformën do të ketë fituar gjysmën e betejës. Çdo përpjekje për të marrë shtetin ose njerëzit do të shtypet. Por, për të fituar, ai ose ajo duhet të zotërojë faktet e nevojshme. Kjo nënkupton zhvillimin e kërkimeve origjinale: Reformatorët duhet të vihen në vendin e të varfërve dhe të shëtisin nëpër rrugë. Statistikat zyrtare nuk përmbajnë informacionin e nevojshëm. Faktet dhe të dhënat mund të shihen vetëm nga jashtë kambanës së qelqtë.

Kur nisa të studioja në lidhje me mundësinë e disponimit të pronësisë formale nga ana e të varfërve të Perusë në vitet '80, çdo firmë jurisprudence me të cilën u këshillova më siguroi se ngritja e një biznesi formal me mundësi kapitali kërkonte vetëm pak ditë. E dija se kjo ishte e vërtetë për mua dhe avokatët, por hamendësova se nuk ishte e vërtetë për shumicën e peruanëve. Kështu që, së bashku me kolegët e mi, vendosa të ndërtoja një fabrikë rrobaqepësie me dy makina qepëse në qytetin-kasolle të Limës. Për ta parë çështjen nga këndvështrimi

i të varfrit, përdorëm kronometrin për të matur se sa kohë i duhej një sipërmarrësi të zakonshëm të Limës për të kapërcyer burokracinë. Zbuluam se, për t'u bërë i ligjshëm, kërkoreshin më tepër se 300 ditë, duke punuar 6 orë në ditë. Kostoja: 32 herë më e lartë se paga minimale mujore. Zhvilluam një eksperiment të ngjashëm për të zbuluar se çfarë duhet të bënte një individ që jetonte në një banesë informale, prania e të cilit njihej nga qeveria, për të siguruar një titull pronësie ligjor për shtëpinë e tij. Vetëm për të siguruar miratimin prej bashkisë së Limës - një prej 11 agjencive qeveritare të përfshira në këtë çështje - duhej kaluar përmes 728 hapave burokratike (shihni figurën 6.3). Gjithë kjo vërtetonte atë që kisha hamendësuar që në fillim: Shumica e të dhënave rrethanore pasqyrojnë interesat e atyre grupeve, sikurse janë avokatët me të cilët u këshillova, të cilët gjenden brenda kambanës së qelqtë. Për këtë arsye kambana e qelqtë mund të shihet vetëm nga jashtë - nga perspektiva e të varfrit.

Në çastin që qeveria do të sigurojë këtë informacion, do të jetë në gjendje të shpjegojë qëllimin e vet në një mënyrë të tillë që të varfrit ta kuptojnë dhe të mbështeten mbi të. Si rezultat, ata do të mbështesin me entuziazëm programet reformuese. I varfëri do të kthehet në mekanizmin më efikas të marrëdhënieve publike për reformën, duke siguruar të dhënat mbi reagimet e rrugëve, çka është e nevojshme për të mbajtur programin brenda binarëve.

Pikërisht kjo ka ndodhur në Peru. Prej vitit 1984 deri më 1994, së bashku me kolegët, kam drejtuar shumë përpjekje për të informuar publikun në lidhje me përfitimet që vijnë nga heqja e kambanës së qelqtë (në atë kohë e kemi quajtur "formalizim"). Qëllimi ynë ishte t'u vërtetonim politikanëve se ekzistonte një konsensus i fshehur kombëtar për reformë dhe se formalizimi i aseteve të të varfërve përbënte një strategji politike fitimtare.

Në fund të viteve '80, anketat vërtetuan këtë fakt: Propozimi ynë për të ndryshuar sistemin formal të pronësisë mbështetej në masën 90 për qind. Me një mbështetje të tillë, nuk ishte për t'u habitur që, kur para Kongresit Peruan, në vitin 1984 dhe në fillim të 1990, u paraqitën copat e para të legjislacionit dhe rregulloreve për formalizim, hartuar prej organizatës sime, ato u miratuan me votë unanime. Gjatë fushatës presidenciale të 1990, çdo kandidat, përfshirë Mario Vargas Llosa, novelistin dhe kandidatin e koalicionit liberal-konservator, dhe Alberto Fujimori, populistin thuajse të panjohur dhe fituesin e atij viti, së bashku me presidentin socialist në fuqi Alan Garcia, u pajtua me agjendën e formalizimit. Edhe sot, me gjithë zbatimin e përpjekjeve të hallakatura dhe shumë të paplota, formalizimi përbën një pikë fikse, të pakundërshtueshme dhe të përrjetshme të peizazhit politik peruan.

Me të dhënat, shifrat dhe opinionin publik nga ana e reformës, qeveria do të jetë në gjendje të përfshijë të gjithë çështjen e varfërisë në programin e saj të rritjes ekonomike. Eliminimi i varfërisë nuk do të shihet më si një çështje bamirësie, e cila ndërmerret kur dhe nëse bëhet e përbalueshme. Përkundrazi, e ardhmja e të varfërve do të gjendet në majë të programit qeveritar për rritje.

Pajtimi i Elitave

Në çastin kur potenciali ekonomik i të varfërve - që përbëjnë shumicën dërrmuese në vend - identifikohet dhe shpalolet mbështetja e tyre ndaj reformës, reformuesit mund të kthehen nga grupet elitare. Në këtë çast duhet të thyhet iluzioni që i përfshin këto grupe se hapja e kambanës së qelqtë është vetëm në përfitim të të varfrit. Kalimi i hendekut që ndan klasat sociale nuk është thjesht një e mirë sociale. Integrimi



ligjor i çdo lloji mund të ndihmojë pothuaj çdo grup interesi në vend. Ashtu sikurse mblodhën fakte dhe numra për të siguruar mbështetjen e të varfërve, reformatorët duhet të përdorin fakte dhe numra të tjerë për të fituar zemrën e të interesuarve të lartë. Grupet elitare duhet të mbështesin reformën jo për shkak të patriotizmit apo altruizmit, por sepse kjo do të trashë kuletat e tyre.



Për shembull, përfshirja brenda ligjit e sektorit informal do të hapë rrugën për programe masive strehimi me kosto të ulët, të cilat do të krijojnë kushte strehimi për të varfrit me shtëpi, që jo vetëm janë të ndërtuara më mirë, por janë edhe më të lira krahasuar me shtëpitë që ata kanë ndërtuar në sektorin informal. Të ndërtosh një shtëpi në botën e rrëmujshme të sektorit informal është njëllë sikur të veshësh në fillim këpucët dhe pastaj çorapet. Kini parasysh se çfarë duhet të heqë një emigrant i ri nga zonat rurale për të ndërtuar një shtëpi për familjen e tij në qytetin-kasolle jashtë qytetit të madh. Së pari, atij jo vetëm që i duhet të gjejë një vend për shtëpinë, por duhet të zërë tokën personalisht së bashku me familjen. Hapi tjetër është ngritja e një tende ose kasolleje ndërtuar me kashtë e hasër, tulla prej balte, karton, kompensatë, hekur të ndryshkur apo kanoçe kallaji, sipas traditës së fshatit – për të ngritur më pas një pretendim fizik (sepse pretendimi ligjor nuk është i mundur). Më pas, emigranti dhe familja e tij do të sjellin mobilie dhe instrumente të tjera shtëpiake. Është e qartë se atyre u nevojitet një banesë më e qëndrueshme dhe më e përshtatshme për të jetuar. Por, si mund ta ndërtojnë atë pa pasur mundësinë e sigurimit të kredisë? Ata bëjnë atë që bën gjithsekush tjetër – magazinojnë materiale të qëndrueshme ndërtimi dhe nisin të ndërtojnë një shtëpi më të mirë, hap pas hapi, në varësi të llojit të materialit që arrijnë të grumbullojnë.

Në çastin që banorët e njëres prej këtyre lagjeve të reja

FIGURA 6.3

728 Hapa burokratike kërkohen nga bashkia e Limas për të marrë certifikatën e pronësisë për një shtëpi në një zonë të ligjësuar për banim





arrijnë një organizim të tillë të mjaftueshëm për të mbrojtur këto zotërimet, ose kur autoritetet lokale venë dorën në zemër për ta, mund të ndërtohen trotuare, kanalizime për ujin dhe mbeturinat dhe elektricitet – të gjitha këto mundësohen përmes shkatërrimit të një pjese të shtëpisë. Vetëm pas vite ndërtimesh e rindërtimesh, si dhe pasi kanë ruajtur materiale ndërtimi, pronarët e shtëpive janë më në fund në gjendje të jetojnë në mënyrë të rehatshme.

Në Perëndim, krijimi i shtëpisë është një lloj sikur të veshësh në fillim çorapet, e pastaj këpucët, një mënyrë më pak e rrezikshme, më pak e kushtueshme dhe më pak degraduese. Një ndërtues, përgjithësisht, zotëron titujt e tokës, gjë që i jep garancinë e ndërtimit të një infrastrukture (rrugë me asfalt, shërbime komunale etj.). Më pas shet shtëpinë duke vazhduar ndërtimet sipas parapëlqimeve të blerësit. Pronarët e rinj, të cilët kanë marrë hua nga banka për të blerë shtëpinë, sjellin mobilitet dhe, më në fund, fëmijët së bashku me macen e shtëpisë.

Në çastin që të varfrit do të bëhen kontabël sipas ligjit formal, do të jenë në gjendje të sigurojnë strehim me kosto të ulët dhe kështu të largohen prej botës së rrëmujshe të sektorit informal. Në këtë çast, edhe grupet elitare do të nisin të marrin frytet: Ndërtuesit dhe prodhuesit e materialeve të ndërtimit do të zgjerojnë tregjet, ashtu sikurse bankat, kompanitë e hipotekave, agjencitë e titujve dhe kompanitë e sigurimit. Formalizimi do të ndihmojë edhe ofruesit e shërbimeve komunale duke shndërruar adresat shtëpiake në terminale të njohur. Do t'u sigurojë qeverive dhe bizneseve informacione dhe adresa për tregtimin, sigurimin e interesave dhe grumbullimin e borxheve, faturave dhe tatimeve. Si rrjedhojë, një sistem formal i pronësisë ofron të dhëna për vendime investimesh në fushën e shëndetësisë, arsimit, vlerësimit tatimor dhe planifikimit mjedisor.

Pronësia ligjore e kudondodhur do të ndihmojë edhe në zgjidhjen e problemit më të përhapur dhe për të cilin ka më shumë ankesa prej të varfërve urbanë në rritje - nevojës për më shumë “ligj dhe rregull”. Shoqëria civile e ekonomive të tregut nuk ka lindur thjesht si rrjedhojë e përparimit më të madh. E drejta për pronë sjell edhe respektim të ligjit. Sikurse ka theksuar historiani i njohur Richard Pipes në librin e tij në lidhje me Revolucionin Rus:

Prona private është institucioni i vetëm më i rëndësishëm i integritetit social dhe politik. Zotërimi i pronës krijon një angazhim ndaj rendit politik dhe ligjor, pasi ky i fundit garanton të drejtat e pronësisë: i bën qytetarët bashkësorë. Si e tillë, pronësia përbën mekanizmin parësor për rrënjosjen e respektimit të ligjit dhe interesin për ruajtjen e *status quo*-së në zemër të popullsisë masive. Dëshmitë historike tregojnë se shoqëritë me një shpërndarje të gjerë të pronës, sidomos asaj tokësore dhe asaj që lidhet me banesat e strehimit, janë më konservatore dhe të qëndrueshme dhe, për këtë arsye, janë më të forta kundër kryengritjeve të çdo lloji. Kështu, fshatarësia franceze, e cila në shekullin e 18-të qe një burim paqëndrueshmërie, në shekullin e 19-të, si rezultat i Revolucionit Francez, u bë një shtyllë e konservatorizmit.¹⁸

Kur të varfrit janë të bindur se toka dhe bizneset u përkasin me të vërtetë atyre, respekti që kanë në lidhje me pronësinë e tjetrit rritet.

Regjistrat formalë dhe të azhurnuar të pronësisë i ofrojnë gjithashtu policisë informacionin e nevojshëm për një kontroll të qytetëruar. Në vendet në zhvillim e ato ish-komuniste, një nga karakteristikat primare të të jashtëligjshmëve është

mungesa e një adrese ligjore. Kur kryhet një krim, policia nuk zotëron të dhënat, provat apo ndonjë informacion tjetër me bazë pronësinë për të “gjurmuar” të dyshuarit kryesorë. Për këtë arsye, autoritetet e zbatimit të ligjit nuk mund të jenë përzgjedhës, sikurse janë homologët e tyre në Perëndim, në rrethimin e të dyshuarve dhe kështu mund të shkelin të drejtat civile të njerëzve të pafajshëm.

Zotërimi i pronësisë formale ka prirje të shkurajojë sjelljen e pabindur. Kur njerëzit detyrohen të ndajnë pronën e tyre në ngastra më të vogla, pasardhësit e pasardhësve të tyre, të mbipopulluar në toka familjare, kanë prirje të zaptojnë toka të tjera. Po ashtu, kur një individ nuk e provon dot se zotëron diçka, ka prirje të korruptojë dikë brenda burokracisë ose, me ndihmën e fqinjëve, të marrë ligjin në duart e veta. Më keq akoma, pa një ligj të mirë i cili imponon përmbushjen e detyrimeve, shoqëria fton gangsterët dhe terroristët që ta bëjnë këtë. Së bashku me kolegët kam drejtuar fushata formale të titullarizimit të cilat kanë lënë mënjanë terroristët, duke shfuqizuar rolin e tyre si forcë sigurie e zonës kundër kërcënimit real ose imagjinar të konfiskimit të tokës.

Po ashtu, pronësia krijon një alternativë ndaj trafikimit të drogës. Për sa kohë që fermerët mbeten pronarë toke informale, të mbjellat me cikël të shkurtër, si bima e kokës ose opiumi, mbeten alternativa e vetme. Për fermerët e vegjël të disa zonave të botës në zhvillim, paratë e siguruara nga trafikantët e drogës përbëjnë të vetmen kredi në dispozicion dhe, për faktin se marrëveshjet e pronësisë nuk shfaqen në asnjë sistem zyrtar, autoritetet zbatuese të ligjit nuk arrijnë as t'i gjejnë, e jo më të ndërmjetësojnë një marrëveshje për parablerjen e të mbjellave. Mungesa e mbrojtjes ligjore nënkupton se kultivuesit e të mbjellave të drogës duhet të bashkohen për të mbrojtur asetet ose të thërrasin në ndihmë trafikantët. Pa një sistem formal të

pronësisë i cili përfshin pronarë të tillë, kontrollimi i rritësve të kulturave të drogës, përndjekja e trafikantëve të drogës dhe identifikimi i ndotësve të ambientit bëhet pothuaj e pamundur. Autoritetet nuk kanë mundësi të depërtojnë brenda marrëveshjeve të ngushta informale që krijojnë njerëzit për të mbrojtur interesat e tyre.

Legalizimi i pronësisë nuk është bamiresi për të varfrit. Krijimi i një tregu të rregullt i cili i bën pronarët kontabël dhe u siguron shtëpive të tyre tituj të rregullt që lejojnë financim, do të prodhojë një treg të gjerë, do të vendosë ligj dhe rregull dhe do të vendosë paratë në xhep të grupeve elitare.

Marrëveshja me Kujdestarët e Kambanës së Qelqit

Pasi reformatorët të kenë tërhequr të varfrit dhe një pjesë të elitës nga ana e tyre, do të ketë ardhur çasti i kontrollimit të burokracisë që administron dhe mbron *status quo*-në – kryesisht, avokatët dhe teknikët.

Avokatët. Teorikisht, bashkësia ligjore duhet të favorizojë reformën sepse kjo përhap zbatimin e ligjit. Por, faktikisht, shumica e avokatëve të vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste nuk mësohen të përhapin ligjin, por ta mbrojnë atë, sikur ta kishin zbuluar vetë. Avokatët janë profesionistët më të angazhuar në biznesin ditor të pronësisë. Ata janë të ulur në zyrat kyçe qeveritare prej të cilave imponojnë vendimet e rëndësishme. Asnjë grup – me përjashtim të terroristëve – nuk ka një pozitë më të mirë për të sabotuar zgjerimin kapitalist. Dhe, ndryshe nga terroristët, avokatët dinë si ta bëjnë këtë ligjërisht.

Megjithëse sipërmarrësit dhe njerëzit e zakonshëm janë krijuesit e vërtetë të kapitalit dhe kapitalizmit, janë avokatët ata që fiksojnë konceptet e pronësisë në dokumente të qartë e të

formalizuar përfaqësimi dhe përcaktojnë këto koncepte përmes statuteve. Sigurimi i pronësisë, kontabilizimi i pronarëve dhe zbatimi i transaksioneve duhet konkretizuar përfundimisht përmes procedurave dhe rregullave të hartuara nga avokatët. Në fakt, është profesioni ligjor ai që rregullon gjithë dokumentet e pronësisë formale: titujt, regjistrimet, markat e fabrikave, të drejtat e autorit, fletë-premtimet, faturat e shkëmbimit, patentat dhe aksionet e kapitalit korporativ. Pavarësisht nga fakti nëse i pëlqeni apo jo avokatët, asnjë proces i mirëfilltë ndryshimi në regjimin e pronësisë dhe formimin e kapitalit nuk mund të ngjasë pa bashkëpunimin e të paktën disave prej tyre.

Vështirësia qëndron në faktin se shumë pak avokatë i kuptojnë pasojat ekonomike të punës së tyre dhe reagimi i tyre spontan ndaj sjelljes informale dhe ndryshimit masiv është përgjithësisht armiqësor. Të gjithë reformatorët me të cilët jam takuar gjatë veprimtarisë për ta bërë pronësinë më të disponueshme për të varfrit, vepronin me arrogancën se profesioni ligjor ishte armiku i tyre natyror. Ekonomistët e përfshirë në reformë janë kaq të acaruar prej konservatorizmit ligjor sa që kanë investuar para dhe kohë për të shpërfillur profesionin ligjor. Duke përdorur të dhënat ekonomike të 52 vendeve, prej vitit 1960 deri më 1980, Samar K. Datta dhe Jefferey B. Nugent kanë ilustruar se për çdo pikë përçindjeje rritje të pjesës së avokatëve në fuqinë punëtore (për shembull nga 0.5 në 1.5 për qind), rritja ekonomike zvogëlohet me 3.68 deri 4.76 për qind – duke treguar se rritja ekonomike lidhet në mënyrë të zhdrejtë me pjesën e avokatëve.¹⁹

Ajo që i acaron në mënyrë të veçantë shumë reformues është mënyra se si avokatët hedhin fajin e sistemeve të dobëta të pronësisë mbi njerëz të tjerë. Shpesh, kam dëgjuar avokatë duke lavdëruar ligjin ekzistues të pronësisë, ndërkohë që, nga ana tjetër, pranonin se titujt e ligjshëm të pronësisë ishin të

vështirë ose të pamundur për t'u përdorur. Sigurisht, një gjë e tillë është e papranueshme. Një avokat nuk mund të hartojë një ligj dhe procedurat administrative për zbatim dhe, nga ana tjetër, të fajësojë për dështimin e ligjit, teknokratët e nivelit të ulët që e zbatojnë apo arsimin e varfër të atyre që e përdorin. Nuk mjafton qëndisja e ligjeve të bukur. Këto ligje duhet të funksionojnë brenda realitetit administrativ dhe social për të cilin janë hartuar.

Është mjaft interesant fakti se kritikantët më të fuqishëm kundër përpjekjes së avokatëve për të ndaluar reformën e pronësisë, vijnë nga kolegët e tyre avokatë. Kështu shkruan S. Rowton Simpson, avokat dhe autori më i famshëm në botë i botimeve në lidhje me regjistrimin e tokës:

Avokatët nga e gjithë bota janë famëkëqij për mungesën e dëshirës për të pranuar edhe ndryshimet më të vogla të procedurave të tyre tradicionale... Torrensi, [zbuluesi australian i një prej sistemeve më të sigurta në botë për regjistrimin], i cili u kundërshtua fuqishëm nga profesioni ligjor, kapërceu kundërshtitë e avokatëve të Australisë së Jugut; por historia e tij përbën një përjashtim. Nevojitet një diamant për të prerë një diamant dhe, në shumicën e vendeve, regjistrimi i titujve ka ardhur zakonisht falë përpjekjeve të avokatëve, megjithëse procesi është dëmtuar nga kundërshtimet aktive të vetë praktikuesve të profesionit ligjor; dhe kundërshtia pasive mund të jetë edhe më e keqe se ajo aktive, e cila të paktën ose fiton ose humbet. Kundërshtia pasive është më e rrezikshme; kjo mund të trullisë përparimin. Jo pak statute janë fishkur që në djep pasi janë mirëpritur nga praktikuesit ligjorë, mikpritje e cila ose ishte buzëqeshje e shtirur ose “të jepte puthjen e vdekjes”; statute të tjera hartohen në bazë të

një procedure kaq të gjatë, saqë përparimi bëhet pothuaj i paprekshëm; statute të tillë nuk përbëjnë kërcënim për praktikën e vendosura, kështu që kanë prirje të jenë të pranueshme për profesionin ligjor por, në të vërtetë, nuk arrijnë objektivin; këto thjesht zgjasin listën e “mossukseseve” për të mos thënë të dështimeve.²⁰

Megjithëse avokatët shpesh pranojnë se disiplinat e tjera duhet të jenë dinamike, ata argumentojnë se ligji duhet të jetë i qëndrueshëm. Një adhurim i tillë i zgjedhës së ligjit, duke mos marrë parasysh pasojat, mund të arrijë një pikë ku avokatët që mbështesin reformën, rrezikojnë të veçohen prej kolegëve të tyre. Në vendet gjermanofone, gjatë shekullit të 19-të dhe fillimit të shekullit të 20-të, armiqësia e profesionit ligjor kundër reformës pronësore ishte kaq e ashpër, saqë çdo avokat reformist quhej Mestbeschmutzer – një bishë që shkatërron folenë e saj.

Lajmi i mirë për reformatoret është se shumica e avokatëve më të aftë (por që nuk janë domosdoshmërisht më të suksesshmit) besojnë se ligji është hartuar për t'i shërbyer jetës dhe jo anasjelltas. Juristët përparimtarë kanë triumfuar përfundimisht mbi prirjet reaksionare të profesionit në Perëndim, edhe për sa i përket ligjit Romak. Rruga ka qenë e gjitha në malore, kryesisht për faktin se, sikurse ka theksuar Piter Stajni, “kontributi i avokatëve në drejtim të njohjes së institucioneve ligjore u errësua nga ndikimi i theksuar i praktikave të dala mode dhe pranimi i ligjit Romak si produkt përfundimtar nga ana e avokatëve”.²¹ Megjithatë, me kalimin e kohës, juristët e mëdhenj evropianë kapërcyen konservatorizmin e tepruar sepse, sikurse thekson Stein, “ata i vendosën për qëllim vetes të bëheshin ekspertë të ligjit të ndërlikuar Romak dhe të siguronin që ky ligj të ndërrohej me kalimin e kohës”.²² Në çdo vend të Evropës lindi një grup elitar avokatësh, të cilët duke dalë hapur kundër

pasivitetit të vazhdueshëm të kolegëve të tyre, ndihmuan në heqjen e kambanës së qelqit.

Çdo qeveri e etur për të hartuar një sistem pronësor të integruar duhet të hartojë një strategji të kujdesshme për t'u përballur me profesionin ligjor. Çelësi është zgjedhja e avokatëve të duhur. Nevojitet një udhëheqës politik i zgjuar dhe dinak për të shmangur goditjet e avokatëve, të cilët janë të aftë të shtyjnë politikanët në një gjendje pasiviteti, si dhe i aftë për të gjetur ata avokatë që mund t'i japin formë ligjore një programi transformimi, edhe nëse kjo nënkupton kundërvënie ndaj sistemit. Nëse politikani reformator nuk zgjedh një nga një avokatët e tij, do të mbetet në mëshirë të teknokratëve ligjorë të cilët do të mbështesin reformën ditën, duke e shkatërruar natën.

Avokatët e guximshëm dhe reformatorë gjenden në çdo vend dhe, pasi qartësohen kriteret për përcaktimin e këtyre cilësive, mund të identifikohen njerëzit e duhur. Shumë mendojnë se faktorët primarë që përcaktojnë ndryshimin gjenden jashtë ligjit. Në çdo vend që kam vizituar, kam zbuluar grupe avokatësh qeveritarë që e njihnin shumë mirë sektorin informal dhe që përpiqeshin çdo ditë të vendosnin një harmoni mes sistemit formal dhe marrëveshjeve informale. Disa avokatë akademikë janë gjithashtu të ndërgjegjshëm se rendet paralele të ligjit formal dhe informal veprojnë njëkohësisht. Por, puna e tyre ka prirje të mos vihet re nga instancat e larta qeveritare dhe, madje, edhe ata mbeten të padukshëm. Me të vërtetë, metoda sipas së cilës avokatët të cilët kanë njohuri në lidhje me ekzistencën e dy rendeve dhe simpatizojnë reformën, shtyhen në caqet e vendimmarrjes politike, është bërë normë.

Pikërisht me këta njerëz, udhëheqja politike mund të godasë *status quo*-në dhe të zbatojë një program kombëtar të parezistueshëm për formalizimin e pronësisë. Megjithatë,

një shumëllojshmëri e tillë nuk mbin papritur. Çdo avokat duhet identifikuar dhe rekrutuar. Të gjithë së bashku, ata do të përbëjnë pararojën që do të mbrojë çështjen reformatore kundër kolegëve avokatë. Pikërisht ata do të jenë në gjendje të mundin dinozaurët dhe do t'i shpjegojnë profesionit zyrtar sipas një gjuhe të njohur se sa i rëndësishëm është, për të ardhmen e tyre dhe të kombit, integrimi i gjithë pronave në një sistem ligjor të përbashkët dhe të hapur për gjithë popullin. Vetëm ata mund t'u shpjegojnë profesionistëve të tjerë se procedurat ligjore ekzistuese nuk janë thjesht një ngatërresë, por përbëjnë pengesat e pakapërcyeshme që nuk lejojnë shumicën e njerëzve të botës të prodhojë kapital. Edhe avokatët janë qenie të gjalla. Kur të kuptojnë se sistemi që mbrojnë është përfundimisht i dalë mode, reagimi i tyre do të jetë pozitiv.

Teknikët. Vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste vazhdojnë të shpenzojnë qindra milionë dollarë në teknologji hartash dhe regjistrimi kompjuterik për të modernizuar sistemet e pronësisë – e përsëri nuk janë në gjendje të integrojnë sektorët informalë. Një gjë e tillë nuk i habit më ata që kanë menduar thellë në lidhje me përparësitë e reformës pronësore. Më 1993, një ekspert i Bankës Botërore paralajmëronte se “ka pasur një prirje për ta quajtur titullarizimin e tokës një problem teknik. Shpesh vizatohen harta dhe kryhen anketime, por titujt nuk lëshohen për shkak të bllokimit të sistemit apo të problemeve ligjore”.

Edhe teknikët janë të shqetësuar se mund të hipnotizohen nga teknologjitë e reja marramendëse. Një prej ekspertëve më të njohur në sistemet e pronësisë tokësore dhe të informacionit në Kanada, ka shprehur shqetësim për faktin se shumë qeveri vazhdojnë ta shohin vizatimin e hartave si pikë kyçe për pronësinë:

Aktualisht jemi në rrezik për shkak të mitizimit të këtij fakti nëpërmjet përpjekjeve për të kufizuar problemin e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS) në përmasa menaxhimi të burimit. Teknologjia është tërheqëse; ajo prodhon rezultate të prekshme. Por është vetëm një pjesë e zgjidhjes... Këshilltarët dhe organizatat e asistencës eksportojnë sisteme të njohur për ta (zakonisht sisteme të tyre ose sisteme me të cilët kanë punuar) pa marrë realisht në konsideratë nevojat dhe kufizimet e vendit që i merr... Ekziston një nevojë për më tepër modesti mes këshilltarëve profesionistë; ekziston një nevojë për të pranuar me raste se ata nuk janë gjithnjë në gjendje të përgjigjen apo se sistemi i tyre mund të mos jetë i përshtatshëm.²⁴

Programet e krijimit të pronësisë do të vazhdojnë të dështojnë për sa kohë që qeveritë do të vazhdojnë të mendojnë se krijimi i pronësisë kërkon vetëm njohuri në lidhje me gjërat fizike – të cilat janë fotografuar, anketuar, matur dhe kompjuterizuar në inventarët e asetëve fizike, e kështu mendohet se është siguruar gjithë informacioni i nevojshëm për titujt e pronësisë. Kjo nuk qëndron. Fotografitë dhe inventarët thjesht informojnë autoritetet në lidhje me gjendjen fizike të asetëve; ato nuk thonë gjë në lidhje me kë i disponon realisht këto asete apo mënyrën sipas së cilës njerëzit kanë organizuar të drejtat që i qeverisin. Të gjitha fotografitë dhe të gjithë inventarët e kompjuterizuar të botës nuk mund të tregojnë se cilat rregulla lokale ndihmojnë në zbatimin e këtyre të drejtave dhe cila strukturë marrëdhëniesh i mbështet ato. Megjithëse hartat dhe inventarët janë të rëndësishme për matjen dhe lokalizimin e asetëve fizike me të cilat lidhet pronësia, ato nuk i tregojnë qeverisë se si duhet të ndërtojë një kontratë sociale kombëtare e cila lejon krijimin e pronësisë ligjore kudo.

Prirja e disa vendeve për të shtrydhur çështjet e lidhura me pronësinë brenda departamenteve të hartave dhe teknologjisë informatike ka errësuar natyrën e vërtetë të pronës. Pronësia nuk është realisht pjesë e botës fizike: mjedisi i saj ka natyrë ligjore dhe ekonomike. Pronësia ka lidhje me gjërat e padukshme, ndërkohë që hartat shfaqin gjëra fizike të terrenit. Hartat rrokin informacionin fizik në lidhje me asetet, por nuk arrijnë të kapin imazhin e gjërë. Pa informacionin përkatës institucional dhe ekonomik në lidhje me marrëveshjet informale, hartat nuk mund të rrokin realitetin jashtë kampanës së qelqtë. Kështu pra, nuk janë në gjendje të përmbushin detyrën e tyre, që konsiston në zotërimin e aspekteve fizike të aseteve në realitetin fizik, duke krijuar një sinkronizim fizik dhe virtual.

Derisa pengesat e përdorimit të sistemeve formale të pronësisë të eliminohen dhe marrëveshjet informale të zëvendësohen nga ligji, njerëzit do të kenë shumë pak stimuj për të paraqitur informacionin e nevojshëm për mbajtjen e hartave dhe bazave të të dhënave të azhurnuara dhe të sigurta. Njerëzit nuk kanë dëshirë të përfshihen brenda sistemit formal të pronësisë sepse nuk kanë dëshirë të dalin në harta, të regjistrohen apo të taten; ata do të bashkohen me sistemin në çastin kur përfitimet ekonomike të bëhen të dukshme dhe kur të jenë të sigurt se të drejtat e tyre do të vazhdojnë të mbrohen.

Për sa kohë që këto të drejta mbrohen nga një kontratë sociale informale, njerëzit nuk do të kenë arsye të njoftojnë autoritetet në lidhje me ndryshimet e vendosjes së aseteve të tyre. Vetëm kur ligji formal të zëvendësojë marrëveshjet informale si burim mbrojtjeje i pronësisë, njerëzit do të pranojnë legjitimitetin dhe do të jenë të interesuar t'u ofrojnë autoriteteve informacionin e nevojshëm për harta dhe regjistrime aktuale. Vendi ku gjendet kontrata sociale është vendi i azhurnimit të hartave dhe regjistrimeve.

Kjo nuk është një çështje e parëndësishme. Projektet teknike të titullarizimit kanë prirje të degjenerojnë në sisteme identifikimi për stoqet fizike, në Librat Domesday të dalë mode apo në relikte historike. Si rezultat, industria e hartave dhe kompjuterëve vuan. Buxhetet e projekteve miratohen nga politikanë të cilët presin që këto metoda të reja të mundësojnë përfshirjen e të varfërve. Kur këta zbulojnë se kjo nuk ndodh, projektet e hartave humbasin rëndësinë prioritare ose ndërpriten. Së bashku me skuadrën time kam zbuluar se një gjë e tillë ndodh vazhdimisht.

Arsyeja pse këto programe funksionojnë kaq mirë në kombet perëndimore, pa qenë nevoja për shumë rregullime ligjore dhe politike, lidhet me faktin se rregullimi është kryer më tepër se 100 vjet më parë. Kontrata sociale gjithëpërfshirëse ka zënë vend tashmë. Kur qendrat e informacionit, sistemet e informacionit gjeografik, sistemet e ndjeshmërisë së largët, sistemet globale të pozicionimit dhe gjithë teknologjitë e tjera të mrekullueshme të informacionit u vunë në dispozicion përgjatë 30 viteve të fundit, ato zunë vend në një infrastrukturë të mirëintegruar informuese dhe ligjore. Kështu pra, mekanizmat e shkruar dhe grafikë të përfaqësimit si dhe mjetet për magazinim, rikthim dhe përpunim më të mirë të informacionit mund të viheshin në përdorim.

Nuk po them se inxhinierët, integrimi i sistemeve, kompanitë e teknologjisë së informacionit, shitësit e pajisjeve, këshilltarët e regjistrimit dhe gjithë palët e tjera që merren me ofrimin e shërbimeve të dokumentimit të pronësisë të specializuara në anketim, vizatim hartash dhe modernizim regjistrash nuk janë të rëndësishëm për krijimin e pronësisë – krejt e kundërta. Nëse përshtaten siç duhet me regjistrimin masiv dhe veprimtarinë në mjedisin informal, janë të domosdoshëm për përcaktimin e vendndodhjes fizike si dhe për përpunimin e integrimin e

informacionit. Këto do të shpenzojnë pjesën më të madhe të buxhetit që shkon për reformë pronësore, por vetëm pasi të jenë zgjidhur problemet ligjore dhe politike të tërheqjes së sektorit informal.

Vetëm udhëheqja e mirëfilltë politike mund të tërheqë ligjin e pronësisë larg nga kthetrat e së kaluarës dhe brenda vlerësimit të së tashmes, nga habitja për shkak të teknologjisë, drejt angazhimit për shoqërinë e mirë. Politikanët janë të nevojshëm sepse institucionet ekzistuese priren të favorizojnë dhe mbrojnë *status quo*-në. Të bindurit e teknokracisë për të dalë nga vetja dhe për të mbështetur ndryshimin, përbën një detyrë politike.

Ndërhyrja politike është gjithashtu e nevojshme për faktin se organizatat qeveritare që ndodhen brenda kambanës së qelqtë nuk janë krijuar për të ndërmarrë programe të shpejta dhe të gjera reformuese. Ato shpesh organizohen si departamente të specializuar, në një strukturë që merr kuptim në kombet e zhvilluara, ku nevojitet vetëm një ndryshim gradual pasi ligji dhe pronësia formale funksionojnë në total. Krijimi i pronësisë nuk është njëlloj si një program privatizimi, i cili përfshin shitjen e një dengu asetesh në vit. Qëllimi i reformës pronësore është akordimi i të drejtave të pronësisë për miliona asete në adresë të miliona njerëzve në një kohë shumë të shkurtër. Kjo nënkupton se gjysma e punës lidhet me komunikacionin. Udhëheqësit e reformës pronësore duhet të përshkruajnë se si kapitalizmi popullor do të ketë ndikim mbi shumë grupe interesi, duhet t'u ilustrojnë këtyre grupeve përfitimet që vijnë nga kjo dhe t'i bindin se kjo është një strategji fituese për gjithë segmentet e shoqërisë. Në lidhje me sektorin informal, këta udhëheqës duhet të adresojnë energjinë sipërmarrëse të mbyllur dhe të ilustrojnë përparësitë e integritit të një ligji të ri formal. Në lidhje me sektorin formal, ata duhet të shpjegojnë se

reformat e propozuara nuk do të dëmtojnë të drejtat legjitime të vendosura dhe se do të ketë përfitime të përbashkëta për gjitha grupet e interesit.

Krijimi i një sistemi pronësie të arritshëm për të gjithë përbën në thelb një detyrë politike sepse duhet të mbahet mbi binarë nga njerëz, të cilët e kuptojnë se qëllimi përfundimtar i sistemit të pronësisë nuk është hartimi i statuteve të bukur, lidhja e kompjuterëve të shndritshëm apo nxjerrja e hartave shumëngjyrëshe. Qëllimi i pronësisë formale është vendosja e kapitalit në duart e gjithë kombit.

7

PËR TA PËRFUNDUAR

*Ku është dija që kemi humbur në njohuri?
Ku është njohuria që kemi humbur në informacion?*

T.S. Eliot, Refren nga "Shkëmbi"

Klubi privat i globalizimit

Jashtë Perëndimit, kapitalizmi është në krizë jo sepse globalizimi ndërkombëtar po dështon, por sepse vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste nuk kanë qenë në gjendje të "globalizojnë" kapitalin brenda vendeve të tyre. Shumica e njerëzve në këto vende e shohin kapitalizmin si një klub privat, një sistem diskriminues prej të cilit përfiton vetëm Perëndimi dhe elitat e kampionëve të qelqtë në vendet e varfër.

Shumica e popujve të botës mund të veshin këpucë "Nike" apo të shohin orët "Casio" por, edhe ndërkohë që konsumojnë mallrat e Perëndimit, janë të vetëdijshëm se gjenden në periferi të lojës kapitaliste. Ata nuk kanë interesa në këtë lojë. Globalizimi nuk duhet të jetë thjesht ndërlidhje e kampionëve të

të privilegjuarve. Ky lloj globalizimi ka ekzistuar edhe më parë. Në shekullin e 19-të, mbretërit sundues të Evropës përbënin një familje të madhe, të lidhur përmes gjakut dhe kontakteve të vazhdueshme tregtare me kushërinjtë e tyre në Angli, Francë, Holandë, Spanjë dhe Rusi. Kapitalizmi ka triumfuar në shekullin e 19-të dhe ka mbizotëruar përmes botës së industrializuar deri në periudhën e Revolucionit Rus dhe Depresionit të Madh. Por, sikurse kanë theksuar Ortega y Gasset i Spanjës dhe eksperti amerikan Walter Lippman, me gjithë mbizotërimin dhe nivelin e lartë të ndërlikueshmërisë, sistemi kapitalist ishte gjithmonë i dobët. Ekonomisti amerikan Lester Thurow tregon se deri më 1941:

Shtetet e Bashkuara dhe Britania e Madhe qenë në thelb vendet [më të mëdha] kapitaliste të mbetura mbi faqen e tokës... Pjesa tjetër e botës ishte fashizëm, komunizëm ose koloni feudale e Botës së Tretë. Kriza përfundimtare e viteve '20 dhe Depresioni i Madh i viteve '30 e kishin shtyrë kapitalizmin deri në prag të zhdukjes. Kapitalizmi që sot duket i pathyeshëm, me disa gabime të tjera mund të ishte zhdukur.¹

Nuk ka nevojë të kujtojmë amerikano-latinët. Në katër raste të njohur që prej arritjes së pavarësisë nga Spanja në vitet '20 të shekullit të 19-të, ata janë përpjekur të bëhen pjesë e kapitalizmit global dhe kanë dështuar. Ata ristrukturuan borxhet, stabilizuan ekonominë duke kontrolluar inflacionin, liberalizuan tregtinë, privatizuan asetet qeveritare (për shembull duke u shitur hekurudha britanikëve), ndërmorën shkëmbime borxhi dhe rihartuan sistemet tatimore. Në nivel konsumatori, amerikano-latinët importuan gjithë llojet e mallrave, që prej stofrave dhe këpucëve klasike të Anglisë, deri te Fordet Model T; ata mësuuan anglisht dhe frëngjisht duke dëgjuar radio ose

muzikë; ata mësuan si të kërcëjnë “Çarlestonin” dhe “Ecjen e Lambethit”, si dhe mësuan të përtypin çamçakëz “Chiclets”. Por kurrë nuk arritën të prodhojnë shumë kapital të gjallë.

Mbase të gjithë ne po mbledhim frytet e revolucionit në komunikacion dhe disa mund të shohin përparim te Sfinks i Egjiptian që qëndron ballë përballë me dritat e neonit të filialit “Kentucky Fried Chicken”. Megjithatë, vetëm 25 nga 200 vendet e botës sot, prodhojnë kapital në sasi të mjaftueshme për të siguruar avantazhe të plota prej ndarjes së punës në tregjet e gjera globale. Gjaku jetësor i kapitalizmit nuk është interneti apo filiali i *fast-food-it*. Është kapitali. Vetëm kapitali siguron mekanizmat për të mbështetur specializimin si dhe prodhimin e shkëmbimin e aseteve në tregjet e gjera. Kapitali është burimi i prodhueshmërisë në rritje dhe pasurisë së kombeve.

E megjithatë vetëm kombet Perëndimore dhe vatrat e vogla të pasura të vendeve në zhvillim dhe atyre ish-komuniste kanë aftësinë të përfaqësojnë asetet dhe potencialin e tyre, pra d.m.th. aftësinë të prodhojnë dhe të përdorin kapitalin në mënyrë efikase. Jashtë Perëndimit, kapitalizmi shihet me keqdashje, si një regjim apartheidi në të cilin shumica nuk mund të përfshihet. Ekziston një mendim, edhe mes grupeve elitare, se nëse vazhdojnë të mbeten të varur përgjithmonë mbi dashamirësinë e kapitalit të jashtëm, kurrë nuk do të jenë lojtarë produktivë në lojën e kapitalizmit global. Ata janë shumë të acaruar që nuk aftësohen për t’u bërë drejtues të fatit të tyre. Meqë i janë përveshur globalizimit pa u dhënë njerëzve mekanizma për të prodhuar kapital, këto vende ngjajnë më pak me Shtetet e Bashkuara dhe më shumë me Amerikën Latine tregtare, me gjithë aktivitetin e larmishëm informal të saj.² Dhjetë vite më parë, shumë pak vetë do të kishin guximin të krahasonin kombet e ish-bllokut sovjetik me Amerikën Latine. Por sot, këto grupe ngjajnë shumë: ekonomi të fuqishme

klandestine, pabarazi të flakta, organizata mafioze të fuqishme, paqëndrueshmëri politike, largim të kapitalit nga vendi dhe shpërfillje flagrante e ligjit.

Për këtë arsye, avokatët e kapitalizmit jashtë Perëndimit po tërhiqen me ceremoni. Mbizotërues vetëm një dekadë më parë, sot shihen vazhdimisht si përgjegjës për mjerimin dhe padrejtësitë që vazhdojnë të kenë ndikim mbi shumicën e njerëzve. Për shembull, më 1999, dhoma e lartë këshilluese e Egjiptit paralajmëroi qeverinë “që të mos mashtrohej më prej thirrjeve pro kapitalizmit dhe globalizimit”.³ Duke harruar çështjen thelbësore të pronësisë, avokatët e kapitalizmit e kanë shndërruar veten në mbrojtës të *status quo*-së, duke u përpjekur qorrazi që të zbatojnë ligjet ekzistuese të shkruar pavarësisht nga fakti nëse janë apo jo diskriminuese.

Dhe ligji i këtyre vendeve është diskriminues. Sikurse ilustrua në kreun 2, të paktën 80 për qind e popullsisë së këtyre vendeve nuk është në gjendje të përçojë jetë brenda aseteve dhe t’i bëjë këta të fundit të prodhojnë kapital, sepse ligji i mban jashtë sistemit formal të pronësisë. Ata zotërojnë trilionë dollarë kapital të vdekur, por janë si liqene të vegjël të veçuar, ujërat e të cilëve zhduken në një rrip rëre jopjellor në vend që të krijojnë një masë të madhe ujore e cila të mund të përhithet brenda një sistemi të përbashkët pronësor, për të marrë formën e nevojshme për prodhim kapitali. Njerëzit i mbajnë dhe i përdorin asetet e tyre përmes marrëveshjeve informale të palidhura, kontabiliteti i të cilave menaxhohet në nivel lokal. Pa standardet e përbashkëta krijuar nga pronësia formale, këtyre marrëveshjeve u mungon gjuha e nevojshme përmes së cilës asetet flasin ndërmjet tyre. Nuk ka kuptim t’u thuash të tregohen të duruar dhe të presin që përfitimeve e kapitalit t’u bjerë rruga andej. Kjo nuk do të ndodhë për sa kohë themelet e pronësisë formale nuk janë në vend.

Ndërkohë, nxitësit e kapitalizmit, që mbeten arrogantë pas fitores mbi komunizmin, duhet të kuptojnë se reformat e tyre makroekonomike nuk mjaftojnë. Nuk duhet të harrojmë se globalizimi po ndodh sepse vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste po hapin ekonomitë e tyre dikur të kyçura, po stabilizojnë monedhat dhe po hartojnë struktura rregullash për të fuqizuar tregtinë ndërkombëtare dhe investimet private. Të gjitha këto janë për mirë. Nuk është gjë e mirë fakti se këto reforma supozojnë se popullsitë e këtyre vendeve janë integruar në sistemin ligjor dhe kanë të njëjtën aftësi për të përdorur burimet në tregun e hapur. Ata nuk e bëjnë këtë.

Sikurse kam argumentuar në kreun 3, shumica e njerëzve nuk mund të marrin pjesë në një treg të gjerë sepse nuk mund të hyjnë brenda një sistemi ligjor të drejtave të pronësisë i cili të përfaqësojë asetet e tyre në një mënyrë të tillë që i bën këto të fundit lehtësisht të transferueshme dhe likuide si dhe i lejon të lihen peng dhe, nga ana tjetër, të kontabilizojë pronarët. Për sa kohë asetet e shumicës nuk dokumentohen e gjurmohen siç duhet prej një burokracie pronësore, ato mbeten të padukshme dhe jopjellore në treg.

Duke stabilizuar dhe rregulluar “sipas procedurës”, “programet makroekonomike të globalizuesve kanë racionalizuar në mënyrë dramatike menaxhimin ekonomik të vendeve në zhvillim”. Por, për faktin se procedura është e pafuqishme kur shumica e njerëzve nuk zotërojnë të drejta pronësie, është përmbushur vetëm një pjesë e vogël e detyrës së kërkuar për krijimin e një sistemi të pranueshëm kapitalist dhe të një ekonomie tregu. Mekanizmat e tyre janë krijuar për të vepruar në vende ku është “globalizuar” për së brendshmi ligji i sistemuar dhe ku janë në vendin e duhur sistemet gjithëpërfshirëse të drejtave të pronësisë, të cilat lidhen me instrumentet monetare dhe investues – diçka që ende nuk është arritur në këto vende.

Shumë hartues politikash kanë një vizion Olimpik në lidhje me procesin e globalizimit. Pasi arrijnë stabilizimin dhe rregullimin në nivel makro, gjë që u lejon bizneseve të ligjshme dhe investitorëve të huaj të përparojnë, si dhe ekonomistëve të rregullt të kontrollojnë thesarin, ata mendojnë se kanë përmbushur detyrën e tyre. Për faktin se përqendrohen vetëm mbi politika që lidhen me faktorët agregat, ata nuk marrin parasysh faktin nëse njerëzit kanë apo jo mjete për të marrë pjesë në një sistem të gjerë tregu. Ata kanë harruar se njerëzit janë faktorët themeltarë të ndryshimit. Ata kanë harruar të përqendrohen tek të varfrit. Dhe të varfrit janë shpërfillur sepse hartuesit e politikave nuk veprojnë duke mbajtur vath në vesh konceptin e klasës. Sipas fjalëve të një prej ekspertëve më të njohur të kësaj fushe, ata nuk “zotërojnë aftësinë për të kuptuar, edhe në mënyrë fare sipërfaqësore, se si jetojnë njerëzit e tjerë”.⁴

Reformatorët ekonomikë e kanë lënë çështjen e pronës së të varfërve në duart e institucioneve ligjore konservatore, të cilat nuk janë të interesuara të ndryshojnë *status quo*-në. Si rezultat, asetet e shumicës së qytetarëve kanë mbetur në formën e kapitalit të vdekur, të ngecura në sektorin informal. Për këtë arsye, avokatët mbrojtës të globalizimit dhe reformave të tregut të lirë po shihen si mbrojtës të vetëkënaqur të interesave të atyre që mbizotërojnë brenda kambanës së qelqtë.

Ringjallja e Fantazmës së Marksit

Shumica e programeve ekonomike reformuese në ekonomitë e varfra mund të bien në kurthin e asaj që u parashikua prej Marksit: Kontradikta e lartë e sistemit kapitalist është se krijon një fron të vetin për shkakun se shmang përqendrimin e kapitalit në pak duar. Duke mos i lejuar shumicës mundësinë

e përfshirjes në tregje të gjera, këto reforma përgatisin terrenin për përballje mes klasave – një ekonomi të kapitalit dhe tregut të lirë që privilegjon ata pak që mund të konkretizojnë të drejtat e pronësisë dhe varfëri relative për një sektor të gjerë të dekapitalizuar e të paaftë për të ngritur asetet e veta.

A mund të ketë përballje klasore në këtë epokë? A nuk u shemb një koncept i tillë së bashku me Murin e Berlinit? Për fat të keq, kjo nuk ndodhi. Për një qytetar të një kombi të zhvilluar kjo mund të jetë e vështirë për t’u kuptuar sepse në Perëndim, të pakënaqurit nga sistemi “numërohen me gishta”. Megjithatë, mjerimi në kombet në zhvillim e ato ish-komuniste nuk është i rrallë, por i përhapur anembanë shoqërisë. Me gishta numërohen vetëm vatrat e pasurisë. Ajo që në Perëndim quhet “klasë e ulët”, këtu përbën shumicën. Dhe, në të kaluarën, nëse kërkesat e saj në rritje nuk plotësoheshin, kjo turmë të varfërisht të inatosur rrëzonte në gjunjë grupet elitare të fuqishme (sikurse ka ndodhur në Iran, Venezuelë dhe Indonezi). Në shumicën e vendeve joperëndimore, qeveritë mbështeten mbi shërbime informative shumë të fuqishme dhe grupet elitare kanë arsye të forta për të jetuar prapa fortesave.

Sot, në shkallë të gjerë, dallimi mes vendeve të zhvilluara dhe pjesës tjetër të botës barazohet me dallimin mes atyre vendeve ku pronësia formale është e përhapur dhe atyre vendeve ku klasat që mund të fiksojnë të drejtat e pronësisë e të prodhojnë kapital, janë të ndara prej atyre që nuk mund ta bëjnë këtë. Nëse të drejtat informale të pronësisë nuk njihen, këto shoqëri mund të bëhen lëmsh me ekonomitë e tyre dualiste – ku nga njëra anë, qëndron i ashtuquajtur i sektor që pajtohet me ligjin dhe, nga ana tjetër, sektori i varfëruar informal. Por, teksa informacioni dhe komunikacioni vazhdojnë të përmirësohen dhe të varfrit mësojnë më shumë në lidhje me atë që nuk mund të kenë, armiqësia kundër aparteidi ligjor ka prirje të përshkallëzohet.

Në një pikë të caktuar, ata që jetojnë jashtë kampionës së qelqtë do të mobilizohen kundër *status quo*-së për shkak të njerëzve me programe politike që mbështeten mbi pakënaqësinë. “Nëse nuk zbulojmë mekanizma për ta bërë më gjithëpërfshirës globalizimin”, thotë Klaus Schwab i Forumit Ekonomik Botëror, “duhet të përballemi me perspektivën e ringjalljes së përballjeve të forta sociale të së kaluarës, të cilat do të theksohen në nivel ndërkombëtar”.⁵

Mbase Lufta e Ftohtë ka përfunduar, por argumentet e klasës së vjetër nuk janë zhdukur. Aktivitetet shkatërruese dhe zgjerimi i shpejtë i konflikteve etnike dhe kulturore nëpër botë ilustrojnë faktin se kur njerëzit janë shumë të pakënaqur, ndahen nëpër klasa sipas dëmtimeve të pësuar. “Newsweek” vëren se në kontinentet Amerikane, që prej viteve ’80, “secili konflikt ka historinë e tij, por luftëtarët përbuzin të njëjtin armik: fytyrën e re të kapitalizmit në Amerikën Latine”.⁶ Në situata të tilla, paketa Marksiste është më e pajisur për të shpjeguar konfliktin klasor krahasuar me mendimin kapitalist, i cili nuk zotëron një analizë krahasuese dhe as një strategji serioze për të afruar të varfrit e sektorit informal. Përgjithësisht, kapitalistët nuk ofrojnë një shpjegim sistematik për të ilustruar rënien e individëve të klasës së ulët dhe se si mund të ndryshohet sistemi për t’i ringritur ata.

Nuk duhet të nënvlerësojmë fuqinë e fshehtë të teorisë së integruar Marksiste në një kohë kur masat popullore të pashpresa po kërkojnë një pikëpamje botërore të bashkuar për të përmirësuar perspektivat e dëshpëruara ekonomike. Në një periudhë bumi ekonomik, nuk ka kohë për mendime të thella. Megjithatë, kriza ka prirje të mpreshtë nevojën mendore për rend dhe shpjegim të paqartësisë. Mendimi Marksist, i shfaqur në çfarëdolloj forme, mund të ofrojë – dhe e bën këtë – një shumëllojshmëri më të gjerë konceptesh për mbërthimin e

problemeve politike të kapitalizmit jashtë Perëndimit, krahasuar gjithmonë me kapitalizmin.

Përafrimet e Marksit në lidhje me kapitalin, sikurse ka vënë re kohët e fundit George Soros, janë shpesh më të ndërlikuara krahasuar me ata të Adam Smithit.⁷ Marksit e ka të qartë se “paraja dhe mallrat nuk përbëjnë në vetvete kapital, sikurse nuk përbëjnë kapital faktorët e prodhimit dhe mbijetesës. Të parat kanë nevojë për të dytat për t’u shndërruar në kapital”.⁸ Po ashtu ishte i vetëdijshëm se, nëse asetet shndërrohen në kapital duke ndërvepruar kështu nëpër tregje, prodhojnë vlerë të pakapshme për shqisat, por e cila mund të rrokët për të krijuar rentabilitet (përfitueshmëri). Sipas Marksit, pronësia ka qenë një çështje e rëndësishme sepse ishte e qartë se ata që zotëronin asetet, siguronin shumë më tepër se atributet fizike. Si rezultat, paketa intelektuale Marksiste ka lënë pas metoda të fuqishme antikapitaliste për të shpjeguar pse prona private do të vendosë domosdoshmërisht asetet në duart e të pasurve në kurriz të të varfërve.

Për ata që nuk e kanë vënë re ende, po grumbullohet një arsenal antikapitalizmi dhe antiglobalizmi. Sot, statistika të shumta u sigurojnë antikapitalistëve municionin që u nevojitet për të argumentuar se kapitalizmi përbën transferimin e pronësisë prej të varfrit tek i pasuri dhe se investimet private Perëndimore në vendet në zhvillim përbëjnë thjesht një përvetësim masiv të burimeve të këtyre vendeve nga shoqëritë shumëkombëshe. Mbase numri i makinave të bukura, shtëpive luksoze dhe qendrave tregtare të stilit Kalifornian mund të jetë shtuar në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste, por është rritur edhe numri i të varfërve. Kërkimet e zhvilluar nga Nancy Birdsall dhe Huan Luis Londonjo ilustrojnë se varfëria është zgjeruar shpejt dhe shpërndarja e të ardhurave është përkeqësuar gjatë dekadës së fundit.⁹ Sipas një Raporti të Zhvillimit Njerëzor të hartuar

nga Kombet e Bashkuara më 1999, prodhimi i brendshëm bruto i Federatës Ruse ka rënë me 41 për qind prej vitit 1990 deri më 1997, duke detyruar miliona njerëz që të kalojnë në sektorin informal. Jetëgjatësia e mashkullit rus është zvogëluar me katër vjet – në 58 vjeç. Raporti ia vë fajin tranzicionit drejt kapitalizmit dhe efekteve të globalizimit.

Këto kërkime na japin sinjale të forta paralajmëruese, por, po ashtu, po ndikojnë në krijimin e kushteve për shkurajimin e programeve të privatizimit dhe kapitalizmit global. Kështu pra, është thelbësore të njihen modelet e fshehura Marksiste, për t'u shtuar këtyre të fundit gjithë sa kemi mësuar gjatë këtij shekulli që prej vdekjes së Marksit. Tashmë mund të ilustrim se, megjithëse Marksit e kuptoi qartësisht se jeta ekonomike mund të krijohet paralelisht me ekzistencën fizike të aseteve – “prodhimet e mendjes njerëzore shfaqen si qenie të pavarura të rrethuara nga jeta”¹⁰ – ai nuk arriti të kuptonte se pronësia formale nuk ishte thjesht një instrument përvetësimi, por edhe një mekanizëm për të nxitur njerëzit në krijimin e kapitalit. Megjithëse analiza e Marksit në lidhje me mënyrën se si asetet bëhen të mrekullueshme dhe se si u shërbejnë përdorimeve më të gjera sociale duke u bërë të shkëmbyeshme është thelbësore për të kuptuar pasurinë, ai nuk arriti të parashikonte se në çfarë shkalle sistemet ligjore të pronësisë do të bëheshin themeltare për forcimin e vlerës së tregtimit.

Marksit e kuptoi më mirë se kushdo tjetër gjatë epokës së tij se, në ekonomi, nuk ka verbëri më të madhe sesa të shohësh burimet ekskluzivisht në kuadër të tipareve fizike të tyre. Ai ishte shumë i vetëdijshëm se kapitali përbënte një “substancë të pavarur... në të cilën paraja dhe mallrat ishin thjesht forma të tij dhe burime çlirimi të tij”.¹¹ Por, ai jetonte në një kohë kur ishte tepër herët për të kuptuar se si pronësia formale, përmes dokumenteve të përfaqësimit, mund t'i bënte këto burime të

kryenin funksione shtesë dhe të prodhonin vlerë shtesë. Si rrjedhojë, Marksi nuk arrinte të shihte se si zgjerimi i spektrit të atyre që përfitonin nga pronësia ishte në interes të të gjithëve. Titujt e pronësisë përbënin majën e dukshme të ajsbergut në rritje të pronësisë formale. Pjesa tjetër e ajsbergut përbën sot një infrastrukturë njerëzore për të nxjerrë potencialin ekonomik prej aseteve. Kjo është arsyeja pse Marksi nuk arrinte të kuptonte se pronësia formale përbënte procesin e nevojshëm të fiksimit dhe vënies në punë të kapitalit, se pa pronësinë individit nuk mund t'i jepte formë të këmbyeshme, likuide fryteve të punës së tij, formë e cila mund të diferencojë, kombinojë, ndahej dhe investojë për të prodhuar vlerë shtesë. Ai nuk e kuptonte se një sistem i mirë ligjor i pronësisë, sikurse një thikë ushtarake zvicerane, përmban shumë më tepër mekanizma sesa thjesht lama elementare e “pronësisë”.

Pjesa më e madhe e mendimeve të Marksit janë të dala mode sepse situata e sotme nuk është e njëjtë me atë të Evropës në kohën e Marksit. Kapitali potencial nuk është më privilegj për pakicën. Pas vdekjes së Marksit, Perëndimi arriti më në fund të hartojë një strukturë ligjore që i lejonte shumicës së njerëzve disponimin e pronësisë dhe mjeteve të prodhimit. Marksi me siguri që do të shtangej nëse do të shihte se masat gëluese të vendeve në zhvillim nuk janë proletarë të ligjshëm të shtypur, por sipërmarrës të vegjël informalë të shtypur, me një sasi të konsiderueshme asetesh.

Admirimi që kemi për sistemet e mira të pronësisë nuk duhet të na verbojë para faktit se, sikurse ka vënë re Marksi, këto sisteme mund të përdoren edhe për të vjedhur. Bota do të jetë gjithmonë e mbushur me peshkaqenë të aftë të përdorin dokumentet e pronësisë për të grabitur pasuri prej njerëzve që nuk dyshojnë gjë. Megjithatë nuk duhet dalë kundër sistemeve formale të pronësisë për një arsye të tillë, ashtu sikurse nuk

duhen ndaluar kompjuterët dhe automobilat sepse njerëzit i përdorin për të kryer krime. Nëse Marksi do të ishte gjallë dhe do të mund të shihte shpërndarjen e gabuar të burimeve që ka ndodhur në të dyja anët e ish Perdes së Hekurt, do të binte dakord se grabitja mund të ndodhë me ose pa pronësinë dhe se kontrollimi i vjedhjes varet më tepër nga ushtrimi i pushtetit se pronësia. Po ashtu, megjithëse Marksi ka dhënë një përkufizim specifik në lidhje me “vlerën e shtuar”, kuptimi nuk mund të jetë i pandryshueshëm. Njerëzit gjithmonë kanë arritur të prodhojnë vlerë shtesë: piramidat, katedralet, ushtritë e kushtueshme... sa për të përmendur disa shembuj. Qartësisht, pjesa më e madhe e vlerës së shtuar në Perëndim e ka zanafillën jo në kohën e punës të shpronësuar në mënyrë skandaloze, por në rrugën sipas së cilës pronësia i ka dhënë mendje mekanizmave me të cilët nxirret puna shtesë prej mallrave.

Sikurse të gjithë ne, Marksi u ndikua nga kushtet sociale dhe teknologjitë e kohës. Privimi i pronarëve të vegjël prej mekanizmave të mbijetesës, mundësia e sigurimit të të drejtave të pronës private përmes titujve feudalë, grabitja e tokave të përbashkëta, skllavërimi i popullsisë aborigjene, shtypja e të pushtuarve dhe “gjuetia për qëllime tregtare e lëkurave të zeza” në kohën e sistemit kolonial mund të kenë qenë parakushte për atë që Marksi quante “grumbullim primitiv i kapitalit”. Këto kushte vështirë se mund të përsëriten sot. Qëndrimet kanë ndryshuar – dhe ka mundësi për shkak të shkrimeve të vetë Marksit. Grabitja, skllavëria dhe kolonializmi nuk gëzojnë më miratimin qeveritar. Shumica e vendeve janë sot palë në traktate sikurse është Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, si dhe zotërojnë kushtetuta të cilat ofrojnë disponibilitet të njëjtë të të drejtave të pronësisë, duke i njohur si të drejta themelore të njerëzimit.

Për më tepër, sikurse vumë re në kreun 6, autoritetet e vendeve në zhvillim nuk kanë qenë fjalëpakë në akordimin e mundësisë për të pasur asete nga të varfrit. Pjesa dërrmuese e ndërtesave dhe bizneseve informale të qyteteve të Botës së Dytë dhe të Tretë mund të mos kenë tituj të rregullt, por qeveritë kanë pranuar ekzistencën e tyre (megjithëse në formë të heshtur) dhe marrëveshjet e pronësisë që lidhen me to. Në shumë vende në zhvillim, gjatë këtij shekulli, sipërfaqe të mëdha tokësore u janë dhënë fermerëve të varfër si pjesë e programeve të reformës agrare (megjithëse pa dokumentet pronësorë të përfaqësimit të nevojshëm për të krijuar kapital). Po ashtu, autoritetet e këtyre vendeve nuk kanë qenë mosdashës në rezervimin e buxheteve për çështje të pronësisë. Miliarda dollarë janë shpenzuar për aktivitete të lidhur me regjistrimin e pronësisë.

Pronësia e bën Kapitalin “Të Kapshëm për Mendjen”

Në këtë libër jam përpjekur të ilustroj se tashmë disponojmë prova të mjaftueshme për të arritur përparim në zbulim. Me këto prova mund të kalojmë përtej debatit të vjetër “e majta kundër së djathtës” në lidhje me pronësinë dhe mund të shmangim përballjen përsëri me betejat e vjetra. Pronësia formale është më tepër se thjesht pronësi. Sikurse vumë re në kreun 3, duhet parë si një proces i nevojshëm që u jep njerëzve mekanizmat për të përqendruar mendimin në ato aspekte të burimeve prej të cilëve mund të nxjerrin kapital. Pronësia formale është më tepër se një sistem titullarizimi, regjistrimi dhe shënimi në hartë i aseteve – është një instrument përfaqësimi i aseteve i menduar në një mënyrë të tillë që mendja njerëzore të punojë mbi ta për të nxjerrë vlerë shtesë. Për këtë arsye, pronësia formale duhet të jetë e disponueshme për të gjithë: për të afruar të gjithë brenda kontratës sociale ku mund të veprojnë për të rritur prodhueshmërinë e shoqërisë.

Ajo që e dallon një sistem të mirë ligjor të pronësisë është natyra e tij “e kapshme për mendjen”. Ky sistem merr dhe organizon njohuri në lidhje me regjistrimin e asetëve në forma të kontrollueshme. Ai grumbullon, integron dhe koordinon jo vetëm të dhënat në lidhje me asetet dhe potencialin e tyre, por edhe mendimet tona në lidhje me to. Me pak fjalë, kapitali rezulton nga aftësia e Perëndimit për të përdorur sistemet e pronësisë për të përfaqësuar burimet në një kontekst virtual. Vetëm në këtë pikë mendjet mund të takohen për të identifikuar dhe kuptuar thelbin e asetëve për njerëzimin.

Kontributi revolucionar i sistemit të integruar të pronësisë përbën zgjidhjen e një problemi themeltar njohjeje. Pesë shqisat tona nuk janë të mjaftueshme për të përpunuar realitetin e ndërlikuar të një tregu të gjerë, e aq më pak atë të një tregu global. Është e nevojshme që faktet ekonomike që lidhen me vetë ne dhe asetet që zotërojmë të shpërbëhen në formuesit e tyre, të cilët mund të rroken lehtësisht nga mendja jonë. Këtë e bën një sistem i mirë i pronësisë – ai i vendos asetet në një pozicion të tillë që na lejon të bëjmë dallimin mes ngjashmërive, dallimeve dhe pikave lidhëse mes tyre. Sistemi i fikson përmes dokumenteve të përfaqësimit, të cilët lejojnë gjurmimin në kohë dhe hapësirë. Po ashtu, ai i lejon asetet të bëhen likuide duke i përfaqësuar para mendjes sonë në mënyrë që të mund të kombinohen, ndahen dhe mobilizohen për të prodhuar përzjerje me vlerë më të lartë. Kjo aftësi e pronësisë për të përfaqësuar aspektet e asetëve në një formë të tillë që na lejon t’i rikombinojmë për t’i bërë më të përdorshme, përbën bazën e rritjes ekonomike, meqë rritja përbën sigurimin e produkteve me vlerë të lartë prej inputeve me vlerë më të ulët.

Një sistem i mirë ligjor i pronësisë përbën një metodë që na lejon të kuptojmë njëri-tjetrin, të vendosim lidhje dhe të sintetizojmë njohuritë në lidhje me asetet në mënyrë të tillë

që të përforcohet prodhueshmëria. Është një mënyrë për të përfaqësuar realitetin, e cila na lejon të kapërcejmë kufizimet e shqisave tona. Dokumentet përfaqësues të pronësisë, të përpiluar siç duhet, na lejojnë të dallojmë potencialin ekonomik të burimeve në mënyrë që atë që mund ta bëjmë me to, ta bëjmë më mirë. Këto dokumente nuk janë “thjesht letra”: përbëjnë mekanizma ndërmjetës që japin njohuri të dobishme në lidhje me gjëra që nuk janë të pranishme në mënyrë të dukshme.

Regjistrat e pronësisë i drejtojnë njohuritë tona mbi gjërat për nga pika finale, “sikurse shigjetari drejton shigjetën”, për të huazuar fjalët e Thomas Aqkuinas.¹² Duke përfaqësuar aspektet ekonomike të gjërave që zotërojmë dhe duke i ndarë ato nëpër kategori të kapshme nga mendja, dokumentet e përshtatshme reduktojnë kostot e menaxhimit të asetëve dhe mundësojnë rritjen e vlerës në mënyrë shpërpjesëtimore. Nocioni sipas të cilit vlera e sendeve mund të rritet duke reduktuar kostot për njohjen dhe përfshirjen e tyre nëpër transaksione, përbën një nga kontributet më të lartë të fituesit të çmimit Nobel, Ronald Coase. Në traktatet e tij, të quajtur “Natyra e Firmës”, Koase shpallte se kostoja e transaksioneve mund të reduktohet shumë brenda kontekstit të kontrolluar dhe të koordinuar të firmës.¹³ Në këtë kuptim, sistemet e pronësisë janë si firmat e Coase – mjedise të kontrolluar për reduktimin e kostove të transaksioneve.

Aftësia e pronësisë për të zbuluar kapitalin, i cili fshihet brenda asetëve që grumbullojmë, lind prej traditave më të mira intelektuale të kontrollit të mjedisit për të arritur përparim. Për mijëra vjet, njerëzit më të zgjuar na kanë thënë se jeta ka shkallë të ndryshme realiteti, shumë prej të cilave janë të padukshme dhe, vetëm duke ndërtuar mekanizma përfaqësimi, do të jemi në gjendje t’i rrokim këto realitete. Në analogjinë e famshme të Platonit, krahasohemi me të burgosurit e lidhur me zinxhirë

brenda një shpelle, me kurriz nga hyrja e saj, në mënyrë që të shohin vetëm hijet e botës që errësojnë murin. E vërteta që ngre ky ilustrim është se shumë gjëra që drejtojnë fatin tonë nuk janë të dukshme. Për këtë arsye qytetërimi ka punuar shumë për të krijuar sisteme përfaqësimi për të arritur dhe rrokur atë pjesë të realitetit tonë që është virtuale dhe për ta paraqitur me parametra që mund të kuptohen.

Sikurse ka thënë Margaret Boden: “Disa prej krijimeve më të rëndësishme të njeriut kanë qenë sistemet e reja të përfaqësimit. Këto sisteme përfshijnë simbole formale, sikurse janë numrat arabë (pa harruar zeron), formulat kimike apo pentagramet dhe notat gjysmë të plota e katërshe të përdorura nga muzikantët. Gjuhët e programimit [kompjuterik] përbëjnë një shembull më të vonë”.¹⁴ Sistemet e përfaqësimit, si matematika dhe pronësia e integruar, na ndihmojnë të manipulojmë dhe rregullojmë faktet e ndërlikuara të botës në mënyrë të tillë që të arrijmë ta kuptojmë dhe të krijojmë kushte komunikimi në lidhje me çështje të caktuara, komunikim i cili nuk do të mund të kryhej ndryshe. Këto sisteme janë quajtur “zgjerime protetike të mendjes” nga filozofi Daniel Dennett.¹⁵ Përmes përfaqësimit, modelojmë aspektet kyçe të botës në mënyrë të tillë që ta kuptojmë më mirë këtë të fundit. Filozofi John Searle ka theksuar se, përmes marrëveshjeve njerëzore, “mund të caktojmë një status të ri për një fenomen të caktuar, status i cili zotëron një funksion shoqërizimi i cili nuk mund të përmbushet vetëm përmes tipareve të drejtpërdrejtë fizikë të fenomenit në fjalë”.¹⁶ Kjo është shumë e përafërt me funksionin që kryen pronësia ligjore: Ajo u cakton asetëve, përmes kontratave sociale të një universi konceptual, një status që i lejon të kryejnë funksione të prodhimit të kapitalit.

Nocioni sipas të cilit ne organizojmë realitetin në një univers konceptual, është në qendër të filozofisë botërore. Filozofi

francez Michel Foucault e ka etiketuar “region mediane”, që krijon një sistem çelësash (codes fondamentaux), të cilët përbëjnë rrjetin sekret në të cilin shoqëria vendos kufirin e përhershëm zgjerues të potencialit të saj (les conditions de possibilite).¹⁷ Unë e shoh pronësinë formale si një lloj çelësi hapës që na lejon të zgjerojmë potencialin e aseteve që grumbullojmë dhe, në çdo herë, kapitali rritet. Po ashtu kam huazuar nocionin e Botës 3 të Karl Popper – një realitet i veçuar nga Bota 1 e objekteve fizike dhe Bota 2 e gjendjes mendore – në të cilën, produktet e mendjeve tona krijojnë një ekzistencë autonome, e cila ndikon mbi mënyrën e përballjes me realitetin fizik.¹⁸ Pikërisht në këtë botë konceptuale na dërgon pronësia formale – një botë ku Perëndimi organizon njohurinë në lidhje me asetet dhe nxjerr prej tyre potencialin për të prodhuar kapital.

Dhe kështu, pronësia formale është një gjë e mrekullueshme, shumë më e madhe se vetë pronësia. Ndryshe nga tigrat dhe ujqërit, të cilët nxjerrin dhëmbët për të mbrojtur territorin, njeriu, i cili fizikisht përbën një kafshë më të dobët, ka përdorur mendjen për të krijuar një mjedis ligjor – pronësinë – për të mbrojtur territorin e tij. Sistemi i përfaqësimit i krijuar nga Perëndimi për të zgjidhur pretendimet territoriale krijoi një jetë të vetën, duke ofruar njohuritë dhe rregullat bazë për fiksimin dhe realizimin e kapitalit dhe askush nuk e kuptoi çfarë po ndodhte në tërësi.

Armiqtë e Përfaqësimit

Në mënyrë ironike, armiqtë e kapitalizmit kanë qenë më të vetëdijshëm për origjinat virtuale të kapitalit krahasuar me vetë kapitalistët. Pikërisht aspektin virtual të kapitalit ata e shohin si shumë kërcënues dhe të rrezikshëm. Viviane Forrester, në librin e saj më të shitur “L’Horreur economique”, sulmon duke thënë: “Kapitalizmi ka pushtuar hapësirën fizike dhe virtuale...

Ai ka konfiskuar dhe ka fshehur pasuritë si kurrë më parë; këtë e ka bërë duke ia fshehur njerëzve përmes simboleve. Simbolet janë bërë subjekt i shkëmbimeve abstrakte që tashmë ndodhin vetëm në botën virtuale”.¹⁹ Në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme, Forrester është pjesë e një tradite të vjetër që është ndier rehat me përfaqësimet ekonomike të realitetit virtual – ato “hollësi metafizike” që sipas Marksit nuk ishin të nevojshme për kuptimin dhe grumbullimin e pasurisë.²⁰

Frika nga virtualizmi i kapitalit është e kuptueshme. Sa herë që qytetërimi nxjerr një mënyrë të re të përdorimit të dokumenteve të përfaqësimit për të menaxhuar botën fizike, njerëzit bëhen të dyshimtë. Kur Marco Polo u kthye nga Kina, ai shtangu evropianët me lajmin se kinezët përdornin kartëmonedha dhe jo ar, gjë që u quajt menjëherë alkimi. Bota Evropiane nuk i përdori kartëmonedhat para shekullit të 19-të. Modelet e fundit të parasë së prejardhur – paraja elektronike, transferimet kablore dhe kartat e kreditit tashmë të kudondodhura – deshën gjithashtu kohë që të pranoheshin. Teksa përfaqësimi i vlerës bëhet më pak i rëndë dhe më shumë virtual, njerëzit bëhen dyshues në mënyrë të kuptueshme. Format e reja të pronësisë (si pengu hipotekar) mund të ndikojnë në formimin e kapitalit shtesë, por këto e bëjnë më të ndërlikuar kuptimin e jetës ekonomike. Dhe kështu njerëzit janë të prirur të ndihen më rehat me imazhin e punonjësve fisnikë dhe të djersitur të muralëve sovjetikë dhe latino-amerikanë, të cilët mundohen nëpër fusha ose vënë në punë makineritë e tyre dhe ndihen më rehat se kapitalistët që mekanizojnë dhe nënshkruajnë tituj, aksione dhe bono në realitetin virtual të kompjuterëve të tyre. Është njëlloj sikur puna me akte përfaqësimi të ndryjë më shumë duart se puna me pisllek dhe graso.

Sikurse gjithë sistemet e përfaqësimit – nga gjuha e shkruar, te paraja dhe simbolet kompjuterike – dokumentet

e pronësisë janë konceptuar nga shumë intelektualë si një instrument mashtrimi dhe shtypjeje. Qëndrimet negative ndaj dokumenteve të përfaqësimit kanë qenë themele të fuqishëm në krijimin e ideve politike. Filozofi francez, Jacques Derrida, kujton në “De la Grammatologie” se si Jean-Jacques Rousseau argumentonte se shkrimi kishte qenë një burim i pabarazisë njerëzore. Sipas Rousseau, ata që kishin njohuri shkrimi mund të kontrollonin ligjet e shkruar dhe dokumentet zyrtarë, dhe kështu, mund të kontrollonin fatin e njerëzve. Claude Levi-Strauss ka argumentuar se “funksioni themeltar i komunikimit të shkruar është thjeshtimi i nënshtrimit”.²¹

Jam po aq i vetëdijshëm sa çdo kapitalist se si sistemet e përfaqësimit, sidomos ata të kapitalizmit, janë përdorur për të shfrytëzuar e pushtuar dhe kanë lënë shumicën në mëshirë të pakicës. Në këtë libër kam diskutuar se si dokumentet zyrtarë janë përdorur për nënshtrim tërësor. E megjithatë, shkenca e përfaqësimit është një tra mbajtës i shoqërisë bashkëkohore. Shkrimi, paraja elektronike, simbolet kompjuterike dhe dokumentet e pronësisë nuk do të zhduken prej hallakatjeve dhe tërbimeve. Përkundrazi, duhet të mundësojmë që sistemet e përfaqësimit të bëhen më të thjeshta dhe më transparente dhe të punojmë shumë që njerëzit t’i kuptojnë. Përndryshe, aparteidi ligjor do të vazhdojë dhe mekanizmat e krijimit të pasurisë do të mbeten në duart e atyre që jetojnë jashtë kambanës së qelqtë.

A ka lidhje me kulturën korrrja e suksesit në Kapitalizëm?

Mendoni për Bill Gates, sipërmarrësi më i suksesshëm dhe më i pasur i botës. Duke lënë mënjanë gjenialitetin e tij personal, çfarë lidhje mund të ketë pasur suksesi me të kaluarën kulturore dhe “etikën e tij Protestante”? Dhe çfarë ndikimi ka pasur në këtë drejtim sistemi ligjor i pronësisë së Shteteve të Bashkuara?

Sa programe të rinj kompjuterikë mund të kishte krijuar pa pasur patenta për t'i mbrojtur? Sa marrëveshje dhe projekte afatgjatë mund të kishte zbatuar pa kontratat imponuese? Sa do të kishte rrezikuar ai në fillim nëse nuk do të kishte sistemet e përgjegjësive të kufizuar dhe politikat e sigurimeve? Sa kapital do të kishte grumbulluar pa regjistrat e pronësisë, në të cilët fiksohet dhe ruhet ky kapital? Sa burime do të kishte mobilizuar pa dokumente përfaqësimi likuide të pronësisë? Sa njerëz të tjerë do të kishte bërë milionerë pa opsionet për shpërndarje të aksionit? Çfarë niveli të ekonomisë së shkallës do të mund të siguronte nëse do të kishte vepruar mbi industri shtëpiake të shpërndara të cilat mund të kombinoheshin? Si do të mund t'i kalonte të drejtat e perandorisë së tij te fëmijët dhe kolegët pa mundësinë e trashëgimisë?

Nuk mendoj se Bill Gates apo ndonjë sipërmarrës tjetër i Perëndimit do të kishte qenë i suksesshëm pa një tërësi sistemesh të të drejtave të pronësisë bazuar mbi një kontratë sociale të fortë dhe të mirëintegruar. Përlësisht jam i mendimit se, para se ndonjë brahman, i cili jeton brenda kampanës së qelqtë, të na shpjegojë se për të qenë i suksesshëm nevojiten një tërësi veçorish kulturore, duhet që fillimisht të vështrojmë se çfarë ndodh kur vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste themelojnë sisteme të të drejtave të pronësisë të cilat janë në gjendje të krijojnë kapital për të gjithë.

Përgjatë historisë, njerëzit kanë ngatërruar efikasitetin e mekanizmave të përfaqësimit që kanë trashëguar për të krijuar vlerë shtesë, me vlerat e trashëguara të kulturës së tyre. Ata harrojnë se shpesh, ai që i jep përparësi një grupi të caktuar njerëzish është përdorimi i veçantë i sistemit të përfaqësimit të themeluar nga një tjetër kulturë. Për shembull, Veriorëve iu desh të kopjonin institucionet ligjore të Romës së lashtë për t'u organizuar, si dhe të mësonin alfabetin Grek dhe simbolet e

sistemet numerike arabe për të bartur të dhëna dhe për të kryer llogaritje. Kështu që sot, shumë pak vetë janë të vetëdijshëm për përparësinë që sistemet formale të pronësisë u kanë dhënë shoqërive Perëndimore. Si rezultat, shumë Perëndimore janë prirur të besojnë se ajo që karakterizon kapitalizmin e tyre të suksesshëm, është etika e punës që kanë trashëguar apo ankthi ekzistencial i krijuar nga besimet e tyre – pavarësisht nga fakti se njerëzit e gjithë botës punojnë rëndë kur munden dhe përvujtëria e tyre ekzistenciale apo nënat autoritare nuk janë monopolet Kalviniste apo Hebraike. (Unë jam po aq i zellshëm sa çdo Calvinist i historisë, sidomos të dielave; dhe, për sa u përket nënave imponuese, nëna ime në Peru është po aq e mirë sa çdo grua në Nju Jork). Kështu, një pjesë e madhe e programit shpjegues të nevojshëm për të qartësuar pse kapitalizmi dështon jashtë Perëndimit, mbetet e fshehur pas supozimeve të pazbuluara dhe të patestueshme të quajtura “kulturë”, efekti kryesor i të cilave është të mundësojnë që shumica e atyre që jetojnë nëpër vatrat e privileguara të shijojnë një ndjenjë e të qenit superior.

Një ditë këto argumente kulturorë do të bien poshtë në saje të efektit të institucioneve të mira politike dhe ligjit të pronësisë. Ndërkohë, sikurse ka vënë re Fareed Zakaria i “Punëve të Jashtme”:

Kultura është e nxehtë. Me kulturë nuk kam parasysh Vagnerin dhe Ekspresionizmin Abstrakt – këta kanë qenë gjithmonë tërheqës – por kulturën si shpjegim të fenomeneve sociale... Shpjegimet kulturore janë ende të parapëlqyera sepse intelektualët i kanë për zemër. Ato u japin vlerë njohurive të detajuara mbi historitë e vendeve, të cilat intelektualët i kanë me shumicë. Këto i shtojnë një ndjenjë misteri dhe ndërlikueshmërie studimit të

shoqërive... Por vetë kultura mund të formohet dhe të ndryshohet. Pas kaq shumë qëndrimesh, shijesh dhe preferencash kulturore veprojnë forcat politike dhe ekonomike që i kanë formuar ato.²²

Kjo nuk do të thotë se kultura nuk ka vlerë. Të gjithë njerëzit e botës kanë preferenca, aftësi dhe tipare specifike të sjelljes, çka përbën kulturën. Sfida e vërtetë është të përcaktosh se në çfarë shkalle këto karakteristika përbëjnë identitetin e vërtetë dhe të pandryshueshëm të një populli dhe cilat karakteristika përcaktohen prej kufizimeve ekonomike dhe ligjore. A ka ardhur zaptimi informal i pasurive të patundshme në Egjipt dhe Peru si pasojë e traditave të lashta e të rrënjësura nomade të arabëve, si dhe e zakonit të gjerë të Keçuasve për të mbjellë bimë në nivele të ndryshme vertikale të Andeve? Apo kjo ndodh për faktin se në Egjipt dhe Peru nevojiten më tepër se 15 vjet për të siguruar të drejta ligjore të pronësisë në një tokë shkretinore? Sipas eksperiencës sime, zaptimi ka ardhur kryesisht për arsyen e dytë. Kur njerëzit të kenë në dispozicion një mekanizëm të rregullt për të arritur një marrëveshje për tokën sipas një forme që pasqyron kontratën sociale, ata do të ndër marrin rrugën ligjore dhe vetëm një pakicë do të vazhdojë të këmbëngulë me përvetësimin informal, sikurse ndodh shpesh. Një pjesë e mirë e sjelljes që sot shpjegohet me trashëgiminë kulturore nuk është rezultat i pashmangshëm i tipareve etnike dhe idiosinkratike të popullit, por rezultat i vlerësimit të tyre racional të kostove dhe përfitimeve relative të përfshirjes në sistemin ligjor të pronësisë.

Pronësia ligjore u jep forcë individëve të çdo kulture dhe dyshoj shumë se pronë në vetvete bie drejtpërdrejt në kundërshti me ndonjë kulturë në tërësi. Emigrantët vietnamezë, kubanë dhe indianë kanë pasur shumë pak probleme për t'u përshtatur

me ligjin amerikan të pronësisë. Nëse hartohet si duhet, ligji i pronësisë mund të kalojë mbi kulturat për të rritur besimin mes tyre dhe, në të njëjtën kohë, mund të pakësojë kostot e binjakëzimit të sendeve dhe mendimeve.²³ Pronësia ligjore vendos normat e këmbimit mes kulturave të ndryshme dhe u jep atyre një themel ngjashmërisht ekonomike, përmes të cilit të mund të kryejnë biznes me njëra-tjetrën.

E vetmja mundësi

Jam i bindur se kapitalizmi ka humbur rrugën në vendet në zhvillim dhe ato ish-komuniste. Kjo nuk është e drejtë. Ai ka humbur lidhjet me ata që duhet të përbëjnë përfaqësuesit më të mëdhenj të tij dhe, në vend që të jetë një kauzë që premtonte mundësi për të gjithë, kapitalizmi shfaqet gjithnjë e më shumë si lajtmotivi i një shoqërie vetëshërbyese biznesmenësh dhe i teknokracive të tyre. Shpresoj që ky libër të ketë përçuar bindjen time se kjo gjendje është relativisht e lehtë të korrigjohet – kjo do të thotë se qeveritë duhet të jenë të prirura të pranojnë këto fakte:

1. Gjendja dhe potenciali i të varfërve duhet të dokumentohen më mirë.
2. Të gjithë njerëzit janë të aftë të kursejnë.
3. Çfarë u mungon të varfërve janë sistemet e integruara të pronësisë të afta të shndërrojnë punën dhe kursimet e tyre në kapital.
4. Mosbindja civile dhe organizatat mafioze të sotme nuk përbëjnë fenomene marginale, por kanë ardhur si rezultat i miliarda njerëzve që marshojnë prej jetës së organizuar në shkallë të vogël, drejt jetës së organizuar në shkallë të gjerë.

5. Në këtë kontekst, të varfrit nuk përbëjnë problemin, por zgjidhjen.
6. Zbatimi i një sistemi pronësie i cili krijon kapital, përbën një sfidë politike pasi përfshin vendosjen e lidhjeve me njerëzit, rrokjen e kontratave sociale dhe rindërtimin e sistemit ligjor.

Me fitoren mbi komunizmin, programi i vjetër i kapitalizmit për përparim ekonomik ka arritur në fund dhe ka nevojë për një tërësi të re angazhimesh. Nuk ka kuptim të vazhdohet të bëhet thirrje për ekonomi të hapura pa u përballur me faktin se reformat ekonomike që po ndodhin, hapin dyert vetëm për elita të vogla dhe të globalizuara, duke lënë jashtë pjesën më të madhe të njerëzimit. Tani për tani, globalizimi kapitalist merret vetëm me ndërlidhjen e elitave që jetojnë brenda kambanës së qelqtë. Për të hequr kambanën e qelqtë dhe për të eliminuar apartheidin e pronësisë, nevojitet të shkohet përtej kufijve ekzistues të ekonomisë dhe ligjit.

Unë nuk jam një kapitalist i thekur. Nuk e kam kapitalizmin bindje. Për mua kanë më tepër rëndësi liria, dhembshuria për të varfrit, respekti i kontratës sociale dhe mundësitë e barabarta. Por, tani për tani, për të arritur këto qëllime, kapitalizmi është e vetmja mundësi. Është sistemi i vetëm i njohur që na ofron mekanizmat për të krijuar vlerë masive shtesë.

Unë dashuroj faktin që jam nga Bota e Tretë sepse ajo përfaqëson këtë sfidë të mrekullueshme – atë të arritjes së një tranzicioni drejt sistemit kapitalist të tregut i cili respekton dëshirat dhe bindjet e njerëzve. Kur kapitali të jetë i suksesshëm jo vetëm në Perëndim, por edhe gjetkë, do të mund të kalojmë kufijtë e botës fizike dhe të lartësojmë mendjet drejtë së ardhmes.


SHTOJCA

FIGURA SH.1
Haiti (popullsia: 7 Milionë)

SA ËSHTË KAPITALI I VDEKUR?

5.2 MILIARDË US\$ KAPITAL I VDEKUR

Në pronësi të 82% të popullsisë



Me fjalë të tjera, 5.2 miliardë us\$ kapital informal do të thotë:


- 4 herë më i madh se gjithë asetet e 123 ndërmarrjeve më të mëdha publike ligjore
- 9 herë më i madh se kapitali i ndërmarrjeve më të mëdha publike në Haiti, të cilat do të mund të çliroheshin nëpërmjet privatizimit
- 11 herë më i madh se të gjitha kursimet dhe depozitat kohore në bankat tregtare në Haiti, 1995
- 158 herë më i madh se vlefia e investimeve direkte të huaja në Haiti deri në 1995.

FIGURA SH. 2
Egjipt (Popullsia 63 milionë)

SA ËSHTË KAPITALI I VDEKUR?

241.4 MILIARDË US\$ KAPITAL I VDEKUR

Në pronësi të 85% të popullsisë



Me fjalë të tjera, 241.4 miliardë US\$ kapital informal do të thotë:

- 6 herë më i madh se të gjitha kursimet dhe depozitat kohore në bankat tregtare në Egjipt.
- 13 herë më i madh se rezervat neto të huaja të grumbulluara deri në 1996.
- 16 herë më i madh se investimi i grumbulluar në asetet ligjore të bëra nga firmat private të tërhequra nga mjetet nxitëse që ka zbatuar qeveria e Egjiptit nëpërmjet Ligjit për Investimet.
- 30 herë më i madh se vlera e tregut e 746 kompanive të regjistruara në Rezervën e Shkëmbimit të Kajros në përgjigje të mjeteve nxitëse të dhëna nga Ligji për Tregun e Kapitalit.
- 55 herë më i madh se vlefata e investimeve direkte të huaja në Egjipt deri në 1996.
- 116 herë më i madh se vlera e 63 ndërmarrjeve publike të privatizuara midis 1992 e 1996.

FIGURA SH. 3
Tipet e informalitetit urban në Lima



FALËNDERIME

Askush nuk e shkruan i vetëm një libër. Kam përfituar nga informacionet, opinionet, nxitja dhe mbështetja e shumë njerëzve – janë aq shumë, saqë është e pamundur t'i falënderoj të gjithë individualisht. Por janë disa, pa të cilët ky libër nuk do të ishte kurrë ai që është, dhe kam dëshirë t'ua bëj falënderimet e mia në formë të shkruar.

Së pari, dua të falënderoj kolegët e mi të Institutit për Liri dhe Demokraci (ILD) në Lima, Peru, të cilët më kanë shoqëruar vazhdimisht në këtë përpjekje për të krijuar një sistem tregu jodiskriminues, ku ligji ndihmon të gjithë të kenë mundësi përparimi. Idetë e këtij libri mbështeten në fakte dhe të dhëna të cilat janë zbuluar gjatë punës në terren që ka zhvilluar ILD, përmes projekteve anembanë botës. Unë me të vërtetë që kam qëndruar mbi supet e tyre. Manuel Mayorga La Torre, drejtuesi operativ, vuri në plan eksperiencën e tij, tamam si një inxhinier projektues i një impianti energjetik, duke planifikuar dhe organizuar gjithë projektet tona, ditë pas dite, deri në detaj. Luis Morales Bayro është ekonomisti kryesor i ILD, i cili ka mbikëqyrur kërkimet dhe analizat kosto-fitim në vendet ku kemi punuar. Puna e tij ka qenë thelbësore për suksesin tonë në identifikimin e kostove të fshehura të ligjit dhe institucioneve. Luisi u ndihmua nga Mario Galantini dhe u mbështet, sipas nevojave, nga Vittorio Corvo.

Për sa i përket pjesës ligjore, kam dy të besuarit dhe kolegët e mi të dashur për 15 vjet: Ana Lucia Camaiora drejton skuadrat ligjore të ILD dhe është përgjegjëse për zbulimin e gjithë pasqyrës ligjore. Ajo mbështetet drejtpërdrejt nga Maria del Carmen

Delgado, analistja jonë ligjore kryesore. Ato janë mendjet më të zgjuara që njoh për sa i përket pluralizmit ligjor. Ato kuptojnë jo vetëm ligjin, por edhe zbatimet e tij. Përpyekjet e tyre mbështeten nga shumë avokatë të ILD, ndër të cilët heronjtë kryesorë që kanë ndihmuar në këtë libër janë Gustavo Marini, Jackeline Silva, Luis Aliaga dhe Guillermo Garcia Montufar. Ndhimësi kryesor teknik është Daniel Herencia, skuadra e të cilit, që përfshin Javier Roblesin dhe David Castillon, ka ngritur sistemin kompjuterik në terren. Elsa Jo drejton administratën e ILD dhe është ndihmuar nga llogaritarja kryesore, Eliana Silva dhe pjesa tjetër e stafit të saj.

Së dyti, janë ata që siguruan themelet intelektuale që më kanë lejuar të përpunoj informacionin e siguruar. Askush nuk më ka qëndruar më pranë gjatë sagës së shkrimit të librit sesa Duncan Macdonald, miku dhe udhërrëfyesi im kozmik nga Skocia. Ka qenë Dankani që më ka njohur me shkencën njohëse, sidomos me kërkimet që po kryhen mbi teorinë e mendjes. Për fatin tim të mirë, kam qenë në gjendje të përdor ato që lexova për të analizuar rezultatet e punës në terren. Pata marrë mësim nga antropologu amerikan, Douglaz Uzzell, në lidhje me dobinë që do të kishte në punën time aftësia antropologjike e “vëzhgimit pjesëmarrës”, ndërsa profesori i jurisprudencës në Universitetin e Georgetown, Warren Schwartz, më ka mësuar në lidhje me zbatimin e parimeve ekonomike në analizën e ligjit. Por ishte Dankani ai që më mësoi se si filozofët e mendjes mund të më ndihmonin për të rrokur lidhjet që kisha kërkuar mes pronës dhe zhvillimit. Diskutimi ynë në lidhje më mënyrën sipas së cilës njerëzit mund të shndërrojnë mjedisin e tyre në një zgjerim të mendjes kanë qenë thelbësore për mua, për të kuptuar se si krijohet kapitali modern. Kur ndihesha i turbulluar, i ngecur në një kënd intelektual, apo kur endesha në errësirë, Duncan më shpëtonte.

Po ashtu, dëshiroj të falënderoj filozofen gjermane, Dorothee Kreuzer për mësimet që më ka dhënë në lidhje me finesën e post-strukturalizmit francez, sidomos Jaques Derrida dhe Michel Foucault. Nga Derrida kam mësuar se kategoritë e një kulture mund të përdoren për të shpjeguar një kulturë tjetër në një mënyrë të tillë që të gjithë ta kuptojmë – pa dhunuar karakterin unik të kulturës. Në këtë mënyrë kam qenë në gjendje të mësoj më mirë se si mund të integroheshin në mënyrë të suksesshme marrëveshjet informale të pronësisë brenda ligjit formal të pronësisë. Nga Foucault kam mësuar themelet e “arkitekturës sekrete” që lidh të padukshmen me të dukshmen dhe po ashtu, në saje të shkrimeve të tij, kam mësuar se si një sistem i mirë përfaqësimi rrit “la condition de possibilite” për gjithë njerëzimin. Ndjenja që kisha në lidhje me fuqinë ekonomike dhe thelbin e dokumenteve të përfaqësimit u fuqizua edhe më tej nga leximet semiotike, kryesisht të Umberto Ekos dhe Ferdinand de Saussure, dhe ato filozofike të mendjes, kryesisht nga punimet e John Searle dhe Daniel Dennett.

Por ka qenë miku dhe kolegu im Mariano Cornejo i cili ka bërë të mundur që idetë e mia të kalojnë testin e ndeshjes në tokë. Sado e zgjuar dhe elegante të jetë një ide, ajo nuk mund të përfshihet brenda një projekti të ILD nëse nuk zotëron dy cilësi themeltare: të jetë funksionale dhe e zbatueshme nga njerëz shumë të zakonshëm. Nëse kam të drejtë, ai thjesht buzëqesh dhe më thotë se kam ngecur në diçka evidente (“No es problema, no es problema”); kur e kam gabim, më drejton atje ku duhet.

Pastaj vijnë ata, pa frymëzimin, nxitjen dhe mbështetjen e të cilëve nuk do të kisha qenë kurrë në gjendje të shkruaja këtë libër. Pas 12 vjetësh si ortak, Stephan Schmidheiny është bërë një mik i dashur. Si intelektual dhe filantrop, po ashtu afarist shumë i suksesshëm, Stephan ka ndikuar në shumë drejtime

në lidhje me suksesin e ILD. Ai ka përforcuar përpjekjet tona në lidhje me gjetjen e mënyrave për t'u siguruar mundësi atyre të cilëve këto u janë privuar në mënyrë të padrejtë. Po ashtu ka fuqizuar bindjen se tregjet globale janë të rrezikshme pa ligje globale. Por kryesisht, Stepan ka ndikuar mbi punën e ILD duke këmbëngulur në lidhje me nevojën për realizëm: Nëse idealizmi nuk është praktik, idealet mbeten vetëm ideale dhe nuk janë të dobishme për ata të cilëve ne kërkojmë t'u japim ndihmesë. Një tjetër mik i rëndësishëm dhe i dashur është Lawrence Chickering, një intelektual i shkëlqyer nga San Francisko, i cili ka ndihmuar ILD për nisjen e shumë projekteve dhe aventurave konceptuale, ndërkohë që më ka ndihmuar personalisht përmes këshillave të dhembshura "baritore".

Nuk mund të harroj miqtë e mi të Agjencisë për Zhvillim Ndërkombëtar: Brian Atwood, Dick McCall, Jim Michels, Norma Parker, Aaron Williams, Paula Goddard dhe sidomos njerëzit e tmerrshëm të Departamentit për Amerikën Latine dhe Karaibet, Mark Schneider, Carl Leonard, Michael Deal, Timothy Mahoney, William B. Baucom, Donald Drga dhe Jolyne Sanjak. Ata jo vetëm që mbështetën dhe nxitën ILD gjatë viteve, por na krijuan shumë mundësi. Dhe, kur gjendesha përballë një problemi organizativ, miku im i vjetër John Sullivan, i cili drejton Qendrën për Sipërmarrje Private Ndërkombëtare, më shpjegoi se si institucionet amerikane do ta zgjidhnin këtë problem. Po ashtu më ka mësuar se paketa e duhur e institucioneve mund të shndërronte pozitat konfliktuale në zgjidhje funksionale dhe fitimprurëse. Nga miku im Bob Litan i Institucionit Brookings, kam mësuar jo vetëm se si ligji ndikon mbi sjelljen ekonomike, por edhe se ekzistojnë mësimet të dobishme për pjesën tjetër të botës në lidhje me mënyrën se si revolucioni financiar në Shtetet e Bashkuara rriti formimin e kapitalit. Një ditë korriku të vitit 1999, Bobi erdhi në shtëpinë time në Lima dhe më tha:

“Kam gjetur një titull pronësie të mrekullueshëm për librin tënd – “Misteri i Kapitalit”. Edhe për këtë e falënderoj.

Një falënderim i veçantë i shkon Fondacionit Smith Richardson, i cili përmes granteve ka ndihmuar shumë në nxjerrjen e këtij libri. Fondacioni është një mik i vjetër dhe besnik i cili, në fillim të viteve '90, kur ILD po qëllohej e bombardohej, na siguroi një makinë të blinduar, duke na dhënë kështu mundësinë të vazhdonim punën tonë.

Po ashtu i jam mirënjohës Harold Krent, Saul Levmore, Rick Messick, Tom Romero dhe Larry Stay për përpjekjet herkuliane që kanë kryer në kërkimet në lidhje me pronësinë në Shtetet e Bashkuara. Gjithashtu i jam mirënjohës miqve të mi të Regjistrisë Tokësore të Madhërisë së Saj në Londër – sidomos John Manthorpe dhe Christofer Westit – të cilët më dhanë librat e duhur që më ndihmuan të kuptoj evolucionin e pronësisë Britanike. Monika Bergmeier dhe Klaus Joachim Grigoleit më kanë ndihmuar të hetoj në lidhje me fillimet e pronësisë gjermane, ndërkohë që Hans-Urs Vili më ka njohur me fillimet e pronësisë zvicerane, duke më dhënë mësim mbi konvertimin e ligjit Romak në traditat zvicerane dhe gjermane nga një sistem i sertë rregullash, në një sistem më të përshtatur për njerëzit. Peter Schaefer, miku im në Uashington D.C., më ka ndihmuar me mendimet, vërejtjet dhe vëzhgimet duke më njohur me përafrime të reja për punën tonë.

Merran Van Der Tak më ka ndihmuar të hetoj marrëdhëniet mes të drejtave të pronësisë dhe zhvillimit të shërbimeve publike. Oskar Beasley më ka mësuar se si funksionon titullarizimi dhe sigurimi i aseteve të pasurisë së patundshme. Robert Freedman thelloi njohuritë e mia të cekëta në lidhje me Marksizmin. Lee dhe Alexandra Benham më kanë ndihmuar shumë në hartimin e një strukture për librin.

Po ashtu libri ka përfituar nga përpjekjet e organizatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare për hartimin dhe zbatimin e projekteve vendore me qëllim kapitalizimin e të varfërve. Mundësia për të grumbulluar të dhëna e për të analizuar institucionet dhe legjislacionin si dhe intervistimi i pjesëtarëve të sektorëve ligjorë dhe informalë të çdo kontinenti, më ka ndihmuar që ta bëj këtë libër të dobishëm për shumë vende të botës. Në këtë pikë, mund të falënderoj hapur kolegët e katër vendeve ku po punojmë aktualisht. Në Egjipt u jam borxhli miqve dhe homologëve të Qendrës Egjiptiane për Studime Ekonomike, Ahmed Galal, Hisham Fahmy, Taher Helmy dhe Gamal Mubarak, si dhe stafëve të tyre. Sherif El Diwani ka qenë i dobishëm gjatë punës së ILD në Egjipt. Po ashtu ka qenë thelbësore mbështetja e kryeministrit Atef Ebeid, e ministrit të financave Medhat Hasanein, e ministrit të ekonomisë Jousef Butros Ghali dhe e ministrit të çështjeve sociale Mervat El Talawi. Në Haiti, i jam mirënjohës për mbështetjen që na ka dhënë presidentit Rene Preval dhe ish-presidentit Jean Bertrand Aristide, si dhe stafit të tyre. Po ashtu i detyrohem shumë Qendrës për Sipërmarrje të Lirë dhe Demokraci, sidomos Georges Sassine, Lionel Delatour, Bernard Craan dhe Jean Maurice Buteau. Në Meksikë, i detyrohem presidentit të zgjedhur Vicente Fox dhe atyre të cilët më kanë ndihmuar në emër të tij, duke përfshirë Eduardo Sojo, Juan Hernandez, Fausto Alzati, Alfonso Galindo, Emilio Duhau dhe shumë kërkues të tjerë të zgjuar. Në Filipine, ndihma që kemi siguruar nga presidenti Jozeph Estrada dhe Sekretari Ekzekutiv Ronaldo Zamora ka qenë thelbësore për suksesin tonë. Kërkimi ynë është plotësuar falë përpjekjeve dhe mbështetjes së Vic Taylor, së bashku me Ernesto Grialo, Jose P. Leviste, Arturo Alvendia, Alex Melchor dhe shumë të tjerëve.

Dorëshkrimi i këtij libri nuk do të kishte dalë kurrë në dritë pa Iris MacKenzie, e cila ka më ka drejtuar nga pikëpamja gjuhësore e Anglishtes; si lexuese dhe redaktore e parë, qe Iris ajo që më drejtonte gjithmonë për nga qartësia. Dua të falënderoj asistenten time Miriam Gago që më ka ndihmuar ta bëj dorëshkrimin të pëlqyeshëm për shumë botues anembanë botës. Por, në thelb, qe mbikëqyrja e saj efikase mbi jetën dhe shkrimin që më ka lejuar të shpenzoj shumë kohë duke shkruar jashtë zyrës.

Së fundi, dua të falënderoj shumë njerëz të tjerë që më kanë ndihmuar të hedh në letër disa ide të mira. Agjenti im Andrew Wylie ka qenë një burim kryeneç ditorish në lidhje me ngjalljen e interesit për librin nga ana e publikut ndërkombëtar. Ai vendosi një standard të lartë dhe nuk më ka lënë kurrë të bie nën të. Pasi sigurova dorëshkrimin, miqtë e mi David Frum dhe Mirko Lauer u bënë arkitektët e tij; në dhjetë ditë, ata përmbysën tërësisht dorëshkrimin, duke “i nxjerrë shkumën” sipas fjalëve të Frumit, e duke i dhënë strukturën që ka sot. Për ta bërë dorëshkrimin të aftë për të përmbushur kërkesat e botuesve të mundshëm, qeshë me fat që kisha me vete Edward Tivnan. Një gazetar dhe autor, doktratura e të cilit në filozofi e ka familjarizuar me idetë dhe afatet, Tivnan shpenzoi 50 ditë me mua në Lima, duke rishkruar gjithë librin, fjali pas fjalie.

Bill Frucht, redaktori amerikan, ka kryer një punë të mrekullueshme për përgatitjen e librit për botim, duke më ndihmuar të qartësoj shumë pika dhe duke përmirësuar shumë librin. Sally Gaminara ka qenë redaktorja britanike. Talenti i saj redaksional tejkalohet vetëm prej gjenialitetit dhe kreativitetit të saj për botimin dhe promovimin e këtij libri.

Suksesi i produktit përfundimtar ka ardhur për shkak të të sipërpërmendurve. Kufizimet kanë ardhur për shkakun tim.

SHENIME

KREU 1

1. Gordon S. Wood, "Inventing American Capitalism", New York Review of Books (9 qershor 1994), f. 49.

KREU 2

1. Donald J. Pisani, Water, Land and law in the West: The Limits of Public Policy, 1850-1920 (Lawrence: University Press of Kansas, 1996), f. 51.
2. Komente nga arkitekti dhe urbanisti Albert Mangonese në Conjunction, Nr. 119, shkurt-mars 1973, f.11.
3. Leonard J. Rolfes, Jr, "The Struggle for private land Rights in Russia", Economic Reform Today, Nr. 1, 1996, f. 12.

KREU 3

1. Adam Smith, The Wealth of Nations (London: Everyman's Library, 1977), ish Vol. 1, f.242
2. Po aty, f. 295.
3. Simonde de Sismondi, Nouveaux principes d'economic politique (Paris: Calmann-Levy, 1827), f. 81-82.
4. Jean Baptiste Say, Traite d'economie politique, (Paris: Deterville, 1819), Vol. 2, f. 429
5. Karl Marx, Frederick Engels, Collected Works (New York: International Publishers, 1996), Vol. 35, f. 82.
6. Smith, The Wealth of Nations, ish Vol. 1, f. 242.
7. Po aty, f. 286
8. Herbert L. Dreyfus dhe Paul Rabinow, Michel Foucault: Beyond Structuralism and Hermeneutics (Chicago: Harvester, University of Chicago, 1982), f. 211.

9. George A. Miller dhe Philip N. Johnson-Laird, language and perception (Cambridge: Harward University press, 1976), f. 578.
10. Gunnar Heinsohn dhe Otto Steiger, “The Property Theory of Interest and Money”, doreshkrim i pabotuar, draft i dyte, tetor 1998, f. 22.
11. Po aty, f. 43.
12. Po aty, f. 38.
13. Tom Bethell, The Noblest Triumph (New York: St. Martin’s press, 1998), f.9.
14. Fernand Braudel, The Wheels of Commerce (New York: Harper dhe Row, 1982), f. 248.

KREU 4

1. “Survey the Internet”, Economist, 1 korrik 1995, f. 4-5.
2. Jeb Blount, “Latin Trade’, News Finance, 20 janar 1997.
3. Tony Emerson dhe Michael Laris, “Migration”, Newsweek, 4 dhjetor 1995.
4. Henry Boldrick, “Reaching Turkey’s Spontaneous Settlements, “World Bank Policy, prill-qershor 1996.
5. “Solving the Squatter Problem”, Business World, 10 maj 1995
6. Newsweek, 23 mars 1998
7. Economist, 6 qershor 1998
8. Manal El-Batran dhe Ahmed El-Kholei, Gender and Rehousing in Egypt (Cairo: Royal Netherlands Embassy, 1996), f. 24.
9. Gerard Barthelemy, “L’extension des lottissements sauvages a usage populaire en milieu urbain ou Paysans, Villes et Bidonvillesen Haiti: Apercus et reflexions”, qershor 1966, Port-au-Prince, offsprint, qershor 1996.

10. Blount, "Latin Trade".
11. Leonard J. Rolfes, Jr. "The Struggle for Private land Rights in Russia", *Economic Reform Today*, Nr. 1, 1996
12. Revista zyrtare e National Geographic Society (Millennium in Maps), Nr. 4, tetor 1998.
13. Donald Stewart, AIPE, dhjetor 1997.
14. Matt Moffett, "The Amazon jungle Had an Eager Buyer, but Was It for Sale?", *Wall Street Journal*, 30 janar 1997.
15. Simon Fass, *Political Economy in Haiti: The Drama of Survival* (New Brunckweeck, N.J: Transaction Publishers, 1988), f. xxiv-xxv.
16. Ahmed M. Soliman, "Legitimising Informal Housing: Accomodating Low-Income groups in Alexandria, Egypt, "Environment and urbanization, Vol. 8, Nr. 1 (prill 1996), f. 190-191.
17. Reuters, Financial review, 11 maj 1992, f. 45.
18. Mavery Zarembo, *Newsweek*, 7 korrik 1997.
19. *Economist*, 5 mars 1994.
20. *Economist*, 6 maj 1995.
21. Terrenos de Gamarra valen tres veces mas que en el centro de Lima, "El Comercio, 25 prill 1995.
22. Jan de Vries, *Economy of Europe in an Age of Crisis, 1600-1750* (Cambridge: University Press, 1976), D.C. Coleman, *Revisions in Merkantilism* (London: Methuen, 1969); J.H. Clapham, *The Economic Development of Finance and Germany, 1815-1914* ((Cambridge: Cambridge University Press, 1963), Eli Heckscher, *Merkantilism*, ed. E.F. Soderland (London: George Allen & Unwin, 1934).
23. Joseph Reid, *Respuestas al primer cuestionario del ILLD* (Lima:Meca, 1985).
24. D.C. Coleman, *The Economy of England, 1450-1750*, (London: Oxford University Press, 1977), f. 18-19.

25. Po aty, f. 58-59.
26. Heckscher, Merkantilism, Vol. 1, f. 323.
27. Po aty, f. 241.
28. Robert B. Ekelund, Jr., dhe Robert Tollison, Merkantilism as a Rent-Seeking Society (College Station: Texas A&M University Press, 1981), kreu 1.
29. Heckscher, Merkantilism, Vol. 1, f. 239-244.
30. Coleman, The Economy of England, f. 74.
31. Heckscher, Merkantilism, Vol. 1, f. 244.
32. Clapham, Economic Development of Finance and Germany, f. 323-325.
33. Joseph Reid pergjigjet per pyetesorin e dyte ted erguar nga ILD, Typewritten memoranda, ILD Library, 1985; Heckscher, Merkantilism, Vol. 1, f. f. 247-251
34. Charles Wilson, Merkantilism, (London: Routledge & kegan Paul, 1963), f. 27
35. Coleman, The Economy of England, f. 105.

KREU 5

1. Francis S. Philbrick, "Changing Conceptions of Property Law", University of pensilvania law Review, Vol. 86, Maj 1938, f. 691.
2. Bernard Bailyn, The Peopling of British North America: An Introduction (New York, 1986), f. 5.
3. Peter Charles Hoffer, Law and People in Colonial America (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1998), f. 1-2.
4. Po aty, f. xii.
5. David Thomas Konig, "Community Custom and the Common Law: Social Change and the Development of Land Law in Seventeenth-Century Massachusetts," në Land Law and Real Property in American History: Major Historical Interpretations, ed. Kermit Hall (New York: Garland Publishing, 1987), f. 339.

6. Po aty, ff. 319-320.
7. Po aty, f. 320.
8. Po aty, f. 323.
9. Po aty, f. 324.
10. Po aty, f. 349
11. Hoffer, Law and People in Colonial America, f. 15.
12. Amelia C. Ford, Colonial Precedents of Our National Land System as It Existed in 1800 (Philadelphia: Porcupine Press, 1910), ff. 112-113.
13. Po aty, f. 114.
14. Konig, "Community Custom", f. 325.
15. Po aty, f. 325.
16. Aaron Morton Sokolski, Land Tenure and Land Taxation in America (New York: Schalkenbach Foundation, 1957), f. 191.
17. Po aty, f. 191
18. Henry W. Tatter, The Preferential Treatment of Actual Settler in the Primary Disposition of the Vacant Land in the United States to 1841, tema e Ph.D., Northwestern University, 1933, f. 23.
19. Po aty, f. 23
20. Ford, Colonial Precedents, f. 103.
21. Po aty, f. 103
22. Ford, Colonial Precedents, ff. 89-90.
23. Po aty, f. 126.
24. Po aty, f. 126
25. Po aty, f. 128.
26. Po aty, f. 129.
27. Po aty, f. 130.
28. Tatter, The Preferential Treatment, ff. 40-41.
29. Cituar nga Stanley Lebergott, "O' Pioneers': Land Speculation and the Growth of the Midwest," in Essays on

- the Economy of the Old Northwest, ed. David C. Klingman dhe Richard K. Vedder (Athens: Ohio University Press, 1987), f. 39.
30. Ford, Colonial Precedents, f. 119.
 31. Sokolski, Land Tenure, f. 192.
 32. Po aty, f. 193.
 33. Po aty.
 34. Cituar nga Donald J. Pisani, *Water, Land, and Law in the West: The Limits of Policy, 1850-1920* (Lawrence: University Press of Kansas, 1996), f. 51.
 35. Sokolski, Land Tenure, ff. 193-194.
 36. Lebergott, "O' Pioneers," ff. 39-40
 37. Po aty.
 38. Po aty, f. 40.
 39. Dokument XXXIII, Mars 1642, *The Statutes at Large, Being a Collection of All the Laws of Virginia from the First Session of the Legislature*, ed. William Henning (New York, 1823), f. 134.
 40. Richard E. Messick, "A History of Pre-emption Laws in the United States," draft i përgatitur për ILD, f. 7.
 41. Ford, Colonial Precedents, f. 124.
 42. Po aty, f. 124
 43. Po aty, f. 132.
 44. Po aty, f. 134.
 45. An act for Adjusting and Settling the Titles of Claimers to Unpatented Land User the Present and Formers Government, Previous to the Establishment of the Commonwealth's Land Office, *The Statutes at Large: Being a Collection of All the Laws of Virginia*, ed. William Hening (Richmond, 1822), f. 40.
 46. Douglas W. Allen, "Homesteading and Property Rights; ose, "How the West Was Really Won," *Journal of Law and Economics* 34 (Prill 1991), f.6.

47. Richard Current et al., eds., *American History: A Survey*, 7th ed. (New York: Knopf, 1987), f. 149.
48. Terry L. Anderson, "The First Privatization Movement," in *Essays on the Economy of the Old Northwest*, ed. David C. Klingman and Richard K. Vedder (Athens: Ohio University Press, 1987), f.63.
49. Current, *American History*, f. 150.
50. Roy M. Robbins, "Preemption: A Frontier Triumph," *Mississippi Valley Historical Review*, Vol, 18, Dhjetor 1931, ff. 333-334.
51. Po aty.
52. Ford, *Colonial Precedents*, f. 117.
53. Lebergott, "O' Pioneer's", f. 40.
54. Po aty, f. 40.
55. Messick, "A History of Preemption," f. 9.
56. Cituar nga Tatter, *The Preferential Treatment*, ff. 91-92.
57. Messick, "A History of Preemption," f. 10.
58. Dokument i 18 Maj 1796, *Public and General Statutes Passed by the Congress of the United States of America: 1789 to 1827 Inclusive*, ed. Joseph Story (Boston, 1828).
59. Tatter, *The Preferential Treatment*, f. 118.
60. Cituar po aty, f. 125.
61. Patricia Nelson Limerick, *The Legacy of Conquest: The Unbroken Past of the American West* (New York: Norton, 1987), f. 59.
62. Po aty.
63. Po aty, f. 140.
64. Lebergott, "O' Pioneer's", f. 44.
65. Po aty.
66. Po aty.
67. Richard E. Messick, "Rights to Land and American Economic Development," draft i përgatitur për ILLD, f. 44.

68. Richard White, *It's Your Misfortune and None of My Own: A new History of the American West* (Norman: University of Oklahoma Press, 1991), f. 146.
69. Po aty.
70. Edward Farrel Personal Communication.
71. Stephen Schwartz, *From West to East* (New York: Free Press, 1998), ff. 105-110
72. Cituar nga Lebergott, "O' Pioneers," f. 40.
73. Cituar nga Anderson, "The First Privatization Movement," f. 63.
74. Paul W. Gates, *Landlords and Tenants on the Prairie Frontier* (Ithaca: Cornell University Press, 1973), f. 13.
75. Po aty, f. 16.
76. Cituar po aty.
77. Cituar nga Gates, *Landlords and Tenants*, f. 24.
78. Lawrence M. Friedman, *A History of American Law*, botimi i dytë (New York: Simon & Schuster, 1986), ff. 241-242.
79. Cituar nga Frieman, *A History of American Law*, f. 242.
80. Po aty.
81. G. Edward White, *The American Juridical Tradition: Profiles of Leading Judges* (New York: Oxford University Press, 1976), f. 48.
82. Cituar nga Ford, *Colonial Precedents*, f. 129 (nënvizimi im).
83. Gates, *Landlords and Tenants*, f. 27.
84. *Green v. Biddle*, 8 Wheaton 1 (1823).
85. Po aty, f. 33.
86. Po aty, f. 66
87. Gates, *Landlords and Tenants*, f. 37.
88. *Current, American History*, f. 149.
89. Cituar po aty, f. 31.
90. Cituar po aty.

91. Tatter, *The Preferential Treatment*, f. 265.
92. Gates, *Landlords and Tenants*, f. 33.
93. *Bodley v. Gaither*, 19 *Kentucky Reports* 57, 58 (1825).
94. *M’Kinney v. Carrol*, 19 *Kentucky Reports* 96, 97 (1827).
95. White, *It’s Your Misfortune*, f. 139.
96. Gates, *Landlords and Tenants*, f. 46; *Congressional Record*, 43 Congress, Sesion I, 1603 (18 Shkurt 1874).
97. Pisani, *Water, Land, and Law*, f. 63.
98. Tatter, *Preferential Treatment*, f. 154.
99. Gates, *Landlords and Tenants*, f. 44.
100. Paul W. Gates, “California’s Embattled Settlers,” *The California Historical Social Quarterly*, Vol. 41, Qershor 1962, f. 115.
101. Messick, “A History of Preemption,” f. 17.
102. Cituar po aty.
103. Po aty, f. 19.
104. Dokument i 29 Majit, 1830, *Public Statutes at Large of United States of America*, Vol. 4 (Boston, 1846).
105. Dokument i 4 Shtatorit, 1841, *Public Statutes at Large of United States of America*, Vol. 5 (Boston: Little and Brown, 1856).
106. Messick, “A History of Preemption,” f. 26.
107. Pisani, *Water, Land, and Law*, f. 69.
108. Allan G. Bogue, “The Iowa Claims Clubs: Symbol and Substance,” në *The Public Lands: Studies in the History of the Public Domain*, ed. Vernon Carstensen (Madison: University of Wisconsin Press, 1963), f. 47.
109. Pisani, *Water, Land, and Law*, f. 53.
110. Po aty, f. 63.
111. Bogue, “The Iowa Claims Clubs,” f. 51.
112. Po aty, f. 50.
113. Cituar po aty, f. 52.

114. Tatter, The Preferential Treatment, f. 276.
115. Bogue, "The Iowa Claims Clubs," f. 54.
116. White, It's Your Misfortune, f. 141.
117. Tatter, The Preferential Treatment, f. 280.
118. Terry Anderson and P. J. Hill , "An American Experiment in Anarcho-Capitalism: The Not So Wild West," Journal of Libertarian Studies 3 (1979), f. 15.
119. Po aty.
120. Bogue, "The Iowa Claims Clubs," f. 50.
121. Po aty, f. 51.
122. Cituar po aty, f. 54.
123. White, It's Your Misfortune, f. 141.
124. Bogue, "The Iowa Claims Clubs," f. 55.
125. Tatter, The Preferential Treatment, f. 273.
126. Po aty, f. 287.
127. John Q. Lacy, "Historical Overview of the Mining Law: The Miner's Law Becomes Law," " në The Mining Law të 1872 (Washington, D.C.: National Legal Center for the Public Interest, 1984), f. 17.
128. Robert W. Swenson, "Sources and Evolution of American Mining Law," në The American Law of Mining, ed. Matthew Bender (New York: Rocky Mountain Mineral Law Foundation, 1960), f. 19.
129. Gates, "California's Embattled Settlers," f. 100.
130. Harold Krent, "Spontaneous Popular Sovereignty in the United States," draft i përgatitur për Institutin Liri dhe Demokraci, f. 2.
131. Pisani, Water, Land, and Law, f. 52.
132. Limerick, Legacy of Conquest, f. 65; gjithashtu shih White, It's Your Misfortune, f. 147.
133. Pisani, Water, Land, and Law, f. 69.
134. Po aty.

135. Gates, "California's Embattled Settlers," f. 100.
136. Po aty, ff. 22-26.
137. Lacy, "Historical Overview of the Mining Law," f. 26.
138. Cituar nga Charles Howard Shinn, *Mining Camps: A Study in American Frontier Government* (New York: Knoph, 1948), f. 107.
139. *Gre v. McBreyer*, 18 Cal. 582 (1861), cituar po aty, f. 22.
140. Po aty, f. 21.
141. Po aty, ff. 24-25.
142. Cituar po aty, f. 24.
143. Po aty, f. 29.
144. Po aty, f. 30.
145. Po aty.
146. Krent, "Spontaneous Popular Sovereignty in the United States," draft i përgatitur për Institutin Liri dhe Demokraci, f. 3.
147. Lacy, "Historical Overview of the Mining Law," f. 33.
148. 14 Stat. 252 (1866).
149. Swenson, "Sources and Evolution," f. 37.
150. Lacy, "Historical Overview of the Mining Law," f. 36.
151. Cituar nga Krent, "Spontaneous Popular Sovereignty," f. 3.
152. Lacy, "Historical Overview of the Mining Law," ff. 37-38; 17 Stat. 91, 30 U.S.C. 22-42.
153. *Jennison v Kirk*, 98 U.S. 240, 243 (1878).
154. Swenson, "Sources and Evolution," f. 27.
155. Messick, "
156. White, *It's Your Misfortune*, f. 143.
157. Po aty, f. 145.
158. Gordon S. Wood, "Inventing American Capitalism," *New York Review of Books*, 9 Qershor 1994, f. 49.
159. White, *It's Your Misfortune*, f. 270.

160. White, *The American Judicial Tradition*, ff. 48-49.
161. Philbrick, "Changing Conceptions of Property Law," f. 694.

KREU 6

1. C. Reinold Noyes, *The Institution of Property* (New York: Longman's Green, 1936), ff. 2 dhe 13.
2. Për një diskutim aktual dhe të qartë mbi këtë temë, shih William M. Landes dhe Richard A. Posner, "Adjudication as a Private Good," *Journal of Legal Studies*, Vol. 8, Mars 1979, ff. 235-284.
3. Noyes, *The Institution of Poverty*, f. 20.
4. John C. Payne, "In Search of Title," Pjesa 1, *Alabama Law Review*, Vol. 14, No. 1 (1961), f.17.
5. Andrzej Rapaczynski, "The Roles of the States and the Market in Establishing Property Rights," *Journal of Economic Perspectives*, Vol. 10, No. 2, (Pranverë 1996), f. 88.
6. Shih Robert C. Ellickson, *Order Without Law: How Neighbors Settle Disputes* (Cambridge: Harvard University Press, 1991) për një diskutim më interesant se si sistemi ekstralegal sundon mbi marrëdhëniet e pronësisë në Shtete e Bashkuara të Amerikës.
7. Shih Richard A. Posner, "Hegel and Employment at Will: A Comment," *Cardozo Law Review*, Vol. 10, Mars-Prill 1989.
8. Harold J. Berman, *Law and Revolution: The Formation of the Western Legal Tradition* (Cambridge: Harvard University Press, 1983), ff. 555-556.
9. Po aty, f. 557.
10. Robert Cooter dhe Thomas Ulen, *Law and Economics: A Economic Theory of Property* (Reading, Mass.: Addison-

- Wesley, 1997) ,f. 79.
11. Margaret Gruter, *Law and the Mind* (London: Sage, 1991), f. 62.
 12. Bruce L. Benson, *The Enterprise of Law* (San Francisco: Pacific Research Institute for Public Policy, 1990), p. 2.
 13. Per një vlerësim se si organizma informal përpiqen të diplomohen në sektorin formal shih Hernando de Soto, *The Other Path: The Invisible Revolution in the Third World* (New York: Harper & Row, 1989,) veçanërisht Kapitujt 1-4.
 14. Bruno Leoni, *Freedom and the Law* (Los Angeles: Nash, 1972), ff. 10-11.
 15. Shih Robert Sugden, "Spontaneous Order," *Journal of Economic Perspectives*, Vol. 3, No. 4 (Vjeshtë 1989), veçanërisht faqet 93 dhe 94. Shih gjithashtu F.A. Hayek, *Law, legislation, and Liberty*, Volumet 1-3 (London: Routledge dhe Kegan Paul, 1973).
 16. Payne, "In Search of Title," f. 20.
 17. Shih John P. Powelson, *The Story of Land*, (Cambridge, Mass.: Lincoln Institute of Land Policy, 1988).
 18. Richard Pipes, *The Russian Revolution* (New York: Vintage Books, 1991), f. 112.
 19. Samar K. Datta and Jeffery B. Nugent, "Adversary Activities and Per Capita Income Growth," *World Development*, Vol. 14, No. 12 (1986), f. 1458.
 20. S. Rowton Simpson, *Land, Law, and Registration* (London: Cambridge University Press, 1976), f.171.
 21. Peter Stein, *Legal Evolution: The Story of an Idea* (Cambridge: Cambridge University Press, 1980), f. 53.
 22. Po aty, f. 55.
 23. Lynn Holstein, "Review of Bank Experience with Land Titling and Registration," *shkresa, Mars 1993*, f. 9.

24. J.D. McLaughlin dhe S.E. Nichols, "Recourse Management: The Land Administration and Cadastral Systems Component," *Surveying and Mapping*, Vol. 49, No. 2 (1989), f. 84.

KREU 7

1. Lester Thurow, *The Future of Capitalism* (New York: Penguin Books, 1996), f. 5.
2. Hernando de Soto, *The Other Path: The Invisible Revolution in the Third World* (New York: Harper & Row, 1989).
3. "Side Effects of Egypt's Economic Reform Warned," *Xinhua (CNN)*, 4 Shkurt 1999.
4. George F. Will, *The Pursuit of Virtue and Other Tory Notions* (New York: Simon & Schuster, 1982).
5. Klaus Schwab dhe Claude Smadja, "Globalization Needs a Human Face," *International Herald Tribune*, 28 Janar 1999.
6. Tim Padgett, *Newsweek*, 16 Shtator 1996.
7. George Soros, *The Crisis of Global Capitalism: Open Society Endangered* (New York: Public Affairs, 1998), f. xxvii.
8. Eugene Kamenka, ed., *The Portable Marx* (New York: Viking Pinguin, 1993), f. 463.
9. Nancy Birdsall dhe Juan Luis Londono, "Assets in Equality Matters," *American Economic Review* Maj 1997.
10. Kamenka, ed., *The Portable Marx*, f. 447.
11. Karl Marx, "Capital," *Collected Works*, Vol. 28, f. 235.
12. Thomas of Aquinas, *Summa Theologica*, Pjesa I e Pjesës së Dytë, Q. 12., Art. 4 (London: Encyclopaedia Britannica, 1952), p. 672.

13. Ronald H. Coase, "The Nature of the Firm," *Economica*, Nëntor 1937.
14. Margaret Boden, *The Creative Mind* (London: Abacus, 1992), f. 94.
15. Daniel C. Dennett, "Intentionality," në *The Oxford Companion to the Mind*, ed. Richard L. Gregory (Oxford: oxford University Press, 1991), f. 384.
16. John R. Searle, *The Construction of Social Reality* (New York: Free Press, 1995), f. 46.
17. Shih Michel Foucault, *Les Mots et les Choses* (Saint Amand: Gallimond, 1993).
18. Karl Popper, *Knowledge and the Body-Mind Problem* (London: Routledge, 1994).
19. Viviane Forrester, *L'Horreur économique* (Paris: Fayard, 1996), f. 61 (përkhimi im).
20. Karl Marx, në Kamenka, ed., *The Portable Marx*, ff. 444-447.
21. Claude Levi-Straus, *Tristes tropiques* (Paris: Plon, Terre Humaine/Poche, 1996), f. 354.
22. Fareed Zakaria, "The Politics of Port," *Slate Magazine*, Internet, 16 Mars 1999.
Crucial reading regarding the phenomenon of trust and social cooperation is, of course, Francis Fukuyama's *Trust* (New York: Free Press, 1995).

INDEX

Adolfus, Gustavus, mbret i Suedisë, 105

Afrika

asetet dhe kursimet e të varfërve, 5-6

kapitali i vdekur në pasurinë e patundshme, 35 (tabela)

sigurimi i fondeve islamik, 97

Afrika e Jugut, 82-83

sektori ekstraligjor i Zambias, 74

Afrika e Jugut, 82

Agrikultura, 85-86, 212

Shih edhe Programet e reformës agrare

Amerika Latine

asetet dhe kursimet e të varfërve, 6

përpjekjet për kapitalizmin, 3, 226

Brazili, 28, 81, 91, 92

Kolumbia, 2

konsumimi, 226-227

kapitali i vdekur në pasurinë e patundshme, 35

Ekuadori (Guajakili), 73

sektori informal, 74, 79, 80-81, 90

tradita ligjore historike, 80, 138, 185

pavarësia nga Spanja, 4, 226

Meksika, 2, 5, 31, 75, 83, 91

privatizimi, 222

legalizimi i pronave, 182

pakënaqësia e klasës së ulët, 231-234

Venezuela, 2, 28, 92, 231

Shih edhe Haiti; Peruja

Antikapitalizmi

dështimet e kapitalizmit, 1-4, 233

armiqtë e përfaqësimit, 241-243

Aparteidi ligjor, 82, 87-89, 171, 203, 231, 243

kolonial i SHBA, 117-120

Asetet

kthimi në kapital, 7-9, 40, 47-65

tregtueshmëria dhe shkëmbyeshmëria, 58-61, 66, 71,

202, 229, 2338

'jeta' paralele, 7, 39, 63, 65, 66, 68-69

transferueshmëria, 47, 202, 228

vlera e shtuar, 156-157, 238

Asetet e zotëruara nga qeveria

zëna (të) në mënyrë të paligjshme, 31, 74, 82

privatizimi, 2-4, 203, 226

vlera relative, 34, 36

Shih edhe Privatizimin

Avokatët, 70, 200, 213-218

Azia

asetet dhe kursimet e të varfërve, 6

Bangladeshi, rrëzimi i kasolleve, 74

kapitali i vdekur në pasurinë e patundshme, 35 (tabela)

rritja ekonomike, forcat që e ushqejnë, 2-3

Indonezia, 75, 98, 171-172, 231

shih edhe Kinën; Japoninë

Bailyn, Bernard, 117

Bangladeshi, rrëzimi i kasolleve, 74

Banka Botërore, 3, 36, 218

Bankat

qendrore, 67

tregtare, 36, 68, 91, 210

mosbesimi ndaj pengut, 98

- Barthelemy Gerard, 83
- Berman, Harold, 185
- Bethell, Tom, 68
- Birdsall, Nancy, 233
- Bizneset, ekstraligjore, 28-30
 - Brazili, industria e ndërtimit, 81
 - Karaibe, 73
 - Kina, punishtet me krah pune të lirë, 73, 79
 - vështira (të) për t'u lokalizuar, 6-7
 - punësimi në bizneset informale, 28-30, 73, 79
 - sipërmarrësit, 29, 79, 84, 89, 236
 - Haiti, 18
 - industria prodhuese, 98, 102-105
 - Meksika, 29, 83
 - shpenzimet e operimit, 88, 165
 - Peruja, 81, 88, 98
 - Rusia, 74, 79
 - vendet sovjetike, ish, 30, 73
 - punishtet me krah pune të lirë, 73, 74, 79
 - transporti, publik, 29, 74, 84, 95
 - deficiti i kapitalit, 7, 28, 231
 - jokorporative, 6, 7, 165
 - shitësit, 18, 29, 74, 81, 102, 193
 - Venezuela, 28
 - Evropa Perëndimore, 102, 108
 - Zambia, 74
 - Shih edhe* Shpirti Sipërmarrës
- Bizneset, ligjore
 - si sektorë që pajtohet me ligjin, 230
 - pengesat për të hyrë, 18-19, 164-165
 - sektori privat, 31, 34, 36
- Boden, Margaret, 240

Bogue, Allan, 146, 148

Boldrick, Henry, 82

Bota e Dytë, 237

Bota e Tretë

 revolucionit ekonomik (1950), 13, 17

 kolonitë feudale, 226

Shih edhe Vendet në zhvillim

Braudel Fernand, 1, 70-71, 163, 167

Brazili

 popullsia e xhunglës së Amazonave, 91

 biznesi, ekstraligjor, 81

 pasuria e patundshme, ekstraligjore, 28, 91, 92

Britania

 sistemi kapitalist, 226

 ligji i ndërlikuar i tokës, 16, 117, 154, 176

 Revolucioni Industrial, 75, 99, 176

 shekulli i nëntëmbëdhjetë, 226, 227

 regjistrimet e pronësisë, 63, 111, 112, 154

 industria tekstile, 102, 105

Shih edhe kombet perëndimore

Burokracitë për regjistrimet e pronësisë, 64, 70, 111, 165, 197, 229

Shih edhe Organizatat, ekstraligjore

Bursat

 Bursa e Kairos, 36

 në vendet në zhvillim, 36

 Bursa e Limës, 34

 Bursa e Filipineve, 36

 SHBA, 2, 3, 113

Certifikata e pronësisë, 7, 63

Coase, Ronald, 15, 239

Cooter, Robert, 188

Datta, Samar K., 214
 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, 177, 236
 Demsetz, Harold, 68
 Depresioni i Madh, 3, 226
 Deutsche Morgan Grenfell, 81
 Dëftesat e borxheve, 67

Dhoma Tregtare për Bizneset e Vegjël e Qytetit të Meksikos
 (CANACOPE), 83

Egjipti

Aleksandria, 96
 asetet dhe kursimet e të varfërve, 6
 Kajro, 16, 31-32, 34
 Bursa e Kajros, 36
 kapitalizmi, 228-229
 kapitali i vdekur, 16, 252
 pengesat e legalizimit, 19-20, 21-27 (tabela)
 pasuria e patundshme, informale, 16, 32, 34, 96,
 246
 urbanizimi, 73, 83

Ekonomia e dyfishtë. *Shih* Sektori ekstraligjor

Ekonomitë e shkallës, 89, 166

Ekonomia e tregut

avokatët mbrojtës, 230
 supozimet lidhur me popullsinë, 230
 bazuar tek kapitali, 41-42, 66
 tranzicioni evropian drejt saj, 105-106
 dhe sistemi formal i pronësisë, 47, 62, 77, 210
 tregjet e lira, 3, 230
 tregjet e hapura, 2, 69, 229
 mundësia e pabarabartë e përfshirjes, 230-231

- Ekonomitë informale, 10, 73, 227
 Shih edhe Sektori ekstraligjor
- Ekuilibrimi i buxhetit, kombëtar, 1
- Estonia, varfëria relative, 4
- Etika protestante, 243
- Eugen Huber, 186, 202
- Evropa
 Lindore, kapitali i vdekur, 35 (tabela)
 sunduesit e shekullit të nëntëmbëdhjetë, 226
 politikanët e “rrugës së tretë”, 3
 shoqëritë tregtare, 104
 urbanizimi, 98-101
 Perëndimore, sektori informal, 101-108
 Shih edhe vendet individuale;
 Kombet perëndimore
- Fass, Simon, 95
- Fashizmi, si ideologji, 3, 226
- Filipinet
 pasuria e patundshme ekstraligjore, 31, 37
 Sa kapital të vdekur ka?
 Manila, 31-34, 75
 legalizimi i pronësisë, 20, 22-23 (figura)
 urbanizimi, 19, 82
- Fondet e ndihmës për zhvillim, 37
- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), 3
- Ford, Amelia, 120, 123
- Forrester, Viviane, 242
- Forumi Ekonomik Botëror, 232
- Franca, 226
 Sektori informal, 11, 102-103
 Pavarësia e Haitit (1804), 6
 Valenca, 103

- Fujimori, Alberto, 208
 Fushatat e titullarizimit, 212
- Gadhafi, Mu'ammar, 97
 Garancia për investimet, 52
 Garcia, Alan, 208
 Gates, Bill, 243-244
 Gates, Pol, 136
 Globalizimi
 - aparteidi/ekskluziviteti, 225-230, 243
 - supozimet, 228-230
 - i kapitalizmit, 204, 225-246
 - shkaqet, 207
 - ndërvarësitë, 74
 - politikat makroekonomike, 69, 110, 178, 229
 - Shih edhe Konsumizmi; Tregu
- Gore kundër McBreyer*, 154
Grin kundër Bidëll (1823), 140
 Grumbullimi i borxheve, 7, 52
 Grumbullimi i kapitalit
 - “primitiv”, 56, 236
 - dhe specializimi, 41, 42
- Grumbullimi i taksave, 7, 52, 63, 103, 210
 Gruter, Margaret, 188
 Guajakili (Ekuador), 73
 Guerrero, Antonio Montiel, 83
- Gjeorgjia, sektori ekstraligjor, 74
 Gjermania
 - sektori ekstraligjor, 106
 - regjistrat e pronësive, 55, 194
 - drejtat (të) universale të pronësisë, 202

Gjykata e Lartë e Kalifornisë, 154
Gjykata e Lartë e SHBA, 143-145, 154, 157

Haga, Konventa Ndërkombëtare (1899), 177

Haiti

asetet dhe kursimet e të varfërve, 6
bizneset, ekstraligjore, 18
pavarësia nga Franca, 6
pengesat e legalizimit, 20, 26 (figura)
Port-au-Prince, 18, 31-34, 73, 251 (figura)
dokumentet e të drejtave të pronësisë, 198
pasuria e patundshme, ekstraligjore, 24, 31, 83-84,
251-253 (figura)
pasuria e patundshme, informale, vlera, 33-34, 92
qytetet-kasolle, 18, 29, 38, 82, 92
urbanizimi, 73-74, 83

Heinsohn, Gunnar, 67

Heksher, Eli, 101-102

Hipotekat, 16, 65, 210

Historia/regjistrimet e kreditit

asetet si peng, 7, 39, 52, 63, 89
humbja e anonimitetit, 56

Historia e Tokës (Powelson), 200

Holanda, shekulli i nëntëmbëdhjetë, 226

Holmes, Oliver Wendel, 115, 163

Homestead, Akti, SHBA (1862), 114, 158

India

Bombai, 75, 98

Kalkuta, rritja, 78

Delhi, rritja, 78

- Indonezia
 përballja mes klasave, 231
 sektori ekstraligjor, 172
 dhe revolucioni industrial, i ri, 75, 97
- Industritë shtëpiake, 29, 244
- Informacioni në lidhje me pronën
 shërbimet e përshkrimit të asetëve, 14, 60, 64-65
 integruar (i), 53, 172, 175
 standardizuar (i), 54, 58, 175, 195
 i disponueshëm për të gjithë, 54, 64
- Infrastruktura, urbane
 ndërtuar nga banorët, 95
 kombet perëndimore, 221
Shih edhe shërbimet, publike
- Institucionet
 përshtatja, 75
 papërshtatshëm (të), 78
 ligjore, të kuptuarit e tyre, 70
 protestat kundra tyre, 3
 përparuara (të), 78
- Instituti Meksikan i Statistikave Kombëtare, 29
- Instituti për Liri dhe Demokraci, 171
- Integrimi i informacionit, 112
Shih edhe Informacioni në lidhje me pronën
- Investimet e huaja direkte, vlera përkatëse, 6, 34, 36, 37, 91
- Investitorët e huaj
 zhdukja gjatë krizave ekonomike, 3
 promovimi, 1, 229-230
 lidhjet e brendshme, 71
 shoqëritë shumëkombëshe, 234
 zotërimi i kapitalit, 71

Investimet

- arsimore, 82, 194, 210
- prodhimi i tyre, 64, 229

Investitorët, lokalë

- zotërimi i kapitalit, 72
- Shih edhe* Investitorët e huaj

Irani, përballja mes klasave, 231

Jackson, Andrew, 142

Japonia

- historia ekonomike, 3-4
- sistemi i integruar i pronësisë, 55, 113, 116
- regjistrimet e pronësisë, 112, 164-165
- Tokjo, zgjerimi urban, 78

Jefferson, Thomas, 138, 202

Jennison kundër Kirk, 157

Kajro

- kapitali i vdekur, 16
- pasuria e patundshme ekstraligjore³¹⁻³², 34

Kalifornia

- Baja, varfëria relative, 4
- suksesi ekonomik, 4
- mësymja për arin, 145-158
- Los Anxhelos, zgjerimi urban, 78
- juridiksioni pronësor (1849), 55

Kambana e qelqit, së brendshmi

- Braudel, citate, 1, 70-71
- avokatët, 204, 213-218
- opinionet mbi kulturën, 243-246
- privilegjuarit (të) e paktë, 70-71, 163, 203-204, 225, 231, 243, 247

Kambana e qelqit, së jashtmi, 79-98, 229, 230

Kanadaja, pronësia formale, 178

Kapitali

përkufizimi, 41

prodhimi dhe përdorimi efikas, 227

në duart e pakicës, 73, 225, 231, 233, 248

si “qënie të pavarura”, 234

kapshëm (i) për mendjen, 237-241

misteret, 12-13

lidhja me paratë, 12, 43-44

si burim pasurie, 41-42, 70

Shih edhe Kapitali i Vdekur; Vlera e shtuar

Kapitali i vdekur

potenciali i aseteve, i perealizuar, 7, 33, 81, 209, 229-230, 247-248

asetet, pakonvertueshmëria, 7, 37, 48-49

shkëmbimi i aseteve, informal, 7, 20, 28, 75-76, 228-229

gjenerimi i kapitalit, paaftësia, 6, 33, 37, 77-78, 228-229

procesi i kapitalizimit, 173-175

pengu për të marrë hua, 7, 98, 165

bota, në pasuri të patundshme, 35 (tabela), 251-253)

Shih edhe Sektori ekstraligjor

Kapitalizmi

si regjim aparteid, 73, 227, 243, 248

kontradikta (Marksii), 230

në krizë, 1-3, 9, 225, 226-230

aspektet kulturore, 10, 243-247

lëngu jetësor *Shih* Kapitali

shekulli i nëntëmbëdhjetë, 225-226

kundërshtarët *Shih* Antikapitalizmi

të vepruarit në nivelin e të pandërgjegjshmes, 69

Shih edhe Vendet në zhvillim,

kapitalizmi në to; Globalizimi

Karaibet, sektori informal, 73

Kartat e kreditit, 243

Kina

Pekini, 73, 79

kapitali i vdekur në pasurinë e patundshme, 35

reformat e Ten Hsiao Pin, 73

sektori ekstraligjor, 73, 79, 82

varfëria relative, 4

urbanizimi, 18, 73, 82

Kombet e Bashkuara (KB)

ndihma e huaj e rekomanduar, 6

“Raporti i Zhvillimit Njerëzor”, 233

Kombet perëndimore

kapitali, i përdorur në mënyrë efikase, 227

imigrimet masive, 4, 78, 99-102

reformat e ligjit të pronësisë, 115, 176, 184-187, 201

sistemet e të drejtave të pronësisë, 46-49, 53, 186, 234, 237

Shih edhe Evropa; Revolucionin Industrial

Kompanitë e Sigurimit, 63, 210

Kompjuterët

dhe pronësia e prejardhur, 243

teknologjia e identifikimit në hartë, 167, 218-221

për regjistrimin e pronësive, 166, 167, 168, 182

Komunizmi, si ideologji, 226

Konig, David Thomas, 119

Konkurrenca, biznesi, në Evropën Perëndimore, 102-103, 106

Kontratat sociale

baza për të drejtat e pronësisë, 241, 244, 246

rrokja e tyre nga qeveria, 193, 248

kombëtare, 167-169, 171, 186, 187, 193, 219, 237

Kontratat sociale, ekstraligjore, 167-186

vendet në zhvillim, 29, 90-91, 110, 161-162, 172

aspektet e pafavorshme, 195

- konceptet e gabuara lidhur me to, 164
- kombet perëndimore, 111
- Kultura, dhe kapitalizmi, 4-5, 10, 243-246
- Kushtetuta, SHBA, 132
- Konsumizmi, i shembullit të perëndimit, 2, 70, 226-227
 - filiale të *fast-food*-eve, 2, 227
 - Interneti, 2, 227
 - atletet Nike dhe orët Casio, 225
 - filialet e videotekave, 2, 70
- Koncepti i klasës, 230
- Konfliktet e klasave, 230, 231-232
- Kontabilitet, individual,
 - sektori ekstraligjor, 228-230
 - sistemet formale të pronësisë, 53, 56-58, 61
- Kontrolli i inflacionit, 226
- Kostoja e transaksioneve, reduktimi, 60, 239
- Krijimi i kapitalit
 - agjentët njerëzorë, 213-214
 - ndërlidhur (i) me të drejtat e pronësisë, 7, 47-48, 160, 195, 234-235, 237, 241
 - paaftësia joperëndimore për të krijuar kapital, 5, 37, 40
- Kursimet
 - asetet e të varfërve, 6, 13, 48-49
 - rekomandimet, 247-248
- Largimi i kapitalit, 10, 228
- L'Horreur economique* (Forrester), 4, 241
- Libia, titujt fisnor të tokave⁹⁷
- Ligji i pronësisë
 - funksionet dhe përbërësit, 167-172, 193-194
 - mandativ, dështimi, 177-184
 - Shih edhe* Sistemet ligjore

Ligji për zotërimin e pafavorshëm, 141

Ligji Metcalfe, 76

Lindja e Mesme

asetet dhe kursimet e të varfërve, 6

kapitali i vdekur në pasurinë e patundshme 35

njohja historike e tregut, 5

Kanali i Suezit dhe Diga Asuan, 6

Shih edhe Egjipti

Lufta Meksikano-Amerikane (1848), 128, 133

Lufta Civile, 2, 155

Lufta II Botërore pasojat, 85-86, 166

Londonjo, Huan Luis, 233

Luminoso, Sendero, 36

Malajzia, kapitalizmi në krizë, 3

Manila, 30-32, 34, 75

Marks, Karl, 12

konceptet e paparashikuara, 69, 230, 234-235

mbi trashendencën e asetit, 43, 233-234

mbi grumbullimin e kapitalit, 41-42

mbi konfliktin mes klasave, 231-232

mbi sistemet e përfaqësimit, 242

mbi vlerën e shtuar, 236

Mbrojtja e patentës, 5, 74, 89, 214, 244

Megaqytetet, 75

Meksika

sektori ekstraligjor, 29, 83, 92

GDP - prodhimi i përgjithshëm vendor, 83

njohja historike e tregut, 4-5

shqetësimi shoqëror, 2

Menaxhimi i riskut

mekanizmat e sigurimit, 63-64, 244

- sistemet e përgjegjesisë së kufizuar, 244
- asetet e mbledhura , 63
- Mesatarja industriale Dow Jones, 2, 113
- Metcalfë, Bob, 76
- Milicisë, 2
- Milkin, Michael, 8
- Miller, George, 67
- Miqtë e Tokës, 111
- Modernizmi, 19, 85, 87, 202
- Modeli parakapitalist
 - shkërmoqja e shoqërisë, 109
 - fiksimi i çmimeve, pagave, të ardhurave, 104, 189-190
 - ligji i “grykimeve primitive”, 176
- Mohamad, Mahathir, 2
- Monedha, kartëmonedha, krijimi, 67, 242
- Muri i Berlinit, rënia, 1

- “Natyra e Firmës” (Coase), 239
- Normat e këmbimit, 247
- Noyes, C. Reinold, 168, 175
- Nugent, Jefferey, 214

- Opsionet për shpërndarje të aksionit, 244
- Organizata Botërore e Punës, 73, 177
- Organizata Botërore e Tregtisë (OBT), 3, 201
- Organizatave Mafioze, 10, 165, 170, 228, 247
- Organizatave, sektori informal
 - vendet në zhvillim, 92-95, 159, 180, 187-189
 - llojet, të listuara, 92-93
 - shoqëritë e pretendimeve në SHBA, 145-151
 - organizatave e minierave në SHBA, 145-146, 149-158
- Orientimi ndaj tregut , 4

Pabarazitë

- vendet në zhvillim, 10, 227-229
- apartheidi ekonomik, 73, 227, 231, 243, 248

Pabarazitë, shkaqet

- gjuha e shkruar, 242
- ligjet e shkruara, 228-229

Pagat, 76, 86, 90

Paine, John C., 176, 196

Paqëndrueshmëria politike, 2, 10, 228

Paraja, 67, 242-243

- monedha, origjina e saj, 62, 242
- prejardhur (e), 242-243
- ndërkombëtare, parajsa e tyre, 3
- joinflacioniste, 68
- presupozimi i pronësisë, 67
- lidhja me kapitalin, 12, 44-45, 66
- Shih edhe* Monedha

Pasojat e Luftës së Ftohtë, 1-2, 69

Pasuria

- krijimi, 41-42, 69-70
- pabarazia, 4, 10
- dhe prodhueshmëria, 41-42, 227
- në kursimet e të varfërve, 6, 13, 32, 33, 38, 48-49
- virtuale, 238
- Shih edhe* Vera shtesë

Pasuria e kombeve, 42, 227

Pasuria e patundshme, ekstraligjore, 30-36

- favelas*-et braziliane, 28, 90, 91, 246, 251 (figura)
- Kina, 82
- ndërtimi i saj, 82, 209
- Egjipti, 6, 20, 34, 36, 96
- Haiti, 26 (figura), 30, 34, 83, 251 (figura)
- Indonezia, 171-172

- Meksika, 83, 92
 strehimi i ushtarakëve, 190
 Peruja, 32, 34, 81, 92, 178, 246
 Filipinet, 33, 36, 82
 Afrika e Jugut, 82
 Suedia, 105
 Shtetet e Bashkuara, 10, 11, 16-17, 110-159
ranchos-et venezuelase, 92
 Evropa Perëndimore, ‘periferitë’, 101-105
Shih edhe Kapitali i vdekur; Qytetet-kasolle; Zaptuesit e tokave
 Pasuria nga Investimet, 63, 70, 91
 Pekini, fluksi i ardhjeve të migruesve, 72, 82
 Pengu hipotekar, 6-7, 242
 Peruja
 kooperativat bujqësore, 32
 Keçuat e Andeve, 246
 konfiskimi i asetëve, 180
 bizneset, ekstraligjore, 83, 89, 98
 legalizimi i bizneseve, 19-20, 164-166, 204
 Gamarra, 98
 ligji historik i tokës, 155
 Lima, 31-32, 34, 98, 204-205
 Bursa e Limës, 34
 pronësia, ekstraligjore, 31, 33-34, 35, 81, 90-91, 180-181, 246
 pronësia, ekstraligjore, vlera, 34, 93
 legalizimi i pronësisë, 19-20, 21 (figura), 32, 204-205, 208-209 (figura), 246
 formalizimi i sistemit të pronësisë, 205-211
 qytetet-kasolle, 204
 Organizata e Vlerësimeve Teknike, 98

Përforcimi

- varura (të) nga adresat, 62
- jo efektive, 183
- për detyrimet hipotekare, 64
- shërbimet e policisë, 211-212

Përshkrimi i asetëve. *Shih* Informacioni në lidhje me pronën
Pipes, Richard, 212

Pisani, Donald, 144, 150

Pluralizmi ligjor, 55, 138, 189

Polanyi, Karl, 3

Politikëbërësit

- reformatorët ekonomikë, 230
- kryetarët e shteteve, 204, 208
- përzgjedhja e avokatëve, 216-217
- ruajtja e status quo-së, 90, 201, 211, 217-218, 221, 228-230, 232

Shih edhe Qeveritë

Port-au-Prince

- në sondazhin e qytetit, 31-32
- transaksionet e pasurisë së patundshme, 32
- urbanizimi, 18, 73
- vlera e pasurisë së patundshme, 33-34

Potenciali i asetëve, 45-46

- Fiksimi i potencialit të asetëve, 43, 46, 47-48
- situatat e simuluara, 60-61
- padokumentuar (i), 7, 33, 81, 205, 230, 247-248

Powelson, John P., 200

Praktika e lënies në trashëgimi me kusht mostjetërsimi, 202

Privatizimi, 2, 4, 206, 222

Produktiviteti

- kapitali dhe produktiviteti, 42, 227
- pengesat, 87, 109

- Produktiviteti, faktorët e rritjes
 të drejtat e pronësisë formale, 79, 230-232
 specializimi, 42-43, 75
 tregtia, 42
- Pronësia
 ndërmjetëse mes kapitalit dhe parave, 63-64
 koncepti, 50-51
 prejardhur (e), 242
Shih edhe Sistemet e përfaqësimit
- Programet e reformës agrare, 84, 85, 179-180, 236-238
- Programet e vogla të financimeve, 74
- Qendra për Studimet Ekonomike të Sektorit Privat
 (CPSES), 83
- Qeveritë
 pranimit i sektorit ekstraligjor, 88, 95-96, 189-191, 236
 administrimi i zhvillimit, 77
 pikat e pakuptuara, 78-79, 80-99
 ryshfetet/komisionet, 88, 104, 107, 166
 centralizimi i pushtetit, 86
 korruptuara (të), 107, 165
 në tranzicion ekonomik, 168-169
 shërbimet informative, 231
 programet e vogla të financimeve, 74
 konceptet e gabuara, 164
 agjencitë publike, 64, 188, 198
 rekomandimet, 80, 168-172, 180-181, 247-248
 nënkapaciteti, 92-93
Shih edhe Asetet e zotëruara nga qeveria; Politikëbërësit
- Qyteti i Meksikos, 29, 31-32, 75

Qytetet-kasolle

Bangladeshi, 74

Haiti, 18, 83, 92

në tokat e qeverisë, 32, 73, 83

Peruja, 205

Turqia, 82

Shih edhe pasuria e patundshme, ekstraligjore

Rapaczynski Andrzej, 182

Raporti i Zhvillimit Njerëzor (KB), 232

Reformat ekonomike

të Ten Hsiao Pin, 73

ekonomitë e hapura, 229, 248

Shih edhe Globalizimi

Regjistrimet e pronësisë

dokumentet e reformës agrare, 237

baza e infrastrukturës, 7, 52-53

britanike, 63, 111, 112, 154

zinxhiri i titujve, 199

ekstraligjore, 198, 201

funksionet, 47-48

papërshtatshme (të), 6-7, 178-179

japoneze, 111, 166

konceptet e gabuara lidhur me to, 163

Revolucioni Amerikan, 121, 125, 133

Revolucioni Francez, 106, 108, 211

Revolucioni Industrial, 41, 75, 80, 109, 176

Revolucioni industrial, i ri

dhe megaqytetet, 75

me urbanizimin, 13, 17-18, 74-75, 78, 92

Revolucioni i komunikacioneve, 84, 194, 222-223, 227

Revolucioni pronësor

pajtimi i elitës, 206-209, 213

detyrat e udhëheqësve, 204

- dëshira e popullit për një revolucion pronësor, 205
- roli i avokatëve, 213-218
- Revolucioni Rus, 106, 211, 226
- Ristrukturimi i borxheve, 226
- Robert Ekelund, 104
- Rusia
 - kapitalizmi në krizë, 2
 - sektori joformal, 30, 73, 79, 226
 - PPB-prodhimi i përgjithshëm bruto, 79, 88, 226
 - zotërimi i tokave, 30
 - jetëgjatësia, ulja, 234
- Rregullat e pagave, 104, 108
- Rritja ekonomike
 - në Azi, forca që e ushqen, 2
 - strategjitë e inputeve/outputeve, 238-239
 - dhe sistemi i integruar i pronësisë, 54, 170
 - efekti i avokatëve, 213
- Rrjetet
 - financiare, 61-63, 72
 - organizative, 77
- Rrotat e Tregtisë* (Braudel), 1
- Schumpeter, Jozeph, 68
- Schwab, Klaus, 232
- Sektori informal
 - tregjet e zeza, 11, 30, 80, 134
 - rritja progresive, 192
 - pranimi nga qeveria, 88-89, 191-192, 236-237
 - strehimi. *Shih* pasuria e patundshme, ekstraligjore varfëruar (i), 95, 231
 - normal, jo margjinal, 30, 92

- pengesat e legalizimit, 19-20, 32, 48, 179
- strehuar zyrtarisht, 54, 109, 112-114, 122, 126-128, 231-232
- tranzicioni, 112, 164-165, 168-171
- ekonomitë informale, 10, 73, 227-228
- Shih edhe Bizneset, ekstraligjore; Zaptuesit e tokave; Urbanizimi
- Spektori i kriminalitetit
 - trafikanët e drogës, 2, 74, 212-213
 - gangsterët, 30, 74, 113, 193, 212
 - organizatat mafioze, 10, 165, 170, 228, 247
 - kontrabandistët, 103
- Senegali, qyteti i Tubës, 97
- Simpson, S. Rowton, 215
- Smith, Adam, 11
 - dhe tregjet e zeza, 11
 - konceptet e paparashikuara, 43, 69
 - mbi konkurrencën në biznes, 102-104
 - mbi kapitalin, 41-42, 233
 - mbi ndarjen e punës, 42, 76
- Sistemi bankar
 - roli i pronësisë, 66
 - transparenca e praktikave, 4
- Sistemet ligjore
 - korruptuara (të), 105-108
 - shpërfillura (të) në mënyrë flagrante, 10, 125, 228
 - kundërshtia ndaj emigrantëve, 87
 - ndërkombëtare, 177
 - përballimi i shpenzimeve të avokatëve, 72
 - dhe krijimi i rrjetit, 76
 - rindërtimi i rekomanduar, 80, 248
 - romak, 55, 65, 186, 189, 195, 216
 - tranzicioni drejt tyre, 161-162, 171-172, 175-176, 195-203, 228-230

- bota perëndimore, 236
- Shih edhe* Ligji i pronësisë
- Sistemet ligjore, ekstraligjore
 - deshifrimi/studimi, 195, 202
 - vendet në zhvillim, 64, 77, 84, 90, 100, 181, 185-187
 - “ligji i njerëzve”, 172, 187, 202
 - SHBA, 137, 146, 156
 - Shih edhe* Organizatat, ekstraligjore; Kontratat sociale, ekstraligjore
- Sistemi monetar, 67
- Sistemi pronësor i SHBA, 111-162
 - konfliktet, 10-11, 16-17, 116-117, 135-136
 - sistemi formal, 54-55, 112, 242-243, 245
 - Akti Homestead, 114, 158
 - integruar (i), 53-54, 155-158
 - juridiksionet (1849), 55, 151-153
 - ligjet e zotërimit, 137-138, 140, 151
 - statuti i parablerjes, 126-127, 150
 - Shih edhe* Organizatat, ekstraligjore; Sistemet e pronësisë, formale
- Sistemet e pronësisë, formale, 225-237, 243-247
 - mbrojtja e aseteve/pronësisë, 47, 72, 166
 - dhe krijimi i kapitalit, 7, 11, 33, 43, 65, 234-235, 237, 241
 - konkretizuara (të) për të privilegjuarit, 70, 230-231, 233
 - konstitucionale, 177, 178, 236
 - aspektet kulturore, 243-247
 - kontratat imponuese, 57-58, 62, 214, 244
 - çfarë përfshijnë, 234-243
 - integruara (të), 53, 155-162
 - humbja e anonimitetit, 56-58, 187
 - mbrojtja politike e tyre, 202-222
 - dhe regjistrimet e pronësisë, 8, 47-48, 245

- rekomandimet, 79-80, 247-248
- dhe vendosja e normave të këmbimit, 247
- gjashtë efektet e tyre, 50-65
- tranzicioni drejt tyre, 176-177, 185-187
- Shih edhe* Revolucioni pronësor; sistemi pronësor i SHBA
- Sistemet e regjistrimit të asetëve, 47-48
 - shërbimet e përshkrimit, 64-65
 - të mishëruara tek titulli, 47, 51
 - standardet operative, 47, 65
- Sistemet përfaqësimit
 - jo të pranishme në vendet në zhvillim, 6-8
 - shkëputja nga objekti, 50, 52, 59
 - Greke/Romake, 244
 - integrimi i informacionit, 53-54
 - kundërshtarët, 241-243
 - mjetet e planifikimit strategjik , 60-61
 - automjetet e përdorura për vjedhje, 235-236
 - dokumentacioni perëndimor, 7-8
 - gjuha e shkruar, 242
- Sistemet e titujve, 63, 178-179, 182-183
 - aspektet teknike, 210, 213-215
- Soros, George, 233
- Sovraniteti popullor, 56
- Spanja
 - pavarësia e Amerikës Latine (1820), 4, 226
 - shekulli i nëntëmbëdhjetë, 225-226
- Specializimi
 - mbështetja kapitaliste për specializimin, 42, 227
 - ndarja e punës, 66, 76, 80
 - rritja e prodhueshmërisë, 42
- Stabilizimi i monedhës, 4, 69, 204, 229
- Steiger, Otto, 68

- Stewart, Donald, 91
- Stori, Jozeph, 11, 137
- Suedia, sektori ekstraligjor, 105
- Shekulli i njëzetë
- sfidat ndaj kapitalizmit, 3, 4, 226
 - vendet e mëdha kapitaliste, 226
- Shërbimet, publike
- varura (të) nga adresat, 52, 62, 210
 - krijimi, 7, 210
 - përfshirja e qeverisë në to, 63, 183
 - papërshtatshme (të), 18, 58-59, 77-78, 82
 - sistemet e higjienës publike, 18, 77-78, 198
 - humbjet teknike/financiare, 62
 - vjedhja e shërbimeve, 8, 29, 62, 74
- Shinn, Charles Howard, 153
- Shkëmbimi i Aseteve
- bazuar në kapital, 41, 227-228, 234
 - ekstraligjor, 7, 75, 89-90, 180-181
 - parakapitalist, 195-196
 - amullt (i), sforcuar (i), 33
 - tregtia e pretendimeve të tokave, 148-149
 - Shih edhe* Transaksionet
- Shpirti sipërmarrës
- blloku komunist, ish, 4
 - i të varfërve, 32, 36
 - Bota e Tretë, 4, 30, 37, 88, 90, 92
 - Perëndimor, 11, 75
 - Evropa Perëndimore, 106, 109
 - Shih edhe* Bizneset, ekstraligjore

Shqetësimi shoqëror

- mosbindja civile, 102, 104, 247
- konflikti i klasave, 231, 232
- konfliktet etnike dhe kulturore, 232
- protestat me domate, 4
- FMN/Banka Botërore, protestat kundra tyre, 3
- paqëndrueshmëria, 2
- e nivelit ndërkombëtar, 232
- agjikatorët politikë, 3, 73, 232
- lëvizjet revolucionare, 108
- OBT, protestat kundër saj (Siatëll), 3

Shtetet e Bashkuara (SHBA)

- ligji britanik i tokës, 16, 117-123, 126-127, 154-155
- Kalifornia, 4, 55, 78, 145-159
- vend kapitalist, 13, 226
- rritja ekonomike, 55
- valët e imigrimit, 114, 117
- marrja e tokave, masive, 128-129
- politikat e “kuponëve tokësorë”, 133-134
- Midwest, 145-151
- Urdhëresat Veriperëndimore, 129-130
- masa e rritjes së popullsisë, 140
- hekurudha, ndërkontinentale, 134-135
- pasuria e patundshme, ekstraligjore, 10-11, 17-18, 111-117
- bursat, 2
- urbanizimi, 77-78
- Shih edhe* Zaptuesit e tokave, SHBA; kombet perëndimore

Taksat, nga firmat e legalizuara, 165, 166

Teknologjia

- dhe sistemet formale të pronësisë, 76-77
- zotësia e jo perëndimorëve, 5, 7, 17, 92

- Teknologjia e armëve, 5
- Ten Hsiao Pin, 73
- Të drejtat e pronësisë
 trashëgimia, 60, 244
 pengesat drejt legalizimit, 19-21, 32, 48, 179
 kontrata sociale si bazë, 184, 241, 244, 246
 aksesit universal, 178, 202
Shih edhe Sektori ekstraligjor; Ligji i pronësisë
- Titujt
 dokumentet formalë, 51, 60, 64, 67-68, 193-197
 dokumentet informalë, 198, 199 (figura)
- Tollison, Robert, 103
- Trafikantët e drogës, 2, 74, 212-213
- Transaksionet
 mbrojtja, 64
Shih edhe Shkëmbimi i asetëve
- Transaksionet, ekstraligjore
 aspektet e pafavorshme, 48, 75, 93, 168
 informale, ad hoc, 33, 75
 llojet, të listuara, 93-94
 jo të imponueshme, 16, 93
- Trashëgimia, 60, 117, 202, 244
- Tregtia, 17, 100-101, 105-106, 227-228
- Tregtia, ndërkombëtare
 shkak i urbanizimit, 85, 97
 liberalizimi, 226
 dhe rritja e produktivitetit, 42
 rregulloret, hartimi, 214
 ilaçi për krizat ekonomike, 4
 kontrabandistët, 103
 barrierat tarifore, 1

Tregjet e mallrave, shkëmbimet e Çikagos, 65

Tregjet, pronësia, 53-55

Triumfi më fisnik (Bethell), 68

Turqia

tërmeti (1999), 74

urbanizimi, dhe *gececondus-i*, 82

Themelimi i kreditit, 67

Thurow, Lester, 226

Ukraina, sektori ekstraligjor, 73

Ulen, Thomas, 188

Urbanizimi, 82-98

shkaqet, 84

Kina, 18, 73, 82

Ekuadori, 73

Egjipti, 73, 83

Evropa, 99-101

Haiti, 73, 83

India, 78

Filipinet, 19, 73

mosndërgjegjësimi politik për urbanizimin, 13

Afrika e Jugut, 82

blloku sovjetik, ish, 90

Turqia, 82

Shtetet e Bashkuara (SHBA), 78

Varfëria

lehtësimi i saj, 80

masa e zgjerimit, 233-234

“ndërkombëtare”, 37

niveli “normal”, 79-81

- “numërohen me gishta”, 231
 relative, 5
 pakënaqësia e klasës së ulët, 232-234
- Varfrit (të)
 asetet e konfiskuara, 180, 181
 asetet dhe kursimet, 6, 13, 48-49, 183, 247
 procesi i kapitalizimit, 203-204
 dhe koncepti i klasave, 230, 232-233
 kontaktet e bashkëpunimit, 205, 208
 kontrolli i tregtisë, 30
 marzhinalizimi i tyre, 69-70, 80-81
 perspektiva e tyre, 204-208
 varfëria relative, 28-31, 231
 si zgjidhje për problemin e kapitalit, 38, 247
 aftësia teknologjike, 5, 8, 17
 potenciali i padokumentuar, 8, 33, 92, 206, 227, 247
 vlera e pronësisë ekstraligjore, 30-32, 48-49
Shih edhe Sektori ekstraligjor; Varfëria
- Vargas Llosa, Mario, 206
- Vendet komuniste (ish), krahasuar me Amerikën Latine, 227
 kriza në kapitalizëm, 1, 225
 shpirti sipërmarrës, 4
 Estonia, varfëria relative, 4
 sektori informal, 29, 74, 88, 90
 Gjeorgjia, 73
 rënia e sistemit të pronësisë, 88
 Rusia, 1, 30, 73, 87, 226
 Ukraina, 74
 urbanizimi, 87
Shih edhe Vendet në zhvillim

Vendet në zhvillim

- konfiskimi i aseteve, 179-180, 212, 234-235
- elitat, 178-179, 208, 209, 2109, 216, 225, 227, 231
- pabarazi të flakta, 10, 230
- shpërndarja e të ardhurave, 233
- revolucionit industrial, i ri, 13, 17-18, 74, 92
- normat e vdekshmërisë foshnjore, 18, 85
- jetëgjatësia, 18, 234
- subvencionimi, rënia, 1
- anketat në qytete, 31-32
- deficiti i kapitalit, 7, 28, 231
- vlera e pasurisë së patundshme ekstraligjore, 37
- Shih edhe Kapitali i vdekur
 - Sektori informal
 - Urbanizimi

Vendet në Zhvillim, kapitalizmi

- kapitali, i përdorur në mënyrë efikase, 80, 227
- aspektet kulturore, 4-5, 10, 243-246
- modernizimi ekonomik, 1
- fondet e tregjeve në zhvillim, 3
- investitorët e huaj, 1, 4, 72, 230
- statusi periferik, 226
- sektori privat, 31, 34, 36
- nxitësit, 229, 230
- Shih edhe Investitorët e huaj;
- Globalizimi

Venezuela

- kapitalizmi në krizë, 1
- përballja mes klasave, 230
- sektori ekstraligjor, 28-29, 90

- Vlera e shtuar, baza e kapitalit, 41-42, 236
konvertimit të aseteve, 46
sistemit të pronësisë, 49, 52, 72, 76, 78, 228
sistemeve të përfaqësimit, 168
- Washington, George, 10, 12, 124-125, 128, 130
White, Edward, 160
Wood, Gordon, 11, 159
- Zakaria, Fareed, 245
Zambia, sektori ekstraligjor, 74
Zaptuesit e tokave
vendet në zhvillim, 91, 167, 188-190, 212
strehimi zyrtar i tyre, 74, 187-188, 191
Afrika e Jugut, 82
SHBA, 16, 55, 114, 120-126, 128-146
dhe ligjet e SHBA për zotërimin , 138-139, 145-146
Zvicra, 4, 56, 186, 202
Zyra e Përgjithshme e Tokës, SHBA, 132-133, 151